

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË

INSTITUTI I GJUHËSISË
DHE I LETËRSISË

STUDIME FILOLOGJIKE

2
LXXVIII (LXII)
2025
TIRANË

BORDI EDITORIAL

Akad. prof. dr. Valter MEMISHA (kryeredaktor)

Prof. as. dr. Evalda PACI (zv. kryeredaktore), prof. dr. Anila OMARI (sekretare shkencore), prof. dr. Artur LAMA, prof. dr. Seit MANSAKU, prof. dr. Rami MEMUSHAJ, akad. prof. dr. Shaban SINANI, prof. dr. Ludmila BUXHELI, akad. prof. dr. Bardhyl DEMIRAJ, akad. prof. dr. Kristina JORGAQI, prof. dr. Giuseppina TURANO, prof. dr. Agron DURO, prof. dr. Tomorr PLANGARICA, prof. dr. Laura SMAQI, prof. dr. Mimoza KORE, prof. as. dr. Spiro GJONI, prof. dr. Dhurata SHEHRI, prof. dr. Blerina SUTA, prof. as. dr. Enkeleida KAPIA, prof. as. dr. Adelina ÇERPJA, prof. dr. Aljula JUBANI, prof. dr. Persida ASLLANI, prof. as. dr. Merita BRUCI, prof. as. dr. Anila KANANAJ, prof. as. dr. Anila ÇEPANI, prof. as. dr. Teuta TOSKA, dr. Arian LEKA, dr. Leonard DAUTI.

Redaktore letrare: Anila Omari

Faqosja: Engjëllushe Karaj

Përkujdesja grafike: Dorina Muka

© Copyright 2024: ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

Të gjitha të drejtat të rezervuara

ISSN: 0563-5780

eISSN 2960-0057

Del dy herë në vit

Pronë letrare e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë
të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Adresa e redaksisë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë
Sheshi “Nënë Tereza”, nr. 3, Tiranë

PASQYRA E LËNDËS

Bardhyl Demiraj	Ndikimi gjuhësor-kulturor sllav në ‘Mesharin’ e Gjon Buzukut – një narrativ shkencor-filologjik	5
Anila Omari	Një provë klasifikimi të italianizmave të shqipes së vjetër (shek. XVI-XVII): huazime popullore dhe huazime librore...	57
Tomorr Plangarica	<i>Për një hapësirë më të gjerë të gjuhësisë së diskursit në mendimin gjuhësor shqiptar</i>	83
Evalda Paci	Elemente të biografisë dhe të autobiografisë në përpilime të autorëve të letërsisë romake (vështrim mbi shqipërime e përshtatje).....	129
Rafaela Marteta	Shkrimet për burgun politik: Trajtat e një teme të re letrare në paskomunizëm.....	141
Abdurrahim Maxhuni	Veçori leksiko-gramatikore të termave në <i>Fjalor i termave të drejtësisë</i>	163

PROBLEME DHE DISKUTIME

Emil Lafe	Rregulla drejtshkrimore që i ka shkelur koha.....	175
-----------	---	-----

KRITIKË DHE BIBLIOGRAFI

Anila Kananaj	<i>Studime në sintaksë teorike dhe të zbatuar nga prof. Seit Mansaku</i>	191
Evalda Paci	Studime albanologjike në indoeuropianistikë, filologji dhe gjuhësi kontakti; vëllim në nderim të prof. Bardhyl Demirajt, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2025.....	201

JETA SHKENCORE

Konferencë shkencore ndërkombëtare për
Albanologji e Gjuhësi historike (A.
Omari)..... 209

Konferenca shkencore “Gjurmët e fjalës-
Martin Camaj në 100-vjetorin e lindjes”,
Akademia e Shkencave e Shqipërisë,
Tiranë, 15 dhjetor 2025 (E. Paci)..... 211

Konferencë shkencore ndërkombëtare
“Frazologjia e gjuhës shqipe në arealin
gjuhësor ballkanik” (A. Lama)..... 215

IN MEMORIAM

U nda nga jeta prof. dr. Hëna Pasho
(1941-2025) (V. Memisha)..... 219

Bardhyl Demiraj

**Ndikimi gjuhësor-kulturor sllav në ‘Mesharin’
e Gjon Buzukut – një narrativ shkencor-filologjik –**

Përmbledhje

Ky studim është pjesë e një projekti individual që po zhvillon dhe boton dora-dorës shkruesi i këtyre radhëve lidhur me ‘Mesharin’ e Gjon Buzukut si libri i parë i botuar shqip që njohim deri sot (Demiraj 2023, 2024, 2025, 2026a – në shtyp, 2026b – në shtyp). Këtu kemi marrë në analizë çështjen e ndikimit të literaturës liturgjike sllave të Kishës Katolike kroate (në shek. XV-XVI) që njihet e mirënjihet sot e gjithë ditën në diskursin albanologjik, qoftë edhe si dytësor, por që ka marrë ndërkohë përmasat e një narrativi shkencor-filologjik (§1). Si sinorë orientues në hulumtim shërbejnë sipas rastit: a) aparati grafik i përdorur në realizimin e veprës; b) gjuha e Buzukut, sikurse, madje sidomos, c) struktura e tekstit të ‘Mesharit’ si përkthim që përqaset prej kohësh me modele (leksionarë e breviarë romakë) të pranishme në letërsinë liturgjike kroate në gjuhë popullore të asaj kohe. Pas një hulumtimi të hollësishëm, të mbështetur me një platformë të re metodike vijmë në këtë studim në përfundimin e natyrshëm, se ky ndikim rrudhet vetëm në aparatin grafik të veprës, edhe pse mbetet e hapur çështja, nëse është Buzuku i pari ai që e ka zhvilluar atë alfabet, apo i takon një tradite të mëhershme shkrimore të shqipes (§2). Përndryshe, ai ndikim disi i kërkuar në gjuhë, stil e përkthim, sikurse edhe në organizmin e tekstit në vetvete, prej modeleve të gatshme në traditën liturgjike të kroatisthes popullore me alfabet latinisht, rezulton të ketë qenë e të jetë thjesht fiktiv në diskursin shkencor-filologjik mbi Buzukun dhe veprën e tij (§§3-6).

Fjalë kyçe: *‘Meshari’ i Gjon Buzukut (1555), kultura e hershme e shkrimit shqip, humanizmi dhe katolicizmi, leksionarë të vjetër kroatë me shkrim latin (1495¹, 1453²,*

1508), alfabeti cirilik (varianti bosančica), Meshari Roman i Milanos (Missale Romanum Mediolanum) (1474).

1. Qerthulli problematik me diskutimin përkatës

Në shumësinë e studimeve të natyrës kryesisht filologjike që fokusohen qoftë në mënyrën e organizimit të tekstit të ‘Mesharit’ ashtu edhe në qëmtimin e atyre shtysave që nxitën Gjon Buzukun për një ndërmarrje të tillë madhore, bie në sy njëherësh interesimi i veçantë, deri në insistim, sa i përket ndikimit të traditës liturgjike-letrare të Kishës Katolike kroate (sllave) në të. Ky ndikim gëzon ndërkohë përmasat e një narrativi shkencor-filologjik me shumë të panjohura, ku kombinohen në dukje natyrshëm një numër treguesish qoftë edhe anësorë, që i ndeshim gjatë leximit të tekstit e që nxisin deduktime të rastit lidhur me sfondin para- dhe peritekstual, në të cilin u përftua vepra, përkatësisht mundësojnë njohjen e atij mjedisi kulturor-intelektual, ku mund a duhet të ketë qenë aktiv autori i saj, Dom Gjon Buzuku d.v. Si sinorë orientues shërbejnë në këtë rast: a) aparati grafik i përdorur në realizimin e veprës, meqë një numër grafemash në Alfabetin e Buzukut përkojnë (pa)ndërmjetshëm me gjegjëse përkatëse në njërin apo tjetrin variant të alfabetit cirilik, të përdorur sidomos në tekste liturgjike sllave të Kishës Katolike në zonën e Bosnjës (varianti *bosančica*); deri edhe, anipse në formë më të moderuar b) gjuha e tekstit apo e autorit të tij, sikurse, madje sidomos, c) organizimi ase struktura e tekstit të ‘Mesharit’ si përkthim që përqaset prej kohësh dhe ndërkohë me modele (leksionarë e breviarë romakë) të pranishme në letërsinë liturgjike kroate të asaj kohe. Shtojmë këtu që këta sinorë orientues fatmirësisht nuk shqyrtohen në asnjë rast të veçantë, por gjithnjë në bashkëvajtje me atë çka ofron përgjithësisht tradita liturgjike e besimit katolik në të dyja anët e Adriatikut, ku natyrisht roli kryesor dhënës i vishet gjithnjë traditës kulturore-fetare latine në përfundim të tij (Itali – Romë, Venedik, etj.).

Prashtu bëjmë fjalë për studime që, duke e parë këtë ndikim si të mirëqenë, rreken të plotësojnë një boshllëk të përfutur në mote për shkak të mungesës së informacionit dokumentar dhe arkivor mbi autorin e veprës dhe vetë përfutimin e saj. Gjithsesi, rezultatet e fituara në to i përmbushin skajshëm kushtet me realizuar atë syzim largvajtës në filologjinë shqipe dhe kulturën shqiptare në përgjithësi, bash me qëmtuar e njohur shterueshëm fillesat dhe zhvillimin e kulturës së shkrimit shqip në Arealin Kulturor të Veriut katolik shqiptar.

Parë nga kjo perspektivë, synimi ynë në këtë shkrim është tejet modest, meqë do të vatrëzohet në lupën e filologut kryesisht pikën e tretë të referuar më lart, pikërisht çështjen e organizimit të tekstit sipas një modeli që supozohet t’i përkasë traditës letrare-liturgjike kroate e që mëtohet të ketë ndjekur Buzuku

gjatë realizimit të veprës së tij (§4). Kësaj rubrike i paraprin në studim shtjellimi i thukët i rezultateve në bashkëlidhje me dy sinorët e tjerë të referimit, pra me ata që kanë të bëjnë me aparatën grafik dhe gjuhën e autorit në vepër (§§1, 2). E këto dy rubrika nuk i kapërcejnë caqet e natyrës kryesisht parashtruese-rezultative, që vjen me thënë i përcillen lexuesit thjesht dhe vetëm për hir të plotësisë së atij qerthulli problematik, të fiksuar dukshëm në titull.

§ 2. Elementi sllav në aparatën grafik të ‘Mesharit’

Sa i përket aparatit grafik që përdor Buzuku në libër, vëmë oroe qysh në fillim se i bashkohemi këtu mendimit sundues në diskursin shkencor-filologjik, sipas të cilit kodi alfabetik dhe rregullat ortografike që sundojnë në tekstin e Buzukut përkrijnë në përgjithësi me ato të grafisë dhe ortografisë latine-italiane me një inventar prej 24+1 grafemash, të stilizuara sipas tipit gotik Rotunda që ishte i përhapur atëbotë gjithkund në Italinë e Veriut¹: <a, b, c, d, e, f, g, h, i, j, l, m, n, o, p, q, r, s/l, t, u, v, x, y, z/ç + & [et]>. Rregullat e ortografisë italiane si edhe ndonjë digraf me vlerë tingullore të veçantë në kuadrin e kësaj tradite (khs. <gn> për [ɲ] /nj/), e plotësojnë edhe më mirë kornizën e këtij aparati. Megjithatë faksin në tekstin e ‘Mesharit’ plot pesë shkronja ase grafema të tjera jolatine që përkrijnë në shumësinë e tyre me njërin ndër variantet e alfabetit cirilik të përdorur në do tekste liturgjike sllave me alfabetin cirilik të variantit bosančica: <□> [v] ‘vjed’, <γ> [u, y] ‘uk’², <ћ> [j, c, g] ‘đerv’, <ѣ> [đ, θ] ‘ksi cyrillic’³, <з> [z] ‘zemlja’.

¹ Lidhur me historikun e hulumtimit gjurmëlënës në këtë drejtim lejohemi të citojmë në mënyrë selektive vetëm disa emra studiuesish, ndër ta: Rrota 1930: 10vv.; Jokl 1930: 145vv.; Roques 1932a: 11vv.; Çabej 1968: 46vv.; Hock 2006: 66vv.; Matzinger 2010: 451vv.; 2013: 79vv.; Omari 2010: 129vv.; etj.

² Për vlerat fonike e fonologjike të grafemave <□> [v] ‘vjed’ dhe <γ> [u, y] ‘uk’ në tekstin e ‘Mesharit’ shih së fundi Schumacher 2024: 233vv.

³ Këtë grafemë nuk e ndeshim në alfabetin e zakonshëm cirilik të bosančica-s, khs. ndër të tjerë Truhelka 1894: 3; Prohaska 1911: 12. Për praninë e tij në tekste të traditës së vjetër të shkrimit kroat me alfabet cirilik shih sidomos Jokl 1930: 147; Roques 1932a: 13; së fundi edhe Matzinger 2013: 80, shën. 24, por me informacion të saktë bibliografik mbi përdorimin e rrallë e me vlerë fonike të mirëfilltë të kësaj grafeme në këto shkrime: “Questo grafema cirillico viene usato molto raramente per rendere il greco <ѣ> /ks/ nei nomi greci (di solito si scrive invece <kc>); d’altra parte è utilizzato per rendere il valore numerico di 60, vedi p.es. Karskij 1928: 209...”. Në një studim të mëparshëm Matzinger-i kumton me referimet përkatëse se kjo grafemë ndeshet sado rrallë edhe në variantin e cirilik të bosančica-s, veçse pa ndonjë vlerë fonike të fiksuar (Matzinger 2010: 453, shën. 181). Interes të veçantë në studimin tonë fiton padyshim edhe konstatimi i Nadin 2012: 293, që e qëmton këtë shkronjë me vlerën fonike [z] në botimet e Lazaro de Soardi-it (1490-1527) në Venedik.

I kemi rreshtuar këto pesë grafema cirilike sllave menjëherë pas fondit të grafemave me burim latin-italian, bash ashtu siç janë renditur dhe fiksuar në të ashtuquajturin Alfabet i Buzukut me plot 30 (= 24+1+5) syresh, të cilin e pikasi i pari Joachim Matzinger (2013: 81v.; 2020: 205vv.) gjatë leximit të kujdesshëm të signaturave redaksionale të shtypit, përkatësisht të regjistrimit tipografik me shkronja alfabetike në çdo faqe të parë në fund djathtas për secilin fashikull dyfoliesh (= me katër faqe) në libër. Tejet i qëlluar është edhe kumti i tij përmbledhës, sipas të cilit: „Edhe pse botuesi i librit të Buzukut jet e mbetet gjer më sot i panjohur, mund të përfundojmë gjithsesi, që ai, duke qenë me siguri venedikas, në mos, thënë më mirë, joshqipfolës, nuk fliste dhe nuk kuptonte gjuhën e librit që po shtypte. Pra alfabeti që ka përdorur për signaturat [redaksionale] të folieve nuk ishte ideimi i tij, por më fort alfabeti i vjetër shqip (d.m.th. <a, b, ..., x, y, z, &, □, γ, h, ξ, z>) që ia kishte autorizuar porositësi i librit, pikërisht Gjon Buzuku”⁴. Gjithsesi, i ndërgjegjshëm për vështirësitë e radhës që bart çështja e kodit alfabetik të Buzukut në vetvete, Matzinger-i mëngon të përmbyllë së fundi po aty (f. 82, shën. 37), se: “Është e paqartë, nëse ky alfabet është sajuar prej Buzukut d.v., apo vijon pas gjase një alfabet parabuzukian.”⁵.

Pa dashur të bëhemi pjesë e këtij diskutimi, madje pa qenë hë për hë as në gjendje me pjesëmarrë në mënyrë aktive në të, mjafton t’u referohemi së fundi vëzhgimeve të mprehta të Lucia Nadin (2012: 302vv.), e cila kërkon dhe gjen disa ndër grafemat specifike, të përdorura në librin e Buzukut edhe në do botime të tjera latinisht dhe italisht, të shtypura në Venedik⁶. Pra, sa u takon karaktereve grafike të alfabetit cirilik në veprën e Buzukut, është mirë të mos vatërzhohet fokusi i hulumtimit vetëm në lindje të Adriatikut (Bosnjë, Dalmaci e

⁴ Citati origjinal: “Anche se rimane finora ignoto lo stampatore del libro di Buzuku, possiamo tuttavia concludere che essendo certamente veneziano, o più cautamente non albanese, egli non parlava e né capiva la lingua del libro che stampava. Dunque, l’alfabeto che ha usato per le segnature dei fogli non è stata la sua ideazione, ma piuttosto l’alfabeto antico albanese (cioè <a, b, ..., x, y, z, &, □, γ, h, ξ, z>) che li avrebbe potuto lasciare solo il committente del libro, ovvero Gjon Buzuku.” (Matzinger 2013: 82)

⁵ Citati origjinal: “Non è chiaro se questo alfabeto sia un’invenzione del Buzuku stesso o se continua forse un’alfabeto prebuzukiano (vedi la discussione in Matzinger 2010a: 465-468).” (Matzinger 2013: 82).

⁶ Nadin 2012: 292vv.; shih edhe më lart shën. 3. Gjithsesi mendimi i saj, sipas të cilit burimi i këtyre grafemave do kërkuar jo patjetër te botimet kroate me alfabet cirilik, por thjesht dhe vetëm në botimet bashkëkohore në Venedik, kundërshtohet nga Matzinger 2013: 80. Shih së fundi Markun 2024: 22 që kumton pa forcë argumenti se grafemat <h, ξ, z> “...duhet të kenë një traditë të hershme arbnore...”.

Raguzë/Dubrovnik)⁷, për më tepër botime tekstesh liturgjike sllave me alfabet cirilik nuk kanë qenë të huaja në Venedik në motet e Buzukut⁸.

3. Ndikimet gjuhësore sllave në 'Meshar'

Kundrejt pranisë së disa elementeve të alfabetit cirilik në aparatin grafik të tekstit të 'Mesharit', ndër të cilat tri: <ѣ, љ, Ѣ> me stilizime të ndryshme i mbijetuan motet në kulturën e hershme e të mëvonë, madje deri në fillimet e shek. XIX, të shkrimit shqip në Arealin Kulturor të Veriut, prania e elementit gjuhësor sllav në tekst rrudhet përgjithësisht në do ndikime që shfaqen në gjuhën popullore, sidomos në zonën e gegnishtes veriperëndimore, ku mendohet të ketë pasur prejardhjen e tij Buzuku, përkatësisht në sosh që pasqyron e folmja që qëndron në bazë të gjuhës së tekstit. Se sa domethënëse është kjo rrethanë gjuhësore në qëmtimin e ndikimit të pandërmjeshëm të teksteve liturgjike të kroatishtes së vjetër në gjuhën e Buzukut, është ky një problem që jet e mbetet sot e gjithë ditën tejet i vështirë për sqaruar. Pa hyrë në hollësi lidhur me historikun e studimeve gjuhësore-filologjike në këtë fushë, lejohemi të përmendim këtu vetëm do prurje jo pa pikëpyetje të rastit, që i ngjerojmë në studimet e Camajt (1960: 56vv.) dhe të Çabejt (1968: 34vv.), të cilët gjithsesi dallojnë shumë prej njëri-tjetrit në metodën e punës dhe rezultatet e studimit.

Prashtu Camaj e konsideron Buzukun "...më shumë se një përkthyes i zoti [ai] do konsideruar shumë herë si një kompilator i mirë..."⁹, sa i përket organizimit të materialit në vepër, meqë, sipas tij, perikopetë e ungjijve në 'Meshar' qenëqëshin pas gjithë gjasash produkt i traditës parabuzukiane në kulturën e hershme të shkrimit shqip, ndërkohë që prurjet që i takuakan mirëfilli Buzukut, përpos kolofonit (pasthënies), ai i rrudh kryesisht në pjesën e parë të 'Mesharit', sidomos te Urtorja e Shën Mërisë së Virgjër (*Officium B.M.V.*) dhe lutjet në përgjithësi¹⁰. Në këtë hulli individuale hulumtimi, Camaj i

⁷ Në fillimet e studimeve mbi 'Mesharin' e Buzukut iu vesh një rol ndërlidhës në këmbimet kulturore ndërmjet Shqipërisë Veriore dhe trevave katolike të Bosnjës sidomos pranisë dhe aktivitetit të Urdhrit Françeskan në të dyja këto treva, khs. Jokl 1930: 146v.; Roques 1932a: 12vv.; Çabej 1968 I 24v. Boshllëkun gjeografik midis këtyre dy hapësirave kulturore përpqien ta mbushin sidomos do studime të mëvonshme, që rrokin në këtë ndërkëmbim edhe rolin e Raguzës (Dubrovnikut); shih sidomos Camaj 1960: 49vv. dhe Çabej 1968 I 24v.

⁸ Shih Roques 1932b: 49vv.; së fundi Nemirovskij 1997.

⁹ Citati origjinal: "Buzuku certamente si servi di questi testi biblici e più che un bravo traduttore si deve considerare spesso volte un buon compilatore, benchè come prete istruito e solerte avrà avuto davanti sempre la sacra scrittura in latino." (Camaj 1960: 35)

¹⁰ Kështu, sipas tij: "...rispetto allo Off. B.M. Virginis e alle preghiere in genere, per cui sono indotto a credere che questa parte del libro è stata tradotta per la prima volta in

sheh sllavizmat në librin e Buzukut më së shumti në pjesën e tij të dytë, sidomos te tekstet biblike si perikope të festave liturgjike (meshës), për të cilët ka krijuar ndërkohë bindjen se janë pjesë e një tradite shkrimore shqipe të mëparshme dhe si të tilla ndjekin si model tekste që i takojnë letërsisë liturgjike, thënë më saktë, leksionarëve në gjuhën popullore kroate e me alfabet latin para Buzukut. Meqë çështjen e të ashtuquajturave modele kroate, ku qenka mbështetur Buzuku do ta trajtojmë hollësisht më poshtë (§ 4), po mjaftohemi të përmendim këtu vetëm mëtimin e Camajt se ky ndikim rrudhet kryesisht në leksik sikurse në prirjen me përcjellë edhe në gjuhën popullore shqipe, pra në gegnishten e folur (veriperëndimore) të atyre moteve, mesazhin ungjillizues të tekstit kanonik të Mesharit Romak¹¹. Pavarësisht bazamentit të brishtë, mbi të cilin mbështetet ky kriter metodik në hulumtim, lejohemi të përmendim këtu se numri i huazimeve leksikore që Camaj sjell me këtë rast për ilustrim prej teksteve biblike në ‘Meshar’ është tejet i rrudhur e, për më tepër, nuk ka të bëjë patjetër me huazime të natyrës savante, pra sosh të letërsisë liturgjike kroate, qoftë kjo edhe e mbështetur kryekëput në kroatishten popullore të kohës. Prashtu, huazime të tilla (rajonale) sllave në tekst, si: *pip* “prek”, *pod* “dysHEME, kat i poshtëm”, *riznicë* “dhomë ku mbahet thesari”, *tjesk* “presë (për verë ose vaj)”, *kërpit* “arvoj”, *grom* “bubullimë”, *bdinj* “ruaj, rri zgjuar”, *shtrazë* “rojë”, etj. (hollësisht Omari 2012), as mund të dëshmojnë as të hedhin poshtë patjetër një ndikim gjuhësor të supozuar të leksionarëve kroatë në motet e Buzukut ose para tij.

Më i moderuar sillet në hetimin e kësaj çështjeje Çabej (1968 I 34vv), sidomos sa i përket numrit të rrudhur të sllavizmave – të gjitha jashtë fondit të terminologjisë kishtarë (!!!) – në tekstin e Buzukut, edhe pse udhon pak a shumë në të njëjtën hulli me Camajn, meqë ndikimin sllav në fushën e leksikut dhe në stilin a mënyrën e shprehjes në një numër tekstesh të “Mesharit” ai i kundron njëllor, bash si pasojë e ndjekjes së modeleve sllave nga ana Buzukut gjatë realizimit të veprës së tij si përkthim¹². Ajo çka e dallon njërin studiues prej tjetrit është pra vetëm kriteri metodik në hulumtimin e ndikimit sllav në ‘Meshar’, të cilin e ndjek me besnikëri vetëm Çabej përgjatë gjithë punës së tij filologjike me transliterimin e tekstit. Kështu p.sh., ai e përqendron këtë ndikim thujse vetëm aso rasash kur tekstet biblike të ‘Mesharit’ shmangen dukshëm prej gjegjëseve në Vulgata (*Biblia Sacra Vulgata* = BSV) si tekst kanonik i Shkrimit të Shenjtë i Kishës Katolike Romake dhe afrohen po aq dukshëm me

lingua albanese dal Buzuku, senza aver innanzi precedenti traduzioni.” (Camaj 1960: 55)

¹¹ Sipas tij: “Però si deve ben precisare dall’inizio che l’influsso dei “lezionari” croati sull’opera buzukiana si rileva piuttosto nei riflessi lessicali e a volte nella maniera di riportare in lingua popolare le idee evangeliche dal latino.” (Camaj 1960: 59)

¹² Hollësisht Omari 2010: 131vv.

tekstet përkatëse të variantit kanonik të Koinesë së Kishës Ortodokse Bizantine (= BIZ), të cilin, sipas tij, Buzuku duhej ta njihte vetëm me ndërmjetësimin, përkatësisht falë njohjes dhe zotërimit të supozuar të traditës letrare-kishtare sllave. Këtë kriter studimi, sikurse edhe rezultatet aspak fatlume, të përfutara prej tij, i kemi parë e shqyrtuar hollësisht nga një tjetër këndvështrim në disa studime tona të fundit mbi ‘Mesharin’ e Buzukut¹³, por do t’u kthehemi rishtas edhe në rubrikën e mëposhtme (§4).

Së fundi vëmë theksin edhe te një ngërç i natyrës metodike që u ka shpëtuar studimeve të derisotme mbi ‘Mesharin’ dhe autorin e tij. Ndërsa ndikimi sllav në aparatin grafik përqendrohet në traditën liturgjike kroate-bosnjake me alfabet cirilik (§2), ndikimi gjuhësor mëtohet të jetë përfutur prej tekstesh kroate-bosnjake me alfabet latin¹⁴. Ky ngërç metodik i lëkund dukshëm përmasat, deri edhe praninë e ndikimit kulturor-gjuhësor sllav në veprën e Buzukut.

Si përfundim paraprak mund të themi tashpërtash se ndikimi sllav në terminologjinë popullore-kishtare shqipe është i papërfillshëm, ndërkohë që ky ndikim në gjuhën e ‘Mesharit’ të Buzukut është shtjelluar deri sot kalimthi e thujse gjithnjë në funksion me përcaktimin e atij teksti ase, më saktë, të atyre teksteve liturgjike me bazë kroatishen e vjetër (popullore të kohës) me alfabet latin, të cilat supozohet sot e gjithë ditën se mund a duhet t’i kenë shërbyer Buzukut si model në punën për realizimin e veprës së tij monumentale, e parë kjo kryesisht si përkthim. Andaj le t’i kushtohemi në vazhdim sinorit tjetër orientues dhe kryesor në studimin tonë, si vijon:

4. Ndikim sllav në organizimin e tekstit të ‘Mesharit’?

Në ç’masë përkon organizimi dhe sendërtimi i tekstit të ‘Mesharit’ me njërin apo tjetrin model liturgjik kroat, para- ose bashkëkohës të Buzukut (?); si mund të qëmtojmë bindshëm ndikimin e njërit apo tjetrit syresh në organizimin e tekstit (?) e, në instancë të fundit, çfarë roli mund a duhet të ketë luajtur mjedisi kulturor-fetar sllavishtfolës në përfutimin e tij? Janë pikërisht këto tri pyetje në dukje të thjeshta që bashkëlidhen pandërmjetshëm me sinorin e tretë orientues në studimin tonë (§1).

Vërejmë fillimisht që këto çështje, edhe pse shoqërojnë qysh në zanafillë studimet mbi Buzukun dhe librin e tij (shën. 1), vijnë e gëzojnë gjithnjë e më fort rëndësinë dhe interesimin e duhur vetëm në diskursin shkencor-filologjik të

¹³ Demiraj 2024: 3-42; 2025 (në shtyp); Demiraj 2026 (në shtyp); shih edhe studimin tonë të mëparshëm në “Hyllin e Dritës”: Demiraj 2023: 165-200.

¹⁴ Gjithsesi ky konstatim nuk parakupton mungesën e leksionarëve kroatë me alfabet cirilik në hapësirën kulturore-fetare në shqyrtim. Një i tillë është p.sh. *Leksionari Dominikan i Dubrovnikut* si kopje në dorëshkrim e Leksionarit të Bernardinit të Splitit (1595 – §4.1); shih Kapetanović 2014: 61vv.

kohës sonë. Veçojmë këtu rishtas studimet e fundit në varg të studiuesit vjenez Joachim Matzinger (2010, 2011, 2012, 2013, 2022) që nuk resht së kërkuari atë model, përkatësisht ato modele tekstesh simotra, që mund e duhet të ketë pasur në tavolinën e punës Buzuku për të hartuar veprën e tij. Lidhur me pjesën e dytë ase atë të mesharit në tekstin e Buzukut, këtë kërkim e kushtëzon, sipas tij, mbajtja parasysh me rigorozitetin e duhur shkencor e disa premisave metodike pune, që po ia përcjellim lexuesit në plotësinë e tyre si vijon:

- Modeli ase modelet në kërkim duhet t'i takojnë një periudhe që i paraprin motit të hartimit të veprës së Buzukut (1554-1555). Pra bëhet fjalë për një botim redaksional paratridentin të Mesharit Romak, meqë vetë ky meshar në hullinë e vendimeve të Koncilit të Trentos (1545-1563) iu nënshtrua reformimit si tekst liturgjik i kanonizuar prej Kurisë së Shenjtë të Vatikanit¹⁵.
- Sa i përket një modeli të mundshëm latinisht që vjen në vështirë, do përqendruar kërkimi sidomos në një botim me përdorim të përgjithshëm, para së gjithash një meshar romak në përdorim edhe të Urdhrit Françeskan, që ishte gjithashtu i pranishëm në Venedik¹⁶.
- Do parë gjithherë edhe mundësia e ndjekjes së një modeli ekzistues, përkatësisht konsultimi plotësues i teksteve liturgjike në kroatishten e vjetër.
- Domethënës në këtë drejtim është edhe kërkimi për një botim që përmban edhe formularin në mos perikopetë që lexohen në meshën e Shën Jobit (me ditë feste më 10 maj), e cila përmbyll pjesën e dytë sikurse gjithë tekstin liturgjik në librin e Buzukut¹⁷.
- Do mbajtur së fundi parasysh edhe rrethana që teksti (si përkthim) i pjesës së dytë të librit liturgjik të Buzukut nuk rrok të gjithë tekstin e Mesharit Romak me formularët e secilës meshë në tërësinë e tij (i ashtuquajtur i Mesharit plotë Romak), por vetëm perikopetë së bashku me lutjen e ditës (*Oratio, Collecta*) dhe atë përmbyllëse (*Oratio Postcommunio*) të secilës meshë në veçanti, më rrallë edhe (*Oratio Super populum*).

¹⁵ Meshari i ri Romak u botua nën siglën e Papës Piu V në vitin 1570, duke ruajtur statusin e tij kanonik në Kishën Katolike Romake deri në Koncilin e Dytë të Vatikanit (Romë 1962-1965). Sqarime të rastit janë bërë në Demiraj 2025 (në shtyp).

¹⁶ Edhe pse i vetëdijshëm për këtë kriter metodik, Çabej (1968 I, II) për arsye objektive nuk e mbajti dot parasysh në botimin e tij monumental të 'Mesharit'; hollësisht Demiraj 2025 dhe 2026 (në shtyp).

¹⁷ Siç do t'i rikthehemi më poshtë (§4.1.1), mesha votive e Shën Jobit përmbyll tekstin e pjesës së dytë dhe të të gjithë 'Mesharit', andaj bëhet fjalë, pas gjase, për shenjtin padron të asaj kishe ku duhet të ketë qenë aktiv Buzuku si bari shpirtëror në shërbim të Kishës Katolike Romake (Nadin 2012: 246vv.)

Jemi më se të ndërgjegjshëm që kjo paketë kriteresh metodike parakupton idealiter një punë të patëmetë filologjike dhe teologjike-historike me tekstin e Buzukut. Gjithashtu jemi po aq të ndërgjegjshëm, edhe po të mëtojmë tash se ndjekja me rigorozitet shkencor e gjithë këtij kompleksi kriteresh metodike vështirë se premtion patjetër sukses, sidomos të menjëhershëm, për një studiues sado të motivuar në hulumtime kësodore. Gjithashtu shpresojmë të mos ekgzagjerojmë aspak, në rast se sinjalizojmë këtu me dashamirësi që kërkime të kësaj natyre mund të kërkojnë më shumë se një jetë aktive dhe të shëndetshme në profesion. Andaj as nuk gabojmë po të ulemi tash këmbëkryq në atë sofër që na ofron Buzuku me librin e tij, duke u kufizuar këtu vetëm në tri pyetjet e parashtruara më lart lidhur me mundësitë e ndikimit sllav në modelet që mendohet të qëndrojnë në bazë të pjesës së dytë në tekstin liturgjik të Buzukut, bash atë që ngjason deri diku me mesharin romak. E në këtë pikë fatmirësisht edhe një pjesë e kriterëve metodike të punës që parashikon Matzinger-i përkohë thuhet në unison me ato të disa studiuesve sqimtarë të Buzukut (Camaj 1960: 35vv.; 56vv.; Çabej 1968 I 34vv.), andaj, parë nga kjo perspektivë, po i riformulojmë, duke i përmbledhur në dy që plotësojnë mirëfilli njëri-tjetrin, si vijon:

- Ndikimi i modeleve sllave në tekstin e 'Mesharit' do parë si dytësor në përjasje me gjegjësit përkatës latinisht (dhe italisht), madje do të pranohet *sine qua non* mungesa e këtij ndikimi aso rastesh (d.m.th. në shumësinë e tekstit), ku bashkëpërkimi ndërtekstual është i trefishtë: modeli latinisht(-italisht) = kroatisht = shqip.
- Një ndikimi i mundshëm në procesin e përkthimit prej modeleve sllave do mbajtur parasysh vetëm në ato raste, ku teksti i Buzukut i shmanget dukshëm gjegjësit latinisht(-italisht) dhe përkon me atë kroatisht.

Një përvojë të mirë pune në lidhje me zbatimin e disa kriterëve të ngjashme metodike e kemi fituar ndërkohë në studimet tona të fundit mbi organizimin e tekstit të Buzukut në përjasje me a) Mesharin Romak të Milanos (*Missale Romanum Mediolani* 1474 = MRM) si teksti liturgjik paratridentin që qëndron në bazë të të gjitha botimeve kësodore në dy brigjet e Adriatikut, së paku në atë hapësirë gjeografike të Kishës Katolike Romake ku mendohet të ketë qenë aktiv Buzuku (Itali e Veriut, Shqipëri Veriore, Dalmaci, Bosnjë); me b) breviarë, uratore e sacerdotale latinisht (Psaultier 1303-8; OBM 1573; Sacerdotale 1554; etj. – Demiraj 2025 – në shtyp); si edhe me d) shqyrtimin analitik të një numri të konsiderueshëm anomalish që shfaqen në tekstet biblike të 'Mesharit' në përjasje me gjegjësit e tyre në BSV, MRM etj. (Demiraj 2023: 180vv.; 2024: 20vv.; 2026a – në shtyp). Kjo rrethanë e lehtëson studimin për shtjellimin e dy pyetjeve të para, meqë na lejon tash të operojmë me të njëjtin aparat metodik edhe në paragrafët në vazhdim.

4.1. Përfaqsjë ndërtekstuale me strukturën e ‘Mesharit’

Këtë paragraf po e hapim me një argument në dukje negativ, meqë organizimi i lëndës që përmban ‘Meshari’ si libri i parë i botuar në gjuhën shqipe, në kushtet e njohurive të derisotme të krijon një përshtypje të parë se përfaqëson mirëfilli një unikat liturgjik, madje jo vetëm në kulturën e hershme të shkrimit shqip. E këtë konstatim sado hipotetik e paravendon një përsiatje e thjeshtë, thujse triviale: lënda e rrokur në të ngjason me pranëvënien radhazi të një numri tekstesh liturgjike llojesh nga më të ndryshmet që përkojnë sipas renditjes në tekst me elemente të Breviarit Romak (bashkë me Uratoren e Shën Mërisë së Virgjër) dhe të Ritualit Romak, sikurse me elemente të Katekezës e në pjesën e vet më të vëllimshme (rreth 80% e tekstit të njohur) me sosh të Mesharit Romak, i kufizuar ky kryesisht në pasqyrimin e atyre teksteve që i ngjetrojmë zakonisht në Liturgjinë e Fjalës gjatë celebrimit të meshës. Kjo pjesë e fundit rroket me formate të ndryshme edhe në të ashtuquajturit leksionarë, si libra liturgjike që përcjellin të fiksuar në letër e shpesh me renditje të kanonizuar në Kalendarin Romak kryesisht perikopetë (pistulli, ungjij) si copëza leximi prej Shkrimit të Shenjtë në çdo meshë përgjatë një viti liturgjik.

Pikërisht ky lloj teksti liturgjik është marrë në analizë në ato pak kërkime filologjike të derisotme që fokusohen mirëfilli në përfaqsjën strukturore të tekstit të ‘Mesharit’ me gjegjësit e vet potencialë në letërsinë liturgjike kroate. Parapëlqehet me këtë rast tradita e botimeve dhe dorëshkrimeve në kroatishten popullore me alfabet latin të shek. XV-XVI, në të cilën faksin sidomos leksionari i Bernardinit të Splitit (*Leksionar Bernardina Splićanina*, Venedik 1495), leksionari në dorëshkrim i Ranjinat (*Ranjinin Leksionar*, Raguzë/Dubrovnik 1508) dhe ai po në dorëshkrim i Zadarit (*Zadarski Leksionar*, Zadar/Zarë, shek. XIV/XV), të cilët gëzojnë këto karakteristika kryesore:

Leksionarij Bernardina Spljećanina (Imp. Venetiis, më 12 mars 1495 = LBS)

Leksionari i fratit Bernardin i Splitit (*Bernardinus Spalatensis, de Spalato*)¹⁸ është leksionari i parë i shtypur dhe një ndër botimet më të

¹⁸ Për jetën dhe aktivitetin e autorit shih së fundi Režić (1983): Bernardin Splićanin, në: “Hrvatski Biografski Leksikon” < <https://hbl.lzmk.hr/clanak/1824> >. Me interes është ndër të tjera edhe kumti i Farlatit IS III 407, 436, sipas të cilit autori më 1495 ushtronte funksionin e mbikëqyrësit në shërbim të gjyqit kishtar kundër herezive për zonën e Dalmacisë, Hungarisë, Kroacisë, Bosnjës, Arbënisë, Serbisë, Rashës (Raška) dhe të Bullgarisë. Përpos ribotimit pa ndryshime të vitit 1543, ky leksionar u ribotua edhe njëherë në shek. XVI, pikërisht në vitin 1586 prej Marko Andriolić-it nga Trogir, veçse me përshtatjet e domosdoshme në përputhje me vendimet e Koncilit të Trentos dhe të Mesharit Romak Tridentin. Në bazë të tij qëndron edhe leksionari i fratit

hershme incunabula kroatish me alfabet latin në traditën liturgjike kroate. Është botuar në Venedik më 1495 në shtypshkronjën e mjeshtrit Damian i Milanos (*Damianus Mediolanensis*). Në pjesën e tij kryesore (fol 1a-95b) rroken tekste biblike ase perikope (pistulli, ungjij) që lexohen gjatë celebrimit të meshave përgjatë kalendarit liturgjik e që sendërtohen në plotësinë dhe renditjen e tyre në Mesharin Romak. Modeli bazë, mbi të cilin është mbështetur frati françeskan, është pas gjase një model latinisht ende i paidentifikuar, meqë edhe titujt e rubrikave dhe të meshave janë në atë gjuhë. Në pjesën e fundit (fol 95b-104b) janë rrokur tekste liturgjike gjithfarësh: prefacione, bekime, ekzorcizma, lutje, etj. si pjesë e festave liturgjike, bash ashtu siç përmbyllet edhe libri: / Euangelia & epistole cum prephationibus & benedictionibus per anni circulum in lingua yllirica feliciter expliciunt; emendata & diligenter correcta per fratrem Bernardinum Spalatensem. Impressum Venetiis per Damianum Mediolanensem. Anno D. MCCCCXLV. die XII. Martii. /.¹⁹ Mungojnë në të si Kalendar i Liturgjik Romak (*Calendarium romanum generale*) ashtu edhe Rendori i Meshës (*Ordo missae*) e Kanoni i Meshës (*Canon Missae*). Botimi gëzoj përhapje të gjerë, duke mbijetuar motet falë edhe ribotimeve të herëpashershme në shekuj. Me rëndësi për studimin tonë është edhe ribotimi i vitit 1543 po në Venedik me përkujdesje të fratis françeskan Benedikt Zborovčić²⁰.

Raĥinin lekcionar (dsh. [Raguzë/Dubrovnik] 20 tetor 1508 = RL)

Ky leksionar kroat në dorëshkrim mban emrin e kopistit e njëherësh (deri më 1577) zotëruesit të tij, Nikša Andrečić (Zot i Dubrovnikut), prej derës fisnike Ranjina (Raĥina) në Dubrovnik. Materiali në dorëshkrim me alfabet latinisht, si kopje e një materiali ende më të vjetër (gjithashtu të panjohur) kroatish e njëherësh si përkthim prej së paku një a disa modeleve italisht të kohës²¹ rezulton të ketë qenë deri në shek. XVII në pronësi private të derës në fjalë, pra pa ushtruar atë funksion që pati dhe

franceskan të Bosnjës Ivan Bandulavić (1613), i cili përfjetoi shumë ribotime deri në vitin 1830; hollësisht Gabrić-Bagarić & Erdman-Pandžić 1997: 15vv.

¹⁹ Botimi i parë kritik prej Maretić më 1885 me të dhëna të bollshme informative në hyrje (f. I-XXV).

²⁰ Sipas Maretić 1885: VIIIv. ribotimi i vitit 1543 nuk dëshmon shmangie të natyrës redaksionale prej botimit të parë, përjashtoj ndonjë rast tejet të rrallë ndërhyrjesh ortografike. Për këtë ai sjell në fund të botimit të tij (f. 202vv.) përqasje të rastit mes copëzash leximi të transkriptuara në ribotimet e radhës së LBS. Shih edhe Gabrić-Bagarić & Erdman-Pandžić 1997: 23vv. Përpjekjet e Kuštović-it (2020: 243vv.) me i dhënë ngjyra protestante këtij ribotimi, nuk i qëndrojnë dot kritikës. Shih edhe shën. 14.

²¹ Camaj 1960: 56vv.; hollësisht Barbarić 2015: 233vv.

gëzoi mirëfilli LBS. Dorëshkrimi bart autorësinë e kopistit Nikša Andrečić për 230 foliet e para, ndër të cilat, përpos leksionarit të mirëfilltë me perikopetë e renditura sipas kalendarit liturgjik romak (fol 13-230) janë ruajtur edhe 13 fletë që rrokin a) të dhëna të natyrës ortografike; b) kalendarin liturgjik e në fund edhe c) një informacion biografik mbi pasardhësit e familjes së kopistit²². Shtojmë këtu, se duke qenë deri në shek. XVII në pronësi private rrudhet dukshëm mundësia e ndikimit të drejtpërdrejtë e këtij leksionari në përfitim të 'Mesharit' të Gjon Buzukut.

Zadarski Lektionar (Zadar/Zarë, shek. XIV/XV = ZL)

Ky leksionar i shkruar në pergament (me 117 folie të ruajtura) daton pas gjase më herët se dy të tjerët më lart. Ngjason me LBS, sa i përket të organizimit të tekstit në pjesën kryesore (fol 1a-97b), ku janë rrokur pistulli dhe perikope që lexohen gjatë celebrimit të festave liturgjike përgjatë kalendarit kishtar sipas rendit përkatës në Mesharin Romak. Pjesa e dytë (fol 98a-117b) rrok në tërësinë e vet ritualin e bekimit të ujit të shenjtë, të kripës, të bukës, të degëve të ullirit (*In die palmarum*), etj. me gjithë përbërësit përkatës (prefacione, bekime, ekzorcizma, lutje, antifona, sentenca bekimi, etj.) për një numër ceremonish të natyrës liturgjike. Edhe ky ndjek pas gjase një model latinisht ende të paidentifikuar, meqë edhe titujt e rubrikave dhe të meshave janë po ashtu në atë gjuhë.²³

Lidhur me historikun e studimit të 'Mesharit' tonë në përjasje me njërin a tjetrin leksionar kroat në shqyrtim përmendim paraprakisht emrat e dy studiuesve albanologë që janë marrë, sado skajshëm, por konkretisht me përjasje ndërtekstuale kësodore, pikërisht Camaj 1960: 56-66 dhe Matzinger 2022: 53vv.²⁴. Ndërsa i pari ka rrokur në vëzhgim të tre leksionarët në fjalë, i dyti është mjaftuar me konsultuar kryesisht LBS, duke u përqendruar në tri copëza leximi tekstesh biblike (Fil 4 4-7; Joh 1 19-28 dhe 2 Kor 13 11-13) në

²² Hollësisht Rešetar 1894: IX-XVI, 97-330. Materiali dorëshkrimor përmban sipas renditjes: ff. 97-320: Leksionar; ff. 321-3: I. Prilog Nekoliko komada iz Ranjinina leksionara u originalnoj ortografiji; ff. 323-8: II. Prilog: Koledar Ranjinina leksionara; ff. 328-330: III. Prilog: Bilješke o Ranjininijoj porodici. Zhbirilime mbi historikun e dorëshkrimit, strukturën e tij, ndikimet e traditave liturgjike latine, italiane, sllavokishtarë si edhe veçoritë gjuhësore së bashku me teknikat e përkthimit të lëndës mund të konsultohen te Barbarić 2015: 233vv.

²³ Rešetar 1894: 1-95 me të dhëna të hollësishme para- dhe peritekstuale në hyrje: ff. V-VIII.

²⁴ Detyrohemi të shtojmë këtu që Eqrem Çabej, në veprën e tij madhore mbi 'Mesharin' e Gjon Buzukut (1968 I-II), në pamundësi objektive shfrytëzimi të këtyre leksionarëve, u mjaftua të operonte në përjasje kësodore me botimin e biblës serb(okroat)isht me autorë Daničić dhe Karadžić (1865, 1847), çka kushtëzoi jo rrallë përfundime më se të diskutueshme; shih edhe shën. 16.

bashkëlidhje edhe me gjegjëset përkatëse në një meshar romak të shek. XVI (de Giunta 1521) e në një rast edhe me BSV. Përndryshe, emri i murgut françeskan Bernardini i Splitit dhe leksionari i tij janë të mëshumëcituarit në historinë e studimeve buzukiane, që datohen në kohë qysh prej vëzhgimeve të para filologjike të Mario Roques-t (1932a: 11vv.).

4.1.1. Afri strukturore

Nisur nga këto rrethana, të cituara më lart, kemi ndërmarrë në studimin tonë si hap të parë përpunimin e të dhënave që fitojmë nëpërmjet përqasjes ndërtekstuale, sa i përket organizimit të teksteve biblike përgjatë kalendarit liturgjik, që i takojnë pjesës së dytë e që përkon në përgjithësi, d.m.th. jo plotësisht e në raportin 1 : 1, me atë të leksionarëve kroatë LBS (1495, 1543) dhe RL (1508). Kemi përzgjedhur në analizat tona përqasëse vetëm këta dy leksionarë, e kjo për arsye që kanë të bëjnë, sipas rastit: a) me faktorin kohë në hulumtim; b) me gjeografinë kishtare ndërmjet trevave të Bosnjës dhe Shqipërisë Veriut, si pjesë e traditës së studimeve buzukiane; si edhe c) me karakteristikat e dy leksionarëve në fjalë, të përfutur prej modelesh kryesisht latinisht dhe italisht që janë shfrytëzuar në përfutimin e tyre²⁵. Si sinor orientues në përqasje është marrë Meshari Romak i Milanos (1474 = MRM), i cili, siç theksuam më lart, konsiderohet me të drejtë si tekst orientues për të gjithë mesharët dhe leksionarët e besimit katolik (latinisht ose të përkthyer në një gjuhë popullore të gjallë) në të dyja anët e Adriatikut për periudhën në fjalë (Demiraj 2025 dhe 2026a – në shtyp). Jashtë analizave ndërtekstuale janë lënë pjesët përmbyllëse në LBS dhe RL, të cilat nuk kanë gjegjëse në 'Mesharin' e Buzukut, sikurse edhe rubrikat e lutjeve (*Collecta*, *Postcommunio*, më rrallë *Super populum*), që regjistrohen për shumicën e meshave në BUM, të cilat gjithashtu nuk kanë gjegjëse në LBS dhe RL.

I gjithë materiali liturgjik, që rrokin në vetvete madhësitë përqasëse në shqyrtim: BUM, LBS, RL (së bashku me MRM) përcillet në formë tabelare në shtojcën e këtij shkrimi (§6). Prashtu do të mjaftohemi në vijim t'i kumtojmë lexuesit në mënyrë të përmbledhur rezultatet e punës paraprake lidhur me karakteristikat e përbashkëta dhe të veçanta që afrojnë përkatësisht dallojnë BUM me LBS dhe RL²⁶.

²⁵ Jashtë përqasjes është lënë ZL, i cili ndan thujse të njëjtat veçori me LBS.

²⁶ Jemi më se të ndërgjegjshëm që këto rezultate janë vërtet paraprake, andaj vëmë theksin në leximin e kujdesshëm të informacionit me materialin liturgjik përkatës dhe paraqitjen e tij tabelare në shtojcë (§6), duke shpresuar kështu, se do të mund të nxisim në të ardhmen studime të detajuara mbi vendin e 'Mesharit' në kulturën e shkrimit shqip dhe në traditën liturgjike në gjuhën shqipe në hapësirën kulturore-katolike që rrok edhe diasporën shqipfolëse në motet e Buzukut.

Duke ecur në këtë hulli metodike vërejmë së pari që karakteristikë e përbashkët për tri madhësitë përfaqëse në shqyrtim është se të tria dëshmojnë pandërmjetshëm organizimin e gjithë materialit liturgjik përgjatë kalendarit kishtar të festave liturgjike (meshave) sipas një modeli zanafillës latinisht(-italisht), i sendërtuar ky mirëfilli në MRM. Ato janë të shpërndara në këto tekste në katër rubrika që dallohen qartë prej njëra-tjetrës: a) *Temporale* (*Proprium de tempore*) si festa liturgjike me ciklet përkatëse të Kërshëndellave, të Pashkëve bashkë me Rrëshajat, si edhe meshat e së Djelës si Dita e Zotit (BUM 30ra-82vb; LBS 2r-77v = 1-144; RL 13r-170v = 99-255), d.m.th. të gjitha meshat që nuk përkojnë me rubrikën b) *Sanctorale* (*Proprium de Sanctis*, *Proprium Sanctorum*) si festa liturgjike për shenjtorë e ngjarje të veçanta fetare, që kanë po ashtu një formular meshe të vetin (BUM 82vb-81/1ra; LBS 77v-86v = 144-163; RL 170v-201r = 255-287); dhe c) *Commune Sanctorum* si festa liturgjike që përkujtojnë shenjtorë kategorish të ndryshme: apostuj, martirë, virgjëresha, etj. pa formular meshe më vete (BUM 81/1ra-88/1vb; LBS 86v-94a = 163-179; RL 201r-224v; 228v-230v = 287-314; 316-318); e së fundi edhe d) *Missa votiva* si festa liturgjike që organizohen për ngjarje të veçanta në jetën e besimtarit, të famullisë ase të dioqezës, si p.sh. martesë, vdekje, sëmundje, katastrofa, pelegrinazhe periodike, apo sosh të padronit të kishës dhe të famullisë, etj. (BUM 88/1vb-90vb; LBS 94a-97r = 179-186; RL 224v-228v = 314-318). Si karakteristikë e përbashkët mes tri teksteve në përfaqje do parë gjithashtu edhe mungesa e rubrikave të veçanta të Rendorit të Meshës dhe të Kanonit të Meshës, e mes BUM dhe LBS edhe ajo e Kalendarit Romak, që gjendet në MRM (si shtojcë edhe në RL) sikurse përgjithësisht në çdo meshar romak²⁷.

Një shqyrtim i hollësishëm i katër pjesëve kryesore në shpërndarjen e meshave përgjatë vitit liturgjik i përforcon më tej afritë mes tri teksteve, por nxjerr në pah edhe dallime që bashkojnë, përkatësisht largojnë ‘Mesharin’ kryesisht me të dy e më rrallë vetëm me njërin leksionar kroat në fjalë, ndër to:

- *Proprium de tempore* përkon thuajse plotësisht në organizim dhe numër meshash ndërmjet BUM²⁸ me LBS dhe RL, ashtu siç i ndeshim të fiksuara së pari në MRM. Dallimet mes sosh janë minimale e mund të konsiderohen si përjashtime të rastit, të përfutuara kryesisht për pakujdesi e lajthitje në njërin apo tjetrin botim, si p.sh. mungesa ose shtesa të njërit a

²⁷ Mundësia e pranisë së kalendarit liturgjik në tri foliet e grisura të ‘Mesharit’ të Buzukut (fol XXVII-XXIX) mund të supozohet, duke shtuar edhe mëdyshjen që një paraqitje e tillë do të mund të kërkonte një hapësirë më të madhe në libër (Demiraj 2025 – në shtyp).

²⁸ Jashtë përfaqjes mbetet sigurisht materiali liturgjik i parashikuar në ato faqe të BUM dhe RL që mungojnë.

tjetrit vers (lat. *versus*) për një numër perikopesh²⁹. E dallime kësodore janë të pranishme edhe në meshat e pjesëve të tjera të materialit liturgjik në BUM, LBS dhe RL.

- Një përfundim të ngjashëm premtan edhe shqyrtimi i kujdesshëm i pjesës së dytë *Sanctorale*, veçse në përqasje me situatën në MRM numri i meshave rezulton të jetë shumë më i rrudhur në numër qoftë në BUM (Matzinger 2012: 279vv.) ashtu edhe në LBS e RL. Kështu p.sh. në përqasje me MRM mungojnë në të tria tekstet mesha të tilla si: *In sanctorum martirum Iohannis et Pauli*; *In sancti Leonis Pape et Confessoris*; *In octava sancti Laurentii*; etj. Po ashtu edhe dallimet në regjistrimin e njëres ose tjetres meshë në BUM në përqasje me LBS dhe RL janë po aq të dukshme. Kështu p.sh. ndryshe nga prania e tyre në dy leksionarët kroatë ose vetëm në njërin syresh mungojnë në BUM mesha të tilla, si: *In cathedra Sancti Petri*; *In sanctorum Martirum septem fratrum et sanctum rufine...*; *In vigilia sancti Laurentii martiris*; etj. Më shumë plotësi në sasinë e meshave në përqasje me MRM dëshmon gjithsesi RL, ku ndeshim mesha të tilla si: *In sancte Agnesis. Virginis et martiris*; *In Sancti Gregorii Pape et confessoris*; *In sancti Petri ad Vincula*; *In sanctorum martirum Cyriaci largi...*; etj. Me shumë interes në këtë rubrikë është regjistrimi i meshës *In sancti Antonii de Padua* në LBS që nuk gjendet as në MRM dhe as në RL dhe BUM, por si shenjtör i Urdhrit Françeskan, ku ishte aktiv frati Bernardin i Splitit, përkujtohej pas gjase edhe në kuvendin e tij (të Shën Françeskut), sikurse njihet dhe nderohet gjithkund në Ballkanin Perëndimor me Shqipërinë e Veriut, në Itali (Padova) e gjetkë. Prashtu nuk duhet të bëjmë aspak çudi që ky shenjtör zë vend të veçantë edhe në pjesën e parë të 'Mesharit', ku feks emri i tij me litaninë përkatëse (Demiraj 2026b – në shtyp).
- Ende më i rrudhur është numri i meshave në pjesën e tretë *Commune Sanctorum* në përqasje me MRM, e kjo situatë bie në sy në të tria madhësitë përqasëse BUM, LBS dhe RL, duke bartur kështu të njëjtat karakteristika si dy pikat më lart.
- Ndër meshat votive (*Missa votiva*) në pjesën e katërt, të regjistruara në tri madhësitë në fjalë janë *Missa in agenda Mortuorum* (Mesha për të vdekurit) dhe *Missa pro sponso et sponsa* (Mesha e Kurorës), të cilave u është lënë hapësirë pak a shumë e njëjtë në BUM, LBS dhe RL. Ndryshe nga MRM nuk specifikohet në to natyra e njëres apo tjetres meshë, që celebrrohet për të vdekurit.

²⁹ Si shtesë, e përfutur më fort si lajthitje e Buzukut, në mos përshtatje me modelin burimor, do parë p.sh. versi 12 në copën e leximit (pistullinë) 2 Kor 13 11-13 të meshës *In die S. Trinitatis* (BUM 72va-73ra), kundrejt 2 Kor 13 11, 13 në LBS e RL, sikurse edhe në MRM (ndryshe Matzinger 2022: 55), apo versi 21 në Lk 2 21-32 i meshës *In Die Purificationis Beatae Mariae Virginis* (BUM 84rb-va) kundrejt tekstit të perikopesë përkatëse Lk 2 22-32 në MRM sikurse në LBS dhe RL.

- Rëndësi të veçantë lidhur me kornizën peri- e paratekstuale të ‘Mesharit’ fiton sidomos mesha votive që përmyll pjesën e dytë dhe të gjithë tekstin liturgjik të Buzukut. Bëjmë fjalë këtu për meshën e Shën Jobit, si shenjt i kuvendit *Convento di San Giobbe* në Sestiere Cannaregio në Venedik. Këtu pritet të ketë qenë aktiv edhe Buzuku si at shpirtëror, ku mbarështonte, me sa duket, edhe grigjën e vet si pjesë e diasporës katolike arbënore në atë zonë (Nadin 2012: 246vv.; miratim te Matzinger 2012: 78v.).

4.1.2 Dallime strukturore

Së fundi mund të përmyllim që këto afri të natyrës së përgjithshme, të radhitura më lart, lidhur me organizimin e materialit liturgjik në BUM në përjasje me LBS dhe RL, përkojnë në instancë të fundit me strukturën e modelit bazë latinisht, i sendërtuar dhe i parë si i mirëqenë në MRM, pa mundur këtu të fiksojmë konkretisht atë variant ase ato variante meshari apo leksionari latinisht-italisht, mbi të cilin a të cilët mbështeten njëra apo tjetra madhësi përjasëse. Gjithsesi kemi mes sosh edhe një dallim strukturor që mënjanon kryekëput çdo lloj marrëdhënieje të pandërmjetshme të BUM më njërin ose tjetrin leksionar kroat në shqyrtim. Vëmë theksin këtu te lutjet që i ngjetojmë rregullisht në shumësinë e meshave (*Oratio, Postcommunio, Super populum*) në BUM, duke e dalluar atë dukshëm në strukturë e, pas gjase, edhe në funksionin e tij zanafillës prej LBS dhe RL, d.m.th. duke e afuar atë edhe më shumë me një meshar të zakonshëm romak. Në këtë mënyrë shpresojmë t’i kemi dhënë një përgjigje negative pyetjes së parë që ngritem në hyrje të kësaj rubrike (§4), çka mundëson edhe një përgjigje bindëse për pyetjen e dytë që bashkëlidhet me të, si vijon:

§ 4.2. Ndikim sllav në përkthim dhe stil?

Vijmë kështu natyrshëm në çështjen më të vështirë të analizës ndërtektuale që parakupton përjasja e ‘Mesharit’ të Buzukut me dy tekstet liturgjike sllave në shqyrtim. Do vënë në dukje rishtas që një ndikim njëdrejtimësh, që vjen me thënë i përthithur prej Buzukut pandërmjetshëm prej tekstesh kësodore në kroatishten popullore njihet dhe pranohet gjithherë si dytësor në krahasim me gjegjësit potencialë latinisht (dhe italisht); e kjo e vështirëson edhe më shumë zgjidhjen e këtij problemi, meqë çdo syzim bart në vetvete një dozë hipotetike që shoqëron në fakt çdo studim. Kështu p.sh. shumëkush e mëton këtë ndikim aso rasash, kur teksti shqip shmanget në stil e deri në përmbajtje prej gjegjësit latinisht (BSV, MRM); sigurisht duke rrokur këtu sipas rastit edhe ato momente që kanë të bëjnë me shkallën e lartë të vështirësisë së stilit në tekstin burimor latinisht. Kështu p.sh. Camaj merr sidomos parasysh këto momente të natyrës stilistike me tumirur opsionin se kësio rasash Buzuku, në rolin e përkthyesit, ka shfrytëzuar si mjet ndihmës

tekste gjegjëse kroatisht. Pra ai sikurse edhe të tjerë para e pas tij mëngojnë ta pranojnë si të mirëqenë këtë ndikim, veçse thjesht dhe vetëm me funksionin e ndërmjetësit, duke e kufizuar atë shi në ato raste, ku teksti i Buzukut shmanget dukshëm prej tekstit të BSV (Camaj, Çabej, etc.) dhe/ose prej MRM (Matzinger), duke iu afruar atij të BIZ.

Siç vumë në dukje edhe më lart këtë rrethanë të dytë e kemi bërë objekt hulumtimi në dy studime të mëparshme (Demiraj 2024; 2026a – në shtyp), ku jemi përqendruar në shtjellimin e një numri relativisht të lartë anomalish që i ngjetojmë në do copëza biblike leximi të Besëlidhjes së Re në BUM në përqasje me BSV dhe MRM. Dhe rezultati i analizës ndërtekstuale mundësoi bindshëm shpjegimin e shumicës dërmuese të këtyre anomalive si pjesë e formimit teologjik-humanist të Buzukut, i cili mund dhe duhet të ketë shfrytëzuar në ndërmarrjen e tij madhore një variant të Besëlidhjes së Re që përkton me përkthimin greqisht-latinisht të humanistit të madh evropian Erasmus i Roterdamit (1516...1536 = NIO), përkatësisht me një variant të saj italisht (prej gjegjësit greko-bizantin të koinesë) me autor, përkatësisht përkthyes, humanistin e njohur italian Antonio Brucioli (= BRU)³⁰. Andaj na mbetet tash thjesht të marrin në analizë rishtas këto anomali, ose një pjesë syresh, për t'i përcjellë lexuesit atë çfarë e dallon përkatësisht e afron tekstin e Buzukut me leksionarët kroatë në shqyrtim. Pra, rezultatet e përfutura nëpërmjet asaj përqasjeje ndërtekstuale na lejojnë tash të shqyrtojmë natyrshëm, nëse këta leksionarë ushtrojnë ose jo ndonjë rol ndërmjetës qoftë edhe dytësor në sendërtimin e veprës së Buzukut. Parë nga kjo perspektivë, çështja e ndikimit potencial të traditës liturgjike-letrare kroate në përfitim të veprës së Buzukut fiton jo vetëm një kornizë të re në hulumtim, por mundëson edhe një rrugëzgjdhje solide falë kritereve metodike që janë sprovuar ndërkohë.

4.2.1 Paraqitje tabelare e përqasjes ndërtekstuale

Le të ndërmarrim tash si shembëllzim një numër anomalish që janë diktuar dhe analizuar në dy studimet e mëparshme në tekstin e Buzukut në përqasje me disa variante latinisht, greqisht, italisht dhe shqip (shek. XIX) të Besëlidhjes së Re, sikurse me MRM. Në vijim e kemi rudhur vetëdijshëm numrin e tyre, duke u përqendruar vetëm në do anomali që janë diktuar në ungjijtë e Shën Mateut dhe të Shën Lukës, e duke i bërë si të tilla edhe objekt përqasjeje me gjegjëset kroatisht në LBS dhe RL. Po ashtu janë mbajtur parasysh të njëjtat premisa metodike së bashku me të njëjtin aparat kritik, çka mundëson që edhe

³⁰ Në ato studime janë mbajtur parasysh edhe përkthimet e Besëlidhjes së Re në gjuhën shqipe prej të ashtuquajturit *Textus receptus* (1633 = TR) nga ana e Vangjel Meksit me Grigor Gjirokastritin (1824, 1827 = ME-GR) dhe e Konstandin Kristoforidhit (1866, 1872 = KR).

rezultatet e përfuara të ngërthehen natyrshëm me ato të arritura në studimet e mëparshme.

Dy tabelat e mëposhtme rrokin gjithë-gjithë 22 (13+9) shembuj të regjistruar me shifra arabe (kol[ona] I = n[umë]r[imi]) me vendin përkatës në dy ungjijtë në fjalë (kol. II), duke i përqsaur ato me gjejëset në BUM (kol. III), në LBS (kol. IV) dhe RL (kol. V). Bashkërendimi i rezultateve, të arritura falë përqsasjes me dy tekstet në fjalë, përmyll secilën tabelë me rubrikën “Vëzhgime”.

Njëloj si në studimet e mëparshme, për pasqyrimin e teksteve të marra në analizë:

-kemi markuar me shkrim *kursiv* vendin e marrë në analizë në çdo tekst, duke e lehtësuar kështu përqsasjen ndërtekstuale për secilin botim. Në rastet kur në BUM ose LBS dhe RL këto vende mungojnë është bërë markimi përkatës me anë të tri pikave të ndërkallura në kllapa katrore: [...];

-ndërsa trepikëshi i pa markuar me kllapa katrore sinjalizon thjesht dhe vetëm ndërprerje para ose prapa fjalive e periudhave të gjata, sigurisht pa vështirësuar aspak leximin dhe kuptimin e vetë tekstit si të tillë.

Le të ndjekim tashti nga afër rezultatet e përqsasjes ndërtekstuale trefishe në dy tabelat e mëposhtme:

a) Anomali dhe paralelizma në ungjillin e Sh. Mateut

I	II	III	IV	V
nr.	vendi	BUM	LBS	RL
1	Mt 5 4-5	fol. 86/1ra 4) <i>Bekuom të butëtë, përse ata të pushtojnë dhenë.</i> 5) <i>Bekuom ata qi klanë, përse ata të jenë ëngushulluom.</i>	f. 171 4) <i>Blaženi su krotki, jere će oni uživati zemlju,</i> 5) <i>blaženi su oni, ki plaču, jere oni će se utišiti.</i>	f. 287 4) <i>Blaženi poniženi, jere oni hoće uživati zemlju,</i> 5) <i>Blaženi koju plaču, jere oni hoće biti utješeni.</i>
2	Mt 6 1	fol. 42rb E ëmbani mend mos e bani të dërejtënë taj përpara njerëzet...	f. 26 Nastojte dobro, da <i>pravdu</i> vašu, ča su dobra dila, ne činite prid ljudi...	f. 126 Nastojte, da <i>pravdu</i> vašu ne činite prjed ljudim...
3	Mt 6 25	fol. 77va Mos u matetë me pasunë kujdes gjellë~së saj qish ju të kini <i>me ëngranë o me pīm</i> , as korpit tij, me se ju ta	f. 132 I za to govoru vam: Nemojte se pečaliti životu vašemu, ča <i>čete</i> <i>blagovati</i> [...], ni tilu vašemu, čim čete se	f. 240 I zato govoru vam: Nemojte se žuriti duši vašoj, što <i>biste jeli</i> [...], ni ti tijelu vašemu, u što ga čete obuoci

		ënvishi.	oditi.	
4	Mt 15 8	fol. 52va Kÿ popullë muo afëronenë, <i>me gojë e me buzë më ënderinë</i> , e zemëra e tyne larg anshtë ën meje fort.	f. 46 Puk ovi usti mene <i>hvalim</i> [...], da srcte ñih daleko jest od mene.	f. 148 Puok ovi ustmi me <i>hvali</i> [...], srcte takoj ñih daleko jest od mene.
5	Mt 20 7	fol. 39va E ata i thanë: Përse kush nukë na muor ëndë punë. E u tha atyne: Ecëni edhe ju ëndë vëneshtë teme, <i>e të kini ta qish të jetë pr arësye</i> .	f. 19 Recoše ñemu: za č nas nitkore ni najal. Reče ñim: pojte i vi u moj vinograd [...].	f. 120 I recoše ñemu: jer nitkor nas ne najemi. Reče ñim: pođite i vi u vinograd moj [...].
6	Mt 20 22-23	fol. 88ra 22) E tue ju përgjegjunë Jezu tha: Ju nukë dini qish ju lypëni. A mundë pini atë kelq qi u kam me pīm [...] E i thanë atī: Mundnjëmë. 23) E u tha atyne: Kelqinē qi u kam me pīm ju ta pini, [...] ma me ëndenjunë ëmbë të djathët e ëmbë të shtëmanktët, ata nukë përket muo me u dhanë juve, por atyne qi t u jetë dhanë ën Atit tim.	f. 157 22) Odgovori Isus i reče: ne znate, ča prosite; morete li piti čašu, ku ja jimam piti [...] Rekoše mu: Moremo. 23) Reče ñim Isus: čašu čete stanovito moju piti [...], da sesti od desne moje i od live ne pristoji se meni dati vam, da onim, kim je priprafjeno od octa moga.	f. 275 22) Odgovoriv takoj Isus reče: ne znate što prosite. Možete li piti čašu, koju ja imam piti [...] Rekoše ñemu: Možemo. 23) Reče ñim Isus: čašu moju popijete [...] s jednije tada j nije menje dati vam na desnu vola na lijevu, nego kojijem je pripravljeno od octa moga.
7	Mt 22 38	fol. 78va E ky anshtë <i>i pari e mā i madhi</i> ordhënë...	f. 134 Ovo je <i>najvekša i prva</i> zapovid...	f. 243 Ovi jest <i>najveći i prvi</i> zakon....
8	Mt 24 31	fol. 82va E të dërgonjë engjëjtë e tī <i>me të madh zā ën trombetësh</i> ...	f. 144 ... [deri në versin 24]	f. 254 I pošle anđele svoje <i>s trublom i glasom velicijem</i> ...
9	Mt 25 1	fol. 88/1va ...qi muorë luqerëtë e tyne, duolë me votë përpara <i>dhandërit</i> [...]	f. 176 ...ke vazamše svitnake svoje izidoše protiva <i>nevistacu i nevistici</i> .	f. 310 ...koje uzimlući kandjele svoje i izidoše supročitiva <i>vjereniku i vjerenici</i> .

10	Mt 25 13	88/1va Bdini prā, përse ju nukë dini as ditënë as orënë <i>qi të vinjë i Biri i njeriut.</i>	f. 175 Bdite tada, za č ne znate dne ni vremena [...].	f. 311 Zato bdite, jere ne znate dan ni časa [...].
11	Mt 27 8	fol. 55/1ra [65va] E prashtu anshtë gri-shunë ajo copë dhë [...] dheu i gjakut, e djerie sod ashtu grëshitetë	f. 72 I za to ja se zvati níva ona: <i>akeldemak</i> , a to je reçi níva krfna do današnega dne.	f. 176 Zatoj zvana jest níva (ona <i>akeldemak</i> , to jest níva) krvna deri do današnega dne.
12	Mt 27 34	fol. 55/1va [65va] E i dhanë tamblëthitë përzienë <i>me uthullë</i> me pīm. E si e kërkoi, z desh me e pītë.	f. 73 i daše mu <i>vino</i> piti smišano s žučju. I kako okusi, ne hti piti	f. 177 I daše mu piti <i>ocat</i> (s) zuočju miješano. I kade okusi, ne htje piti.
13	Mt 27 35	fol. 55/1va [65va] E tue pasunë vum ëmbë kryqt, danë petëkatë e tī, tue qitunë short përëmbī to përse të ëmbaronë ta qish thashunë ish klenë ën profetët, <i>tue thashunë: Danë petëkatë e mī, e përëmbī cohët teme shtinë short.</i>	f. 73 A pokle ga propeše, razdiliše svite negove ždribe mičuci, da se napuni ča pisano jest po proku govoreći: <i>Razdiliše svite moje sebi i sfrhu sfite moje vrgoše ždribe.</i>	f. 177 Potom toga (kada) raspeše (nega), razdijeliše svite negove zdrijebe mecuće, da se ispuni što jest rečeno <i>po proroku govoreće: razdijeliše svite moje sebi i na svitu moju vrgoše ždrijebi.</i>

Vëzhgime:

- Shembulli nr. 1: BUM përkon me LBS dhe RL, sa i përket rendit të bekimeve, të tre u bashkohen modeleve latinisht të BSV dhe MRM, sikurse atij italisht të BRU (khs. MRM: (4) *Beati mites quoniam ipsi possidebunt terram*; | (5) *Beati qui lugent. quoniam ipsi consolabuntur*; BRU: (4) *Beati i mansueti: perche essi benediranno la terra.* |(5) *Beati i quegli che si affliggono: perche questi saranno consolati*), duke u larguar kështu njëherësh prej NIO, BIZ, etj. (khs. NIO: (4) *Beati qui lugent quoniā ipsi consolationē accipiēt*; (5) *Beati mites, quoniam ipsi hæreditaem accipient terræ* (Demiraj 2026a – në shtyp).
- Shembulli nr. 2: Situatë deri diku e ngjashme me shembullin më lart, meqë BUM përkon me LBS dhe RL sikurse me BSV dhe MRM në përdorimin e emrit “e drejtë” (khs. MRM: *Attendite ne iustitiam uestram faciat is coram hominibus ut uideamini ab eis*) kundrejt tekstit përkatës në NIO, BRU, BIZ etj. që përdorin në vend të saj fjalën “lëmoshë” (khs. NIO: *Adtendite ne eleemosina uestrā faciat is corā hoibus ut spectemini ab illis*; BRU:

- Gvardate à non fare la uostra *elemosina* (Demiraj 2024: 21; 2026a – në shtyp).
- Shembulli nr. 3: BUM përkon me NIO, BRU, etj. lidhur me përdorimin e foljeve të pranëvëna me bashkërenditje “ha” dhe “pi” (khs. NIO: ...quod *esuri sitis*, aut *bibituri*...; BRU: Non siate adunque solleciti, dicendo: che *mangeremo*, ò che *beremo*...), kundrejt LBS dhe RL, ku ndeshim vetëm foljen “ha”, njëlloj si në modelet latinisht të BSV dhe MRM (khs. MRM: Ideo dico uobis. ne solliciti sitis animae uestrae. quid *manducetis* [...]) (Demiraj 2026a – në shtyp).
 - Shembulli nr. 4: Ashtu si në shembullin më lart (nr. 3) BUM përkon natyrshëm me NIO, BRU etj. lidhur me pranëvënien e emrave “gojë” dhe “buzë” (khs. NIO: ...populus hic *ore suo*, & labijs me honorat...; BRU: Questo popolo *mi si appropinqua con la boca sua*, & con le labra mi honora...), duke u shmangur dukshëm prej gjegjësit në LBS dhe RL, ku mungon emri “buzë”, pra njëlloj si në modelet latinisht të BSV dhe MRM (khs. MRM: Populus hic [...] labijs me honorat... (Demiraj 2024: 21; 2026a – në shtyp).
 - Shembulli nr. 5: Ashtu si në shembujt më lart (nr. 3, 4) teksti i Buzukut përkon natyrshëm me NIO, BRU etj. lidhur me praninë e fjalisë përmbyllëse (khs. NIO: Abite & uos in uineam, & *quicquid fuerit iustum accipietis*; BRU: Andate anchora uoi nela uigna, & *ha[u]jete quello che sera giusto*), e cila mungon në LBS dhe RL, sikurse edhe në modelet latinisht BSV dhe MRM (khs.: Ite et uos in uineam meam [...]) (Demiraj 2024: 22; 2026a – në shtyp).
 - Shembulli nr. 6: Sikurse në shembullin nr. 2 BUM përkon me LBS dhe RL, duke iu bashkuar si i tillë edhe gjegjëseve në BSV dhe MRM, përkatësisht duke iu larguar njëherësh teksteve të NIO, BRU, BIZ etc., që dëshmojnë zgjerim me fjali shtesë (khs. NIO: 22. ...ego bibiturus sum, & *baptismate quo ego baptizor, baptizatori*. Dicunt ei. Possumus | 23. Ait illis. Calicem quidem meum bibetis, & *baptismate quo ego baptizor, baptizabimi*...; BRU: ...che io ho à bere? & *essere battezzati del battesimo, del quale io sono battezzato*? Essi dicono, possiamo. | (23) Et dice à questi. Voi certamëte berete il calice moi, & *sarete battezzati del battesimo, del qual io sono battezzato* (Demiraj 2024: 22v; 2026a – në shtyp).
 - Shembulli nr. 7: Teksti i Buzukut shmanget dukshëm prej gjegjësit në LBS dhe RL sa i përket topikës së dy mbiemrave, duke u dalluar edhe prej modeleve latinisht të BSV dhe MRM (khs. MRM: Hoc est *maximum* et *primum* mandatum...), kundrejt topikës së njëjtë në tekstin e NIO, BRU, etj. (khs. NIO: Hoc est *primum et magnum* mandatum...; BRU: questo è *il primo*, & *grande* comandamento (Demiraj 2026a – në shtyp).
 - Shembulli nr. 8: E njëjta situatë si në shembujt më lart (nr. 3, 4, 5, 7): BUM largohet dukshëm prej LBS dhe RL, njëlloj si prej gjegjëseve përkatës në

BSV dhe MRM, por edhe në NIO (khs. MRM: Et mittet angelos suos *cum tuba et uoce magna* RL; NIO: Et mittet angelos suos *cum tuba et uoce magna*), kundrejt përkimit në përkthim me BRU, BIZ, etj. (khs. BRU: ...& mandera gli angeli suoi *con gran voce di tromba* (Demiraj 2026a – në shtyp).

- Shembulli nr. 9: E njëjta situatë si në shembujt më lart (nr. 3, 4, 5, 7, 8), ku teksti i Buzukut i shmanget atij në LBS, sikurse gjegjëseve në modelet latinisht të BSV dhe MRM (khs. MRM: ...exierunt obuiam *sponso et sponse*), kundrejt paralelizmit që ndeshim në NIO, BRU, etj. (khs. NIO: ...exierunt in occursum *sponso* [...]; BRU: ...vscirno incontro à *lo sposo* [...]) (Demiraj 2026a – në shtyp).
- Shembulli nr. 10: Ashtu si në shumësinë e shembujve më lart (nr. 3, 4, 5, 7, 8, 9) BUM përkon natyrshëm me NIO, BRU etj. lidhur me praninë e fjalisë përmbyllëse (khs. NIO: Vigilate itaque. quia nescitis diem neque horam, *in qua filius hominis ueniet*; BRU: Vigilate adunque: perche voi non sapete ne il di, ne l'ora, *ne la quale uerra il figliuolo de l'huomo*), e cila mungon në LBS dhe RL, sikurse edhe në modelet latinisht BSV dhe MRM (khs. MRM: Uigilate itaque. quia nescitis diem neque horam [...]) (Demiraj 2024: 23v; 2026a – në shtyp).
- Shembulli nr. 11: Në BUM nuk citohet emri burimor i toponimit në fjalë, njëlloj si në NIO, BRU, etj. (khs.: NIO: ...propter uocatus est ager ille, [...] ager sanguinis; BRU: Per questo è stato chiamato quel campo: [...] cāpo di sangue), kundrejt përmendjes së tij në LBS dhe RL, sikurse në modelet latinisht të BSV dhe MRM (khs. MRM: ...propter hoc uocatus est ager ille *Acheldemach* ager sanguinis (Demiraj 2026a – në shtyp).
- Shembulli nr. 12: Një situatë e ndryshme me shembujt e marrë në analizë më lart, ku BUM përkon me RL, sikurse me tekstet në NIO, BRU, BIZ, etj. që dëshmojnë emrin “uthull” (khs. NIO: ...et dederunt ei *acetum* bibere cum felle mixtum; BRU: ...et dettogli bere *acceto* mescolato cō fiele), kundrejt situatës në LBS dhe në modelet latinisht të BSV dhe MRM, që në vend të saj kanë emrin “verë” (khs.: MRM: Et dederunt ei *uinum* bibere cum felle mixtum (Demiraj 2024: 24; 2026a – 2026a – në shtyp).
- Shembulli nr. 13.: Një situatë e ndryshme me shembujt e marrë në analizë më lart, meqë teksti i Buzukut përkon me gjegjësit në LBS dhe RL e njëherësh edhe me NIO, BRU, etj. (khs. NIO: ... quod dictum est per prophetam. *Diuiserunt sibi uestimenta mea, & super uestam meam miserunt sortem*; BRU: che si è detto per la propheta. *Et si diuisono i miei uestimenti, & messono la sorte sopra la ueste mia.*), kundrejt modeleve latinisht në BSV e MRM, ku mungon fjalia përmbyllëse (khs. MRM: Postquam autem crucifixerunt eum. diuiserunt vestimenta eius sortem mittentes [...]) (Demiraj 2024: 24v; 2026a – në shtyp).

b) Anomali dhe paralelizma në ungjillin e Sh. Lukës

		BUM	LBS	RL
14	Lk 2 21	fol. 84rb Ënd atë mot, ëmbassi klenë ëmbaruom tetë dit me u përëm <i>djalëtë</i> , u grish emënitë e tî Jezu...	f. 13 U ono vrimë pokle se svršiše osam dan, da se obriže <i>ditić</i> , zvano jest ime ñegovo Isus...	f. 114 U onoj brijeme kada se ispuniše osam dan, da obriježu <i>dijete</i> , zvano jest ime ñegovo Jezus...
15	Lk 4 41	fol. 72va ...tue thirë e tue thashunë: <i>Ti je Krishti Biri i Tinëzot</i>	?	f. 228 ...se neprijatelj i vikahu: ti jesi [...] <i>sin božji</i> .
16	Lk 10 35	fol. 77ra E të dytënë ditë, <i>si kish me u dām</i> , dha dy denarë osti...	f. 131 A drugi dan [...] izne dva dukata i da staña- ru...	f. 239 I drugi dan [...] ize dva dinara i da ih gostiñi- ci...
17	Lk 10 41	fol. 88vb E tue ju përgjegjunë <i>Jezu i tha...</i>	f. 159 I odgovoriš i reče ñoj <i>gospodin...</i>	f. 278 Odgovori i reče ñoj <i>gospodin...</i>
18	Lk 11 13	fol. 68vb ...sā mā fort Ati yj i qiullet t apë <i>Shpirtinë shenjtë...</i>	f. 113 „koliko veće otac naš s neba dati hoće <i>duh dobri</i> onim...	f. 216 ...koliko veće otac vaš s neba dati će <i>duh dobar...</i>
19	Lk 11 53	fol. 86/1 E aj tue thashunë atyne këto kafshë, zunë <i>dokto- rëtë e ligjsë e farizejtë</i> me i thanë kontra...	?	f. 319 Kada ovo rekao njim, počeše <i>farizei i knjižnici</i> tegotno ustrpjenja bit...
20	Lk 14 21	fol. 73va ...të vobegjitë e të pāatij e të <i>shkjepënitë e të verbënitë</i> sjellë këtu ëmbrenda	f. 124 ...ubozih i nevoñnih, <i>hromih i slipih</i> , susih i klastih uvedi ovde.	f. 230 ...(i) ubozijeh i slabijeh i <i>slijepijeh i hromijeh</i> uvedi ovdi.
21	Lk 24 36	fol. 64/1vb ...e u tha atyne: <i>Paqi me jū</i> [...]	f. 105 ...i reče ñim: Mir vam, <i>ja sam, nemojte se bojati</i> .	f. 207 ...i reče ñim: mir vam: <i>ja sam, ne hotjete se bojati</i> .
22	Lk 24 43	fol. 65ra E ën faqe tyne angrë [...]	f. 105 I budući blagoval on prid ñimi <i>vazamše ostatke poda ñim</i> .	f. 207 I kade blagova prjed ñimi, <i>uzam ostalo i da ñim</i> .

Vëzhgime:

- Shembulli nr. 14.: Një situatë të veçantë përcjell ky shembull në përqasje me shembujt më lart, meqë emri “djalë” shfaqet si në BUM ashtu edhe në LBS e RL, sikurse në MRM, NIO, BRU, etj. por jo BSV dhe BIZ (khs. BSV: et postquam consummati sunt dies octo ut circumcideretur [...] uocatum est nomen eius Iesus...; MRM: Postquam consummati sunt dies octo ut circumcideretur *puer*...; BRU: Et poiche compiti forno gli otto di del circumcidere *il fanciullo*, fu chiamato il nome suo Giesu...). Pra ky shembull nuk mëton të jetë domethënës për çështjen në shqyrtim, meqë madhësitë kryesore përqasëse (përjashtoj BSV) shfaqin të njëjtat karakteristika: BUM = LBS = RL = MRM = NIO (Demiraj 2026a – në shtyp; ndryshe Lloshi 2020, 2025).
- Shembulli nr. 15: Në tekstin e Buzukut shfaqet emri i Krishtit me funksion predikativ, të cilin nuk e ndeshim në RL (në LBS nuk kemi mundur ta fiksojmë dot), sikurse edhe në BSV, MRM, NIO (khs. MRM: ...quia *tu es* [...] *Filius Dei*). BUM shfaq gjithsesi të njëjtat proporcione me BRU (khs. BRU: *Tu sei Christo figliuolo di Iddio*), njëlloj si në përkthimet e Besëlidhjes së Re shqip në shek. XIX (Demiraj 2024: 26; 2026a – në shtyp).
- Shembulli 16: BUM përmban një fjali të varur kohore që nuk shfaqet në LBS dhe RL, sikurse edhe në BSV dhe MRM (khs. MRM: ...et altera die [...] protulit duos denarios. et dedit), por përkon me tekstin gjegjës në NIO, BIZ, BRU, etj. (khs. Et postero die *egrediens*, depromptos duos denarios...; BRU: Et l'altro giorno *partendosi*, cauati fuora duoi denari... (Demiraj 2026a: në shtyp).
- Shembulli 17: Në BUM në përqasje me LBS dhe RL, sikurse edhe në BSV e MRM ndërndërojnë vendet emri i Jezusit me “Zotin” (khs. MRM: Et respondens dixit illi *dominus*...). Teksti i Buzukut përkon ashtu si në shumësinë e shembujve në shqyrtim me NIO, BIZ, BRU, etj. (khs. Et respondens dixit illi *Iesus*...; BRU: Et rispondendo *Giesu* disse... (Demiraj 2026a – në shtyp).
- Shembulli 18: Të njëjtat proporcione i ndeshim edhe në këtë shembull, ku BUM përkon me NIO, BIZ, BRU, etj. (khs. NIO: ...dabit *spiritum sanctum*...; BRU: ...dara *lo spirito santo*) dhe shmanget dukshëm prej LBS dhe RL, sikurse prej BSV dhe MRM (khs. MRM: ...dabit *spiritum bonum*... (Demiraj 2026a – në shtyp).
- Shembulli 19: Njëlloj si në shembullin nr. 7 BUM shmanget prej RL (në LBS nuk kemi mundur ta fiksojmë), sa i përket topikës së dy emrave, duke u dalluar kështu edhe prej modeleve latinisht në BSV dhe MRM (khs. MRM: ...coeperunt *Phariseae et legis periti* grauiter insistere...), kundrejt topikës së njëjtë në NIO, BIZ; BRU, etj. (khs. NIO: ...coeperunt *legisperiti & phariseae* et grauiter insistere...; BRU: ...cominciorno i *dottori de la*

legge, & i pharisei grandemente à oppugnare... (Demiraj 2026a – në shtyp).

- Shembulli 20: Ky shembull është interesant për faktin se topika e dy emrave (të) emëruar *...të shkjepënitë e të verbënitë...* përkon me atë në LBS sikurse edhe në NIO, BIZ, BRU, etj. (khs. NIO: *...claudosque &, cæcos...*; BRU: *...zoppi, & ciechi...*), duke iu shmangur gjegjësit në RL sikurse atyre në BSV dhe MRM (khs.: MRM: *cecos et claudos* (Demiraj 2026a – në shtyp).
- Shembulli 21: Të njëjtat proporcione i ndeshim edhe në këtë shembull, ashtu si në shumësinë e rasteve në shqyrtim, ku BUM dallon dukshëm në përkthim prej LBS dhe RL, sikurse me BSV dhe MRM (khs.: MRM: *... Pax uobis. ego sum nolite timere*) dhe përkon me NIO, BIZ, BRU, etj. (khs. NIO: *Pax uobis [...]*; BRU: *Pace di uoi [...]* (Demiraj 2026a – në shtyp).
- Shembulli 22: BUM dallon prej LBS dhe RL me mungesën e një fjalie, e cila na shfaqet edhe në NIO, BIZ, BRU, etj. (khs. NIO: *Et accepit & in conspectu illorum comedit [...]*; BRU: *Et presala, nel conspetto loro mangiò [...]*), ndryshe nga BSV dhe MRM (khs. MRM: *et cum manducasset coram eis sumens reliquias dedit eis* (Demiraj 2026a – në shtyp).

4.2.2. Rezultate paraprahe

Shembujt e marrë në shqyrtim në dy tabelat më lart janë në fakt një numër i rrudhur, por gjithsesi më se domethënës, së paku, për të gjitha ato anomalitë (rreth 65) në tekstin e Buzukut që kemi pasur rastin t'i qëmtojmë shterueshëm në dy studime të mëparshme mbi 'Mesharin' e Buzukut në përjasje me variante të ndryshme latinisht, greqisht, italisht dhe serbisht(-kroatisht) të Besëlidhjes së Re sikurse me Mesharin Romak të Milanos (Demiraj 2023, 2024, si edhe 2026a – në shtyp). Për më tepër rezultatet që u arritën këtu shpresojmë të jenë orientuese edhe sa i përket pranisë, më saktë mospranisë së marrëdhënieve të drejtpërdrejta ndërmjet 'Mesharit' të Gjon Buzukut me leksionarët kroatë që qarkullonin atëbotë në Dalmaci e Bosnjë. Prashtu mjafton të mbajmë parasysh ato kritere metodike që u fiksuan në krye të kësaj rubrike (§4), në kuptimin që një ndikim i mundshëm prej modeleve kroate vjen në vështrim seriozisht vetëm aso rasash, kur teksti i Buzukut përkon me të dyja ose me njërin prej teksteve kroatisht, por shmanget dukshëm prej gjegjëseve latinisht(-italisht), ndër ta edhe prej BSV dhe MRM. E në analizën e 22 shembujve në fjalë rezultatet dëshmojnë vetëm të kundërtën, pasi për 15 syresh (nr. 3, 4, 5, 7, 8, 9, 10, 11, 15, 16, 17, 18, 19, 21, 22 = 68%) dallimet ndërmjet BUM dhe LBS me RL janë më se dukshme si në stil ashtu edhe në përkthim, pasi burojnë pas gjase prej modelesh të ndryshme, meqë tekstet e Buzukut largohen njëlloj edhe prej BSV me MRM, duke bashkëpërkthuar bindshëm me

ato në NIO dhe BRU. Këtyre u shtohen natyrshëm edhe dy shembuj të tjerë (nr. 12, 20 = 9%), ku shmangiet në tekst feksin në përjasje vetëm me njërin ose tjetrin leksionar, veçse edhe për to vërtetohet njëherësh edhe prania e tyre së paku në BSV dhe MRM. Prashtu, bashkëpërkime të plota mes BUM dhe LBS me RL rezultojnë të jenë gjithë-gjithë 5 shembuj (23%), anipse asnjë syresh nuk e përfshijnë të veçuar vetëm për këto tri madhësi përjasëse, përkundrazi: edhe pse të një natyre heterogjene, çka parakupton hulumtim të veçantë për secilin shembull në veçanti, këto bashkëpërkime shfaqen sipas rastit në bashkëvajtje me një model më të hershëm latinisht-italisht (si p.sh. BSV, MRM, NIO, BRU), gjë që nuk përmbush asnjë nga kriteret metodike që orientuan hulumtimin tonë në këtë hulli kërkimi.

Mbetet kështu për t'u sqaruar, më saktë për t'ia paraqitur lexuesit si çështje e fundit brenda kësaj rubrike, edhe një pyetje e natyrës më fort kulturore-gjuhësore, që vjen me thënë sociolinguistike, së cilës do t'i përkushtohemi thukët në vijim:

4.3. Roli i mjedisit kulturor-fetar sllavishtfolës

Çfarë roli mund a duhet të ketë luajtur mjedisi fetar sllavishtfolës si realie kulturore-historike në përfitim të 'Mesharit' të Gjon Buzukut? Besojmë të jemi ndër të parët që shtrojmë për debat një pyetje të tillë në diskursin shkencor-filologjik, meqë ndikimi i këtij mjedisi në përfitim të 'Mesharit' të Gjon Buzukut është pranuar dhe pranohet deri sot si i mirëqenë, domethënë pa u shoqëruar me ndonjë pikëpyetje të rastit, në mos thjesht duke heshtur lidhur me të. Megjithatë perspektivat e reja që orientuan hulumtimin tonë filologjik dhe rezultatet e ndryshme që i përcollëm lexuesit për diskutim e bëjnë një pyetje të tillë të vetëkuptueshme dhe një përgjigje të saj po aq të pashmangshme, anipse në mungesë të kornizës peritextuale dhe të dokumentacionit arkivor qoftë mbi veprën, ashtu edhe autorin e saj kjo përgjigje vështirë se mund të jetë shteruese. Lejohemi pra t'i përcjellim lexuesit paraprakisht disa arsyt objektive dhe subjektive që kanë çuar në një përfundim të tillë, edhe pse ai në gjendjen e studimeve të derisotme rezulton të mos i kapërcejë kufijtë e një narrativi shkencor-filologjik.

Prashtu kur flasim e shkruajmë për mjedis kulturor-fetar parakuptojmë dy faktorë të përbashkët, që janë: a) territori i Shqipërisë së Veriut me rrethina (*Albania Veneta*) që ndajnë së bashku këto dy bashkësi etnike-gjuhësore, të cilat jetojnë në fqinjësi e vise-vise deri në përzjerje multietnike me njëra-tjetrën; e b) së dyti besimi fetar si përbërës po aq themelor në matriksin e kulturës etnike të secilës syresh. Është pikërisht besimi i krishterë i orientuar prej Kurisë së Shenjtë të Vatikanit, i cili nuk njeh as gjuhë e as kufij territorialë në plotësimin e misionit të tij largvajtës që është ungjillëzimi i popujve, bashkë me siç gjëllin i fiksuar edhe në fjalën e Birit të Tinëzot: "Euntes in mundum

universum praedicate evangelium omni creaturae.” (Mk 16 15). Veçse brenda kësaj kornize etnokulturore i jepet përparësi (vetëm) rolit të së ashtuquajturës liturgji e fjalës sllavokishtare si kumt i folur dhe i shkruar në një periudhë bukur të gjatë e që gëzonte si e tillë bekimin e përsëritur të vetë Papës³¹ e të dëshmuar në shekuj prej një tradite të shëndetshme liturgjike-letrare në kroatishten e vjetër. Ndërkohë që mungojnë të dhëna arkivore-dokumentare për liturgjinë e fjalës shqipe në celebrimin e festave liturgjike, që vjen me thënë, nëse ishte e lejuar edhe shqipja si e tillë prej Selisë së Shenjtë të Romës. Është pikërisht kjo rrethanë sikurse edhe gjuha e tekstit të Buzukut që përkon me të folmet e gegnishtes veriperëndimore, të cilat përçojnë natyrshëm atë fill sa logjik aq edhe magjik në gjykimin racional lidhur zgjidhjen e ngërçit paratekstual që lidhet pandërmjetshëm me syzimin dhe sendërtimin e librit të parë të botuar shqip, që njohim deri sot. Prashtu ky gjykim, pas gjase, ka ardhur e ka marrë formë e hedhur shtat sipas një skenari fare të thjeshtë: Në këtë hapësirë të përbashkët multietnike kanë qenë aktivë etër shpirtërorë që mbarështonin besimin njëlloj në këto bashkësi etnike në rrethanat e dy- deri trigjuhësisë. E ndër ta kishte padyshim edhe etër shqipfolës, që në bashkëvajtje me formimin e tyre teologjik-intelektual dhe gjuhësor qenkëshin frymëzuar prej asaj lirie për ushtrimin e liturgjisë së fjalës (edhe) në kroatishten popullore, andaj edhe “paskëshin guxuar” ta gëzojnë këtë liri edhe me shqipen e folur në atë hapësirë³². I tillë pritet të ketë qenë së paku Gjon Buzuku që i paskësh dhënë formë e shtat kësaj ndërmarrjeje, në mos edhe ajo instancë vendore e institucionit të kultit që e paskësh miratuar, në mos edhe financuar produktin e punës së tij. Është bash ky skenar që përcjell si të mirëqenë shfrytëzimin qoftë edhe dytësor të letërsisë liturgjike në kroatishten popullore që e paskësh nxitur dhe kurorëzuar me sukses gjithë këtë ndërmarrje.

Sa i përgjigjet ky arsyetim logjik realitetit kulturor-historik në përfitim të librit të Buzukut? Po mjaftohemi paraprakisht t'i kumtojmë lexuesit, që kjo pyetje është vështirë të marrë një përgjigje konkrete, d.m.th. bindëse, sa kohë që mungon dokumentacioni përkatës, ndërkohë që, siç shtjelluam edhe në disa rubrika të këtij shkrimi, ndikimi kulturor sllav, si i mundshëm dhe dytësor, rrudhet sot për sot vetëm në aparatën grafik (§2) që ka shfrytëzuar Buzuku për realizimin e vepërës së vet.

Një tjetër mjedis kulturor-fetar në aktivitetin e Buzukut si bari shpirtëror i Kishës Katolike Romake dhe hartues i librit të parë të botuar shqip po bëhet

³¹ Për përdorimin e sllavishtes kishtare në liturgji dëshmon së pari breve *Industriae tuae* e Papa Johannes VIII në vitin 880, e cila është përsëritur dhe miratuar në vite e shekuj, si p.sh. prej Papa Innocentius IV në vitin 1248; shih ndër të tjerë Gabrić-Bagarić & Erdman-Pandžić 1997: 8. Hollësisht mbi historikun e lejes së përsëritur për përdorimit të sllavishtes kishtare në shekuj sh. Korolevskij 1958: 111-133.

³² Shih sidomos Camaj 1960: 56vv.

gjithnjë e më i ndjeshëm dhe i prekshëm në diskursin shkencor-filologjik të kohës tonë, i cili fokuson në hulumtim edhe diasporën shqiptare në Italinë e Veriut, përkatësisht aktivitetet e saj intelektuale në periudhën midis fundit të shek. XV dhe gjysmës së parë të shek. XVI prej pinjollësh të tillë intelektualë si Marin Barleti, Marin Biçikemi, Gjon Gazulli, Dhimitër Frangu, etj. Është studiuesja italiane Lucia Nadin ajo që e ka freskuar ndërkohë këtë diskurs lidhur me aktivitetin e mundshëm të Gjon Buzukut si frat françeskan në Convento di San Giobbe në rrethinat e Venedikut (sot Sestiere Cannaregio), ku gjëllinte atëbotë edhe një ngulim i diasporës shqipfolëse³³. Veçse një shqyrtim i hollësishëm i këtij opsioni në zgjidhjen e enigmës së Buzukut dhe të ‘Mesharit’ të tij i kapërcen caqet dhe synimet e këtij shkrimi, duke hapur njëherësh vend për diskutimin e radhës, që ka marrë përsipër ta zhvillojë shkruesi i po këtyre radhëve në një studim të veçantë.

5. Përfundim

Përfundojmë pra këtu studimin tonë, të ndërgjegjshëm se kemi lënë ende hapur, anipse me rezervat e rastit, çështjen e rolit që mund a duhet të ketë luajtur mjedisi kulturor-fetar sllavishtfolës në realizimin e veprës së Buzukut, i cili deri sot nuk mbështetet me kurrfarë dëshmie gjuhësore dhe dokumentacioni arkivor (§4.3). I mundshëm paraqitet ky ndikim, qoftë edhe dytësor, vetëm në aparatin grafik të veprës, meqë kodin alfabetik të Buzukut e përmbyllin pesë shkronja të natyrës cirilike: <□> [v] ‘vjed’, <γ> [u, y] ‘uk’³⁴, <h> [j, c, g] ‘derv’, <ξ> [ð, θ] ‘ksi cyrillic’³⁵, <3> [z] ‘zemlja’ (§2). Përndryshe, ai ndikim disi i kërkuar në gjuhë, stil e përkthim, sikurse edhe ai në organizmin e tekstit në vetvete, prej modelesh të gatshme në traditën liturgjike të kroatishes

³³ Nadin 2012, 2015.

³⁴ Për vlerat fonike e fonologjike të grafemave <□> [v] ‘vjed’, <γ> [u, y] ‘uk’ në tekstin e ‘Mesharit’ shih së fundi Schumacher 2024: 233vv.

³⁵ Këtë grafemë nuk e ndeshim në alfabetin e zakonshëm cirilik të Bosančica-s, khs. Ndër të tjerë Truhelka 1894: 3; Prohaska 1911: 12. Për praninë e tij në tekste të traditës së vjetër të shkrimit kroat me alfabet cirilik (pa të dhëna bibliografike) shih sidomos Jokl 1930: 147; Roques 1932a: 13; së fundi edhe Matzinger 2013: 80, shën. 24, por me informacion të saktë bibliografik mbi përdorimin e rrallë e me vlerë fonike të mirëfilltë të kësaj grafeme në këto shkrime: “Questo grafema cirillico viene usato molto raramente per rendere il greco <ξ> /ks/ nei nomi greci (di solito si scrive invece <kc>); d’altra parte è utilizzato per rendere il valore numerico di 60, vedi p.es. Karskij 1928: 209...”. Në një studim të mëparshëm Matzinger-i kumton me referimet përkatëse se kjo grafemë ndeshet sado rrallë edhe në variantin e cirilik të bosančica-s, veçse pa ndonjë vlerë fonike të veçantë (Matzinger 2010: 453, shën. 181). Interes të veçantë në studimin tonë fiton padyshim edhe konstatimi i Nadin 2012: 293, që e fikson këtë grafemë me vlerën fonike [z] në botimet e Lazaro de Soardi-it (1490-1527) në Venedik.

popullore me alfabet latin, rezulton të ketë qenë e të jetë thjesht fiktiv në diskursin shkencor-filologjik mbi Buzukun dhe veprën e tij (§§3, 4). Janë rezultatet e analizave përfaqëse ndërtekstuale ato që përcjellin bindshëm dhe natyrshëm përfundimin që së paku ndikimi i shumëciturat prej leksionarëve kroatë të shek. XVI sa i përket strukturës dhe organizimit të ‘Mesharit’ të Buzukut nuk i kapërcen sot për sot caqet e një hipoteze pa forcë argumenti, e që nuk mbështetet assesi me atë kornizë paratekstuale që arrijmë ta rindërtojmë brenda mundësive që lejon analiza filologjike e tekstit si të tillë. Andaj është më afërmendësh që në pikëpamje metodike të kërkohen zgjidhje të reja alternative lidhur me syzimin dhe përfitim të librit të parë shqip që njohim deri sot si edhe mbi autorin e tij, Dom Gjon Buzukun d.v.

6. Adenda I: Organizimi i materialit liturgjik në BUM, LBS dhe RL

Siç informuam lexuesin më lart (§4.1.1), tabela e mëposhtme sendërton vertikalisht në katër rubrika rezultatet e përfaqësjes së materialit liturgjik të marrë në analizë për ‘Mesharin’ e Gjon Buzukut (kol[ona] II) me atë të leksionarëve kroatë të Bernardinit të Splitit (1495 – kol. III) dhe të Ranjinas së Dubrovnikut (1508 – kol. IV). Si sinor orientues është marrë edhe në këtë rast MRM (Meshari Romak i Milanos 1474 – kol. I) që qëndron në bazë të botimeve kësodore, së paku deri në botimin e mesharit të reformuar tridentin (1570). Për realizimin e tabelës është ndjekur e njëjta procedurë metodike si në një studim të realizuar ndërkohë (Demiraj 2025 – në shtyp), ku është marrë gjithashtu në analizë organizimi i materialit liturgjik që përmban pjesa e dytë e mesharit. Po ashtu të mbahet parasysh:

- sa u përket referimeve të gabuara dhe lajthitjeve në kumtin e ndonjë perikopeje (pistullie apo ungjilli) për mesha të ndryshme, lejohemi të orientojmë lexuesin në punën e akribtë me citimet e hollësishme gjatë transliterimit të të gjithë tekstit të Buzukut prej Ressulit 1958 e sidomos prej Çabejt 1968 II.
- lidhur me shkurtesat në citimin e teksteve biblike u jemi përmbajtur praktikave të sotme në letërsinë kishtarë të liturgjisë katolike (shih Qendro 2014: 11v.).

Pas këtyre sqarimeve të rastit, shpresojmë që lexuesi do të mund të ndjekë pa vështirësi klasifikimin e materialit liturgjik sipas kalendarit kishtar që ngjerojmë në tri tekstet e marra në analizë, si vijon:

MRM	BUM	LBS	RL
Materiali liturgjik (perikopetë)			
Calendaria	[- mungojnë fol. 27ra-29vb]	-	[f. 323-8]
Ordo ad faciendam aquam benedictam	[-]	-	-
Dominica prima de adventu	Domin. prima Adventus [30ra-rb]	+	+
- Rom 13 11-14	+	+	+
- Lk 21 25-33	+	+	+

Dominica secunda de adventu	Dominica II. In adventu [30rb-vb]	+	+
- Rom 15 4-13	+	+	+
- Mt 11 2-10	+	+	+
Dominica tertia de adventu	Domin. III. In adventu [30vb-31ra]	+	+
- Fil 4 4-7	+	+	+
- Gjon 1 19-28	+	+	+
Feria quarta quatuor temporum de adventu	Feria IV. quatuor temp. [31ra-va]	+	+
- Is 2 2-5	+	+	+
- Is 7 10-15	+	+	+
- Lk 1 26-38	+	+	+
Feria sexta quatuor temporum (de adventu)	Feria VI. quat. temp... [31va-b]	+	+
- Is 11 1-5	+	+	+
- Lk 1 39-47	+	+	+
Sabbato quatuor temporum (de adventu)	Sabbato quat. temp. [31vb-32vb]	+	+
- Is 19 20-22	+	+	+
- Is 35 1-7	+ [Is 35 1-6]	+	+
- Is 40 9 11	+	+	+
- Is 45 1-8	+	+	+
- Dan 3 49, 50, 47, 48, 51	Dan 3 46-56, 58-59	+	Dan 3 49-55
[shih katër rreshta më poshtë]	1 Kor 4 1-5	[-]	[-]
- 2 Sel 2 1-8	+	+	+
- Lk 3 1-6	-	+	+
Dominica quarta de adventu	[32vb [...]]	+	+
- 1 Kor 4 1-5	[shih katër rreshta më lart]	+	+
- Evangelium. Anno quinto decimo. Requ- ire in sabbato precedenti [= Lk 3 1-6]	[- mungojnë fol. 33ra - 36vb]	+	+
In uigilia natiuitatis domini	[-]	+	+
- Rom 1 1-6	[-]	+	+
- Mt 1 18 -21	[-]	+	+
In natiuitate domini. In prima missa	[-]	+	+
- Tit 2 11-15	[-]	+	+
- Lk 2 1-14	[-]	+	+
In secunda missa (natiuitatis)	[-]	+	+
- Tit 3 4-7	[-]	+	+
- Lk 2 15-20	[-]	+	+
Ad missam maiorem	[-]	+	+
- Hebr 1 1-12	[-]	+	+
- Gjon 1 1-14	[-]	+	+
(In sancti stephani prothomartiris)	[-]	+	+
- VA 6 8-10, 7 54-59	[-]	+	+
- Mt 23 34-39	[-]	+	+
(In octaua sancti stephani)	[-]	-	-
- Suspice domine et supra [f. 8b.]	[-]	-	-
(In sancti iohannis apostoli et euangeliste)	[-]	+	+
- Ekl 15 1-6	[-]	+	+
- Gjon 21 19-24	[-]	+	+
(In festo sanctorum innocentium)	[-]	+	+
- Apk 14 1-5	[-]	+	+
- Mt 2 13-18	[-]	+	+
(In sancti thomae episcopi et martiris)	[-]	+	+
- Hebr 5 1-6	[-]	+	+
- Evangelium....Require in dominica pri- ma post octauam pasce [= Gjon 16 16- 22]	[-]	+	+
Dominica infra octauam natiuitatis Domini	[-]	+	+

- Gal 4 1-7	[-]	+	+
- Lk 2 33-40	[-]	+	+
In Sancti Siluestri Pape et confessoris	[-]	+	+
- Epistola...Require in comuni unius confessoris pontificus [=]	[-]	+	+
- Evangelium... Require ubi epistola	[-]	+	+
In ocatua natiuitatis Domini	[-]	+	+
- Epistola...Require in prima misa natiuitatis domini [= Tit 2 11-15]	[-]	+	+
- Lk 2 21	[-]	+	+
In uigilia epiphanie Domini	[-]	+	+
- Mt 2 19-23	[-]	+	+
In epiphania domini	In Epiphania domini [37ra-b]	+	+
- Is 60 1-6	+	+	+
- Mt 2 1-12	+	+	+
Dominica infra octauam epiphanie	Dom. infra oct. Epi. [37rb-vr]	+	+
- Rom 12 1-5	+	+	+
- Lk 2 42-52	+	+	+
In octaua epiphanie (domini)	In octaua epiphaniae [37vb-38ra]	+	+
- Epistola...Require in die epiphanie [= Is 60 1-6]	+	+	+
- Gjon 1 29-34	+	+	+
Dominica secunda post epiphaniam	Dominica II. post epi. [38ra-b]	+	+
- Rom 12 6-16	+	+	+
- Gjon 2 1-11	+	+	+
Dominica tertia post epiphaniam	Dom. tertia post Epiphania [38rb-vb]	+	+
- Rom 12 16-21	+	+	+
- Mt 8 1-13	+	+	+
Dominica quarta post epiphaniam	Dom. IV post epi. [38vb-39ra]	+	+
- Rom 13 8-10	+	+	+
- Mt 8 23-27	+	+	+
Dominica quinta post epiphaniam Domini	Dom. V. post epi. Domini [39ra-b]	+	+
- Kol 3 12-17	+	+	+
- Mt 13 24-30	+	+	+
Dominica in septuagesima	[Mungon titulli i meshës - 39rb-vb]	+	+
- 1 Kor 9 24-27, 10 1-4	+	+	+
- Mt 20 1-16	+	+	+
Dominica in sexagesimal	Dom. in sexagesima [39vb-40va]	+	+
- 2 Kor 11 19-33, 12 1-9	2 Kor ...12 1-10	+	+
- Lk 8 4-15	+	+	+
Dominica in quinquagesima	Dom. in quinquag. [40va-41ra]	+	+
- 1 Kor 13 1-13	+	+	+
- Lk 18 31-43	+	+	+
Feria quarta cinerum	Feria quarta cinerum [41ra-va]	+	+
- Joel 20 12-19	+	+	+
- Mt 6 16-21	+	+	+
Feria quinta post cineres	Feria V. post cinerem [41va-42ra]	+	+
- Is 38 1-6	+	+	+
- Mt 8 5-13	+	+	+
Feria sexta post cineres	Feria VI. post cinerem [42ra-va]	+	+
- Is 58 1-9	+	+	+
- Mt 5 43-48, 6 1-4	+	+	+
Sabbato post cineres	Sabbato quat. temp. [42va-43ra]	+	+
- Is 58 9-14	+	+	+
- Mk 6 47-56	+	+	+

Dominica prima in quadragesima	Dom. prima in quadrag. [43ra-va]	+	+
- 2 Kor 6 1-10	+	+	+
- Mt 4 1-11	+	+	+
Feria secunda post domin. I. in quadragesima	Feria secundav[43va-44ra]	+	+
- Ezek 34 11-16	+	+	+
- Mt 25 31-46	+	+	Mt 25 31-45
Feria tertia post dominica I. in quadragesima	Feria tertia [44ra-va]	+	+
- Is 55 6-11	+	+	+
- Mt 21 10-17	+	+	+
Feria IV. quatuor temporum in quadragesima	Feria quarta [44va-45ra]	+	+
- Eks 24 12-18	+	+	+
- (Lectio libri regum) 3 Mbret 19 3-8	+	+	+
- Mt 12 38-50	+	+	+
Feria quinta post dominica I. in quadragesima	Feria quinta [45ra-va]	+	+
- Ezek 18 1-9	+	+	+
- Mt 15 21-28	+	+	+
Feria sexta quatuor temporum in quadragesima	Feria sexta [46va-46ra]	+	+
- Ezek 18 20-28	+	+	+
- Gjon 5 1-15	+	+	+
Sabbato quatuor temporum in quadragesima	Sabbato quatuor temp. [46ra-vb]	+	+
- Deut 26 15-19	+	+	+
- Deut 11 22-25	+	+	+
- 2 Makab 1 23	2 Makab 1 23, 2-5	2 Makab 1 23, 1 2-5	2 Makab 1 23, 2-5
- Ekl. 36 1-10	+	+	+
- [= Dan 3 49-51]	-	-	Dan 3 49-51
- 1 Sel 5 14-23	+	+	+
- Mt 17 1-9	[= Mt 17 1-9]	+	+
Dominica secunda in quadragesima	Dom. II. in quadrag. [46vb-47ra]	+	+
- 1 Sel 4 1-7	+	+	+
- [= Mt 17 1-9]	[= Mt 17 1-9]	+	+
Feria II. post dominicam II. in quadragesima	Feria II. in domin. II. quadrag. 47ra	+	+
- Dan 9 15-19	+	+	+
- Gjon 8 21-29	+	+	+
Feria tertia post domin. II. in quadragesima	Feria tertia [47rb-vb]	+	+
- 3 Rg 17 8-16	+	+	+
- Mt 23 1-12	+	+	+
Feria quarta post domin. II. in quadragesima	Feria quarta [47vb-48rb]	+	+
- Est 13 9-11, 15-17	Est 8/9-11, 15-17	+	+
- Mt 20 17-28	+	+	+
Feria quinta post domin. II. in quadragesima	Feria V. in secunda Dom. [48rb-vb]	+	+
- Jer 17 5-10	+	Jer 17 5-7	+
- Lk 16 19-31	+	-	+
Feria sexta post dominicam II. in XL	Feria VI. in II. Dom. XL [48vb-50ra]	+	+
- Gjen 37 6-22	+	-	+
- Mt 21 33-46	+	Mt 21 34-46	+
Sabbato post dominicam II. in quadragesima	Sab. post II. Dom. XL [50ra-50va]	+	+
- Gjen 27 6-39	Gjen 27 6-40	Gjen 27 6-40	+
- Lk 15 11-32	+	+	+
Dominica tertia in quadragesima	Dominica tertia in XL [50va-51ra]	+	+
- Efes 5 1-9	+	+	+
- Lk 11 14-28	+	+	+
Feria secunda post domin. III. in quadragesima	F. II. post III. Dom. XL [51ra-vb]	+	+
- 4 Mbret 5 1-15	+	+	+

- Lk 4 23-30	+	+	+
Feria tertia post domin. III. in quadragesima	F. III. post III. D. XL [51vb-52ra]	+	+
- 4 Mbret 4 1-7	+	+	+
- Mt 18 15-22	+	+	+
Feria quarta post domin. III. In quadragesima	F. IV. post III. Do. XL [52ra-52va]	+	+
- Eks 20 12-24	+	+	+
- Mt 15 1-20	+	+	+
Feria quinta post domin. III. in quadragesima	F. V. post III. D. XL [52va-53ra]	+	+
- Jer 7 1-7	+	+	+
- Lk 4 38-44	[= Lk 4 38-44]	+	+
Feria sexta post domin. III. in quadragesima	F. VI. post III. D. XL [53ra-53vb]	+	+
- Num. 20 2-3, 6-13	+ [Num. 22 1, 3 dhe 6-13]	+	+
- Gjon 4 5-42	+	+	+
Sabbato post dominicam IV. In quadragesima	Sab. post III. D. XL [53vb-55ra]	+	+
- Dan 13 1-62	Dan. 13 1-9, 14-17, 19-30, 33-62	+	[= BUM]
- Gjon 8 1-11	+	+	+
Dominica quarta in quadragesima	[Mungon titulli – 55ra-va]	+	+
- Gal 4 22-31	+	+	+
- Gjon 6 1-14	Gjon 6 1-15	+	+
Feria II. post dominicam IV in quadragesima	F. II. post IV. D. XL [55va-56ra]	+	+
- 3 Mbret 3 16-28	+	+	+
- Gjon 2 13-25	+	+	+
Feria III. post dominicam IV in quadragesima	F. III. post IV. D. XL [56ra-vb]	+	+
- Eks 32 7-14	+	+	3 Rg ?
- Gjon 7 14-31	+	+	+
Feria Quarta post dominicam IV. in XL	F. IV. post IV. D. XL [56vb-57va]	+	+
- Ezek 36 23-28	+	+	+
- Is 1 16-19	+	+	+
- Gjon 9 1-38	+	+	+
Feria quinta post dominicam IV. in XL	F. V. post IV. D. XL [57va-58ra]	+	+
- 4 Mbret 4 25-38	+	+	4 Mbret 4 25-31, 36-8
- Lk 7 11-16	+	+	+
Feria sexta post dominicam IV. in XL	F. VI. post IV. D. XL [58ra-59ra]	+	+
- 3 Mbret 17 17-24	+	+	+
- Gjon 11 1-45	+	+	+
Sabbato post dominicam IV. in quadragesima	Sabbato [59ra-59va]	+	+
- Is 39 8-15	+	+	+
- Gjon 8 12-20	+	+	+
Dominica de passione	Dominica in passione [59va-60ra]	+	+
- Hebr 9 11-15	+	+	+
- Gjon 8 46-59	+	+	+
Feria secunda post dominicam de passione	Feria II. in Dom. passio. [60ra-b]	+	+
- Jon 3 1-10	+	+	+
- Gjon 7 32-39 LXrb	+	+	+
Feria tertia post dominicam de passione	F. III. in Dom. pass. [60rb-59/1ra]	+	+
- Dan 14 28-42	Dan 14 27, 28-42	+	+
- Gjon 7 1-13	+	+	+
Feria quarta post dominicam de passione	F. IV. in Dom. pass. [59/1ra-va]	+	+
- Lev 19 1-2, 11-19	+	+	+
- Gjon 10 22-38	+	+	+
Feria quinta post dominicam de passione	Feria quinta [59/1va-62ra]	+	+
- Dan 3 34-45	Dan 3 25, 34-45	+	+
- Lk 7 36-50	+	+	+

Feria sexta post dominicam de passione	F. VI. post Dom. de pass. [62ra-va]	+	+
- Jer 17 13-18	+	+	+
- Gjon 11 47-54	+	+	+
Sabbato post dominicam de passione	Sabbato in passione [62va-63ra]	+	+
- Jer 18 18-23	+	+	+
- Gjon 12 10-36	+	+	+
In beneditione palmarum	In Dominica palmarum [63ra-va]	+	+
- Eks 15 27, 16 1-7	+	+	+
- Mt 21 1-9	+	+	+
In dominica in palmis	In dom. oliv. ad mis. [55/1-56/1ra]	+	+
- Fil 2 5-11	+	+	+
- Mt 26 1-75, 27 1-61, 62-66	Mt 26 1-75, 27 1-66	+	+
Feria secunda maioris hebdomadae	Feria II. in dom. palm. [56/1ra-b]	+	+
- Is 50 5-10	+	+	+
- Gjon 12 1-9	+	+	+
Feria tertia maioris hebdomadae	Feria III in dom. palm. [56/1rb-va]	+	+
- Jer 11 18-20	+	+	+
- Mk 14 1 – 15 46 (Passio domini nostri yhesu christi)	+ [Pasionenë thuaje për letërë = Mk 14 1 – 15 46]	+	+
Feria quarta maioris hebdomadae	F. IV. dom. palm. [56/1va-57/1ra]	+	+
- Is 62 1-12, 63 1-7	+	+	+
- Is 53 1-10, 12	Is 53 1-12	+	+
- Lk 22 1 – 23 49; 23 50-53 (Passio domini nostri yhesu christi. Secundum lucam)	+ [Pasionenë ecë e vgjaj për letërë me e thanë = Lk 22 1 – 23 49; 23 50-53]	+	+
Feria quinta in cena Domini	Feria V. in cena Dom. [57/1ra-vb]	+	+
- 1 Kor 11 20-32	+	+	1 Kor 11 20-31
- Gjon 13 1-15	+	+	+
Feria sexta in parasceue	F. VI. in parasc. [57/1vb-59/1va]	+	+
- Hos 6 1-6	+	+	+
- Eks 12 1-11	+	+	+
- Finito tractu Passio super nudum pulpitem dicitur. (Passio domini nostri yhesu christi. Secundum Iohannem) Gjon 18 1-40; 19 1 37; 19 38-42	+ [Pasiona e tinë Zot Jezu Krishti porsì shkrou Gjoni Cap XVIII = Gjon 18 1-40; 19 1-42]	+	+
In Sabbato Sancto	Sab. S. Profetia [59/1va-62/1vb]	+	+
- (Prof. prima geneses) Gjen 1 1-31 – 2 2	+	+	+
- (Profetia secunda genesis) Gjen 5 31; 6 1-7, 13-22; 7 6, 11-14, 18-24; 8 1-3, 6-12, 15-21	E dyta Lekcion e Gjenezit: Gjen 5 31; 6 1-22; 7 1-24; 8 1-21	+	+
- (Profetia tertia genesis) Gjen 22 1-19	Lectio tertia Genezis	+	+
- (Profetia quarta exodi) Eks 14 24 – 15 1	Lectio quarta Libri Esodi	+	+
- (Profetia quinta ysaie) Is 54 17; 55 1-11	Lectio quinta e Izaie profete	+	+
- (Profetia [sexta] exodi) Bar 3 9-38	Lectio sexta Baruch profetë	+	+
- (Profetia septima ezechielis) Ezek 37 1-14	Lektio sept. Ezechielis Profete	+	Ezek 37 1-3
- (Profetia octava ysaie) Is 4 1-6	Lektio octava	+	[mungojnë f. 120-1 të dorëshkr. Origjinal]
- (Profetia nona exodi) Eks 12 1-11	[numërim i gabuar] Lektio X Ezodi XII Ecë e vgjaj të anenë ëmbas Dominica de Passione	+	[-]
- (Profetia xª Ione prophete) Iona 3 1-10	[numërim i gabuar] Lektio XI Joneh Profete Ecë e vgjaj të anenë ëmbas Dominica de Passione	+	[-]
- (Profetia xj deuteronomij) Deut 31 22-30	Lectio deuteronomii	+	[-]

- (Profetia xij* danielis) Dan 3 1-24	[- mungon fol 63/1ra-vb]	+	Dan 3 4-24 [mungon f. 121 në fund Dan 1-3]
- Kol 3 1-4	[-]	+	+
- Mt 28 1-7	[-]	+	+
Rubricae	[-]	-	-
Dominica resurrectionis domini	[-]	+	+
- 1 Kor 5 7-8	[-]	+	+
- Mk 16 1-7	Mk 16 1-7 [64/1ra]	+	+
Feria secunda post pascha	Feria II. post pascha [64ra-va]	+	+
- VA 10 37-43	+	+	+
- Lk 24 13-35	+	+	+
Feria tertia post pascha	Feria III. post resurr. [64vb-65ra]	+	+
- VA 13 16, 26-33	+	+	+
- Lk 24 36-47	+	+	+
Feria quarta post pascha	Feria quarta [65ra-va]	+	+
- VA 3 12-19	+	+	VA 3 13- 15, 17-19
- Gjon 21 1-14	+	+	+
Feria quinta post pascha	Feria V. post pascha [65va-66ra]	+	+
- VA 8 26-40	+	+	+
- Gjon 20 11-18	+	+	+
Feria sexta post pascha	Feria sexta [66ra-b]	+	+
- 1 Petr 3 18-20	1 Petr 3 18-22	+	1 Petr 3 18-22
- Mt 28 16-20	+	+	+
Sabbato in albis	Sab. post resurrection. [66rb-vb]	+	+
- 1 Petr 2 1-10	+	+	+
- Gjon 20 1-9	+	+	+
Dominica in octaua pasche	Dom. in octaua pasche [66vb-67ra]	+	+
- 1 Gjon 5 4-10	+	- Jak 5 16-20	+
- Gjon 20 19-31	+	+	+
Dominica secunda post pascha	Dom. II. post resurrection. [67ra-b]	+	+
- 1 Petr 2 21-25	+	+	+
- Gjon 10 11-16	+	+	+
Dominica tertia post pascha	Dom. III. post pascha [67rb-67vb]	+	+
- 1 Petr 2 11-19	+	+	+
- Gjon 16 16-22	+	+	+
Dominica quarta post pascha	Dom. IV. post pascha [67vb-68rb]	+	+
- Jak 1 17-21	+	+	+
- Gjon 16 5 14	+	+	+
Dominica quinta post pascha	Dominica V. post pascha [68rb-va]	+	+
- Jak 1 22-27	+	+	+
- Gjon 16 23-30	+	+	+
In letaniis maioribus	Feria II. In letan. maior. [68va-b]	+	+
- Jak 5 16-20	+	+	+
- Lk 11 5-13	+	+	+
In vigilia ascensionis Domini	[mungon]	+	+
- Epistola ad ephesios: Require in natiuitate plurimorum apostolorum [= Efes 4 7-13]	-	+	+
- Gjon 17 1-11	-	+	+
In festo ascensionis Domini	In ascensione Dom. [68vb-69rb]	+	+
- VA 1 1-11	+	+	+
- Mk 16 14-20	+	+	+

Dominica infra octava ascensionis	Dom. infra oct. ascension. [69rb-va]	+	+
- 1 Petr 4 7-11	+	+	+
- Gjon 15 26 - 16 4	[Të zanëtë ënfill të Ungjillit shenjtë pors shkrou Gjoni: Ecë e vgaj të parënë të diel mbas Ërshajesh = Gjon 15 26 - 16 4]	+	+
In vigilia pentecostes	Sab. in vigil. Penthecost. [69va-b]		
Postea leguntur prophetie sinë titullo... Prophete omnes et tractus dicuntur de Sabbato sancto...	Këtu janë me u thane shtatë lekcion[a].	+	+
- VA 19 1-8	+	+	+
- Gjon 14 15-21	+	+	+
In die pentecostes	In die pentecostes [69vb-70rb]	+	+
- VA 2 1-11	+	+	+
- Gjon 14 23-31	+	+	+
Feria secunda post pentecosten	Feria II. post pentecostes [70rb-vb]	+	+
- VA 10 34, 42-48	+	+	+
- Gjon 3 16-21	+	+	+
Feria tertia post pentecosten	F. III. post pentecostes [70vb-71ra]	+	+
- VA 8 14-17	+	+	+
- Gjon 10 1-10	+	+	+
Feria quarta post pentecostes	F. quarta post pentecostes [71ra-b]	+	+
- VA 2 14-21	+	+	+
- VA 5 12-16	-	+	+
- Gjon 6 44-52	+	+	+
Feria quinta post pentecosten	Feria V. post pentecostes [71rb]	+	+
- VA 8 5-8	+	+	+
- Lk 9 1-6	+	+	+
Feria sexta post pentecosten	[mungon titulli i meshës – 71va-b]	+	+
- Joel 2 23-27	+	+	+
- Lk 5 17-26	+	+	+
Sabbato post pentecosten	Sab. post pentecostes [71vb-72va]	+	+
- Prophetia prima: Joel 2 28-32	Joel 2 28-32	+	+
- Proph. secund. Lev 23 9-11; 15-17; 20-21	Lectio II.: Lev 23 9-11; 15-17; 20-21	+	+
- Prophetia tertia: Deut 26 1-11	Lectio tertia: Deut 26 1-11	+	+
- Prophetia quarta: Lev 26 3-12	Lectio quarta: Lev 26 3-12	+	+
- Prophetia quinta: Dan 3 49	Lectio V. [...]	+	Dan 3 49-55
- Rom 5 1-5	+		+
[mungon]	Lk 4 38-44	Lk 4 38-44	Lk 4 38-44
In festo SS. Trinitatis	In die S. Trinitatis [72va-73ra]	+	+
[mungon]	1 Gjon 4 8-21 [shih më poshtë - Dominica prima post Pentecostem]	+	+
- 2 Kor 13 11, 13	2 Kor 13 11-13	2 Kor 13 11, 13	2 Kor 13 11, 13
- Gjon 16 4 [?]	Gjon 15 26-27; 16 1-4	Gjon 15 26 – 16 4	Gjon 15 26 – 16 4
Dominica prima post Pentecostem	-	+	+
- 1 Gjon 4 8-21	[shih lart: In die S. Trinitatis]	+	+
- Lk 6 36-42	-	+	+
In festo glorissimi corporis Christi	In sexto glor. Corp. Christi [73ra-b]	+	+
- 1 Kor 11 23-29	+	+	+
- Gjon 6 56-59	+	+	+
Domin II. post pentecosten	Domin. II. post pent. [73rb-vb]	+	+
- 1 Gjon 3 13-18	+	+	+
- Lk 14 16-24	+	+	+

- [RL 231: Leccj. dela epistola dj s. Giov. Apostollo dicesj la prima dom. dopo la pentecoste nel c. IIII. / V.]	-	-	+
- [I Gjon 4 8-21]	-	-	+
- [Lk 6 36-42]	-	-	+
Dominica III. post pentecosten	Domin. III. post pent. [73vb-74ra]	+	+
- 1 Petr 5 6-11	+	+	+
- Lk 15 1-10	+	+	+
Dominica IV. post pentecosten	Dominica IV. post pent. [74ra-b]	+	+
- Rom 8 18-23	+	+	+
- Lk 5 1-11	+	+	+
Domin quinta post pentecosten	Domin. V. post pent. [74rb-vb]	+	+
- 1 Petr 3 8-15	+	+	+
- Mt 5 20-24	+	+	+
Dominica sesta post pentecosten	Domin. VI. post pent. [74vb-75ra]	+	+
- Rom 6 3-11	+	+	+
- Mk 8 1-9	+	+	+
Dominica septima post pentecosten	Dominica VII. post pent. [75ra-b]	+	+
- Rom 6 19-23	+	+	+
- Mt 7 15-21	+	+	+
Dominica octaua post pentecosten	Domin. VIII. post pent. [75rb-vb]	+	+
- Rom 8 12-17	+	+	+
- Lk 16 1-9	+	+	+
Dominica [nona] post pentecosten	Domin. IX. post pent. [75vb-76ra]	+	+
- 1 Kor 10 6-13	+	+	+
- Lk 19 41-47	+	+	+
Dominica decima post pentecosten	Dom. X. post pentecostes [76ra-b]	+	+
- 1 Kor 12 2-11	+	+	+
- Lk 18 9-14	+	+	+
Dominica undecima post pentecosten	Dom. XI. post pent. [76rb-va]	+	+
- 1 Kor 15 1-10	+	+	+
- Mk 7 31-37	+	+	+
Dominica duodecima post pentecosten	Dom. XII. post pent. [76va-77ra]	+	+
- 2 Kor 3 4-9	+	+	+
- Lk 10 23-37	+	+	+
Dominica XIII. post pentecosten	Dom. XIII. post pent. [77ra-b]	+	+
- Gal 3 16-22	+	+	+
- Lk 17 11-19	+	+	+
Dominica XIV. post pentecosten	Dom. XIV. post pent. [77rb-vb]	+	+
- Gal 5 16-24	+	+	+
- Mt 6 24-33	+	+	+
Dominica decima quinta post pentecostes	Dom. XV. post pent. [77vb-78ra]	+	+
- Gal 5 25 – 6 1-10	+	+	+
(Secundum Lucam) Require in feria quinta post dominicam quartam in quadragesima [= Lk 7 11-16]	[Ungjillë ecë e vgaj të katërtënë të diel ëndë Këreshmë ferienë e pestë = Lk 7 11-16]	+	+
Dominica sexta decima post pentecosten	Dominica XVI. post pent. [78ra-b]	+	+
- Efes 3 13-21	+	+	+
- Lk 14 1-11	+	+	+
Dominica decima septima post pentecosten	Dom. XVII. post pent. [78rb-va]	+	+
- Efes 4 1-6	+	+	+
- Mt 22 34-46	+	+	+
Feria IV. quattuor temporum septembris	F. IV. q. t. septemb. [78va-79rb]	+	+
- Amon 9 13-15	+	+	+
- Ester 8 1-10	+	+	+

- Mk 9 16-28	+	+	+
Feria VI. quattuor temporum septembris	F. VI. q. t. in mens. Sept. [79rb]	+	+
- Hos 14 2-10	+	+	+
Require in quinta feria post dominicam de passione [= Lk 7 36-50]	Ungjillë ecë e vgjaj ferienë e pestë ëndë të dielt të Pasionësë [= Lk 7 11-16]	+	+
Sabbato quat. temporum mensis septembris	Sab. q. t. mens. Sept. [79rb-80rb]	+	+
- Prophetia prima: Lev 23 27-32	+ [Lectio libri Lev 23 27-32]	Lev 23 26-32	Lev 23 26-32
- Prophetia secunda: Lev 23 39-43	+ [Lectio libri Lev 23 39-43]	+	+
- Prophetia tertia Mi 7 14, 16, 18, 20	+ [Lectio Mi 7 14, 16, 18-20]	+	+
- Prophetia quarta Za 8 1, 14-9	+ [Lectio Za 8 14-9]	Za 8 14-19	Za 8 14-19
- Prophetia quinta Dan 3 42	-	Dan 3 49-55	Dan 3 49-55
- Hebr 9 2-12	+	+	+
- Lk 13 6-17	+	+	+
Dominica decima octava post pentecosten	Domin. X. octava post pent. [80va]	+	+
- 1 Kor 1 4-8	+	+	+
- Mt 9 1-8	+	+	+
Dominica XIX. post pentecosten	Dom. XIX. post pent. [80va-81ra]	+	+
- Efes 4 23-28	+	+	+
- Mt 22 2-14	Mt 22 1-14	+	Mt 22 1-14
Dominica XX. Post pentecosten	Dom. XX. post pent. [81ra-b]	+	+
- Efes 5 15-21	+	+	+
- Gjon 4 46-53	+	+	+
Dominica XXI. post pentecosten	Dom. XXI. post pent. [81rb-va]	+	+
- Efes 6 10-17	+	+	+
- Mt 18 23-35	+	+	+
Dominica XXII. Post pentecosten	Dom. XXII. post pent. [81va-b]	+	+
- Fil 1 6-11	+	+	+
- Mt 22 15-21	+	+	+
Dominica XXIII. Post pentecosten	Dom. XXIII. p. pent. [81vb-82rb]	+	+
- Fil 3 17 21, 4 1-3	+	+	+
- Mt 9 18-26	+	+	+
Dominica XXIV. post pentecosten	Dom. XXIV. p. pent. [82rb-vb]	+	+
Kol 1 9-14	+	+	+
Mt 24 15-35	+	+	+
INCIPIT OFFITIUM PROPRIUM SANCTORUM	[mungon titulli i rubrikës]	+	+
In uigilia Sancti Andree apostoli	In v. S. Andree apost. [82vb-83ra]	[mungon]	+
Epistola...Require in comuni in uigilia unius apostoli [= Ekl 44 5 – 45 9]	Ekl 44 26-27; 45 2-9	-	Ekl 44 26-27, 45 2-9
Gjon 1 35-51	+	-	+
In die Sancti Andree apostoli	In sexto S. Andree apost. [83ra-b]	+	+
Rom 10 -18	+	+	+
Mt 4 18-22	+	+	+
(In Sancti Nycolay confessoris)	In S. Nicholaih confes. [83rb-va]	-	-
Oratio	+	-	-
Post communionem	+	-	-
(In Sancti Damasi confessoris)	[mungon]	-	-
(In sancte Lucie, uirginis. et martyris)	[mungon]	-	-
(In Sancti Thome apostoli)	In Sancti Thome Apostoli [83va-b]	+	+
Epistola...Require in uigilia sancte thome. Benedictio domini caput [= Ekl 44 5 – 45 9]	+ [Ekl 44 26-27; 45 2-9]	+	+
Gjon 20 24-29	+	+	+

(In Sancti Felicis in Pincis)	[mungan]	-	-
(In sancti Marcelli Pape et martyris)	[mungan]	-	-
(In sancte prisce. uirginis et martyris)	[mungan]	-	-
In sanctorum martirium Mauriti Marthe audifax et Abbacum	[mungan]	-	-
In sanctorum Martirum Fabiani et Sebastiani	In S. Mart. Fab. et Sebast. [83vb]	-	+
Require in communi martirum: [?]	[+]	-	Hebr 11 33-39
Require ut supra: [?]	[+]	-	Lk 6 17-23 [+ f. 319]
In sancte Agnesis. Uirginis et martiris	[mungan]	-	+
Episola: Require in communi Uirginum [?]	-	-	Ekl 51 1-8, 12
Evangelium: Require ut supra [?]	-	-	Mt 25 1-13
In sanctorum martirum Uincentii et Anastasii	[mungan]	-	-
In conuersione S. Pauli	In conuersione S. Pauli [83vb-84rb]	+	+
VA 9 1-22	+	+	+
Euangelium: Require in communi apostolorum	Të zanëtë e ënfill të Ungjillit shenjtë pors shkrou Matheq. Ecë e vgjaj ëndë Komut të apostojt e të vangjelistëvet. Capitulo XIX. [?]	Mt 19 29-29	Mt 19 27-29
In Sancte Agnesis secundo	-	-	-
In festo purificationis beate Marie uirginis	In purif. beate Marie [84rb-va]	+	+
Mal 3 1-4	+	+	+
Lk 2 22-32	Lk 2 21-32	+ Lk 2 22-32	+ Lk 2 22-32
In sancte Agathe Uirginis et martiris	[mungan]	-	-
In sancti Ualentini presbiteri et martiri	[mungan]	-	-
- [mungan – In festo s. Symeonis prophete]	[mungan]	+	[në fund]
In Cathedra Sancti Petri	[mungan]	+	+
1 Petr 1 1-7	-	+	+
[Euangelium... = Mt 16 13-19]	-	+	+
In sancti Mathie Apostoli	In die S. Mateih apostoli [84va-b]	+	+
VA 1 15-26	+	+	+
Euangelium...Require in communi plurimorum martirum = Mt 11 25-30	Ungjillë ecë e vgjaj ëndë Komut të Apostojt	+	+
In sanctorum Uirginum et martirum perpetue et felicitatis	[mungan]	-	-
In Sancti Gregorii Pape et confessoris	In S. Gregori Pape et conf. [84vb]	-	+
Epistola...Require in communi confessorum = 2 Tim 4 1-8	-	-	+
Euangelium...Require in comuni unius confessoris pontificis = Mt 5 13-19	-	-	+
In sancti Benedicti abbat	-	-	-
In Annuntiatione Beate Marie Uirginis	In A. Beate Marie Uirgin. [84vb-85ra]	+	+
Lectio ysaie prophete: Require in quarta feria quat. tem. de adventu = Is 7 10-15	Ecë e vgjaj ëndë Temporajt të Adventit [+]	+	+
Euangel.: Require in feria quarta quatuor temporum de aduentu = Lk 1 26-38	[+]	+	+
In sanctorum Martirum Tiburtii, Ualeriani et Maximi	-	-	-
In S. Georgi martiris	-	-	-
In Sancto Marco Evangelista	In S. Marco Evangelista [85ra]	+	+
Oratio	+	+	-
[?]	-	+	Ezek 1 10-14
[?]	-	+	Lk 10 1-9

Post communionem	+	-	-
In sancti Uitalis martiris	-	-	-
In sanctorum apostolorum Phylippi et Iacobi	In S. Mart. t.Philipi et Iacobi [85ra-b]	-	+
Epistola...Require in communi martirum post pasca	Pistullinë ecë e vgjaj ëndë Komüt të Munduosit	-	Sap 5 1-5
Gjon 14 1-13	+	-	Gjon 14 1-13
In inuentione Sancte Crucis	In inuent. Sancte Crucis [85rb-va]	+	+
Fil 11 5-11	Pistullinë ecë e vgjaj të Dielë e Endet = Fil 11 5-11	+	Gal 5 10-12, 6 12-14
Gjon 3 1-15	+	+	+
In sancttorum Martirum alexandri...	[mungon]	-	-
In sancttorum Martirum Gordiani	[mungon]	-	-
In sancttorum Martirum Nerei	[mungon]	-	-
In sante potentiane uirginis	[mungon]	-	-
In sancti Urbani Pape et martiris	[mungon]	-	-
In sanctorum martirum Marcelini et...	[mungon]	-	-
In sanctorum martirum Primi et...	[mungon]	-	-
In sancti Barnabe apostoli	[mungon]	-	-
In sanctorum martirum Basilidis...	[mungon]	-	-
In sancti Antoni Confessoris	[mungon]	-	-
In sanct. martirum Uiti	[mungon]	-	-
In sanct. martirum Marci et Marcelani	[mungon]	-	-
In sanctorum martirum Geruasii et...	[mungon]	-	-
- [LBS: In sancti Antonii de Padua]	[mungon]	+	-
- [LBS: Sap ? – Ć. knig od mudrosti]	[mungon]	+	-
- [LBS: Evangelium...require in natali confessorum]	[mungon]	+	-
In uigilia S. Ioannis Baptiste	In uigilia S. I. Baptiste [85va-86ra]	-	-
Jer 1 4-10	+	-	-
Lk 1 5-17	+	-	-
In Natiuitate Sancti Iohannis Baptiste	In die S. Iohannis Baptiste [86ra-b]	+	+
Is 49 1-3, 5, 6, 7	Is 49 1-7	+	Is 49 1-3, 5-7
Lk 1 57-68	+	+	+
In sanctorum martirum Iohannis et Pauli	[mungon]	-	-
In sancti Leonis Pape et Confessoris	[mungon]	-	-
In uigilia apostolorum Petri et Pauli	In uigilia Petri et Pauli [86rb-va]	-	+
VA 3 1-10	+	-	+
Gjon 21 15-19	+	-	-
In die apostolorum Petri et Pauli	In die apost. Petri et Pauli [86va-b]	+	+
VA 12 1-11	+	+	+
Mt 16 13-19	+	+	+
In commemoratione Sancti Pauli	In commem. S. Pauli [86va-87rb]	+	+
Gal 1 11-20	+	+	+
Evangelium...Require in communi apostolorum [= Mt 19 27-29 ?]	Ungjillë ecë e vgjaj ndë Kommüt te Apostojet.	+	+
Offitium visitationis Marie. Require ante infra octauam apostolorum omnia...	In uisitatione Beate Marie [87ra-b]	+	+
Require ante† infra octauam apostolorum omnia dicuntur ad missam de communi apostolorum preter orationem	- KK 2 8-14 - Lk 1 39-47	+	+
In sanctorum Martirum / Processi et...	[mungon]	-	-
In octaua apostolorum Petri et Pauli	In oct. a. Petri et Pauli [87rb-va]	+	+
Epistola...Require in communi plurimorum martirum	Pistullinë ecë e vgjaj ndë Komüt të shumëve Martuj	+	+

Mt 14 22-33	+	+	+
In sanctorum Martirum septem fratrum et sanctum rufine...	[mungon]	-	+
Prov 31 10-31	-	-	+
Mt 12 46-50	-	-	Mt 47-50
In sanctorum martirum Naboris et Felices	[mungon]	-	-
In sancte Praxedis uirginis	[mungon]	-	-
In sancte Marie Magdalene	In S. Marie Magdalene [87va-vb]	+	+
Epistola... Require supra in sanctorum septem fratrum = Prov 31 10-31	+	+	+
Euangelium...Require in feria quinta post dominicam de passione [= Lk 7 36-50]	Ungjillë ecë e vgjaj ndë të Dielt të Pasionesë. Feria quinta	+	+
In sancti Appolinaris episcopi et martiris	In s. Appol. martiris [87vb-88ra]	-	+[f. 318vv.]
[?]	Pistullinë ecë e vgjaj ndë komūt të njëj Martiri iustus cor suum	-	-
Lk 22 24-30	+	-	+
- [Mt 5 1-12]	-	-	+
- [Lk 6 17-23]	-	-	-
- [Lk 11 47-54]	-	-	+
- [Lk 11 25-30]	-	-	+
In Sancti Jacobi apostoli	In S. Jacobi apostoli [88ra]	+	+
Epistola...Require in communi in uigilia plurimorum postolorum [= Efes 1 3-8]	Pistullinë ecë e vgjaj ëndë Komūt të Munduonet	+	+
Mt 20 20-23	+	+	+
In sanctorum martirum nazarii et Celsi...	[mungon]	-	-
In sanctorum martirum Felicis Simlitii....	[mungon]	-	-
In sancte Marthe	[mungon]	-	-
In sanctorum Martirum Abdon et Senen	[mungon]	-	-
In sancti Petri ad Uincula	[mungon]	+	+
Epistola...Require... [= VA 12 1-11]	-	+	+
Euangelium...Require... [= Mt 16 13-19]	-	+	+
In sancti Stephani Pape et martiris	[mungon]	-	-
In sancti Dominici confessori	[mungon]	-	-
In sanctorum martirum Syxti Pape...	[mungon]	-	-
In sancti Donati episcopi et martiris	[mungon]	-	-
In sanctorum martirum Cyriaci largi...	[mungon]	-	+
Epistola...Require.... [= Sap 10 17-20]	-	-	+
Mk 16 15-18	-	-	+
In uigilia sancti Laurentii martiris	[mungon]	+	+
Epistola...Require... [= Ekl 51 1-8, 12]	-	+	+
Euangelium...Require... [= Mt 16 24-28]	-	+	+
[Missa in festo transfigurationis Domini. In transfiguratione Domini Nostri Iesu Christi]	In transfiguratione Domini Nostri Iesu Christi [88rb-va]	+	+
2 Petr 1 16-21	+	+	+
Euangelium...Require... [= Mt 17 1-9]	+	+	+
In festo sancti Laurentini martiris	In die s. Laurentini martiris [88va]	+	+
2. Kor 9 6-10	2 Kor 9 6-10	+	+
Evangel....Require... [= Gjon 12 24-26]	+	+	+
In sanctorum martirum Tiburti et Susane	[mungon]	-	-
In sanctorum martirum Ypoliti et Cassiani	[mungon]	-	-
In sancte Clare uirginis	[mungon]	-	-
In sancti Eusebii confessoris	[mungon]	-	-
In uigilia Assumptionis beate Marie uirginis	[mungon]	+	+
Epistola...Require... [= Ekl 24 23-31]	-	+	+

Euangelium...Require... [= Lk 11 27-28]	-	+	+
In assumptione beate uirginis Marie	In assumpt. uirginis Marie [88va-b]	+	+
Ekl 24 11-13, 15-20	+	+	+
Lk 10 38-42	+	+	+
In octaua sancti Laurentii	[mungon]	-	-
In sancti Agapiti martiris	[mungon]	-	-
In sancti Ludouici confessoris	[mungon]	+	-
In sanctorum Martirum Thymotei Ypoliti...	[mungon]	-	-
In sancti Bartholomei apostoli	[mungon]	-	-
In sancti Augustini episcopi et confessoris	[mungon]	-	-
In decolatione S. Iohannis Baptiste	In d. S. Ioh. Bapt. [88vb-79/1ra]	+	+
Epistola...Require... [= Ekl 14 22, 15 3-4, 6]	+	+	+
Mk 6 17-29	+	+	+
In sanctorum Martirum Felicis et Audacti	[mungon]	-	-
In sanctorum Martirum XII. fratrum	[mungon]	-	-
In natiuitate beate uirginis Marie	In nativ. beate u. Marie [79/1rb-va]	+	+
Prov 8 22-35	+	+	+
Mt 1 1-16	+	+	+
In sancti Gorgonii martyris	[mungon]	-	-
In sanctorum martirum. Prothi et Iacinti	[mungon]	-	-
In exaltatione sancte Crucis	In exaltatione S. Crucis [79/1va-b]	+	+
Fil 2 8-11	+	+	+
Gjon 12 31-36	- [Mt 20 17-19]	+	+
In sanctorum martirum Corneli et Cypriani	[mungon]	-	-
In sancti Nychomedes martiris	[mungon]	-	-
In sanctorum Martirum Lucie et Geminiani...	[mungon]	-	-
In uigilia S. Mathei apostoli et euangeliste	In sexto s. Mathei apostoli [79/1vb]	+	+
Epistola...Require in communi unius martiris pontificis [= Prov 3 13-20]	+	+	+
Lk 5 27-32	+	+	+
In festo sancti Mathei apostoli et euangeliste	In sexto s. Mathei apostoli [shih lart – 79/1vb]	-	+
Epistola...Require... [= Ezek 1 1, 10-14]	+	-	+
Mt 9 9-13	- [Lk 5 27-32]	-	+
In sanctorum martirum...Cypriani et Iustine	[mungon]	-	-
In dedicatione Sancti Michaelis	In ded. S. Michael. [79/1vb-80/1ra]	+	+
Apk 1 1-5	+	+	+
Mt 18 1-10	+	+	+
In sancti Jeronimi presbiteri	[mungon]	+	-
In sancti Francisci confessoris	In s. Franc. confessoris [80/1ra-b]		
Gal 6 14-18	+	+	+
Euangelium... Require [= Mt 11 25-30]	+	+	+
[In festo transfigurationis Domini nostri Iesu Christi – shih poshtë fol 180b]	In transfiguratione Domini Nostri Iesu Christi [80/1vb-81/1ra]	+	[f. +]
In s. Martirum Dionisii Rustici et Eleuterii	[mungon]	-	-
In sancti Calixti Pape et Martiris	[mungon]	-	-
In sancti Lucae euangelista	[mungon]	-	+
In sanctorum Martirum Crisanti et Darie	[mungon]	-	-
In uigilia apostolorum Symonis et Iude	[mungon]	-	-
In festo apostolorum Symonis et Iude	[mungon]	-	+
In uigilia omnium sanctorum	In v. omnium sanct. [80/1rb-va]	-	-
Apk 5 6-12	+	-	Apk 5 1-14
Evangelium...Require... [= Lk 6 17-23]	+	-	Lk 6 17-23
In festo omnium sanctorum	In sexto omnium sanct. [80/1va-b]	+	+
Apk 7 2-12	+	+	+

Evangelium...Require... [= Mt 5 1-12]	+	+	+
In sanctorum martirum Sergii Bachi Marcelli et Appulei	In s. martirum Sergii Bachi Marcelli et Apulei [80/1vb-81/1ra]	-	-
[mungon]	Pistullinë ecë e vgajj ndë Komut të shumëve Munduosa	-	-
[mungon]	Mt 24 3-13	-	-
In sancti Cesarii	[mungon]	-	-
In sanct. Martirum quatuor coronatorium	[mungon]	-	-
In sancti Theodori Martiris	[mungon]	-	-
In sancti Martiri Confessoris	[mungon]	-	-
In sancti Mene	[mungon]	-	-
In sancte Cecile uirginis et martiris	[mungon]	-	-
In sancti Clementis Pape et Martiris	[mungon]	-	-
In sancte Felicitatis Martiris	[mungon]	-	-
In sanci Grisogoni martiris	[mungon]	-	-
In sancte Katerine Uirginis et Martiris	[mungon]	-	-
INCIPIT COMMUNE SANCTORUM	Këtu zë ënfill Komuni i Apostojt [81/1ra]	+	+
In uigilia unius apostoli Ekl 44 5 – 45 9	[mungon titulli – 81/1ra] Ekl. 44 26-27, 45 2-9	+	+
Gjon 15 12-16	-	+	+
In uigilia plurimorum apostolorum	[mungon titulli – 81/1rb-va]	+	+
VA 5 12-16	+	+	+
Efes 1 3-8	+	+	+
1 Kor 4 9-14	+ [1 Kor 4 9-13]	+	+
Gjon 15 1-7	+ [shih 9 rreshta poshtë]	+	+
In natali apostolorum	[mungon]	-	-
In natali plurimorum apostolorum	[mungon titulli – 81/1va-82/1vb]	+	+
Efes 2 19-22	+	+	+
Efes 4 7-13	+	+	+
Rom 8 28-39	+ Rom 8 28-38	+	+
Ezek 1 10-14	+ Ezek 1 1,5, 10-14	+	+ ³⁶
-	Gjon 15 12-16	-	-
Gjon 15 17-25	+	+	+
-	[Gjon 15 1-7 – shih 9 rreshta lart]	-	-
Mt 10 16-22	+	+	+
Mt 19 27-29	+	-	-
Lk 10 1-9	+	+	+
In festo unius martiris pontificis	Këtu ze ënfill Komuni i njëj Munduosi [83/1ra – 84/1rb]	+	+
Ekl 39 6-13	+	+	+
Ekl 31 8-11	+	+	+
Prov 3 13-20	+	-	+
Ekl 14 22; 15 3, 4, 6	+	+	+
Sap 10 10-14	+	-	+
2 Kor 1 3-7	+	+	+
2 Tim 2 8-10; 3 10-12	+	+	+
Mt 10 34-42	+	+	+
Mt 16 24-28	+	+	+
Gjon 12 24-26	Gjon 12 24-32	+	+
Mt 10 26-32	+	-	+

³⁶ Vendosur pas Mt. 10 16-22

Lk 14 26-33	+	-	+
In festo unius martiris non pontificis	-	-	-
In festo unius sancti a pascha usque Penetecosten ubi alius non Assignatur	Këtu zë ënfill për një shenjt ën Pashkëshit djerje ën Rshajesh [84/1rb-va]	+	+
Sap 5 1-5	+	+	+
-	-	?	Gjon 15 1-7
Gjon 15 5-11	+	?	+
In natalitiis plurimorum martirum	Këtu zë ënfill Komuni i t shumëve shenjtë [84/1va – 86/1va]	+	+
Prov 15 2-4, 6-9	+	+	+
Sap 5 16-20, 22	+	-	+
Sap 3 1-8	+	-	+
Prov 10 28-32; 11 3-6, 8-11	+	-	+
Sap 10 17-21	Sap 10 17-20	-	-
Ekl 44 10-15	+	+	+
Ekl 2 18-21	+	-	+
Ekl 39 1-5	+	-	+
1 Petr 1 3-7; 4 1, 2	+	-	+
Hebr 10 32-38	+	?	+
Hebr 11 33-39	+	?	+
Mt 5 1-12	+	+	+ [+ f. 318v.]
Mt 24 3-13	-	+	+
Lk 12 1-8	-	+	+
Lk 6 17-23	-	-	-
Lk 11 47-54	+	-	-
Lk 21 9-19	-	-	+ [+ f. 319]
Lk 10 16-20	+	-	+
Mt 11 25-30	+	+	- [+ f. 320]
In natalitiis unius confessoris pontificis	Këtu ze ënfill Komuni i Konfesorëvet [86/1va-88/1ra]	+	+
2 Tim 4 1-8	+	+	+
Ekl 45 1-6	-	+	+
Ekl 47 9-13; 24 1-4	-	-	+
Sap 4 7-11, 13-15	-	-	+
-	Sap 7 7-15	-	Sap 4 7-11, 13-15
Hebr 13 9-16	+	-	+
Hebr 7 23-27	+	-	+
Ekl 44 20, 22, 25.; 45 3	Ekl 44 16-17; 45 1-6, 8, 19-20	-	+
-	-	+	Sap 10 10-14
Ekl 24 1-5, 21-22	-	-	+
Mt 5 13-19	+	+	+
Mt 24 42-47	-	-	+
Mt 25 14-23	+	-	+
Lk 12 35-40	+	+	+
Lk 11 33-36	+	+	+
Mk 13 33-37	+	-	+
Lk 12 32-34	+	-	+
Lk 19 12-26	-	-	+
In nativit. unius confessoris non pontificis	[mungan]	-	-

In natalitis uirginum	Këtu ze ënfill Komuni i Virgjënavet [88/1ra-vb]	+	+ ³⁷
Ekl 51 13-17	+	+	+
2 Kor 10 17 – 11 2	-	?	+
1 Kor 7 25-34	+	?	+
Prov 8 22-35	-	-	+
Ekl 51 1-8, 12	+	-	-
Mt 13 44-52	+	+	+
Mt 25 1-13	+	+	+
In dedicatione ecclesie	[mungon]	+	+
Apk 21 2-5	-	+	+
Lk 19 1-10	-	+	Lk 19 1-9
In anniuersario dedicationis ecclesie	[mungon]	-	-
Missa in honore sanctorum quorum corpora habentur	[mungon]	-	-
Missa in honore Sancte Trinitatis	[mungon]	-	-
Missa de Spiritu Sancto	[mungon]	+	+
VA 8 14-17	-	+	+
Gjon 14 23-31	-	+	+
Missa in honore Sancte Crucis	[mungon]	+	-
Fil 2 8-11	-	+	-
Mt 20 17-20	-	+	-
Missa in commemoratione Beate Uirginis Marie ab Aduentu usque ad natiuitatem	[mungon]	+	-
Is 1 2-5	-	+	-
Lk 1 26-38	-	+	-
A natiuitate usque ad purificationem	[mungon]	-	-
A purificatione usque ad Pascha	[mungon]	+	+
Ekl 24 14-16	-	+	+
Lk 11 27, 28	-	+	+
A Pascha usque Pentecosten	[mungon]	+	+
A Pentecoste usque ad Aduentum	[mungon]	+	+
Missa in honorem angelorum	[mungon]	-	-
Missa in honorem apostolorum Petri et Pauli	[mungon]	-	-
Missa ad poscenda suffragia sanctorum	[mungon]	-	-
Alia miss ad poscenda suffragia...	[mungon]	-	-
Missa pro paçe	[mungon]	-	-
Missa pro papa	[mungon]	-	-
Missa pro iter agentibus	[mungon]	-	-
Missa pro anniuersario pontificis	[mungon]	-	-
Missa pro seipso sacerdote	[mungon]	-	-
Alia misa ut supra	[mungon]	-	-
Missa pro congregatione	[mungon]	-	-
Missa pro omni gradu ecclesie	[mungon]	-	-
Alia misa pro congregatione	[mungon]	-	-
Missa pro concordia fratrum	[mungon]	-	-
Missa pro temptatione carnis	[mungon]	-	-
Missa pro peccatis	[mungon]	-	-
Missa pro tribulationibus peccatorum	[mungon]	-	-
Missa pro remissione pec[c]atorum	[mungon]	-	-
Missa ad repellendum Malas cogitationes	[mungon]	-	-
Missa pro petitione lacrimarum	[mungon]	-	-

³⁷ Me një numër copëzash leximi shtesë.

Missa pro amico peccatore	[mungon]	-	-
Missa pro amico uiuente	[mungon]	-	-
Missa pro salute uiuorum	[mungon]	-	-
Missa pro deuotis amicis	[mungon]	-	-
Missa ad pluuiam petendam	[mungon]	-	-
Missa ad serenitatem postulandam	[mungon]	-	-
Missa contra temptationes	[mungon]	-	-
Missa generalis sancti Augustini pro uiuis...	[mungon]	-	-
Missa pro uiuis et defunctis	[mungon]	-	-
Missa contra paganos	[mungon]	-	-
Missa pro quacumque tribulatione	[mungon]	-	-
Alia missa ut supra	[mungon]	-	-
Missa pro imperatore	[mungon]	-	-
Missa pro rege	[mungon]	-	-
Missa pro persecutores et male agentes	[mungon]	-	-
Missa pro nimiis pressuris	[mungon]	-	-
Missa in tempore belli	[mungon]	-	-
Missa pro quacunque necessitate	[mungon]	-	-
Missa postulandam sapientiam	[mungon]	-	-
Missa ad postul, fidem spem et caritatem	[mungon]	-	-
Missa ad postulandam humilitatem	[mungon]	-	-
Missa ad postulandam caritatem	[mungon]	-	-
Missa ad postulandam patientiam	[mungon]	-	-
Missa pro stabilitate loci	[mungon]	-	-
Missa pro confitente	[mungon]	-	-
Missa pro inimicis	[mungon]	-	-
Missa pro facientibus nobis elemosinas	[mungon]	-	-
Missa pro amico incarcerato	[mungon]	-	-
Missa pro nauigantibus	[mungon]	-	-
Missa pro sferilitate terre	[mungon]	-	-
Missa pro peste animalium	[mungon]	-	-
Missa pro mortalitate hominum	[mungon]	-	-
Missa pro infirmo qui proximus est morti	[mungon]	-	-
Missa in agenda mortuorum	Këtu ze ënfill për të vdekunitë [88/1vb-89va]	+	+
- [Apk 14 13]	Apk 14 13	+	+
1 Kor 15 51-57	+	+	+
1 Sel 4 12-17	+	+	+
2 Makab 12 42-46	+	+	+
Gjon 11 21-27	+	+	+
Gjon 6 37-40	+	+	+
Gjon 5 25 – 29	+	+	+
- [Gjon 5 21-25]	-	+	+
Gjon [6] 51-55	+	+	+
Alia missa ut supra	[mungon]	-	-
Missa pro episcopo defunto	[mungon]	-	-
Missa pro episcopis et sacerdotis	[mungon]	-	-
Missa pro uno defuncto	[mungon]	-	-
Missa pro una defuncta	[mungon]	-	-
Missa pro defunctis fratr. et beneficatoribus	[mungon]	-	-
Missa pro his qui in cimiterio requiescunt	[mungon]	-	-
Missa in anniuersario	[mungon]	-	-
Missa pro patre et matre	[mungon]	-	-
Missa pro omnibus defunctis	[mungon]	-	-

Missa pluralis pro defunctis	[mungon]	-	-
Missa pro omnibus defunctis	[mungon]	-	-
Missa generalis pro fidelibus defunctis	[mungon]	-	-
Alia Missa ut supra	[mungon]	-	-
Missa pro defuncto nuper baptizato	[mungon]	-	-
Missa pro desiderantibus penitentiam oratio	[mungon]	-	-
Missa pro cuius anima dubitatur	[mungon]	-	-
Benedictiones	[mungon]	-	-
In festo transfigurationis Domini nostri Iesu Christi	[In transfiguratione Domini Nostri Iesu Christi = fol 88rb-va]	?	?
Benedictio puerorum	[mungon]	-	-
[mungon – Missa pro sponso et sponsa]	Mesha e Kunorësë [89va-90ra]	+ [f. 184vv.]	+ [f. 316vv.]
[-]	1 Kor 6 15-20	+	+
[-]	Mt 19 1-6	+	Mt 19 1-30
[mungon]	[2 Mbret 24 15-19, 25] ³⁸	-	-
[mungon]	In S. Jobi [90ra-b]	-	-
[-]	Job 1 6-22; 2 1-10	-	-
[-]	[Ungjillë ecë e vgjaj t enjëtenë të së dytësë të diel ëndë Këreshmë - Lk 16 19-31]	-	-
...		...	...
Mediolani. Mcccclxxiiii. die vi decembris finitum	Laus Deo, Pax viuis et requiem defuntis	FINIS	Amen
	[Colophon / Pasthënie - 90b]		

Bibliografi

1. Sigla, shkurtime

BUM = sh. më poshtë, rubrika nr. 2: Çabej, Eqrem (bot.) dhe Ressuli, Namik (bot.)

BSV = sh. më poshtë, rubrika nr. 2: Weber, Robert & Gryson, Roger (bot.) dhe Wordsworth, Iohannes S.T.P & White, Iuliano A.M. (bot.)

LBS = sh. më poshtë, rubrika nr. 2: Maretić, Tomislav (bot.).

NIO = sh. më poshtë, rubrika nr. 2: Erasmus, Desiderius

BRU = sh. më poshtë, rubrika nr. 2: Brucioli, Antonio

BIZ = sh. më poshtë, rubrika nr. 2: Robinson, Maurice A. & Pierpont, William G. (bot.)

ME-GJ = sh. më poshtë, rubrika nr. 2: Meksi, Vangjel – Gjirokastriti, Grigor

KR = sh. më poshtë, rubrika nr. 2: Kristoforidhi, Konstandin

RL = sh. më poshtë, rubrika nr. 2: Rešetar, Milan (bot.)

ZL = sh. më poshtë, rubrika nr. 2: Rešetar, Milan (bot.)

³⁸ Këtu mbyllet me <Amen> leksionari në fjalë, duke vijuar pastaj me copa te tjera leximi specifike: f. 318-320.

2. Literaturë e cituar

- Brucioli, Antonio. BRU *La Biblia... Il Nvovo Testamento di Christo Giesv Signore, et Salvatore nostro... Di greco tradotto in lingua Toscana, per Antonio Brucioli*. Impresso in Vinegia, ne le case di Lucantonio Giunti fiorentino. In Venetia 1532.
- Buzuku, Gjon. BUM ‘Meshari’ i Gjon Buzukut (1555), shih më poshtë Ressuli (bot.) 1958; Çabej (bot.) 1968.
- Camaj, Martin. 1960. Il “Messale” di Gjon Buzuku, Roma.
- Çabej, Eqrem (bot.). 1968. ‘Meshari’ i Gjon Buzukut (1555), bl. I-II, Tiranë.
- Daničić, Đura & Karadžić, Vuk. 1865, 1847 Sveto Pismo: <https://newchristianbiblestudy.org/de/bible/serbian/>.
- Demiraj, Bardhyl. 2023. Shfaqje të humanizmit kristian në tekstet biblike të ‘Mesharit’ të Gjon Buzukut, në: *Hylli i Dritës* 2 [2023] 165-200. Shkodër.
- _____. 2024. Manifestazioni dell’umanesimo cristiano nei testi biblici del «Messale» di Gjon Buzuku (I), në: *Shêjzat – Pleiades* viti IX, nr. 1-2, f. 3-42. Romë/Tiranë.
- _____. 2025. Viti liturgjik në ‘Mesharin’ e Gjon Buzukut (1555), në: *Hylli i Dritës*, nr 2 (në shtyp).
- _____. 2026a. Manifestazioni dell’umanesimo cristiano nei testi biblici del «Messale» di Gjon Buzuku II, në: *Shêjzat – Pleiades*, nr. 1-2 (në shtyp).
- _____. 2026b. Pjesa e parë e ‘Mesharit’ të Gjon Buzukut, në: *Hylli i Dritës*, nr 1 (dërguar në shtyp).
- Erasmus, Desiderius. NIO Novum Instrumentum omne i Erasmus-it. Basel 1516⁽¹⁾, 1519⁽²⁾, 1522⁽³⁾, 1527⁽⁴⁾, 1535⁽⁵⁾, etj.
- Farlati, Daniele. IS *Illyricum Sacrum*, bl. III, Venetiis 1765.
- Gabrić-Bagarić, Darija & Erdman-Pandžić, Elisabeth von. 1997. Das Perikopenbuch des Ivan Bandulavic von 1613. Teil b: Glossar und Kommentar, në: *Quellen und Beiträge zur kroatischen Kulturgeschichte. Bd. 7b. Vrela i prinosi za hrvatsku kulturnu povijest*. Bamberg.
- Jokl, Norbert. 1930. Nji studim për rreth librit të Buzukut, në: *Hylli i Dritës* VI, nr. 3, f. 146-154, Shkodër.

- Kapetanović, Amir. 2014. Jezična uporaba u ćiriličnom *Dubrovačkom dominikanskom lektionaru*, në: *Filologija*, nr 62, 61-68. Zagreb.
- Karadžić, Vuk. (1847) shih Iart Daničić, Đura
- Korolevskij, Cyrille. 1958. *Liturgie in lebender Sprache. Orient und Okzident*. Klosterneuburg.
- Kristoforidhi, Konstandin. 1866. *Katër Ungjillat e Zotit edhe Shëlbuesit Tynë Iezu Krishtit edhe Punët e Apostuivët, këthymun prej greqishtes Vietër shqip ndë gjuhë gegënishte prei Konstantinit Kristoforidhit, Elbasanasit*. Konstantinopol. Stampuem për Bretaniken & të Hujën Shoqëninë e Biblës. Prei A. I. Bojagjian.
- _____. 1872. *Dhiata e Re e Zotit edhe Shëlbuesit tynë Iezu-Krishtit, këthyem prej greqishtesë Vietër shqip prei Konstantinit Kristoforidhit, Elbasanasit*. Konstantinopol. Ndë shtypë-shkronjë të Bojagjianit.
- Kušćović, Tanja. 2020. Prijevod uraškog glagoljskog *Novog Testamenta* i mogući utjecaji jezika istarskih hrvatskokrkvensoslavenskih kodeska (na primjeru *Drugog Beramskog Brevijara*), në: *Slovo*, nr. 70, 243-264. Zagreb.
- Lloshi, Xhevat. 2020. Një vështrim tjetër për librin e parë shqip: Meshari i Buzukut dhe Meshari kroat, në: *Dita* (18 dhjetor). Tiranë.
- _____. 2025. Vështrime të reja për librin e parë shqip, në: *Dita* (8 qershor). Tiranë.
- Marećić, Tomislav (bot.). 1885. *Lektionarij Bernardina Spljećanina – po prvom izdanju od god. 1495*. Izdala Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjenosti. U Zagrebu 1885.
- Marku, Vinçenc. 2025. *Buzuku i lehtëlexueshëm*. Shkodër.
- Matzinger, Joachim. 2010. Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 2: Verschriftung des Albanischen mit Schwerpunkt auf Paulus Angelus und Gjon Buzuku. In: (B. Demiraj – ed.) *Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet*. In: AF 29. Wiesbaden, S. 421-486.
- _____. 2011. Ein Beitrag zur Buzuku-Philologie: Die Anordnung der Heiligennamen in der Allerheiligenlitanei des altalbanischen

- Seelsorgehandbuchs ('Missale'), në: *Zeitschrift für Balkanologie* 47, 81-96.
- _____. 2012. Die Heiligenfeste, oder wie sich das Proprium de Sanctis und das Commune Sanctorum im Seelsorgehandbuch des Gjon Buzuku (1555) prasentieren, në: B. Demiraj (Hg.), *Aktuelle Fragestellungen und Zukunftsperspektiven der Albanologie. Akten der 4. Deutsch-Albanischen kulturwissenschaftlichen Tagung „50 Jahre Albanologie an der LMU Munchen“*, Wiesbaden, S. 270–293.
- _____. 2013. Nuovi indizi su Buzuku. Alcune osservazioni sul volume "Shqipëria e rigjetur – Albania ritrovata" di Lucia Nadin, në: *Hylli i Dritës*, nr. 1-2, f. 76-83. Shkodër.
- _____. 2020. Das erste albanische Alphabet bei Gjon Buzuku (1555) – ein paar Beobachtungen, në: Demiraj, Bardhyl (ed.), në: *Altalbanische Schriftkultur – aus der Perspektive der historischen Lexikographie und der Philologie der Gegenwart – Akten der 6. deutsch-albanischen kulturwissenschaftlichen Tagung (27. September 2019, Buçimas bei Pogradec, Albanien)*, Albanische Forschungen 44. Wiesbaden: Harrassowitz, f. 205–219.
- _____. 2022. Eine Randnotiz zu Gjon Buzukus Seelsorgehandbuch, në: *Shêjzat*, 1-2, f. 49-59. Roma.
- Meksi, Vangjel & Gjirokastriti, Grigor. 1824. *Ungjilli i Jizu Hrishtoit Zotit sene që na shpëtoi. Sikundrë shkruan Shënt Mattheua. Mbë di gjuhë greqishte edhe shqipe*. Korfoi En ti tipografia tis Dhiokiseos.
- _____. 1827. *Dhiata e Re e Zotit sonë që na shpëtoi, Iizu Hrishtoit. Mbë di gjuhë do me thënë greqishte e dhe shqipëtarçe* (nën kujdesin e Grigorit, kryepeshkopit të Eubeas). Korfoi En ti tipografia tis Dhiokiseos.
- Nadin, Lucia. 2012. *Shqipëria e rigjetur. Zbulim gjurmësh shqiptare në kulturën dhe artin e Venetos në shek. XVI – Albania ritrovata. Recupero di presenze albanesi nella cultura e nell'arte del cinquecento veneto*. Onufri. Tiranë.
- _____. 2015. Ancora sul *Meshari* di Gjon Buzuku, në: *Hylli i Dritës*, 1-2, f. 43-66.
- Nemirovskij, Evgenij L'vovič. 1997. *Gesamtkatalog der Frühdrucke in kyrillischer Schrift, Bd. 2: Die Druckereien des Makarije in der Walachei und von Giorgio Rusconi in Venedig*. Baden-Baden.

- Omari, Anila. 2010. Ndikimet sllave te Buzuku: Kontributi i Camajt, në *Studime Filologjike*, nr. 3-4 [2010] 129-141, Tiranë.
- Prohaska, Dragutin. 1911. *Das kroatisch-serbische Schrifttum in Bosnien und der Herzegowina: von den Anfängen im XI. bis zur nationalen Wiedergeburt im XIX. Jahrhundert*. Wien.
- Qendro, Thoma. 2014. *Fjalor i shqipes së Gjon Buzukut (me rreth 3200 fjalë, 350 emra të përveçëm dhe 260 fjalë e shprehje latinisht)*. Tiranë.
- Ressuli, Namik (bot.). 1958. *Il "Messale" di Giovanni Buzuku. Riproduzione e trascrizione*. Città del Vaticano.
- Rešetar, Milan (bot.). 1894. Zadarski i Račinin Lekcionar. Za štampu priredio Milan Rešetar, në: *Djela Jugoslavenske Akademije Znanosti i Umjenosti*, Kniga III. Zagreb.
- Režić, Ksenija. 1983. Bernardin Splićanin, në: *Hrvatski Biografski Leksikon* < <https://hbl.lzmk.hr/clanak/1824> > (1983 = 2021).
- Robinson, Maurice A. & Pierpont, William G. (bot.). 2005. *The New Testament in the Original Greek Byzantine Textform*. Chilton Book Publishing: Southborough, Massachusetts.
- Roques, Mario. 1932a. *Recherches sur les anciens textes albanais*. Paris.
- _____. 1932b. Deux livres d'heures du XVIe siècle en cyrillique bosniaque, në: *Revue des études slaves*, tome 12, pp. 49-69.
- Rrota, Justin. 1930. *Monumenti mâ i vjetri i giûhës shqype. D. Gjon Buzuku (1555)*, Shkodër.
- _____. 1936. *Për historin e Alfabetit Shqyp*, Shkodër.
- Truhelka, Ćiro. 1894. Die Bosančica, në: *Wissenschaftliche Mittheilungen aus Bosnien und der Herzegovina*, Bd. II. Wien
- Weber, Robert & Gryson, Roger (bot.). 2007. *BSV Biblia Sacra Iuxta Vulgatam Versionem – Adiuvantibus B. Fisher, I. Gribmont, H.F.D.Sparks, W. Thiele – recensuit et brevi apparatu critico instruxit Robert Weber. Editionem quintam amendatam retractatam praeparavit Roger Gryson*. Deutsche Bibelgesellschaft. C.H.Beck, Nördlingen.
- Wordsworth, Iohannes S.T.P & White, Iuliano A.M. (bot.). 1889-1954. *Nouum Testamentum Domini nostri Iesu Christi Latine, secundum editionem sancti Hieronymi*. Ad codicum manuscriptorum fidem recensuit Iohannes Wordsworth, S.T.P – Episcopus Sarisburiensis. In operis societatem adsumto Henrico Iuliano White, A.M. – Collegii Mertonensis Socio. Pars Prior – Quattuor Eunagelia. Oxonii E

Typographeo Clarendoniano M DCCC LXXXIX-M DCCC XCVIII *Nouum Testamentum Domini nostri Iesu Christi Latine, secundum editionem sancti Hieronymi*. Ad codicum manuscriptorum fidem recensuit Iohannes Wordsworth, S.T.P – Episcopus Sarisburiensis. In operis societatem adsumto Henrico Iuliano White, A.M. – Collegii Mertonensis Socio. Pars Tertia – Actus Apostolorum – Epistulae canonicae Apocalypsis Iohannis. Oxonii E Typographeo Clarendoniano M DCCCC LIV.

- _____. 1911. *Nouum Testamentum Latine, secundum editionem sancti Hieronymi*. John Wordsworth, Henry Julian White (eds.) (Editio minor ed.). Oxford: Clarendon Press. 1911.

SUMMARY

The Slavic Linguistic-Cultural Influence on Gjon Buzuku's 'Missal' – a Scientific-Philological Narrative

Conceived as a continuation of several contributions to a project in progress by the author on the 'Missale' by Johannes Buzuku (1555) and its position in ancient Albanian writing culture, this article aims to examine the potential influence of liturgical texts in the ancient Croatian vernacular in the 15th and 16th centuries (§1). This influence has been repeatedly noted in philological and linguistic discourse in many respects: a) graphemically, since several graphemes in Buzuku's alphabet appear to be taken from the Cyrillic script; b) linguistically and stylistically, as the text of 'Missale' presumably contains vernacular Slavic influences; and c) structurally, especially in the second part of the text, which resembles a pericope book, shows clear similarities with the Old Croatian lectionaries in Latin script (in the 15th-16th centuries). Apart from the question of five graphemes with partly ambiguous values in the Buzuku's alphabet, including: <□> [v] 'vjed', <y> [u, y] 'uk', <h> [j, c, g] 'đerv', <§> [ǫ, θ] 'ksi cyrillicque', <3> [z] 'zemlja' (§2), which unambiguously originate from the Cyrillic alphabet (the Bosančica variant) and still require thorough investigation, the author sees no reason to perceive linguistic influence from the Old Croatian liturgy and its written culture (§3). The third question has been subjected to a thorough analysis in an intertextual comparison between Buzuku's 'Missale' and two Old Croatian lectionaries (1494¹, 1543² and 1508), and the result clearly indicates that there is no Slavic influence in terms of style and text structure either (§§4-6).

Anila Omari

**Një sprovë klasifikimi të italianizmave të shqipes
së vjetër (shek. XVI-XVII): huazime popullore
dhe huazime librore**

Përmbledhje

Artikulli analizon korpusin e italianizmave të shqipes së teksteve të vjetra, të përpunuar në kuadrin e projektit DPEWA të Universitetit Ludwig-Maximilian të Mynihut, nga këndvështrimi i mënyrës së transmetimit të tyre në gjuhën shqipe. Për këtë qëllim janë përcaktuar disa kritere për dallimin e huazimeve të marra në rrugë librore dhe huazimeve të hyra nëpërmjet gjuhës së folur, kryesisht si huazime kulturore përmes kontakteve gjuhësore. Si huazime librore apo diturore (savante) në radhë të parë janë klasifikuar fjalët e marra drejtpërdrejt nga tekstet italiane që autorët e vjetër kishin si model përkthimi, shpesh herë për nevoja të çastit dhe të mbetura pa vazhdimësi në hapësirë dhe kohë. Huazimet diturore dallohen edhe nga përmbajtja semantike e tyre, si fjalë të leksikut abstrakt ose fetar. Fjalët e karakterit libror mund të dallohen edhe nga grafia që pasqyron tipare fonetike italiane në tekstet e vjetra. Përkundrazi, huazimet e tipit popullor, sidomos ato më të vjetrat, kanë karakteristika fonetike e leksikore veneciane, janë me përhapje relativisht të gjerë në gjuhë, kanë pësuar ndryshime fonologjike e semantike në krahasim me modelin e gjuhës dhënëse, karakterizohen nga prania e varianteve fonologjike e morfologjike në hapësirë e në kohë dhe nga një derivacion i pasur.

Në përfundim të kësaj analize, rezulton një raport i tillë mes dy kategorive: nga një numër i përgjithshëm prej 950 italianizmash, 232 përcaktohen si huazime popullore dhe 718 të tjerat janë huazime diturore, fjalë librash, shumë prej të cilave janë përdorur vetëm një herë për nevoja të tekstit, ndërsa shumë të tjera mbeten me përdorim të kufizuar në shqipen e vjetër.

Fjalë kyçe: *italianizmat e shqipes së vjetër, huazime librore/savante, huazime popullore, kritere klasifikimi, huazime të përsëritura, huazime dyfishe*

Hyrje

Në shtresëzimin e leksikut me prejardhje nga gjuhët e tjera në gjuhën shqipe, huazimet italiane përbëjnë shtresën më të pasur. Gustav Meyeri në të dhënat e tij statistikore për prejardhjen e leksikut të shqipes të analizuar etimologjikisht prej tij, rendiste në vend të parë nga sasia huazimet romane, pa dalluar mes latinizmave e italianizmave, që arrinin në 1420 njësi, në një total prej 5149 lemash. Në monografinë më të re mbi italianizmat e shqipes, jepet një shifër totale prej 5926 huazimesh (Dashi 2013: 15), të cilat përbëjnë numrin më të madh të huazimeve italiane të regjistruara deri më sot, duke përfshirë regjistrimet diakronike, që nga teksti më i vjetër shqip, i vitit 1555, dhe ato sinkronike deri te prurjet e fundit mediatike të paregjistruara në fjalorë, madje edhe fjalë zhargoni.

Nëse deri në fillim të viteve '90 studimi sistematik i italianizmave të shqipes nuk kishte përparuar që nga monografia e Robert Helbigut e vitit 1903, pas gjase edhe për arsye të purizmit gjuhësor që ishte i pranishëm në gjuhësinë shqiptare të periudhës së pasluftës, pas kësaj periudhe shihet një ringjallje e interesit edhe për këtë shtresë të rëndësishme të leksikut të shqipes. Serinë e studimeve monografike në këtë fushë e hapën gjuhëtarët shqiptarë, duke filluar nga Kristina Jorgaqi, me disertacionin e saj mbi italianizmat e shqipes (Jorgaqi 1995c), të botuar në formë artikujsh në revistën *Studime Filologjike* (1992-1998) e në revista të huaja (Jorgaqi 1995a; 1995b; 1996; 1997a; 1997b; 1998; 2000), për të vijuar me disertacionin e Genc Lafes, botuar në dy numra të revistës *Ponto-Baltica* (Lafe 1998/9; 2000), subjekt të cilit ai i është rikthyer edhe më vonë me studime më të thelluara për çështje të veçanta të dallimit të italianizmave (Lafe 2018; 2020) dhe së fundi me disertacionin e përmendur të Brunilda Dashit, botuar në vitin 2013 nga Universiteti La Sapienza. Këto studime, së bashku me artikuj të ndryshëm të përqendruar në aspekte të veçanta të marrëdhënieve mes dy gjuhëve (Landi 1991; 1992; Vicario 1992/3; Di Giovine 2008 etj.) mund të themi se e kanë kompletuar trajtimin e problematikës së këtyre marrëdhënieve. Nuk ka munguar edhe vëmendja e posaçme mbi italianizmat e shqipes së vjetër, shekujt XVI-XVII, me studimin themelvënës të Kristina Jorgaqit (Jorgaqi 2001), mbështetur në leksikun e teksteve të autorëve të arealit verior katolik, nxjerrë e përpunuar nga Kolë Ashta dhe në konkordancat e veprave të Budit nga Gunnar Svane. Italianizmat e Da Lecces, fjalori i të cilit doli në dritë vetëm në vitin 2009, u shqyrtuan nga Brunilda Dashi në një artikull të vitit 2016 (Dashi 2016).

Vitet e fundit në studimet diakronike të shqipes janë bërë përparime të mëdha jo vetëm si pasojë e zhvillimit të vetë metodës historike-krahasuese të zbatuar edhe në fushën e shqipes, por edhe falë përsosjes së teknologjisë elektronike dhe komunikimit virtual. Botimi kritik-ekdotik i trashëgimisë së shkruar shqipe tashmë përbën një cikël thuajse të mbyllur (khs. Demiraj &

Omari 2022: 131) dhe tekstet e vjetra të botuara në dekadat e fundit janë pajisur me konkordanca elektronike të lematizuara¹, gjë që mundësoi edhe ndërmarrjen e projektit DPEWA të Universitetit LMU të Mynihut². Në këtë fjalor i kushtohet vëmendje edhe përhapjes gjeografike të fjalës në dialektet e shqipes, gjë që ndihmon në saktësimin e prejardhjes së një romanizmi. Pasqyrimi i përhapjes dialektore të lema mbështetet në studimet etimologjike të Çabejt (Çabej SE I-VII) dhe Topallit (Topalli FEGJSH), por është nevojitur kërkim plotësues për shumë lema për të cilat nuk ka të dhëna të sakta për burimin e përhapjes së tyre. Gjithashtu në këtë fjalor bëhen përpjekje edhe për të përcaktuar rrugën e depërtimit të një huazimi.

Interneti ofron lehtësi të tjera për kërkim, duke vënë në dispozicion të studiuesve gjithmonë e më shumë materiale e fjalorë. Përveç fjalorit të Boerios për venecianizmat, që ishte ndoshta i vetmi në dispozicion për studiuesit deri para disa dekadash, tani ka një numër fjalorësh dialektorë të italishtes online dhe sidomos fjalori TLIO - Tesoro della Lingua Italiana delle Origini, një fjalor historik i italishtes së vjetër që mbledh dhe analizon tekste të shkruara deri në shekullin XIV. Përmes këtyre fjalorëve, po edhe veprave italisht të shekujve XVI e XVII të digjitalizuara, mund të zbulojmë forma të italishtes së vjetër që shpjegojnë më mirë burimin e huazimit.

Hulumtimi dhe përpunimi filologjik-etimologjik i romanizmave të shqipes së vjetër, në kuadrin e projektit DPEWA, na solli si rezultat një mori huazimesh italiane, një sasi prej rreth 950 njësisë leksikore, nga të cilat rreth 126 dalin për herë të parë të Da Lecce (kundrejt rreth 750 të regjistruara nga Jorgaqi vetëm për 4 autorët më të vjetër katolikë të veriut). Një shqyrtim *ad hoc* i fjalorit të Da Lecces jemi të sigurt se do të nxirrte elemente të tjera të burimit italian. Këto shifra flasin shumë për rëndësinë e ndikimit italian në shqipen e vjetër. Megjithatë, për të fituar një tablo më të qartë e realiste të ndikimit gjuhësor italian në këtë fazë të shqipes, tërësia e huazimeve, mjaft heterogjene nga statusi dhe nga prejardhja e tyre, është e nevojshme t'i nënshtrohet një studimi diferencues sipas aspekteve të ndryshme të kategorizimit të tyre. Brenda caqeve të një artikulli jemi përqendruar në një klasifikim sipas mënyrës së transmetimit të huazimeve, ku dallohen huazime librore ose savante dhe huazime të gjuhës së folur ose huazime popullore. Këtë çështje e pati vënë në dukje Çabej në punimin mbi karakteristikat e huazimeve latine të shqipes, si një çështje e cila nuk ka tërhequr vëmendjen e duhur deri në atë kohë (Çabej 1974: 30).

¹ Shih për proceset e punës dhe sfidat e përpunimit filologjik të leksikut historik të shqipes: Demiraj & Omari 2022: 128-136.

² DFG-Projekt "Digitales Philologisch-Etymologisches Wörterbuch des Altitalbanischen" (15.-18. Jh.) <https://www.dpwa.gwi.uni-muenchen.de/>

Huazimet librorë

I. Veçimi i huazimeve letrare nga ato të gjuhës së folur, është një procedim aspak i lehtë, sidomos kur është fjala për dallim brendapërbrenda shtresës së italianizmave, ku nuk ndihmojnë shumë ndryshimet fonomorfologjike siç është rasti me dallimet e alotropeve latine nga ato italiane, të tipit *farkë* : *fabrikë*, *fëmijë* : *familje*, *fytyrë* : *faturë*, *kallënduer* : *kalendar*, *ltër*: *altar* etj. Huazimet savante, të quajtura edhe fjalë librash apo kultizma, duhen shqyrtuar rast pas rasti për t'u përcaktuar si të tilla, duke kombinuar kriteret e ndryshme. Një diferencim i kësaj natyre ka munguar deri para disa dekadash edhe në studimin etimologjik të leksikut të italishtes, dhe vetëm në fjalorët etimologjikë më të rinj, si DELI (Dizionario etimologico della lingua italiana) të Manlio Cortelazzo dhe Paolo Zolli (1979-1988) dhe sidomos në Leksikon Etimologjik të Italishtes (LEI) të Max Pfisterit me pasuesit e tij të sotëm Elton Prifti e Wolfgang Schweickard janë arritur rezultate të rëndësishme në studimin dhe dallimin e atyre që quhen "latinizma" në italisht dhe në gjuhët romane në përgjithësi (khs. Ernst 1991: 185).

Për rastin e shqipes së vjetër do të përqendrohemi kryesisht në italianizmat, duke veçuar nga studimi latinizmat e mirëfillta. Nga një shqyrtim nga ky këndvështrim i materialit të italianizmave të përpunuara për DPEWA shikëputëm një numër prej 49 njësisht leksikore që rezultojnë huazime latine. Pjesa e mbetur janë rreth 950 njësi të cilat i janë nënshtruar një analize diferencuese në aspektin e përmendur më lart.

I.1. Si huazime librorë në radhë të parë duhen veçuar fjalët e marra drejtpërdrejt nga tekstet italiane që autorët e vjetër kishin si model përkthimi. Këto janë të ashtuquajtura *fjalë të huaja* (*Fremdwörter*, *forestierismi*, *foreignisms*) që janë përdorur për nevoja të çastit dhe nuk kanë përjetuar vazhdimësi në gjuhë. Për të pasur një ide mbi përhapjen e tyre në shqipen e vjetër, është me interes të sjellim një të dhënë nga Jorgaqi (2001: 259), sipas së cilës tek secili nga autorët e vjetër rreth 1/2 e italianizmave janë huazime idiolektore, përkatësisht te Bardhi rreth 1/3. Nga këto lloj huazimesh, për lehtësi numërimi e studimi, kemi veçuar së pari ato që gjenden ekskluzivisht te Buzuku (hapax legomena) dhe nuk përmenden më në literaturën e mëpasme dhe as në fjalorët e vjetër. Të tilla janë një numër prej rreth 153 njësisht leksikore, në një total prej rreth 350 njësisht leksikore me burim nga italishtja te Buzuku, i cili zë dhe vendin e parë për sasinë e italianizmave ndër autorët e vjetër të Veriut, dhe jo vetëm në nivel absolut por edhe në raport me numrin më të paktë të faqeve të veprës së tij në krahasim me të autorëve të tjerë të mëvonshëm (Jorgaqi 2001: 269, 251). Por edhe ndër këto huazime ekskluzive është vështirë të dallohen ato që janë marrë për nevoja të çastit nga modeli burimor italian dhe ato që janë ndikime të hyra që më parë në gjuhën e tij ose në gjuhën e elitës klerikale të kohës, përmes ndikimit të letërsisë kishtare.

Në aspektin semantiko-leksikor, huazimet librore, nga vetë përmbajtja fetare-diturore e teksteve të vjetra dhe e modeleve origjinale që u kanë shërbyer për përkthim, i përkasin kryesisht fushës së leksikut abstrakt dhe atij fetar, por ka edhe huazime kulturore, që lidhen me terma konkretë.³

Si huazime që kanë hyrë me rrugë letrare, kemi identifikuar lemat e renditura në vijim, duke u mbështetur edhe në përcaktimet e dhëna nga Çabej në Studimet etimologjike dhe në hyrjen e botimit të Mesharit. Këtu kanë vlerë sidomos kriteret e transkriptimit të fjalëve të burimit roman që përmbajnë grafemat <c> dhe <s>, të cilat kanë vlerë fonologjike të dyfishtë: [c] e [tʃ] dhe [s] e [ʃ]. Kështu, në fjalët e karakterit libror, të marra nga modelet latine a italiane, Çabej në rindërtimin e tekstit kritik e ka transkriptuar shkronjën <c> me <ç>, sipas shqiptimit italian (dhe jo atij venecian me [ts]): *patroçinie, feliçe, soliciçtoni* etj., kurse shkronjën <s> me <s> në fjalë që janë të një periudhe më të re dhe dallohen si të tilla edhe nga forma më e plotë që kanë: *abis, balsam, sepelyem* etj.⁴ Numri i këtij grupi fjalësh te Buzuku arrin në 108 njësi leksikore:

abitoj ‘banoj’ < it. *abitare* ‘id.’: BuM 17vb: Bijtë e sherbëtorëvet tuve kanë *me abituom...* (Filii servorum tuorum habitabunt... – Psalm 101/102 29); ***adoratuor** ‘adhurues’ < it. *adoratore*: BuM 53va: e tash anshtë, qi të vërtetë *adoratorë* të adononjëne Atënë ëndë shpirt e ënde e dërejtë. (veri adoratores adorabunt in spiritu et veritate – Gjon. 4 23); **adoroj** ‘adhuroj’ < it. *adorare*: BuM 78vb E u përvunë e *adoruonë* me faqe për dhë. (...et incurvati sunt et adoraverunt – Neh 8 6); **aliment** ‘ushqim’ < it. *alimento* ‘id.’: BuM 53vb: ata tue u ëmbajtonë ën *alimentashit*; **anatemë** < it. *anatema*: BuM 76ra=86ra: *anatema* qi do me thashunë i dani ën Sinëzot; **apetit** < it. *appetito*: BuM 23ra: me dhanë *appetit* korpit tit e të pëlqem; **aromë** < it. *aroma*: BuM 59va=69va: e pështuoll ëndë lincjoj me ato *aromata* (et ligaverunt eum linteis cum aromatibus – Gjon. 19 40); **autore** < it. *autore*: BuM 10rb: O *Autore*, kujtoq ën së shëlbuomit sinë (Memento, rerum Conditor, Nostri quod olim corporis – Himn); **autoritat**⁵ < it. vj. *autoritate*, lat. *autoritatem* ‘autoritet, pushtet’: BuM 71rb=81rb: e u dha atyne të mujtunë e *autoritat* përëmbi gjithë dreqënit (dedit

³ Për një ndarje të italianizmave të shqipes së vjetër sipas fushave semantike, shih K. Jorgaqi, *Ndikimi i italishtes në letërsinë e vjetër shqipe*, vep. cit., f. 252-258.

⁴ Çabej është shprehur në këtë drejtim për një numër italianizmash të Buzukut, duke i përcaktuar si huazime librore, të marra drejtpërdrejt nga tekstet origjinale (khs. Çabej SE I-VII s.v., Çabej 1968: 76, 86), si psh. *adoroj, axim, balsam, cimbal, cinamom* (lat.), *cipres* (mund të jetë dhe huazim popullor), *çelebroj, desqaroj, dromedar, feliçe, ëmpaçohem, patroçinie, rivë, santifikoj, sepeljo, soliciçtoj, vestë*.

⁵ Sipas Çabejt SE II 111 trajta e përgjithshme *autoritet* është huazim i ri latino-roman, i krijuar duke u mbështetur në huazimet e vjetra popullore më *-tet*, si *pushtët, qytët, shëndët*. Te Buzuku dhe Budi këto lloj neologjizmesh dalin me fundoren *-tat* sipas latinishtes së teksteve, përkatësisht italishtes së vjetër, si p.sh. *divinitat, ereditat, fragjilitat, karitat*.

illis virtutem et potestatem super omnia daemonia – Lk 9 1); **avancoj** ‘tejkaloj’ < it. *avanzare*: BuM 30v67: E paqa e Tinëzot, qi *avancon* o qi mundën gjithë mende (pax Dei exsuperat omnem sensum – Filip. 4 7); **avaricie** ‘kurnacëri’ < it. *avarizia* ‘id.’: BuM 50va: E katnë e pāglanë e gjithë kafshë të pēgana, o *avaricienë* (Fornicatio autem et omnis inmunditia aut avaritia... – Efes. 5 3); **axim** ‘bukë e ndorme’ < it. *azzimo* ‘id.’: BuM 64ra: E të parën ditë të *Aximavet* erdhnë dishipujtë (die Azymorum accesserunt discipuli – Mt. 26 17); **balsam** < it. *balsamo*: BuM 11vb: porsi cinamomi e porsi *balsami* qi kã erë të bukurë (Sicut cinnamomum, et balsamum aromatizans odorem dedi – Ekl. 24 20); **çelebroj** ‘festoj’ < it. *celebrare*: BuM 37rb: ato kafshë qi na me të madhe festë festojmë e *çelebrojmë*; **cimbal** (vegël muzikore) < it. *cimbalo* ‘id.’: BuM 40vb: u jam bām porsi një remb qi bije, o porsi një *cimbalë* për të gëzuom (aut cymbalum tiniens – 1 Kor. 13 1); **cinamom** ‘kanellë’ < lat. *cinnamomum*, it. *cinnamomo* ‘id.’: BuM 11vb: Ëndë pjacat porsi *cinamomi* e porsi *balsami* qi kã erë të bukurë (Sicut cinnamomum et balsamum aromatizans odorem dedi – Ekl. 24 20); **cipres** ‘qiparis’ < it. *cipresso* ‘id.’: BuM 88vb=98vb: e porsi *cipressi* ëndë malt të Sionit (quasi cypressus in monte Sion – Ekl. 24 17); **deliberoj** ‘marr vendim’ < it. *deliberare* ‘id.’: BuM 47vb: ...*deliberoj* me na shëlbuous nē (...vendos të na shpëtosh – Ester. 4 17), **dezert** ‘shkretëtirë’ < it. *deserto*: BuM 30vb: U jam zani i d njai qi thëret ëndë *dezertit* (Et perrexit in desertum via unius diei – 1 Mbret. 19 4), **deskricion**, **deskrecion** ‘diskrecion, vetëpërmbajtje, masë’ < it. *discrezione* ‘id.’: BuM 49ra=39ra: përvutë ëndë gjithë kafshë, tue pasunë *deskrecion* (et dilecti, viscera misericordiae, benignitatem, humilitatem, modestiam, patientiam – Kol 3 12); **despensoj** ‘shlyej, liroj nga dëka’ < it. *dispensare*, ven. *despensar* ‘id.’: BuM 62vb: as mos *despenso* katnë e tyne ën faqejt sote (et peccatum eorum a facie tua non deleatur – Jer. 18 23); **desputoj** ‘diskutoj, debatoj’ < ven. *desputare*: BuM 69vb=79vb: E hini Pali ëndë sinagogët, për tre muoj me besë tue *desputuom* (introgressus autem synagogam cum fiducia loquebatur per tres menses disputans – Vep. Apost. 19 8); **desgracie** ‘fatkeqësi’ < ven. *desgrazia*: BuM 75va=85va: e kÿ kle shtëm ëndë të madhe *desgracie* përpara tī (... hic diffamatus est apud illum – Lk 16 1); **i divinë** ‘hyjnor’ < it. *divino*: BuM 38rb: tue klenë ëshqyem ën sakramentashit *së divina* (ut divinis vegetati sacramentis – Oratio); **divinitat** ‘hyjni’ < it. vj. *divinitate*, lat. *divinitatem* ‘id.’: BuM 73rb=83rb: e ën *divinitatit* sit na me ʘ ëmbushunë; **dromedar** ‘deve’ < it. *dromedario*: BuM 37ra: m.pl.n.b. E shumica e kamillet të të ëmbëlönjënë, e *dromedarëtë* e Dimidjesë e të Efësë (Inundatio camelorum operiet te, dromedarii Madian et Ephra – Jes 60 6); **ereditat** ‘trashëgimi’ < it. vj. *ereditate*, lat. *ereditatem*: BuM 11ra: e ëndë pjesët të Zotit tim e ëndë *ereditatit* të tī (... et in parte Dei mei hereditas illius – Sir. 24 16); **felice** ‘i lumtur’ < it. *felice*: BuM 12va: adj. tue ëmbetunë përherë Virgjënë, dera *felice* e regjinisë qiellsë (felix coeli porta); **ferie** ‘pushim kishtar’ < it. *feria* ‘id.’: BuM 78ra=88ra: Ungjillë

ecë e vgjaj të katërtënë të diel ëndë Këreshmë *ferienë* e pestë; **fior** ‘lule’ < it. *fiore*: BuM 14va: e *flori* i ranzësë tī kā me votë përmaal (flos de radice eius ascendet – Is 11 1); **fermoj** ‘ndaloj’ < it. *fermare*: BuM 79/1rb: ...kur aj *fermon* erëtë përsipëri... (quando aethera firmabat sursum... – Prv 8 28); **fondament** ‘themel’: BuM 78ra: ...ëndë zemërat tuoj, të fabrikuom me *fondament* ën karitati (...in cordibus vestris in caritate radicati et fundati – Eph 3 17); **fondo** ‘themeloj’: BuM 83/1rb: Zotynë me urtët *fondo*u dhenë (...quando adpendebat fundamenta terrae – Prv 3 19); **forsi** < it. vj. *forsi* ‘ndoshta’: BuM 11ra: kur mënihishnë me furie të tyne kondra nē, *forsi* ujënatë na kishnë përpitë; **fragjilitat** ‘brishtësi’: BuM 11rb: Epna ëndimë, o i mishëriershimi Zot, *fragjilitatit* tinë (ndihmona Zot, në brishtësinë tonë); **gaxofilacio** ‘vendi ku ruheshin thesari dhe dhuratat në tempullin e Jeruzalemit’: BuM 59rb-59va: E këto fjalë i foli Jezu ëndë *gaxofilacio* qi do me thanë tuk banë offerta; **glorifikoj** ‘lëvdoj, himnizoj, thur lavde’ < it. *glorificare*: BuM 32va: Ashtu atëherë të tre porsi për një gojë lëvdonjinë e *glorifikonjinë* Tenëzonë; **glorioj** ‘glorifikoj’ < it. *gloriare*: BuM 9rb: E *glorionë* gjithë ëm Tenëzonë, o ju ën zemëret së dërejtë; **golë** ‘grykësi’ < it. *gola* ‘id.’: BuM 16vb: Psalmus kondra *golësë*; **granë** ‘e kuqe e errët’ < it. *grana* ‘id.’: BuM 57ra: të kuq porsi *grana* në klofshinë, ata të banenë porsi leshi i bardhë (et si fuerint rubra quasi vermiculus, velut lana alba erunt – Is. 1 18); **guloz** ‘grykës’ < it. vj. *guloso* ‘id.’: BuM 77va: e lakëmī e gjakësi, të dejunë, *guloz*, e shumë të tjera kafshë qi këtyne glasënë (Gal. 5 21); **idol** ‘idhull’ < it. *idolo*: BuM 75vb=85vb: As *idolatë* mos adroni; **irë** ‘zemërim’ < it. *ira*: BuM 16rb mos më kastigo ëndë *irët* tande (neque ira tua corripas me – Ps 6 2); **izop** ‘bimë aromatike’ < it. *issopo*: BuM 17ra: Ti muo të më bekojnsh me *izopt*, e u të dëlirem (asperges me hyssopo – Ps 50 9); **kandeljer** ‘shandan’ < it. *candeliere*: BuM 87rb=107rb: As drita nukë ëndhezetë ëm u vum ëndenë një mastel, por ëmbë *kandeljert* (ponunt (lucernam) ... super candelabrum – Mt 5 15); **karitat** ‘mëshirë, dashuria për tjetrin’ < it. *carità*, it. vj. *caritate*: BuM 26va: E kush kā të dashunë, kā *karitatnë*; **klemente** ‘i butë, i mëshirshëm’ < it. *clemente*: BuM 16rb: O *klemente*, o e përmishëriershime, o e ambla Virgjëna Mëri (O clemens, o pia, o dulcis Virgo Maria – Salve Regina); **kolpë** ‘faj’ < it. *colpa*: BuM 41va: O Zot, qi ën *kolpet* je offenduom (culpa offenderis – Oratio); **komemoracionë** ‘fjalim përkujtimor, fet. përkujtim i shenjtëve gjatë meshës’ < it. *commemorazione*: BuM 9rb: *Komemoraciona* e gjithë Shenjtet (Festum Omnium Sanctorum); **kompanjoj** ‘shoqëroj’ < it. *accompagnare*, it. vj. *compagnare* (Treccani): BuM 24va: e ti të denjonesh atë me *kompanjuom* ëmbë mishërier të Bagmit shenjtë tat; **konfesor** ‘prift rrëfyes’ < it. *confessore*: BuM 18va: O ju gjithë shenjtët Papë e *Konfessorë*, lutī për nē (Sancti Pontifices et Confessores – Litania); **konfidohem** ‘shpresoj, kam besim’ < it. *confidare*: BuM 9rb: qi aj ëndë d lutunit të Apostojet Pjetrët e Palit, e të tjerëvet Apostoje u *konfiduo*; **konfort** ‘ngushëllim, lehtësim, mbështetje’ < it. *conforto* ‘ngushëllim; lehtësim; nxitje;

mbështetje’: BuM 38ra: o kush konforton ëndë herë të konfortit (Sive qui exhortatur, in exhortando – Rom. 12 8); **konfortoj** ‘ngushëlloj’ < it. *confortare* ‘ngushëlloj, inkurajoj, jap zemër, mbështes’: BuM 12rb-12va: o Sion, lëvdo Zotnë tand, përse aj konfortoi të ëmbërshelatë e dyeret tuve (quoniam confortavit seras portarum tuarum – Ps 147 13); **konfuzion** ‘turbullim; poshtërim’ < it. *confusione* ‘turbullim, hutim; letr. poshtërim, përbuzje’: BuM 19ra: Klofshinë ëndë shumë konfuzion e ëndë ënmnër gjithë ata qi lypnjënë shpirtinë tem (confundantur et reveareantur qui quaerunt animam meam – Ps 69 3); **konkë** ‘kungë (e kishës)’ < it. *conca absidale*: BuM 43rb: e vu ëmbë konkët përsipëri të klisë (et statuit eum supra pinnaculum templi – Mat. 4 5); **konservoj** ‘ruaj’ < it. *conservare* ‘id.’: BuM 18vb: Ti të denjonesh, zotnë Papë e Apostojet me gjithë ordënit të shenjtësë Klisë ëndë shenjte religjon me ruojtunë e me konservuom; **konvertoj** ‘kthej’ < it. *convertire* ‘shndërroj; e bëj dikë të ndërrojë fenë’: BuM 13ra: Konvertona, Zot, o i Shelbuomi ynë; **koronoj** ‘kurorëzoi’ < it. *coronare* ‘id.’: BuM 81ra=101ra: e atë ënveshi ëndë kunorët të gloriesë, e atë koronoi ëndë anët të vertytsë (et circumcinxit illum zonam gloriae induit illum stolam gloriae et coronavit illum in vasis virtutis – Eccl 45 9); **kordë** ‘litar’ < it. *corda*: BuM 55vb: E bani një bisk ën kordësh... (cum fecisset quasi flagellum de funiculis... – Jh 2 12); **krimezin** ‘ngjyrë e kuqe e ndezur’ < it. *cremisino*: BuM 56/1va: Kush anshtë kÿ qi erdh prej Edonit, me petëka ën fëtyret së krimezinit? (... venit... tinctis vestibibus – Is. 63 1); **kuatro** ‘katër’ < it. *quattro* (*tempora*) = katër periudhat e agjërimit në Kishën katolike: BuM 22va: E këti kati fëjen aj qi kurajtë kuatro temporatë nukë ëngjënon; **luzion** ‘iluzion’ < it. *illusione*: BuM 16vb: Përse pishqitë e mÿ janë plot kat ën luzione, et ën mishit sim s ashtë gjã të shëndoshë. (quoniam lumbi mei impleti sunt inclusionibus et non est sanitas in carne mea – Ps 37 8)⁶; **makullë** ‘njollë’ < it. letr. *macula* ‘njollë, sidomos në kuptim moral’ (Treccani): BuM 11vb: Ëmbas parti ti ëmbete Virgjënë, pã ëndonjë makullë; **manjifikoj** ‘i këndoj lavde, madhështoj’ < it. *magnificare* ‘id.’: BuM 20rb: 2.sg.aor. përse ti manjifikove gjithë emënë tand (magnificasti super omne nomen tuum – Ps 137 2); **ëmpaçohem** ‘ngatërrohem, përzihem’ < it. *impacciare* variant i *impicciare*, id. (Treccani: <https://www.treccani.it/vocabolario/impacciare/>): BuM 65rb: Mos u ëmpaço ënd atë gjak të dërejtë (nihil tibi et iusto illi multa enim... it. Non t’impacciare nelle cose di quel giusto – Mt 27 19); **nard** ‘nard, vaj esencial aromatik’ < it. *nardo*: BuM 12ra: Tue klenë regji ëmbë shkambt të vet, nardi em dha erënë e amblë ënde e pëlqyem. (dum esset rex in accubitu suo nardus mea dedit odorem suum – KK 1 11); **ënkulpoj** ‘fajësoj, padis, qorto’ < it. *inculpare* ose lat. *inculpare* ‘id.’: BuM 57/1rb: i sillidota të ketë ëngranë këtë bukë o të ketë pÿm kelqinë e Tinëzot i pãdenjë, të jetë ënkulpuom ën korpit e ën

⁶ Në këtë kontekst specifik *iluzione* ka kuptimin “vuajtje fizike e shpirtërore”, khs. <https://www.bibleref.com/Psalms/38/Psalm-38-7.html>

gjakut së Tinëzot (itaque quicumque manducaverit panem vel biberit calicem Domini indigne reus erit corporis et sanguinis Domini – 1 Kor 11 27); **obligacione** ‘detyrim’ < it. *obbligazione* ‘id.’: BuM 11ra: Ma atyne qi dahanë ën Sinëzot për të ëndenë *obligacione*, Zotynë kã me i shpëm me bākëqīt (declinantes autem in obligationes adducet Dominus cum operantibus iniquitatem – Ps 124 5); **ofendoj** ‘fyej’ < it. *offendere* ‘id.’: BuM 41va: O Zot, qi ën kolpet je *offenduom*; **ofertë** ‘dhuratë’ < it. *offerta* ‘id.’: BuM 84va: E ata me bãm *offertë* Tinëzot, [...] një pãr turtuj o dy zogj ën pëllumbash; **onest, onesto** ‘i ndershëm’ < it. *onesto* ‘id.’: BuM 67va: e të shkuomitë taj të jetë të dëlirë e *onesto* ëndër gjindt; BuM 77va: tue klenë *onest* ëndë gjithë sen; **ornoj** ‘zbukuroj’ < it. *ornare* ‘id.’: BuM 9va: Amë ën gjithë hirënash, Mëri, n mishërierje *ornuom*; **oroj** ‘lutem’ < it., lat. *orare* ‘id.’: BuM 9rb: oro për popullit, gojëtareja jonë; **pacient** ‘i durueshëm’ < it. *paziente* ‘id.’: BuM 38ra: Tue klenë *pacient* ënde e këqiat (in tribulatione patientes – Rom. 12 12); **pal**, çmim, shpërblim për fitoren në një garë: BuM 39va: Vëllazënë, as nukë dini se shumë rjedhënë ëmbë *palit*, ma një e e mer *palinë*? (omnes quidem currunt, sed unus accipit bravium – 1 Kor 9 24); **paladin**, në kontekstin specifik ‘gjigant’ < it., ven. *paladino* ‘kalorës; luftëtar, mbrojtës’: BuM 62/1ra: Aty klenë *paladinjtë* me emënë ata qi ën së zanët së shekullit klenë, ën shtati të mëdhenj e qi dinjinë luftënë. (Ibi fuerunt gigantes nominati illi, qui ab initio fuerunt, statura magna, scientes bellum. – Bar 3 26); **part** ‘lindje’ < it. *parto* ‘id.’: BuM 11vb: Ëmbas *parti* ti ëmbete Virgjënë, pã ëndonjë makullë; **parturoj** ‘lind’ < it. *partorire* ‘id.’: BuM 31rb: Hinje se një virgjënë të zanë, e të *parturonjë* një bër... (ecce virgo concipiet et pariet filium – Is 7 14); **patroçinie** ‘mbrojtje, patronazh’ < it. *patrocinio* ‘id.’: BuM 10ra: Defendo popullinë tand, Zot, qi aj ëndë *patroçiniet* t Apostojet Pjetrët e Palit e të tjerëvet Apostoje u besuo; **presë** ‘dyndje njerëzish’ < it. vj. letr. *pressa* ‘id.’: BuM 54va: E kthyenë popullia me të madhe *presë*. (reversus est ergo populus cum festinatione – Dan 13 50); **provedoj** ‘kujdesem, siguroj, ofroj, jap’ < it. *provvedere* ‘id.’: BuM 78vb: Ecëni e ani të majm e pini t amblë, e dërgoni pjesënë atyne qi nukë *kanë proveduom* për vetëhenë... (ite comedite pinguia et bibite mulsum et mittite partes ei qui non praeparavit sibi – Neh 8 10); **proverb** ‘fjalë e urtë’: < it. *proverbio* ‘id.’: BuM 85/1rb: E aj të lypnjë kafshëtë e ënfshehuna e *ën proverbijeshit*... (occulta proverbiorum exquiret...) – Ekl 39 3); **purgoj** ‘dëlir, pastroj’ < it. *purgare* ‘id.’: BuM 62vb: Kur të lae Zotynë qelbësinënë e d bijavet Sionit, e të purgonjë gjaknë e Jeruzalemit (si abluerit Dominus sordem filiarum Sion et sanguinem Hierusalem laverit – Is 4 4), **purifikoj** ‘dëlir, pastroj’ < it. *purificare* ‘id.’: BuM 59va: aj të *purifikonjë* konshiençietë tonë (emundabit conscientiam vestram – Hebr 9 14), **refreskoj** ‘freskoj’ < it. *rinfrascare*, ven. *refrescar*: BuM 86rb: Eni gjithë ju qi pësuo të keq, e u t u *refreskonj* (venite ad me omnes qui laboratis et onerati estis et ego reficiam vos – Mt 11 28); **remedio** ‘ilaç, rrugëzgjdhje’: ven. *remedio* ‘id.’: BuM 62ra: e ën

dhunëtijet së kësaj gjelle neve na kloftë bām *remedio* për jetë të jetësë (fiat nobis remedium – Oratio); **resushitoj** ‘ringjallem’: it. *resuscitare* ‘id.’: BuM 13vb: përse atë qi meritove ëndë bark tat me bartunë, Aleluja, *resushitoi* si tha (Denn der, den du in deinem Schoß zu tragen verdient hast, Halleluja, ist auferstanden, wie er gesagt hat); **rivë** ‘breg deti’ < it. *riva* ‘id.’: BuM 43va: e u t i kullos ëndë malet të Israelit, ëmbë *rvat* e ëmbë gjithë të abituom të dheut (pascam eas in montibus Israël, in rivis, et in cunctis sedibus terrae – Ez 34 13); **rumor** < it. vj. letr. *rumore* ‘trazirë, kryengritje’: BuM 63vb: E thoshnë: Mos ditë feste, përse mos bane *rumor* ëndë popullit. (dicebant autem non in die festo ne forte tumultus fieret in populo – Mt 26 5); **salute** ‘shpëtim (i shpirtit)’ < it. *salute* ‘id.’: BuM 9va: f.sg.abl.b. Rekordou, o Bāsi i parë, ën *salutet*, porsi ën korpit sinë një tjetërë herë formë more me vertyt tande, tue lëm njëj Virgjëne. (Memento salutis Auctor, quod nostri quondam corporis, ex illibata Virgine nascendo, formam sumpseris – Himn i Offices së vogël të Zonjës), **santifikoj** ‘shenjtëroj’ < it. *santificare* ‘id.’: BuM 56vb: U të *santifikonj* emënitë tem të madhtë (et sanctificabo nomen meum magnum – Ez 36 23); **sepeltoj** ‘varros’ < it. *sepellire* ‘id.’: BuM 59va: porsi ish zakoni i Xhudhivet *me sepelyem* (sicut mos Iudaeis est sepelire – Gjon. 19 40); **sincero** ‘i sinqertë’ < it. *sincero*, ven. *sincero* ‘id.’: BuM 82ra: Edhe tÿ, *sincero* shoqi em, të lus (etiam rogo et te germane conpar – Phil 4 3), **skorpion** ‘akrep’ < it. *scorpione* ‘id.’: BuM 86rb: Hinje se juve u dhae të mujtunë ju me shkalë gjerpanjë të *skorpionatë*... (ecce dedi vobis potestatem calcandi supra serpentes et scorpiones – Lk 10 19); **soliçitoj** ‘nxitoj, shpejtoj; shqetësohem’ < it. vj. *sollicitare* ‘nxitoj’: BuM 100rb: O Zot, *soliçitou* muo me më ëndimuom (Domine, ad adiuvandum me festina – Ps 69 2); **spinë** ‘gjemb, ferrë’ < it. *spina* ‘id.’: BuM 40rb-40va: E pjesë rā ëndër *spinat*, e duol përnjëherë ferra me grunët (et aliud cecidit inter spinas et simul exortae spinae – Lk 8 7); **i spirituom** ‘i djemnuar, i pushtuar nga djalli’ < it. *spiritato* ‘id.’: BuM 18rb: E hinje se ish një gruo *e spirituome* qysh tetëmbëdhjetë vjetë (et ecce mulier quae habebat spiritum infirmitatis annis decem et octo – Lk 13 11); **superbje** ‘kryelartësi, mendjemadhësi’ < it. *superbia* ‘id.’: BuM 22ra: I pari kat mortār anshtë *superbja* qi madhështonetë njeri; **temperoj** ‘zbus, moderoj’ < it. *temperare* ‘id.’: BuM 17va: e të pinëtë tem me lot u e *temperonje*... (et potum meum cum fletu miscebam – Ps 101 10); **tentator** ‘joshës në mëkat’ < it. *tentatore* ‘id.’: BuM 43rb: E tue votë tek aj *tentatori*, i tha... (et accedens tentator, dixit ei – Mt 4 3); **terremot** ‘tërmet’ < it. *terremoto* ‘id.’: BuM 65vb: si pānë *teremotnë* e ato kafshë qi banishnë, fort i muor ënmnerja... (viso terraemotu – Mt 27 54); **torent** ‘përrua’ < it. *torrente* ‘id.’: BuM 12ra: Ëmb udhë piu ën *torentit* (de torrente in via bibet – Ps 109 7); **trat** ‘çast’ < it. *tratto* ‘vizë; tipar; segment, copë rrugë; çast, grimëherë’: BuM 38va: E atë *trat* kle dëlirunë lepra e tī. (confestim mundata est lepra eius – Mt 8 3); **turboj** ‘turbulloj, hutoj’ < it. *turbare* ‘id.’: BuM 14rb: E ajo tue pasunë gjegjunë këto kafshë, u *turbuo* ëndë këto fjalë të tī (...turbata est in sermone

eius – Lk 1 29); **uman** ‘njerëzor, i njeriut’ < it. *umano* ‘id.’: BuM 10rb: O Autore, [...], qi ën motit së shkuom formë more ëndë korp **uman**; **vendetë** ‘hakmarrje’ < it. *vendetta* ‘id.’: BuM 38va: Muo lësho **vendetënë** (mihi vindictam – Rom. 12 19); **vendikoj** ‘hakmerrem’ < it. *vendicare* ‘id.’: BuM 46vb: përse Zotynë anshtë aj qi **vendikonetë**, e aj kthen gjithëkuj si të ketë bām... (quoniam vindex est Dominus de his omnibus – 1 Thess 4 6); **vestë** ‘rrobë, veshje’ < it. *veste* ‘id.’: BuM 58/1vb: E soldatë banë një kunorë ën drizash e ja vunë përëmbi krye të ti, e i qitnë një **vestë** të kuqe përqark. (et milites plectentes coronam de spinis inposuerunt capiti eius et veste purpurea circumdederunt eum – Gjon 19 2).

Disa nga këto *fjalë të huaja* Buzuku i ka marrë madje direkt nga modeli italian pa ia përshtatur fleksionit të shqipes: *autore*, *ezempio*, *feliçe*, *salute*, *obligacione*, *onesto*, *sincero*, *remedio*.⁷

Një numër jo i paktë italianizmash librorë gjenden përveç Buzukut edhe te një autor tjetër dhe shumë të tjerë përdoren vetëm te një nga autorët pas Buzukut: *akuilon* ‘veri’ (BuM, BoC), *alegori* (BuM, BoC), *alfjer* ‘flamurbajtës’ (BID), *aloe* (BuM, BoC), *amaxonë* (BoC), *aministracione* (BoC), *amit* ‘shami katrore që vë prifti mbi supe gjatë meshës’ (BuR), *ampuletë* ‘ampulë ku ruhet vaji i shenjtë’ (BuR), *anagogji* (BoC), *anale* shm. ‘vjetarë’ (BoC), *analogji* (BoC), *anatomist* (Bog.), *antifënë/antifunë* (BuM, BuR), *antonomazi* (BoC), *apostat* (BoC), *astrolog*, *astrologji* (BoC), *augurie* (BuS), *austrë* ‘jug’ (BuM, BoC), *avizoj* ‘njoftoj’ (BuS), *batister* (LeD), *benefatuer* ‘bamirës’ (LeD), *benefic* (BuR), *çensurë* (BuR), *çinik* ‘cinik’ (BoC), *çançator* ‘llafazan’ (BID), *çemiter* ‘varrezë’ (BuR), *çenakull* ‘dhomë buke’ (BoC), *çentër* ‘qendër’ (BoC), *çirkustancie* ‘rrethanë’ (BuR), *dalmatikë* ‘tunikë e gjerë e priftit në meshën solemne’ (BuR), *deçembre* ‘dhjetor’ (BoC), *dedikoj* (BID), *diafano* ‘transparent’ (BoC), *diamant* (LeD), *diaspër* ‘një gur i çmuar’ (LeD), *dicionar* ‘fjalor’ (BoC), *dindë* ‘pulë deti, pulë hinde’ (LeD), *dizobediencie* (BuR), *dubitoj* ‘dyshoj’ (BID), *eban* ‘dru i çmuar’ (LeD), *eburné* ‘fildish’ (BoC), *ekuinoç* (BoC), *element* (BoC), *embrion* (BoC), *emendoj* (BID), *error* (BID), *esod* (BoC), *ezam* ‘provim’ (BuR), *ezempio/ezempie* (BuM, BuR), *fastidie* (BuR), *imagjine* (BuR), *impediment* (BuR), *impedit* (BuR), *improibit* (BuR), *indulgjencë* (BuR) e shumë të tjera.

I.1.1. Ndër këto huazime, që mbas ‘Mesharit’ nuk përmenden më në letërsi e në fjalorë, pra mund të konsiderohen si *huazime të vdekura*, disa janë huazuar përsëri në kohën e sotme (*reborrowing*)⁸ si ndërkombëtarizma, shpesh me forma e kuptime të ndryshme: *benefic*, *celebroj* ‘formalizoj martesën’,

⁷ Përkundrazi, Budi ia përshtat huazimet italiane lakimit të shqipes: *rremedie*, *ezempie*...

⁸ Koncept i përpunuar së pari nga Haugen, *Language* 25, 1950, f. 22; khs. Lafe 1999: 71.

dedikoj, *diamant*, *diskrecion*, *element*, *embrion*, *iluzion*, *konfuzion*, *konservoj* ‘bëj conserva’; *konvertoj* ‘këmbej monedhë’; *obligacione* (në terminologjinë bankare), *ofendoj*, *ofertë* (në terminologjinë e ekonomisë tregtare), *pacient* (si substantiv në ligjërimin e mjekësisë), *perfekt* (në trajtë rilatinizuese), *praktikoj* (në trajtë rilatinizuese), *port*, *proverb*, *purifikoj*, *rebelohem*, *spinë* (në terminologjinë e elektricitetit), *studie* ‘studim’, sot *studio* ‘dhomë pune, atelie’; *temperoj* (në terminologjinë e metalurgjisë e të kimisë) etj. Nga shqipja e vjetër e shek. XVII një numër i madh huazimesh librare u zhdukën nga përdorimi letrar në shekujt e mëvonshëm, kur edhe letërsia e arealit katolik të Veriut pati një periudhë heshtjeje, dhe u huazuan përsëri në kohën e sotme. Një veçori e italianizmave të shek. XVII është ndikimi fonetik i italishtes në shqiptimin e afrikateve postalveolare, si pasojë e formimit në kolegjet e Italisë Qendrore të shkrimtarëve të këtij shekulli dhe e botimit në Romë të veprave të tyre: *çensurë* (Budi) < it. *censura*; *çerimónie* ~ *çeremónie* < it. *cerimonia*; *çinik* (Bogdani) < it. *cinico* të cilat janë huazuar përsëri në kohën e sotme të përshtatura me trajtën latine sipas rregullave të drejtshkrimit: *censurë*, *ceremoní*, *cinik*; *dedikoj* (Bardhi) < it. *dedicare*, huazuar përsëri në kohën e sotme; *dicionar* (Bardhi), sot sporadikisht *diksioner* nga frëngjishtja; *dinjitat* < it. vj. *dignitate*, në kohën e sotme huazuar në trajtën *dinjitet* sipas modelit të huazimeve latine më -*tet*; *ekuinoç* (Bogdani) < it. *equinozio*, sot në trajtë rilatinizuese *ekuinoç* (ose < fr. *équinoxe*); *katarat* (Bogdani) < it. *cataratta* dhe huazimi i ri *katarakt* me trajtë rilatinizuese; *element*, *embrion*, *esod* (Bogdani), sot *eksod* me trajtë latinizuese, etj.

I.1.2. Një numër huazimesh të përsëritura kanë hyrë në rrugë letrare por ndeshen gjithashtu në dialekte, të hyra përmes gjuhës së folur. Një rast i tillë është emri *balsam*, në shqipen e vjetër i dëshmuar vetëm te Buzuku, i huazuar përsëri në kohën e sotme, por haset edhe nëpër të folme me trajtën *ballcam* në Gjirokastër (Kristoforidhi FSG 47) dhe *basan* në togfjalëshin terminologjik *lule basani* ‘Hypericum perforatum’, pra kemi të bëjmë me huazim të trefishtë nga italishtja. Nëse konsiderojmë format më të vjetra *bálçëm*, *bállshëm* të hyra nga latinishtja (Çabej SE II 143v.), fjala është një huazim i shumëfishtë, që, krahas huazimeve të shumta të kësaj tipologjie, flet për një proces huazimi të pandërprerë latino-italian (Çabej 1974: 29v.). Një rast tjetër nga Buzuku është leksema *kordë* ‘litar’, e përdorur vetëm një herë, pas gjase për nevoja të tekstit, e cila është huazuar edhe në rrugë orale si *kordhë* ‘tel violine prej zorre’, *kordhëz* ‘kukurec; delli që shërben për të ngrehur harkun e për të hedhur shigjetën; gjalmë o tërkuzë thurur me zorre shtazësh’, me përhapje të gjerë në gjuhë. Te Da Lecce regjistrohët italianizmi *kalenda* ‘viti i ri’, i cili është huazuar në gjuhën e folur si *këllâna*, *kullana*, *kollana* ‘dhuratë Krishtlindjesh’. Huazimi letrar *konsoli* shm. te Bogdani, ndeshet në gjuhën e folur si *kushullë* ~ *korsull* ~ *korcull*, sot *konsull*. Emri etnik *lati*, -*ni* ‘latin; i krishterë katolik’

është huazuar në rrugë letrare (te Bardhi, Bogdani) nga italishtja dhe në një fazë më të hershme nga latinishtja si *lētī* ‘latin; italian’, me përhapje në gegërishten veriore. Leksema it. *biscotto* është huazuar dy herë, së pari si *bërskot* ‘galetë marinari, panis nauticus’ (te Bardhi dhe Da Lecce), e së dyti në kohët e reja si *biskotë* me kuptimin modern.

I.1.3. Për shumë nga huazimet e natyrës librore shtrohet edhe problemi i dallimit të italianizmave nga latinizmat, në varësi edhe nga teksti latin apo italian që ka shërbyer si model.⁹ Fjalë librore si *akuilon*, *aloe*, *austrë* ‘jug’ te Buzuku ose Bogdani mund të jenë marrë si nga një tekst latin ashtu edhe italian, *aromata* shm. te Buzuku është marrë nga latinishtja kishtare por mund të jetë ndikuar edhe nga ven. *aròmato* ‘nome generico d’ogni spezieria e profumo’ (Boerio 44). Latinishtja kishtare mesjetare duhet të ketë shërbyer si burim edhe për një numër njësisish leksikore kryesisht të sferës së religjionit, si *arkangjel*–*arkangjell*, *artikull* (*i fesë*), emrat abstraktë me {-tat}: *autoritat*, *dinjitat*, *divinitat*, *ereditat*, *fragjilitat*, *karitat*, *kastitat*, *libertat*, *proprietat*, *potestat*, *virgjinitat*, për të cilat vjen në vështrim edhe it. e vjetër *autoritate*, *dignitate* etj., *devocion*, *dëshpëroj*, *dishipullë*: < lat. kishtare *discipulus* ose it. vj. *discipolo*), *kapitull*: < lat. *capitulum* ose it. vj. *capitolo*, *konkë*: < lat. *concha* ose it. *conca* ‘conca absidale – kungë e kishës’, *corp*, *martir*, *natyrë*, prejardhja latine e së cilës është vënë në pikëpyetje për shkak të ruajtjes së parrëgjuar të zanores së patheksuar (khs. De Vaan 2010: 233, Topalli FEGJSH 1031), por që mund të jetë ruajtur pikërisht për shkak të transmetimit të saj në rrugë letrare; *resushitoj* mund të vijë si nga lat. e vonë kishtare ashtu dhe nga it. *resuscitare*; *reverencie*: < lat. e vonë *reverentia* ose it. vj. *reverenzia*; *sentencie*: < lat. e mesme *sententia* ose it. vj. *sentenzia* etj. Siç e ka vënë në dukje Çabej në përgjithësi për latinizmat e shqipes, ky problem mbetet një nga çështjet parimore të gjuhësisë shqiptare të pazgjidhura deri sot.¹⁰ Për përcaktimin e një statusi gjuhësor të këtij tipi huazimesh në letërsinë e vjetër shqipe, në studimet tona të specializuara është zbatuar koncepti i etimologjisë dyfishe, latino-italiane, të formuluar së pari nga studiuesi rumun Aleksandër Graur.¹¹

Huazimet popullore

II. Grupi tjetër i huazimeve të Buzukut janë huazime që pas gjithë gjasash i përkasin **ligjërimit të folur** të tij si individ, ndoshta brenda një bashkësie të

⁹ Shih më gjerë K. Jorgaqi, *Ndikimi i italishtes në letërsinë e vjetër shqipe*, vep. cit., f. 22-25.

¹⁰ E. Çabej, Karakteristikat e huazimeve latine në gjuhën shqipe, SF, 2, 1974, f. 29.

¹¹ A. Graur, “Etimologie multiplă”, *Studii și cercetări lingvistice*, 1, 1950, f. 22–34; E. Çabej, Karakteristikat e huazimeve latine në gjuhën shqipe, art. i cit., f. 29 v.; K. Jorgaqi, *Ndikimi i italishtes në letërsinë e vjetër shqipe*, vep. cit., f. 25.

caktuar bashkëkombasish. Për dallimin e këtyre huazimeve mund të tentohet përvijimi i disa kriterëve për klasifikimin e tyre si huazime të ashtuquajtura “popullore”. Këto kriterë vlejné në përgjithësi për italianizmat e shqipes së vjetër, pra jo vetëm për ato të Buzukut.

II.1. Një kriter për përfshirjen në këtë grup së pari janë huazimet veneciane. Dihet se ndikimi italian mbi shqipen fillon me ardhjen e venecianëve në bregun lindor të Adriatikut, rreth shekujve 13-14, pra ndikimi venecian në gjuhën shqipe është më i vjetri në ndikimet italiane dhe i takon periudhës paraletare të shqipes. Në ‘Mesharin’ e Buzukut kemi rreth 24 leksema të tilla me karakteristika të qarta fonetike e leksikore veneciane¹², si: *i bandizuom* ‘të nxjerrë jashtë ligjit’ (BuM 13vb) < ven. *bandizar* ‘nxjerr jashtë ligjit, leçis’ (Boerio 61); *bonacë* ‘det i qetë, gjendje qetësie e detit, pa erë e pa lëvizje’ (BuM 49ra=39ra) < ven. *bonazza* (khs. it. *bonaccia*); *desqaroj* ‘sqaroj, shpjegoj’ < ven. *deschiarare* (BuM 52va); *fraxilitat* ‘brishtësi’ (BuM 38vb) (khs. it. *fragilità*), *manacon* (BuM 67rb), *menacon* (BuM 42va) ‘kërcënoj’¹³; khs. it. *minacciare*, me afrikatat alveolare të venecianishtes (/ts/, /dz/) për afrikatat palatoalveolare të italishtes (/dʒ/, /tʃ/); *red* ‘trashëgimtar’ (BuM 55rb) variant venecian i *erede* (Boerio 560); *ënxenjohem* ‘angazhohem, përpqem’ (BuM 38ra) < ven. *inzegnarse* ‘përpqem me të gjitha mundësitë, i vihem punës, përvesh mëngët’ (Boerio 354); *fogacë* ‘pogaçe’ (BuM 44vb), < ven. *fogazza*, e dokumentuar te Goldoni: *vender pan per fogazza* (Goldoni 1833: 180) ose te mbiemri *Fogazzaro*, përkundrejt *fugazza* që jep Boerio 290; *kapetanjë* ‘kapiten’ (BuM 65va=75va) < ven. vj. *capitagno*; *karkaç* ‘këllëfi i shigjetave’ (BuM 86ra) < ven. vj. *carchasio* (*uno archo et uno carchasio pleno de freze*, shek. XIV, khs. TLIO, s.v. *carcasso*); *maqe* ‘njollë’ (BuM 20vb), *maqoj* ‘njollos’ (BuM 56/1vb) < ven. *machia, machiare*; *maravejë* ‘mrekulli’ (BuM 37va) < ven. *maravegia* (Boerio 396); *mastel* ‘kovë druri’ (BuM 87/1rb) < ven. *mastela, mastelo* ‘kovë druri për të larë rrobat’ (Boerio 404; Çabej SE V 288); *mënestër* ‘supë’ (BuM 60va) < ven. *manestra* (Boerio 395) për it.

¹² Për trajtat veneciane të Buzukut khs. E. Çabej 1968: 33, 76, 86 e passim. Për venecianizmat në gjuhën shqipe të shihet dhe punimi i F. Vicario, “L’influsso lessicale veneto in albanese”, në: *Balkan Archiv n.F.* 17/18, 1992/3, p. 187-232; për tiparet fonologjike të huazimeve khs. f. 192-193. Një tipar dallues i venecianishtes është shqiptimi alveolar (/ts/, /dz/) i afrikateve palatoalveolare të italishtes (/dʒ/, /tʃ/), khs. *bonazza* (Boerio 90) për it. *bonaccia*, *fogazza* (ose *fugazza*, Boerio 290) për it. *focaccia*, *zovene* ‘djalosh’ (Boerio 822) për it. *giovine*, *zudegar* ‘gjykoj’ (Boerio 824) për it. *giudicare*, shqiptim që ka qenë i pranishëm deri në shekullin XIX, khs. https://it.wikipedia.org/wiki/Fonologia_della_lingua_veneta;

https://it.wikipedia.org/wiki/Grafia_veneta_classica

¹³ Përdoret edhe sot në Shkodër *menaçoj*: Ky na ka *menaçu* (E diela shqiptare: Shihemi në gjyq – Zaptuesit përballë “pronarit”, 20 tetor 2024).

minestra; *ost* ‘hanxhi’ (BuM 77ra) < it./ven. *oste*; *ostari* ‘bujtinë’ (BuM 77ra) < ven. *ostaria* (Çabej SE VI 117); *pont* ‘centimetër’ < ven. *ponto* ‘pikë; shenjë; cak; etj.’ (Boerio 522), për it. *punto*; *porteg* ‘hajat’ (BuM 10va) < ven. *portego* (Boerio 527) për it. *portico*; *refreskoj* ‘freskoj; këndell’ (BuM 41va) < ven. *refrescar* (Boerio 562); *segur* ‘i sigurt’ (BuM 12va) < ven. *seguro*; *shponxë* ‘sfungjer’ (BuM 65va) < ven. *sponza*; *viaxë* ‘udhëtim’ (BuM 40ra) < ven. *viazo* për it. *viaggio*; *xil* ‘zambak’ (BuM 79rb) < ven. *zilio* (khs. TLIO s.v. *giglio*, lista e formave, khs. dhe Boerio 811 *ziliato* për *gigliato*). Buzuku përdor edhe italianizma të cilat dokumentohen në italishten e vjetër por nuk kemi dëshmi të mjaftueshme nëse kanë qenë përdorur edhe në venecianishten e vjetër, si *dupjo* që mund të vijë nga një variant i italishtes së vjetër dialektore me /-u-/ të patheksuar në vend të /-o-/, khs. listën e formave në TLIO s.v. *doppio*: *dupio*, *dupla*, *duple*, *dupli*, *duplo*, *duplu*, *duppii*, *duppio*, *duppla*, *duppli*, *dupplu*; ose *sanëp* ‘sinap’ nga it. vj. *sanapa* për it. moderne *senape* (khs. L’olio espresso dai semi di Senapa è dolce, quantunque la *sanapa* sia piccante, *Elementi di chimica rurale del signore Humphry Davy ... tradotti ... Napoli, 1815, S. 103*; khs dhe TLIO s.v. *senape*);

Edhe në këto të dhëna ka raste të diskutueshme, nëse i përkasin njërit grup apo tjetrit, pasi psh. fjala *fragjilitat*, *fraxilitat* del në dy trajta të ndryshme te Buzuku, njërën nga të cilat e kemi përfshirë te huazimet librorë, dhe tjetrën te ato popullore. Po kështu variantet *cimbal*, *cinamom*, *cipres*, *deskricion*, *despensoj*, *sincero*, *segur*. Këto variante mund të shpjegohen me faktin se Buzuku është ndikuar në gjuhën e shkruar edhe nga gjuha apo dialekti që dëgjonte më shpesh në jetën e përditshme, dhe ky ishte dialekti venecian.

Nga lista jonë e italianizmave kemi evidentuar një numër prej 77 venecianizmash në shqipen e vjetër, ku përfshihen edhe ato të Mesharit të Buzukut. Në këtë numër nuk kemi përfshirë dy pseudovenecianizma që gjenden në fjalorin e Da Lecces (1702), fjalë me prejardhje veneciane por që kanë hyrë përmes gjuhëve të tjera ndërmjetësuese: *bajloz* (nga turq. osm. *balyos*, *baylos* ‘titull i ambasadorit venecian në Portën e Lartë’, Bufla & Rocchi 2021: 59) dhe ndoshta edhe *barbun* ‘lloj peshku’ që sipas Çabejt (SE II 161) mund të ketë hyrë nga dy burime të ndryshme, në varësi të përhapjes gjeografike: në bregdetin verior direkt nga venecianishtja, në jug përmes greqishtes. Më poshtë regjistrujmë venecianizmat e tjerë që gjenden te Meshari dhe në tekstet mbas tij:

almise ‘vegla, instrumente’ (BoC) nga ven. *armizo* ‘ormeggio, cavo che tien ferma la nave dalla parte di poppa’ (Boerio 44, Çabej SE II 34), *avoj* ‘fildish’ (BoC) < ven. *avolio* (Jorgaqi 2001: 47), *ballë* ‘top, gjyle’ (BoC, LeD) < ven. *bala* (Boerio 56); *ballkon* (BID, BoC, LeD) < ven. *balcon* (Boerio 58; Tagliavini AD 77), *baticë* (BoC, LeD) < ven. *bataizza* (Çabej SE II 183), *bocë* ‘shishe’ (LeD) < ven. *bozza* (Miklosich AF II 6 etj.); *botë* ‘goditje’ (BoC, LeD) < ven. *bota* (Boerio 94, Çabej SE II 296); *brakesha* ‘pantallona të gjera të

bardha' (LeD) < ven. *braghesse* (Çabej SE II 299); *burillë, burilë, bulirë, buljerë* etj. (BoC, LeD) < ven. *barila* 'vazo druri të bëra me dërrasa si një fuçi, me kapacitet zakonisht prej gjashtë kovash' (Boerio 65, Çabej SE II 364); *caf, saf* 'bandit' (BuM, BID) < ven. *zafo* 'roje, xhandar' ose it. vj. *zaffo* 'truproje; vrasës' (Çabej SE III 4); *celadë* 'helmetë' (BuM *callatë*, BID *qallatë*, BoC *celadë*, LeD *salatë, qelatë*, CuA *qelatë*) < ven. *celada* (Çabej SE III 7); *copë* < ven. *zopa* 'plis dheu; copë toke' (Boerio 821, Tagliavini AD 291); *cunk, xunkth* (LeD) < ven. *zunco* (Çabej SE VII 277); *despjek* (BuM, LeD) 'inat, kokëfortësi' < ven. *despeto* (Çabej SE III 248); *fëdigë* 'mundim' (BuM, BuD, BID, BoC, LeD, CuA, CaB) < ven. *fadiga* (Miklosich AF I 24 etj.); *fortunë* 'furtunë, stuhi' (BuM, BID, BoC, LeD, CuA) < it. vj., ven. *fortuna di mare, fortuna di vento* (TLIO s.v. *fortuna*); *fustë* 'galerë e vogël' (BID, LeD) me origjinë veneciane (Treccani); *gajuf* 'bjerraditës' (LeD) < ven. *gajuf*o në një dokument venecian të 1238 (Cassese 2009: 184vv.); *gradelë* 'zgarë' (LeD) < ven. *gradella* (Treccani); *kalamar* 'shishe boje' (BuR) < it., ven. *calamaro*; *kanavetë* 'arkë e vogël druri' (LeD) < ven. *caneveta* (Meyer EWA 173); *gardinal, gardhinall* 'kardinal' (BuR, BID, BoC, LeD, CuA, CaB) < ven. *gardenal* (Boerio 500); *karrikë* (BID) < ven. *carega*, pop. *cariëga* (Boerio 137); *kokolë* 'bërthamë ulliri' (LeD) < ven. *coccola* 'kokërr' (Vicario 1992/3: 205); *kurtjelë* 'thikë' (BoC) < ven. *cortela* (Çabej SE V 179); *kusi* 'tenxhere' (BID, BoC, LeD, BeK, KaP) < ven. *cusina* (Meyer EWA 217); *kuzhinë* (LeD) < ven. *cusina* (Çabej SE V 186); *lincuo, lincjoll* (BuM) 'çarçaf' < ven. *linzòl, linçiol*; *lexon* (LeD) < ven. *lezer* (Meyer EWA 239 etj.); *lëmshënë* 'lëmshë' (BuM, BuD, BID, BoC, LeD, CuA) < ven. *lemosina* (Boerio 365); *librari* 'bibliotekë' (BoC) < it. vj., ven. *libraria* 'bibliotekë' (Boerio 369); *masarë-të* 'enë, sendet e shtëpisë' (BID) < ven. *massaria* (Boerio 403); *navëgon* 'lundron' (BuR) < ven. *navegar* (Jorgaqi 2001: 134); *patërshanë, patërzanë* 'heshtë' (BID, BoC, LeD) < ven. *partesana* (Çabej SE VI 157, Jorgaqi 2001: 145); *pinjoll* 'filiz' (BoC, LeD) < ven. *pignol* (Çabej SE VI 230); *pupë* 'pjesa e pasme e anijes' (BID, LeD) < ven. *pupa* (Boerio 540); *razënoj* 'arsyetoj' (BID, LeD) < ven. *rasonar* (Boerio 554); *renegoj* 'mohoj fenë' (BuM, BuD, LeD, CuA) < ven. *renegar* (Çabej SE VI 286); *responoj* 'përgjigjem' (BuM, BuD, BID, LeD, CuA) < ven. *respondere* (edhe lat. *respondere*, it. vj. *respondere*); *respostë* 'përgjigje' (BuM, LeD) < ven. *resposta* (Çabej 1968: 33); *rrufë* (BID, LeD, KaP) < ven. *rufa* 'ndyrësi' (Meyer EWA 370 etj.); *rrugë* (BuR, BoC, LeD) < ven. *ruga* 'rrugicë' (Meyer EWA 376 etj.); *i strupjuom, i strupijuem* 'gjytyrim, sakat' (BuM, BoC) < ven. *strupiato*, me mbaresën e mbiemrave prejpjesorë të shqipes; *shkollë* (BuS, BID, BoC, LeD, CuA) < ven. *scola* (Meyer EWA 387); *tramontanë* 'tramundanë, erë e veriut' (BoC, LeD) < ven., it. *tramontana* (Çabej SE VII 129); *tratë* 'rrjetë e madhe peshkimi' (LeD) < ven. *trata* (Çabej SE VII 129). Statistikat e Brunilda Dashit japin një përqindje

prej 10% të venecianizmave në italianizmat e shqipes së vjetër të shekujve 16-17 (Dashi 2013: 20).

II.1.1. Huazimet veneciane shpesh herë paraqesin edhe probleme dallimi nga huazimet italiane të vjetra apo latine. Madje, siç e ka vënë në dukje H. Haarmann, dallimi midis latinizmave dhe venecianizmave është më i vështirë sesa dallimi mes formave italiane e veneciane, duke pasur parasysh vështirësinë për identifikimin e prejardhjes së tingullit *sh* (Haarmann 1977: 318). Disa huazime nuk mund të përcaktohen qartë si venecianizma për shkak të një fonetizmi devijues që paraqesin në raport me modelin italian/venecian. Në këtë ndërlikim na vjen në ndihmë shpesh herë kriteri i përhapjes gjeografike të fjalës në shqipe. Kështu *dulfino* (BID), *dulfi* (gegërishte veriore), *dyllft* (LeD) mund të jetë marrë si nga lat. e mesme *delphinus*, it. vj. (shek. 13-14) *dalfino*, *delfino* ashtu edhe nga ven. *dolfìn* (Boerio 243; TLIO s.v. *delfino*), megjithatë varianti venecian *dolfìn* vjen në vështirësi si për shkak të ngjyrimit më të mbyllur të zanores së pathekse ashtu edhe për shkak të përhapjes gjeografike në gegërishten veriore (trajta e sotme *delfìn* e gjuhës standarde është huazim i përsëritur kulturor); *faqell* ‘turban’ (LeD), sipas Meyerit nga ven. *faziol*, *fazzuol*, *faciol* (Boerio 258, 264) ‘shami ose cohë prej liri; mantel prej liri etj.’, por për shkak të devijimit në ngjyrimin e zanores në rrokjen fundore është vënë në diskutim nga studiuesit. Shpjegimet që jepen në fjalorin Treccani online për fjalën *fazzolo* ‘shami qafe ose koke; copë e gjerë pëlhure në formë katrore; shall koke që mbanin gratë veneciane në shek. 16’, si fjalë e formuar në arealin venecian, nga lat. mesjetare *faciolum* < lat. e vonë *faciale* (< *facies* ‘faqe’), të shpien te ven. *faciol* si burim i drejtpërdrejtë i fjalës, e jo nga lat. e mesme *faciolum*, edhe për shkak të përhapjes krahinore të kufizuar në geg. veriore. Prejardhja e *shestë* ‘compasso; piano, misura’ nga it. *sesto*, *sesta* ‘id.’ (Treccani) u vu në pikëpyetje për shkak të ndërrimit /s:/sh/ që mendohej se ka prekur huazimet latine dhe jo ato italiane (Thumb 1909: 10v.). Tashmë e dimë që nga Helbigu (1903: 74vv.; 100) se ndërrimi /s:/sh/ ka prekur po ashtu edhe huazimet më të vjetra italiane, por dihet edhe se /s/-ja veneciane shqiptohet disi e palatalizuar (Tagliavini AD 33), prandaj Çabej (SE VII 51) anon, edhe për arsye të gjeografisë dialektore të fjalës, të kufizuar në geg. veriore, nga një ndikim venecian më shumë sesa të italishtes së vjetër. I njëjti kriter i përhapjes gjeografike vjen në vështirësi edhe për raste të tjera huazimesh të diskutueshme, si *kurtjelë*, nga it. *coltello* apo lat. *cultellum*, për të cilin Çabej (SE V 179f.) zgjedh ven. *cortela* edhe për shkak të përhapjes gjeografike në Shqipërinë e Veriut, apo për huazimin *shkollë*, prejardhjen veneciane të së cilës e mbështesin përhapja dialektore pas gjase në zanafillë në geg. veriore (në toskërisht ka qenë në përdorim greqizmi *skoli*) si dhe arsye kulturore-historike.

Huazime popullore duhen konsideruar edhe ato fjalë që shfaqin ndikime dialektore të italishtes, si *gjinipero*, *gjeniper* ‘dëllinjë’ te Buzuku, nga it.

ginepro 'id.': BuM 44vb: e aty e muor gjumi përëndenë *gjeniperit* (et obdormivit in umbra iuniperi – 1 Mbret III 19: 5); BuM 44vb: E erdh e ëndenj përëndenë një lis *gjinipero* (et sederet subter unam iuniperum – 1 Mbret 19 4). Trajtat e Buzukut duket të jenë ndikuar nga format gjegjëse të dialekteve qendrore të italishtes së vjetër *çenepero*, *çineparo*, *gineparo* etj. (khs. TLIO s.v. *ginepro*).

II.2. Një tjetër kriter që mund të zbatohet për të veçuar huazimet e gjuhës së folur, janë ato që quhen *huazime intime*, sipas konceptit të Bloomfield-it (Bloomfield 1935: 461). Këto janë huazime që vijnë si pasojë e dygjuhësisë së folësve të gjuhës më pak prestigjioze, që jetojnë në të njëjtën hapësirë me gjuhën huazuese, e cila është gjuha dominante kulturalisht, politikisht dhe ekonomikisht. Huazimet intime përfshijnë fusha semantike më të gjera sesa ato të *huazimeve kulturore* që lidhen me marrjen (importimin) e një risie kulturore (Bloomfield 1935: 445 vv.) dhe përfshijnë edhe elemente funksionale ose fjalë gramatikore, si ndajfolje, mbiemra etj. Te Buzuku gjenden një numër fjalësh të tilla, që nuk janë huazime kulturore, si *fashë* < it. *fascio* 'tufë'; *fī*, *-ni* 'fund; qëllim'; *fior* 'lule'; *fond* 'fund'; *maganjë* nga it. *magagna* 'difekt, e metë', që është një fjalë e gjuhës bisedore, joformale, prandaj duhet të jetë huazim nga gjuha e folur; *mulë* 'mushkë'; *pin* 'pishë'; ose janë elemente funksionale: *ajme* (pasth.), *dupjo*, *epur* (përdorur 6 herë në tekst), *fermo* 'i qëndrueshëm' (BuM 40va: ma nukë jesënë *fermo*); *opur* 'ose'; *pur* 'edhe; megjithatë, gjithsesi'; *i segurë* (me mende të *segūra*), po edhe *segur*: ata me klenë *segūr* 'të sigurt' < ven. *seguro*; *voluntjera* 'me gjithë qejf' etj.

Ky bilinguizëm i përparuar dhe prania imponuese e italianizmave përkth. venecianizmave te Buzuku, qofshin ndikime letrare apo të gjuhës së folur, konfirmojnë konkluzionin e Çabejt për lidhjet e ngushta të autorit me jetën e kulturën veneciane dhe ndoshta një qëndrim të tij mjaft të gjatë në ato anë (Çabej 1968: 33), dhe i japin një mbështetje edhe hipotezës së prof. Lucia Nadin që Buzuku mund të ketë qenë pjesëtar i komunitetit shqiptar në Venecie, madje një famullitar françeskan i kuvendit të Shën Jobit, dhe veprën e tij e shkroi për përdorim dhe dobi të atij komuniteti (Nadin 2012: 231-271).

II.3. Huazimet popullore dallohen si të tilla edhe nga ndryshimet fonologjike e semantike që kanë pësuar në krahasim me modelin e gjuhës dhënëse, nga prania e varianteve fonologjike e morfologjike në hapësirë e në kohë, si dhe nga një derivacion i pasur. Këto veçori lidhen edhe me një vjetërsi të huazimit. Një fjalë si *cār* 'çelik' e Da Lecces, nga it. dial. (kal.) *azzaru* (Lambertz II 16, KZ 53 283; Çabej SE II 10), me rënien e rrokjes së patheksuar, flet për huazim të marrë në rrugë popullore dhe për njëfarë vjetërsie të huazimit. Në raport me huazimin individual të Buzukut *adoroj*, trajta *adhëroj* e përhapur në gegërishten e vjetër në shek. XVII, më vonë, në shek. XIX *adhroj*, *avroj*, sot *adhuroj*, me labializim të ë-së paratheksore,

paraqet ndryshime fonologjike që flasin për një huazim përhapur në gjuhën e folur, fillimisht të hyrë në gjuhën kishtare nga latinishtja mesjetare dhe më pas nën ndikimin e vazhdueshëm të italishtes në gjuhën kishtare. Ky tip huazimi mund të konsiderohet si *gjysmëdituror*. Fjala e leksikut detar *angurrë* (BID), *angur* (LeD), me ndryshimet formale që përmban në krahasim me trajtën e sotme *ankorë*, të përdorur sporadikisht në përkthime, mund të klasifikohet si fjalë e gurrës popullore, ndoshta veneciane, duke pasur parasysh edhe ndikimin venecian në fushën e detarisë. Përhapja e kufizuar dialektore në geg. veriore flet në të mirë të huazimit italian ndaj atij latin, format origjinale të të cilave dalin njësoj fonetikisht. Një italianizëm që pësuar ka ndryshime formale e semantike në rrjedhë të kohës është huazimi kulturor *arkivol*, nga it. *archivolto*, te Bogdani shm. *arkivojet*, i cili ka marrë kuptimin ‘arkëmort’, kuptim i cili është zhvilluar përmes kuptimit të ndërmjetëm “përmendore varri” (Çabej SE II 79). Megjithatë në origjinë fjala është marrë në rrugë librore, zhvillimi semantik flet për transmetim gojor të fjalës. Për huazim “popullor” te leksema *bocë* e Da Lecces flet jo vetëm trajta e saj veneciane (< ven. *bozza*), por edhe prania e saj dialektore në geg. e Shqipërisë së Mesme të Tiranës me kuptimin ‘fuçi e vogël’ (Kristoforidhi 53). Një huazim kulturor i shqipes së vjetër që shfaq vijimësi në ndonjë dialekt të shqipes, me shumë gjasë është një huazim i hyrë përmes ligjëritimit të folur, qoftë edhe atij kishtar. I tillë është rasti i termit në origjinë kishtar *baldakī*, -ni te Budi, i cili haset edhe në rrethinat e Krujës me kuptimin ‘tendë’ (Çabej SE II 602). Romanizmi *diluv* ka hyrë së pari në gjuhën e shkrimit për të dhënë lat. *diluvium*, it. *diluvio* të shkrimeve biblike dhe që këtej u përhap edhe në gjuhën e folur si *dëludh* (BID) me shndërrimin e frikatives labiale në dentale që haset shpesh në huazimet popullore: *ajovimë*: *ajodhimë*, *vespër*: *dhespër*, *vjoli*: *dhjoli* etj. (Çabej SE III 189). *Despjek*, *dispjek* nga it. *dispetto*, ven. *despeto* përmbajnë edhe shndërrimin e shpeshtë dialektor *t* > *k* (*tërmek* < *tërmet*, *Ferik* < *Ferit*). Folja *divënoj* ‘parashikoj të ardhmen, profetizoj’ paraqitet në variante të shumta fonomorfologjike në shqipen e vjetër: *ndivënoj*, *divënej*, *ndivënej*, *ndëvënej*, *divinoj* dhe ka krijuar një numër të madh derivatesh: *divënyem* (të) ‘parashikim i së ardhmes’, *dëvënatës*, *divënyes* ‘fallxhor, profet’, *ndëvënesë* ~ *ndivënesë* ‘profeci’, të cilat në dialekte kanë pësuar shndërrime të mëtejshme fonologjike, edhe semantike, psh. *dimnej* ‘truej tue përmendë dreqin’ me asimilim *vn* : *m*, *divnac* ‘fallxhor, shortar’, *divnace* ‘fallxhore, shortare’ etj. (Çabej SE III 253). Fjala është një huazim i vjetër në të cilin kanë ndikuar disa modele italiane: *indovinare*, *indivinare*, *divinare* ‘parashikoj me aftësi magjike, parathem, parandiej, gjej me intuitë’ (fjalë diturore), pra mund të jetë huazim me etimologji dy apo trefishe, fillimisht i hyrë përmes gjuhës kishtare, më pas përhapur në gjuhën e folur në arealin verior. *Navë* është një huazim i fushës së detarisë i shqipes së vjetër, i cili është përdorur në gegërishten veriperëndimore të bregdetit nga Ulqini në breg të Bunës (Çabej SE VI 10). Folja *ngadhënjej*, *gadhënjej* ‘fitoj mbi dikë,

mposht' përmban ndryshime fonologjike dhe semantike ndaj modelit it. *guadagnare* 'fitoj, përfitoj' dhe ka formuar një çerdhe të pasur fjalëformuese. Emri abstrakt *tradhëmend* (< it. *tradimento*) te Buzuku duhet të jetë huazim i gjuhës së folur, i hyrë që më parë në gjuhë për shkak të ndryshimeve fonologjike që ka pësuar, dhe që ka vijuar në të folmen e Shkodrës me një zhvendosje semantike si *tradhmend* 'befasi'; ndf. 'papritur': "mbandej *tradhmend*, tûrijt në gjas t'lugatit, // krejt zëmren në krahnuer i a ngrîn udhtarit" (L. Shantoja). Në raport me këtë huazim, trajta *tradiment* ,tradhti; mashtrim, ligësi' e Budit duket huazim letrar, i përshtatur për nevoja të tekstit. Emri etnik *tudheshk*, shm. *tudheshqitë* 'gjerman' i Bardhit dhe Bogdanit ka vazhdimësi në të folmet e geg. veriperëndimore dhe me ndryshimet formale që ka pësuar rezulton huazim popullor nga it. vj. *todesco*.

Një fjalëformim të pasur në shqipen e vjetër kanë krijuar fjalë si *barkë*: *barkëtar*, *barkëzë*; *caf*: *cafni*; *copë*: *copëzë*, *copëtoj*; *debëloj* 'deboloj, dobësoj': *i debëluem*, *të debëluem* (e.asnj.), *debëlim*, *debëlueshim*; *i denjë*: *të denjë-të* (e.asnj.), *i denjshëm*, *denjshëm*, *i padenjë*, *të padenjë-të* (e.asnj.), *denjoj*; *dëshpëlqen*: *të dëshpëlqyem*, *dëshpëlqim*; *dëshpëron*: *i dëshpëryem*, *të dëshpëryem*, *dëshpërim*, *dëshpërueshim*; *disqaroj/desqaroj* 'sqaroj': *i disqaruem*, *të disqaruem-it* (e.asnj.), *disqarues*, *disqarim*; *divënoj/divënej*: *të divënyem-it* (e.asnj.), *dëvënatës*, *divënyes*, *ndëvënesë* ~ *ndivënesë*; *dragoman* 'përkthyes': *dragomani* 'përkthim, interpretim'; *duroj*: *të duruem-it* (e.asnj.), *i durueshim*, *durueshim*, *durim*, *dures*, *të paduruem-it* (e.asnj.), *i paduruem*, *i padurueshim*, *padurim*; *fabrikoj*: *i fabrikuem*, *të fabrikuem-it* (e.asnj.); *festë*: *feston*, *i festuem*, *festueshëm*, *festues*; *fëdigë*: *fëdig*, *fëdigëtar*, *fëtigëzë*, *i fëdigshëm*, *fëdigshëm*, *fëdigues*, *i fëdigunë*; *fitoj*: *të fituem*, *fitim*, *fitues*, *sfitoj*; *forcë*: *forcon*, *i forcuem*, *të forcuar*, *forcim*, *i paforcuem*; *formë*: *formon*, *i formuem*, *formëzë*; *i fortë*: *të fortë-të* (mb.asnj.), *fortshim*; *furi*: *i furishim*; *gënjej*: *i gënjyem*, *të gënjyem-itë* (e.asnj.), *gënjim*, *gënjyes*, *gënjyeshim*, *gënjeshtër* e shumë të tjera.

Mbyllje

Në përfundim të këtij klasifikimi ajo që vihet re është se këto dy klasa leksikore nuk ndahen dot në mënyrë të prerë; ato formojnë një tërësi ku modeli i gjuhës së kultivuar ushtron presion mbi gjuhën popullore (gjuhën e folur / vernakulare) dhe anasjelltas. Megjithatë, një llogaritje, qoftë edhe subjektive, e raportit mes huazimeve diturore e huazimeve popullore nga italishtja na jep një statistikë të tillë: nga një numër i përgjithshëm prej 950 italianizmash, 232 rezultojnë huazime popullore dhe 718 të tjerat i përkasin grupit të huazimeve diturore a librore, shumë prej të cilave janë idiolektale ose të përdorura një herë të vetme për nevoja të hartimit të tekstit, ndërsa shumë të tjera mbetën me përdorim të kufizuar në shqipen e vjetër. Ato u tretën së bashku me rënien e

kulturës dhe të shkrimtarisë në rrethanat e vështira të historisë shqiptare të fundshekullit XVII, siç ishte disfata e Koalicionit perëndimor në luftë me Perandorinë Osmane dhe pasojat e saj në përndjekjen e klerit katolik, largimin e besimtarëve dhe kalimin e tyre në islam (“giuha jonë qi me dijet dvuer ende fjalëtë” – Bogdani, Të primitë XVI).

Bibliografi

1. Burime

- Boerio, Giuseppe. 1856. *Dizionario del dialetto veneziano*. Venezia
- Çabej, Eqrem (ed.). 1968. “*Meshari*” i *Gjon Buzukut (1555)*. Botim kritik. Punuar nga Eqrem Çabej. Pjesa I: Hyrje dhe transliterim; Pjesa II: Faksimile dhe transkribim fonetik. Tiranë – [BuM]
- Demiraj, Bardhyl. 2006. *Gjon P. Nikollë Kazazi dhe 'Doktrina' e tij*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Prishtinë – [CaB]
- . 2008. *Dictionarium latino-epiroticum per R. D. Franciscum Blanchum, (Romae 1635)*. Botim kritik dhe konkordanca leksikore. Shkodër – [BID]
- . 2019. *Concili Provintiaali o Cuvendi j Arbenit (Romae 1706)*. Botim kritik. Shkodër – [CuA]
- . 2019. Kodiku Beratas – Ο Μπερατινός κώδικας (me një botim kritik të pjesës shqip të përgatitur nga Bardhyl Demiraj), ASHSH. Tiranë – [BeK]
- . 2024. “Fjalësi shqip në fjalorin trigjuhësh të Kavaliotit, në: *Kulturë e shkrimit shqip me alfabet greqisht (Shekujt XV/XVI – XIX)*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, f. 127-290 – [KaP]
- Gurga, Gëzim (ed.). 2009. *Àt Francesco Maria da Lecce O.F.M.: Dittionario Italiano-Albanese (1702)*. Botim kritik me hyrje dhe fjalësin shqip. Shkodër – [LeD]
- Omari, Anila (ed.). 2005. *Pjetër Bogdani. Cuneus Prophetarum (Çeta e Profetëve)*. Botim kritik. Tiranë – [BoC]
- Qendro, Thoma. 2013. *Fjalor i shqipes së Gjon Buzukut*. Tiranë: Shoqëria biblike ndërkonfesionale e Shqipërisë.
- Svane, Gunnar (ed.). 1985. *Pjetër Budi. Dottrina christiana (1618). With a transcription into modern orthography and a*

- concordance* (= Sprog og Mennesker 9), Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet. Århus – [BuD]
- _____. 1986a. *Pjetër Budi. Rituale Romanum (1621). With a transcription into modern orthography and a concordance* (= Sprog og Mennesker 11), Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet. Århus – [BuR]
- _____. 1986b. *Pjetër Budi. Speculum Confessionis (1621). With a transcription into modern orthography and a concordance* (= Sprog og Mennesker 13), Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet. Århus - [BuS]
- TLIO *Tesoro della Lingua Italiana delle Origini*. Pubblicazione periodica online – prima pubblicazione 1997 –, Istituto del CNR. Firenze
- VULGATE. The Holy Bible In Latin Language With Douay-Rheims English Translation (<https://vulgate.org/>)

2. Literaturë e cituar

- Bloomfield, Leonard. 1935. *Language*. London: Allen & Unwin.
- Cassese, Michele. 2009. *Espulsione, assimilazione, tolleranza. Chiesa, Stati del Nord Italia e minoranze religiose*. Trieste: EUT (Edizioni Università di Trieste).
- Çabej, Eqrem. 1968. *Hyrje në: “Meshari” i Gjon Buzukut (1955)*. Botim kritik. Pjesa I.
- _____. 1974. Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe. Në: *Studime Filologjike*, nr. 2, 13-54.
- _____. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, vëll. I-VII. Tiranë 1976-2014 – [SE]
- Dashi, Brunilda. 2013. *Italianismi nella lingua albanese*. Università di Roma “La Sapienza”. Roma: Edizioni Nuova Cultura.
- _____. 2016. Il contributo lessicale di Francesco Maria da Lecce alla lingua albanese tra tradizione e innovazione. Në: *Spunti di ricerca per un mondo che cambia. Studi in onore di Emanuele Paratore*. A cura di Luca Romagnoli. Vol. II. Edigeo. Roma, f. 909-936.
- Demiraj, Bardhyl & Omari, Anila. 2022. Leksiku historik i gjuhës shqipe (shek. XV-XVIII) në fokusin e përpunimit filologjik - etimologjik bashkëkohor. Në: *Akte të Kuvendit*

- Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike*, II. Tiranë: ASHSH, ASHAK. 125-153.
- Di Giovine, Paolo. 2008. Un millennio di storia linguistica albanese: l'influsso lessicale della lingua italiana. Në: *L'Italia Dialettale*, LXIX, 107-139.
- Ernst, Gerhard. 1991. "Latinismen des Italienischen in DELI und LEI". Në: *Linguistica*, 31(1). Ljubljana. 185-200.
- Graur, Alexandru. 1950. Etimologie multiplă. Në: *Studii și cercetări lingvistice*, 1, 22-34.
- Haarmann, Harald. 1977. Die Problematik der Abgrenzung des lateinischen Elements vom romanischen im albanischen Wortschatz. Në: *Akten des internationalen albanologischen Kolloquiums, Innsbruck 1972 zum Gedächtnis an Norbert Jokl*. Innsbruck. 313-319.
- Haugen, Einar. 1950. The Analysis of Linguistic Borrowing. *Language*, 26, 2, 210-231.
- Helbig, Robert. 1903. *Die italienischen Elemente im Albanesischen*. Leipzig.
- Jorgaqi, Kristina. 1992. Sprovë për identifikimin e huazimeve leksikore italiane në shqipen e sotme. Në: *Studime Filologjike*, nr. 1-4, 55-66.
- . 1995a. Italianizma të shqipes standarde si ballkanizma. Në: *Studime Filologjike*, 1-4, 69-76.
- . 1995b. Huazimet italiane në shqipen e '500 nën dritën e Mesharit të Buzukut. Në: *Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*. Tiranë. 493-501.
- . 1995c. *Huazimet leksikore italiane në shqipen e sotme letrare, tezë doktorate paraqitur pranë Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë*, Tiranë.
- . 1996. Mbi përshtatjen fonetike të huazimeve italiane në shqipen standarde. Në: *Studime Filologjike*, 1-4, 121-134.
- . 1997a. Rreth përshtatjes morfologjike të huazimeve italiane në shqipen standarde. Në: *Studime Filologjike*, 1-4, 111-128.
- . 1997b. Contributo allo studio dei prestiti lessicali italiani nell'albanese. Në: *Studi di lessicografia italiana*, XIV, 413-425.
- . 1998. Mbi integrimin leksiko-semantik të italianizmave në shqipen standarde. Në: *Studime Filologjike*, 1-2, 85-102.

- . 2000. Italian lexical influence on modern Albanian. A Balkan comparative survey. Në: *Zeitschrift für Balkanologie*, 36, 2, 143-157.
- . 2001. *Ndikimi i italishtes në letërsinë e vjetër shqipe (XVI-XVII)*. Tiranë: Toena.
- Lafe, Genc. 1998/9. Der italienische Einfluss auf das Albanische. Erster Teil: Allgemeine Erörterungen. Në: *Ponto-Baltica* 8-9, 47-172.
- . 2000. Der italienische Einfluss auf das Albanische. Zweiter Teil: Wörterbuch der Italianismen im Albanischen. In: *Ponto-Baltica* 10, 31-120.
- . 2018. Nuovi spunti per la definizione degli italianismi nell'albanese. Në: *Matteo Mandalà dhe albanologjia sot* (në 60-vjetorin e lindjes), përg. nga F. Altimari, G. Gurga, Sh. Sinani. Tiranë: Fast Print. 259-272.
- . 2020. Mbi ripërcaktimin e italianizmave në gjuhën shqipe. Në: *Studimet albanistike në Itali/Albanistic studies in Italy/Gli studi albanistici in Italia*. Prishtinë: ASHAK. 383-406.
- Landi, Addolorata. 1991. Italianismi nella lingua albanese contemporanea. Në: *L'italiano allo specchio, Atti del I Convegno della SILFI*, a cura di L. Coveri. Torino: Rosenberg e Sellier, II: 93-105.
- . 1992. Elementi veneti in albanese. Në: *Studi di linguistica albanese*. Napoli, Edizioni Scientifiche Italiane. 119-138.
- Nadin, Lucia. 2012. *Shqipëria e rigjetur / Albania ritrovata. Recupero di presenze albanesi nella cultura e nell'arte del Cinquecento veneto*. Tiranë: Onufri.
- Tagliavini, Carlo. 1937. *L'albanese di Dalmazia. Contributi alla conoscenza del dialetto ghegho di Borgo Erizzo presso Zara*. Firenze. – [AD]
- Thumb, Albert. 1909. "Altgriechische Elemente des Albanesischen". Në: *Indogermanische Forschungen* 26, 1-20.
- Vicario, Federico. 1992/3. L'influsso lessicale veneto in albanese. Në: *Balkan Archiv n.F.* 17/18, 187-232.

SUMMARY

**Classification of Italianisms in Old Albanian (16th-17th centuries):
Learned vs. Vernacular Loanwords**

The paper discusses the significant influence of Italian loanwords on the Albanian language, particularly in relation to Old Albanian from the 16th and 17th centuries. It focuses on classifying loanwords based on their mode of transmission, distinguishing between literary or learned loanwords and vernacular loanwords derived from spoken language.

Recent studies have identified almost 6,000 Italian loanwords, including both historical and contemporary entries.

Until the 1990s, there was a gap in systematic studies on Italianisms, partly due to linguistic purism in Albanian linguistics post-World War II. However, recent research, particularly from scholars like Jorgaqi, Lafe, and Dashi, as well as contributions from Landi, Vicario, and Di Giovine has renewed interest in this area. Studies have focused on 16th- and 17th-century Albanian texts, utilizing historical lexicons and concordances.

New technologies have greatly aided diachronic studies of Albanian, facilitating critical editions of ancient texts and electronic concordances. Projects such as the DPEWA (Digitales Philologisch-Etymologisches Wörterbuch des Altalbanischen (15.-18. Jh.)) at the University of Munich have advanced this field of research by also examining the geographical distribution of lexemes in Albanian dialects. This provides valuable insight into the origin of Romanisms.

The DPEWA project identified around 950 Italianisms in Old Albanian, with 126 documented for the first time. However, the set of loanwords is heterogeneous in terms of status and origin and therefore requires more precise classification. This paper classifies these loanwords based on their mode of transmission, distinguishing between learned and vernacular loanwords. Çabej had already highlighted this distinction in his study of Latinisms in Albanian as an issue that had not received adequate attention until then.

First of all, among learned borrowings, it is necessary to distinguish the terms that were borrowed directly from Italian texts which served as models for translation. These are the so-called “foreign words” used momentarily without continuity. The Buzuku Missal, for instance, contains 350 Italianisms, with around 113 being literary in origin. After the Buzuku Missal, many of these borrowings disappeared, but many of them reappear in modern times as *reborrowings*, often in the form of internationalisms and with new meanings.

For many learned loanwords, it is necessary to distinguish between Italianisms and Latinisms depending on the model text. These cases of 'double etymology', as described by Alexandru Graur, still represent an open problem in Albanian linguistics today.

As distinct from learned borrowings or cultisms, there are borrowings that have entered the language through spoken use. This paper attempts to outline some useful classification criteria in order to distinguish these borrowings. Vernacular loanwords, influenced by spoken language, are primarily Venetian in origin, dating back to the 13th-14th centuries. Examples include *almise* 'tools' < ven. *armizo*; *avoj* < ven. *avolio* 'ivory'; *baticë* < ven. *bataizza*; *fëdigë* < ven. *fadiga*; *kurtjelë* 'knife' < ven. *cortela*; *kusi* 'pot' < ven. *cusina*; *lexon* 'read' < ven. *lezer*; *rrufë* 'catarrh' < ven. *rufa*; *rrugë* < ven. *ruga*; *tratë* 'trawl' < ven. *trata*. Other criteria for distinguishing vernacular loanwords include "intimate borrowings" from everyday bilingualism, as seen in the Buzuku Missal with terms like *fashë*, *fior*, *mulë*, *maganjë* 'defect', as well as functional elements such as adverbs, conjunctions and interjections. A fundamental criterion for identifying loanwords are phonological and semantic changes, and the presence of formal variants over time and across space, as well as their incorporation into derivational systems.

The text concludes that, although learned and vernacular loanwords are interconnected and cannot be clearly distinguished from one another, it is estimated that of the 950 Italianisms, 232 belong to the vernacular category and 718 to the learned category. Many of these loanwords declined amid the cultural and literary setbacks of the late 17th century, resulting from the political and social circumstances of this difficult period in Albanian history.

Tomorr Plangarica

*Për një hapësirë më të gjerë të gjuhësisë së diskursit në mendimin gjuhësor shqiptar**

Përmbledhje

Në këtë punim synohet të hidhet dritë mbi zhvillimet në etapën e tanishme të një hullie të veçantë kërkimi në shkencat e ligjërimit, që po njihet përgjithësisht me emërtimet “gjuhësi e diskursit” ose “analizë e diskursit”; synohet, gjithashtu, të sillen argumente për nevojën e thellimit të shqyrtimeve në kuadër të gjuhësisë/analizës së diskursit në mendimin gjuhësor shqiptar. Në punim i kushtohet vëmendje kontekstit epistemologjik që mundësoi hedhjen e vështrimit përtej paradigmës strukturaliste të shqyrtimit të *gjuhës si sistem*, drejt *gjuhës në përdorim*, dhe vihen në dukje përparësitë e qasjes së re metodologjike në studimin e entiteteve “diskurs” e “tekst”, qasje që mundësuan të kapërcehet parimi i imanencës dhe të vlerësohet edhe ndikimi i faktorëve jashtëgjuhësorë në kuptimësimin e mesazheve në praktikën e ndryshme diskursive (kushtet e prodhimit të mesazheve, situatat e komunikimit, situatat e të thënit, roli i subjektit folës etj.). Mbështetje në parashtrime bëhen prurjet shkencore në disa shkolla gjuhësore, përkatësisht prurjet e shkollës anglo-saksone (në Europë e në SHBA), në kuadër të analizës së diskursit, prurjet e shkollës franceze të gjuhësisë së diskursit, sidomos përmes analizës së diskursit, gjuhësisë/analizës tekstore dhe semantikës tekstore, të dhënat për analizën e diskursit në shkollën gjermanike, e zhvilluar sidomos në kuadër të zhvillimeve në gjuhësinë e tekstit dhe shkencat sociale. Në mënyrë të veçantë nënvizohen disa aspekte që do të mundësojnë institucionalizimin

* Shkrimi në vijim është mbështetur në ligjëratat e mbajtura nga autori në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë: “Për institucionalizimin konjitiv dhe social të dijeve të gjuhësisë së diskursit, në përbërje të shkencave të ligjërimit, në studimet gjuhësore për shqipen” (30 janar 2024); “Shqyrtimi i kontekstit epistemologjik i përvijimit të gjuhësisë së diskursit dhe kaheve të zhvillimit të saj – mundësi për zhvillim më sistemor të shqyrtimeve në studimet tona për shqipen” (30 qershor 2025); “Prej gramatikës së fjalisë në atë të tekstit/diskursit – koncepte, metodologji, përvoja” (21 nëntor 2025).

konjitiv e social të dijeve të gjuhësisë së diskursit në mendimin gjuhësor shqiptar, pa të cilat ai do të shfaqej i gjymtë.

Fjalë kyçe: *diskurs, tekst, folës, thënepërftues, akt i të folurit, gjuhësi e diskursit, analizë e diskursit, praktikë diskursive.*

Hyrje

(Rreth vonesës në shqyrtimin e praktikave ligjërimore e diskursive)

Në mendimin gjuhësor të prirur natyrshëm drejt shqyrtimit të *universit ligjërimit* (ku gjuhët nuk shterin së shfaquri veçanti dhe gjuhëtarët nuk reshtin së shqyrtuari ato), mbetet gjithnjë e pranishme kërkesa për të zbuluar territore të paeksploruara më parë, të lidhura me veçanti formale të gjuhëve përkatëse, por edhe kërkesa për të shqyrtuar më nga afër veçantitë e vlerat e produkteve ligjërimore, praktikave ligjërimore e diskursive në gjuhët përkatëse, kërkesë gjithnjë e më e theksuar në etapën e tanishme.

Ndërsa informacioni nga fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore po qarkullon lirshëm tashmë nga njëra hapësirë gjeografike në tjetrën, si pasojë e teknologjive të reja të komunikimit, ndërsa opinionet, qëndrimet, interpretimet për dukuritë e sotme a të së shkuarës zënë vend në tryezat e diskutimeve e debateve pavarësisht nga përkatësia lokale, ndërsa dija jonë enciklopedike, tashmë më e plotësuar, po zgjeron natyrshëm edhe kompetencën tonë gjuhësore e komunikative, mendimi shkencor i kapërcen edhe më lehtësisht kufijtë ndarës të hapësirave gjeografike, ngaqë është një kërkim i vetëdijshëm, me synueshmëri të shprehur, dhe ka të pranishëm ndërkëmbimin e metodologjive, koncepteve, mbështetjeve teorike sa më të përshtatshme në lidhje me lëndën në shqyrtim, duke mundësuar përvetësimin më të shpejtë të prurjeve të reja shkencore.

Në lëmin e mendimit gjuhësor gjendemi tashmë në një hulli kërkimi që ka shndërruar në objekt studimi edhe praktikatat e larmishme ligjërimore e diskursive që karakterizojnë veprimtarinë sociale të njeriut në etapën e tanishme, në një shoqëri që po shndërrohet gjithnjë e më shumë në një shoqëri të komunikimit. Është një territor i ri shqyrtimesh që meriton vëmendje më të madhe në mendimin tonë gjuhësor, ndërsa prurjet në shkollat të ndryshme gjuhësore mund të bëhen mbështetje për të përforcuar e mprehur më shumë “shqisën” e dallimit të veçantive e vetive të produkteve të përfuara në praktikatat e larmishme ligjërimore të komunitetit të folësve e shkruësve në gjuhën shqipe.

Gjithsesi, në ecurinë e zhvillimit të mendimit shkencor (edhe në periudha angazhimesh intensive), përvijohet vetvetishëm, jo pak herë, më shumë prirja për të vijuar me vullnet në thellime dhe vështrime të imtësuar të atyre profileve të lëndës që janë shndërruar tashmë në *objekt studimi*, sesa synimi për të kërkuar e dalluar në atë lëndë profile ose aspekte të tjera që *mundet*, madje *duhet* të shndërrohen në objekt studimi. Ndikojnë një sërë faktorësh në këtë

inerci, por ndoshta ndër më kryesorët është fakti se shqyrtimi i mbështetur tashmë mbi një kontekst teorik të formësuar krijon më shumë komoditet në kërkim, sesa kërkesa për përfitim e qasjeve të reja teorike që krijojnë mundësinë për të mprehur shqisën e vëzhgimit për të dalluar në lëndën në shqyrtim e sipër pikërisht edhe veti, karakteristika, veçanti që mund të shndërrohen në objekte të reja shqyrtimi e, si të tilla, edhe nxitje për zhvillime të mëtejshme në përpunim të koncepteve të reja, metodave a qasjeve më funksionale, për vetitë e asaj lënde, brenda hapësirës së disiplinës shkencore përkatëse.

U desh jo pak kohë që dijet e përfutuara në shqyrtimin e gjuhës a universit ligjërimitor përmes qasjeve retorike, logjike, filozofike e gramatikore të mundësonin përpunimin e koncepteve, metodologjive a mbështetjeve teorike për t'iu drejtuar në mënyrë sistimore jo vetëm veçantive formale të atij mjeti komunikimi, informimi e pasqyrimi, por edhe vetë procesit të funksionimit të tij në bartës realë, në situata e kushte nga më të larmishmet të përdorimit; të bëhej natyrshëm kalimi prej një përvoje formale shqyrtimi, të përshkrimit formal të njësive të sistemit gjuhësor, drejt shqyrtimit të produktit që përftohet përmes organizimeve të njësive, në sajë të rregullave e ligjësive të caktuara, në bartje reale prej individit/-ve, në situata konkrete komunikative e thënësore, të një produkti që, edhe pse ngjizet a formësohet prej atyre njësive në hierarki me njëra-tjetrën, ishte përtej tyre në veti, karakteristika dhe funksione.

Me këtë fazë të re shqyrtimi, futemi natyrshëm në një tjetër univers, që është ai i përdorimit të mjetit të komunikimit, i konsideruar tashmë si *diskurs*, me marrëdhënie me të tjera entitete, si *teksti* dhe *thënia*. Është një kapërcim i natyrshëm në conceptualizim, pasojë e prurjeve të mëparshme në mendimin gjuhësor, por që u shpreh më qartë dhe më drejtpërdrejt në teoritë e të thënit, të zhvilluara kryesisht duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit XX dhe zhvilluar më tej në një tjetër hapësirë shqyrtimeve gjuhësore që, edhe pse u quajt me emërtime të ndryshme (*translinguistikë, gjuhësi e jashtme, gjuhësi përtejfralore* etj.), kishte si bazë këto entitete të tjera, përtej njësive të sistemit.

E kanë vënë në dukje këtë risi epistemologjike shumë personalitete në mendimin gjuhësor, mes të cilëve edhe E. Benveniste-i në një sërë pohimesh të tij, ndërsa ngulmon që “[...] çdo punë e gjuhëtarit të çon në fakt të diskursi, i identifikuari në mënyrë të vetëkuptueshme me gjuhën” (Benveniste 1966, 11). Sipas tij: “Fjalja (kupto thënia, TP), krijim i pafundëm, e pakufizueshme në larminë e shfaqjeve, është vetë jeta e gjuhës a ligjërimit në veprim. Do të arrinim në përfundimin që me fjalinë (kupto thënia, TP) e lëmë fushën e gjuhës si sistem i shenjave, dhe me të hyjmë në një univers tjetër, atë të gjuhës si instrument i komunikimit, shprehje e të cilit është diskursi. Kemi aty vërtet dy universe të ndryshme, megjithëse ato kanë të bëjnë me të njëjtin realitet, dhe mundësojnë përfitim e dy gjuhësive të ndryshme, edhe pse hullitë e tyre takohen a kryqëzohen në çdo moment” (Benveniste 1966, 129-130). “[...]”

ligjërimi është te njeriu vendi i ndërveprimit të jetës mentale dhe i jetës kulturore dhe, në të njëjtën kohë, instrument i këtij ndërveprimi. Një tjetër gjuhësi do mund të përvijohet mbi termat e këtij trinomi: gjuhë, kulturë, personalitet” (Benveniste 1966, 16).

Hedhja e vështirimit përtej “stacionit” të fundit në shqyrtime (fjalisë) po tentohej edhe në disiplina përtej gjuhësisë, në semiotikë, hermeneutikë a filozofi. R. Barthes-i, ndër të parët, do të theksonte: “Gjuhësia ndalet te fjalja: ajo është njësia e fundit për të cilën ajo mëton dhe jep përkujdesjen e saj shqyrtuese” (Barthes 1966, 3). Por vështirimi duhet hedhur përtej saj, te diskursi. Për R. Barthes-in, “diskursi ka njësitë e tij, rregullat e tij, ‘gramatikën’ e tij: përtej fjalisë, diskursi duhet të jetë objekti i një gjuhësie të dytë” (Barthes, po aty). Ndërkohë që edhe F. Rastier shprehet i bindur që “tekstet janë objekt empirik i gjuhësisë” (Rastier 1989, 281).

Këtë hap drejt shqyrtimit të këtij realiteti tjetër, diskursit, Henri Meschonnic-u (specialist i teorisë së ligjërimit, poetikës, përkthimtarisë etj.) e vlerëson në këtë mënyrë: “Të menduarit mbi ligjërimin në shek. XX karakterizohet nga kalimi nga gjuha te diskursi. Nocioni i gjuhës ka gëzuar përkujdesje tejet të hershme, ai ka më së paku 2500 vjet që zë vendin qendror të të menduarit a dijes. Nocioni i diskursit është mjaft i vonë, ai daton në vitet tridhjetë. [...] Gjithsesi ky nocion i diskursit është shpikja më e madhe e shekullit XX në të menduarit a dijen për ligjërimin [...] (Meschonnic 1999, 74).

Në fakt, dallimi i diskursit si entitet që mundësonte komunikimin ishte dalluar si i tillë qysh më parë, me Saussure-in, edhe pse nuk e kishte përfshirë në hapësirën e shqyrtimeve gjuhësore, duke parakuptuar në atë hapësirë veçse dukuritë që ngjizin entitetin “gjuhë”, të vështuar si kod, si sistem dhe jo ato që shfaqeshin në të folur, shfaqje individuale e përdorimit të njësive të sistemit. Sipas J.-M. Adam-it (2011, 19-24) “megjithëse e vendos gjuhën në qendër të programit të tij, Sosyri diskuton gjithashtu mbi ‘atë çka e ndan’ gjuhën në kuptimin e mirëfilltë të fjalës prej ‘diskursives’. Ai flet, përveç kësaj, për ‘ligjërim diskursiv/langage discursif’ (Saussure 2002, 95), po aq sa edhe për ‘të folurit/de parole’ dhe bën një ndarje dukshëm pamëdyshje midis shenjave-fjalë dhe fjalisë: ‘Fjalja ekziston veçse në të folur, në gjuhën diskursive, ndërsa fjala është një njësi e gjallë jashtë çdo diskursi në thesarin mental’ (Saussure 2002, 117). Siç e saktëson në ‘shënime mbi diskursin/note sur le discours’ me datim ende të pasigurtë por i konsultueshëm sot në ‘Ecrits de linguistique générale’, subjekti folës nuk shprehet me fjalë të izoluara. Preokupimi parësor i Saussure-it është operacioni që mundëson të abstragojmë në lidhje me sistemin e gjuhës duke nisur prej dukurive të diskursit. Emil Benveniste-i do ta rimarrë çështjen,

duke privilegjuar vënien në diskurs, çka ai do ta tregojë e trajtojë si *enonciacionin* (Adam 2011, 24)¹.

Ndërsa F. Rastier-i, duke interpretuar dorëshkrimet e gjetura të Saussure-it, thekson: “Botimi i dorëshkrimeve të gjetura më së voni të Saussure-it [...] ka mundësuar të ndriçohet një profil i panjohur i prurjeve të Saussure-it në mendimin gjuhësor, duke e shfaqur atë jo vetëm gjuhëtar të gjuhës, por edhe gjuhëtar të të folurit dhe gjuhësinë e tij jo vetëm gjuhësi të shenjës, por edhe gjuhësi të tekstit (shih më gjerë Rastier 2015, 9, 17, 110, 177).

Gjithnjë sipas J.-M. Adam-it, para Saussure-it, kjo ide ka qenë e përpunuar edhe në teorinë e ligjërimit të Wilhelm von Humboldt-it (madje ai shënim i Saussure-it mund të të sjellë në mendje edhe një tekst të Platonit, “Sofisti”). Humboldi thekson: “Gjuha konsiston veçse në diskursin e lidhur, gramatika dhe fjalori janë thjesht të krahasueshëm me skeletin e saj të vdekur”. Humboldi thekson: Më e çmuara dhe më e vlefshmja [...] mundet të perceptohet ose ndjehet veçse në *diskursin e lidhur*. Është diskursi që duhet menduar si e vërteta dhe i pari në të gjitha shqyrtimet që mëtojnë të futen në thelbin e gjallë të ligjërimit. Fragmentimi në fjalë dhe rregulla është veçse *prodhim i vdekur i segmentimit shkencor*” (cituar nga Adam 2014, 20-21).

Ishte reflektimi teorik (kërkesa për thellim në interpretime, zgjerimi i kufijve të paradigmës që s’mundte të sillte përgjigje për dukuri që ishin të pranishme në lëndën gjuhësore në shqyrtim e sipër) që nxiti gjuhëtarë me formim strukturalist e njohës të thelluar e ithtarë të Saussure-it (në atë kohë dorëshkrimet e Saussure-it ende nuk ishin zbuluar), si Hjelmslev, Z. Harris,

¹ Ja teksti i gjetur në dorëshkrimin e tij *Shënim mbi diskursin*: “Gjuha është krijuar për hir të diskursit/si nevojë e përfutimit a ngjizjes së diskursit, por çfarë e ndan diskursin prej gjuhës ose, në një moment të caktuar, çfarë na mundëson të themi që gjuha *hyn në veprim si diskurs*?”

Koncepte të ndryshme janë aty, të gatshme në gjuhë (domethënë të veshura me një formë gjuhësore), të tilla si *buall, liqen, qiell, i kuq, i trishtë, pesë, copëtoj, shoh*. Në ç’moment ose me anë të cilit veprim, të cilës *lojë* që vendoset/përvijohet mes tyre, të cilave kushtëzime, këto koncepte do të formësojnë DISKURSIN?

Njëpasnjëshmëria e këtyre fjalëve, sado e pasur qoftë me idetë që ajo evokon, nuk do t’i tregojë asnjëherë një individ i njerëzor që një individ tjetër, duke i shqiptuar ato, arrin t’i përçojë diçka të kuptimshme me to. Çfarë duhet që të bëhemi të vetëdijshëm që duam të themi diçka të kuptimshme, duke përdorur terma që janë në dispozicion në gjuhë? Është e njëjta pyetje me atë që na kërkon të dimë se ç’është diskursi, dhe në pamje të parë përgjigjja është e thjeshtë: diskursi konsiston, qoftë edhe në formë rudimentare, dhe nga hulli që i shpërfillim, në pohimin e një lidhjeje mes dy koncepteve që paraqiten të veshura me formë gjuhësore, ndërkohë që gjuha arrin të ketë të pranishme veçse koncepte të izoluara, që presin të vihen në raport mes tyre që të kemi domethënie të të menduarit”. (Saussure 2002, 277).

Benveniste a Culioli etj., të shkojnë përtej paradigmës *strukturaliste* e të piren drejt rrymave a drejtimeve të tjera (në jo pak aspekte, edhe të ndryshme prej zanafillës së formimit të tyre). E tillë ishte prirja drejt shqyrtimit të tekstit të Hjemslevi, qasja drejt vijimësisë së fjalive në një entitet si diskursi të Harris-i, drejt procesit të të thënit a enoncacionit të Benvenisti, ose drejt operacioneve enonciative të Culioli-a, me teorinë e tij të operacioneve enonciative.

Duhet të theksojmë, gjithsesi që, edhe pse vijmë prej një tradite të formësuar qysh herët, qysh në antikitet, ndërsa diskursi ishte objekt i përkujdesjeve teorike të përvijuara në retorikën antike, e përqendruar kryesisht në formën e folur (për të mundësuar efektin e duhur përmes saj, për të argumentuar e ndikuar përmes pushtetit të fjalës), ndërsa teksti i shkruar ishte objekt i filologjisë (që synonte të nxirrte në pah veçantitë dhe të interpretonte vlerat e mesazheve të pranishme në monumentet shkrimore të trashëguara), *diskursi* dhe *teksti*, si dy nocione çelës në ato shqyrtime vijnë deri në kohët e reja duke përfutur një histori interpretimesh ku herë i zbehin dallimet mes qasjeve, herë duket sikur parakuptojnë njëri-tjetrit, e herë të tjera janë bashkëplotësues të njëri-tjetrit. Pikëvështrimi ndaj tyre, si entitete të përfutura në dy realitetet, të folur e të shkruar, dhe qasja metodologjike që mëtonte të nxirrte në pah veti e vlera sipas synimeve të disiplinave a kaheve studimore që përkujdeseshin për to (kryesisht, pra, prej retorikës e filologjisë), nuk mundësonte ndriçimin e plotë të vlerave që vetë ajo lëndë në shqyrtim shfaqte, nuk e profilonte atë lëndë në objekt studimi prej të cilit mund të ndriçoheshin edhe tregues të tjerë që do ta shfaqnin atë lëndë me plotërinë e vetive e vlerave që ajo bartte.

Zhvillimi i dijes gjuhësore në shekullin e 20-të, veçanërisht pas zgjerimit të hapësirave të saj me kahe shqyrtimesh përtej njësive të sistemit, u shoqërua me përkujdesjen e veçantë që të folurit dhe aktet ligjërimore të ndriçoheshin në raport me subjektet thënëse (thëniepërfutuesit e bashkëthënësit), me situatat e komunikimit e ato të të thënit, me konceptimin e komunikimit si proces, ku aktorët në komunikim përfutonin një lloj dialogimi në të cilin roli i mesazhdhënësit dhe mesazhmarrësit ishte rol aktiv i dy *interpretëve* që kodonin dhe dekodonin për të përfutur në vijimësi *domethënie* prej shenjave gjuhësore e *kuptime* e *(ri-)kuptimësi* në situatat përkatëse komunikuese në lidhje me mesazhin e komunikuar. Ishte statusi i “interpretit” që i parakuptonte një rol të rëndësishëm dhënësit/marrësit të mesazhit, folësit/shkruesit dhe bashkëfolësit/receptuesit të mesazhit të shkruar/të folur që, përmes shenjave gjuhësore që kishin përfutur domethënie, të ndërtonin së bashku kuptimin a të arrinin rikuptimësimin e domethënieve të përfutura përmes shenjave gjuhësore; kjo qasje i mundëson F. Rastier-së të pohojë që “[...] kuptimi nuk është brenda tekstit, por në situatën e interpretimit, ai ndryshon bashkë me të” (Rastier 1995, 175).

Ndërmarrja e studimeve që shndërrojnë në objekt studimi dukuri që përftohen dhe karakterizojnë praktikat ligjërimore e diskursive të përftuara qoftë për nevojat e komunikimit në përditshmëri, qoftë si produkte më të veçanta të përftuara nga përpunime të qëllimita për nevoja komunikimi në sfera të caktuara të veprimtarisë njerëzore, has në një sërë vështirësish, që në etapën e tanishme kanë nxitur angazhime të shumëfishta jo vetëm në shkencat që përkujdesen drejtpërdrejt për mjetin e komunikimit, gjuhën, siç është gjuhësia (dhe më gjerë, shkencat e ligjërimit), por përgjithësisht tashmë tërë hapësirën e shkencave humane e sociale.

Përvijimi i gjuhësisë së diskursit si kah studimi në shkencat e ligjërimit

Qasja e re teorike dhe pikëvështrimet e reja metodologjike e konceptuale ndihmuan për përvijimin e një riqasjeje ndaj entiteteve “tekst” e “diskurs”, ndihmuan në përvijimin e një gjuhësie të një natyre të re që ishte thirrur *të luante rolin e violínës së parë* në një hulli plotësuese të mendimit gjuhësor, gjuhësi e konsideruar *gjuhësi e diskursit*. Emërtimin “gjuhësi e diskursit” e përdorim duke parakuptuar përvojën e konsoliduar tashmë në gjuhësinë franceze me këtë emërtim (përgjithësisht në hapësirën frankofone, ibero-amerikane dhe atë italiane), përvojë që parakupton një hulli studimi ku dallohet më dukshëm gjuhësia e njësisë të sistemit (si *gjuhësi e gjuhës*), në përjasje me gjuhësinë *përtej* njësisë të sistemit gjuhësor, që ka si objekt studimi entitetet “diskurs/tekst/thënie” (si *gjuhësi e diskursit*), me disiplina të tilla të konsoliduara tashmë, si *Analiza e diskursit*, *Gjuhësia/Analiza tekstore*, *Semantika tekstore*, në një kontekst të gjerë prurjesh të *Teorive të enonciacionit*, *Pragmatikës gjuhësore*, *Semiotikës* etj. (shih më gjerë Paveau dhe Sarfati 2011, 166-236), ndërkohë që ky emërtim do të parakuptojë gjithashtu *Analizën e diskursit* në përvojat shqyrtuese anglofone, përvojë që parakupton shqyrtimet në kuadër të *Discours Analysis*, *Discourse Studies*, *Critical Discours Analysis*, të lidhura ngushtë me *Etnometodologjinë*, *Retorikën*, *Stilistikën*, *Analizën e bisedës* etj.; dhe po ashtu përvojën e shkollës gjuhësore gjermanike, ku shqyrtimet janë përvijuar të lidhura ngushtë me *Gjuhësinë e tekstit (Textlinguistik)* dhe *Analizën e diskursit (Diskursanalyse)*.²

² Është domethënësi pohimi i P. Charaudeau-së për këtë fushë shqyrtimesh në kuadër të shkencave të ligjërimit, që mundëson njëherazi edhe marrëdhënie ndërdisiplinare me shkencat humane e sociale. Ai thekson :“Unë mbroj idenë që duhet dalluar një gjuhësi e gjuhës si analizë e sistemeve të gjuhës, dhe një gjuhësi e diskursit si analizë e përdorimeve të gjuhës dhe konfigurimeve të tyre të ndryshme tekstore. Ky dallim është vetëm për synime studimi, ndërsa përpiqemi të analizojmë, por le ta theksojmë sërish, gjuha dhe diskursi parakuptojnë njëri-tjetrin. Unë mbroj gjithashtu idenë që analiza e diskursit, semiotika, pragmatika, sociolinguistika, etnografia e komunikimit,

Zhvillimi në këtë hulli të re shqyrtimesh ishte i pritshëm, pas suksesit të teorive të enoncacionit në Europë (sidomos të shkollës gjuhësore franceze), pragmatikës dhe gjuhësisë së akteve të të folurit (të shkollës anglo-saksone) dhe, po ashtu, të etnometodologjisë, etnologjisë së komunikimit, analizës së bisedës, analizës së brendisë, etj. (në gjuhësinë amerikano-veriore) a gjuhësisë së tekstit, në atë gjermanike. Entitetet “tekst” e “diskurs” u bënë nxitje për përpunimin e qasjeve metodologjike e koncepteve ndihmëse të lidhura me to; dhe, nga ana tjetër, vetë veçantitë e këtyre entiteteve u ndriçuan më qartë, për të kapërcyer edhe qëndrime hera-herës mosdalluese ndaj vetive të dy entiteteve (edhe pse një qëndrim më i plotë për dallimin veçmas të secilit prej tyre do të përvijohet disi më vonë), a qasjes ndaj tyre si dy kategori a entitete që mund të parakuptonin njëri-tjetrin, në marrëdhënie sinonimie mes tyre.

Në shqyrtimet për diskursin tejkalohet ndërkohë edhe konceptimi i tij si sinonim i të folurit (la parole); po ashtu, edhe qasja që vinte prej retorikës dhe filologjisë që termin “tekst” e lidhnin me produktin e shkruar dhe atë të diskursit me një prodhim gojor. L. Hjeltslev-i kishte pohuar pa mëdyshje, ndërkohë, që fjala “tekst” duhet marrë në kuptimin më të gjerë dhe parakupton një thënie të çfarëdollojshme, qoftë ajo e folur ose e shkruar, e gjatë ose e shkurtër, e vjetër ose e re” (Hjeltslev, 1966:27).

Për më tepër, përkujdesja ndaj këtyre entiteteve ishte shtrirë ndërkohë në një hapësirë më të gjerë sesa gjuhësia: edhe te semiotika, filozofia a dijet savante që lidheshin me ligjërimin dhe proceset diskursive (interpretimet që vinin edhe nga këto fusha, veçse e pasuronin qartësimin e veçantive të këtyre entiteteve). Madje çifti tekst-diskurs (një vijim i traditës sasyriane të konceptualizimit dyjar të dukurive gjuhësore), mundësoi të zgjerohen hapësirat e shqyrtimit të vetë gjuhësisë, duke i përafuar dhe bashkuar jo pak herë me territore të disiplinave të caktuara të shkencave humane e sociale, duke mundësuar njëherazi edhe qasje metodologjike të suksesshme ndërdisiplinare, shumëdisiplinare, a tejdisiplinare.

etnometodologjia, analiza e bisedës, një pjesë e shkencave të informacionit dhe të komunikimit etj. janë rryma, mënyra analize, metodologji që kanë të përbashkët të njëjtin objekt: diskursin si fenomen të komunikimit njerëzor dhe social. Unë jam pra për federatën e këtyre rrymave të ndryshme në një zonë të gjerë disiplinare të shkencës së ligjërimit, të diskurseve dhe të komunikimit njerëzor. Unë e di që kjo nuk do të bëhet kurrë, sepse çdonjëra prej këtyre rrymave dëshiron të ekzistojë si disiplinë dhe të mbrojë territorin e vet, siç ndodh në Bashkimin Europian mes vendeve të ndryshme që e përbëjnë atë, por kjo nuk na pengon të ëndërrojmë. Përtej kësaj utopie federuese, unë mbroj idenë e një ndërdisiplinariteti të fokusuar në përbërje të shkencave humane dhe sociale. Është ndoshta pozicioni i një gjuhëtari, që pa shpirt hegjemonik, shoh që ligjërimi është kudo. Por si mundet të analizojmë dukuritë ligjërimore pa arritur të shohim, në një mënyrë a tjetër, atë çka thuhet në disiplinat e ndryshme që janë historia, filozofia, sociologjia, antropologjia, psikologjia?” (Charaudeau, 2015b:137).

Por ai nxit shqyrtime të vlerta edhe brenda fushës së *gjuhësisë së njësive të sistemit*, duke mundësuar shqyrtime të reja në lidhje me funksionet e kuptimit e njësive të tilla (me “domethënie të zbrazët”), si lidhëzat, ndajfoljet, pasthirrat, përgjithësisht konektorët dhe organizuesit tekstorë (që në shumë përvoja studimore emërtohen me etiketa të ndryshme, por që grumbullohen në skajin më gjithëpërfshirës tashmë: “shenjues diskursivë”).

Rreth kontekstit shkencor në të cilin lindën dhe u përvijuan prurjet që formësuan korpusin e dijes në gjuhësinë e diskursit

Përvijimi i një qasjeje të re në studimet gjuhësore në gjysmën e dytë të shekullit XX u përftua si rrjedhojë e ndryshimit të pikëvështrimeve shkencore në shqyrtim, në kapërcimin e *paradigmës strukturaliste*; por në aspekte të ndryshme, edhe në opozicion me të, si pasojë e ndryshimit të vëzhgimit e shqyrtimit të realitetit gjuhësor nga pikëvështrime e qasje të tjera teorike, që mundësuan të shndërrohet në objekt studimi për gjuhësinë jo thjesht gjuha si sistem, si kod, me fillesë qysh me Saussure-in, por edhe proceset përdorimore të saj, entitetet, kategoritë a njësitë përtej fjalës dhe fjalisë, ku ndalej qasja strukturaliste. Për më tepër, u shfaq dukshëm ngulmimi për të vëzhguar proceset që mundësonin përfitim e kuptimit, me rolin e aktorëve në atë proces, të lidhur me situatat e larmishme, kontekstin a kontekstet që ndikonin në kuptimësimin a rikuptimësimin e mesazheve, thënieve, teksteve, diskurseve.

Në varësi të qasjeve metodologjike në shqyrtime, pikëvështrimeve dhe koncepteve me anë të të cilave do të interpretoheshin veçantitë e ndryshme të këtij objekti “të ri” në shqyrtim, u përpunuan dije që mundësuan lindjen a konfigurimin e hapësirave të reja të gjuhësisë (që natyrshëm po shndërrohej në shkencë a shkenca të ligjërimit). Në këtë hapësirë u zhvilluan, me tiparet gjithnjë e më të theksuara, edhe veçantitë e shkollave gjuhësore, sidomos asaj anglo-saksone, franceze e gjermanike.

Problematika më drejtpërdrejt e lidhur me treguesit gjuhësorë dhe situatat e të thënit (përmes të cilave përftohet kuptimi) u shqyrtua në shkollën franceze të studimeve gjuhësore, ku entitetet tekst/diskurs u studiuan në kuadër të tri kaheve kryesore: të *analizës së diskursit*, *gjuhësisë/analizës tekstore* dhe *semantikës tekstore*, në kontekstin e *teorive të të thënit/enonciacionit*, *pragmatikës së integruar*, *semiotikës e retorikës së re*, *hermeneutikës e sociokritikës*, që po formësonin po ashtu një korpus të suksesshëm dijeje në atë periudhë; këto disiplina a kahe shqyrtimesh lidheshin natyrshëm me proceset përdorimore të gjuhës, produktet dhe entitetet që ishin shprehëse të kompetencës gjuhësore dhe komunikative të përdoruesve në praktikat ligjërimore.

Me lindjen e këtyre pikëvështrimeve të reja dhe shndërrimin në objekt studimi të vetive a karakteristikave të tjera të lëndës gjuhësore, shkallë-shkallë

u përforcua mendimi i shprehur vijimisht më tej nga gjuhëtarët se *gjuhësia nuk është një shkencë monolitike, por një fushë me shumë regjistra epistemologjikë*. Sipas këtij këndvështrimi, gjuhësia e diskursit nuk e zëvendëson gjuhësinë formale, por e plotëson atë me përmasën e kuptimit, të formësuar a ngjizur në kontekstin shoqëror, historik dhe retorik. Gjuhësia diskursive nuk është as më pak rigorozë, as më pak shkencore se gjuhësia formale – ajo është thjesht e vendosur mbi kritere të tjera të dijes. Dhe në etapën kur gjuha është bërë mjet i fuqishëm i politikës, i mediave, e përgjithësisht i ndërtimit të realitetit, gjuhësia diskursive është më e domosdoshme se kurrë. Për më tepër, angazhimi në shqyrtimin e dukurive ligjërimore i entiteteve përtej fjalës e fjalisë nuk e shkëput këtë qasje nga gjuhësia e sistemit, por veçse shton profilet e shqyrtuara në lëndën gjuhësore, realitetin gjuhësor. Sipas D. Maingueneau-së, “[...]gjuha/ligjërimi nuk është objekt i dy gjuhësive pranë e pranë, që do të angazhoheshin çdonjëra me gjysmën përkatëse të dukurive gjuhësore/ligjërimore, por është vetë gjuhësia që dyfishohet dhe zgjeron hapësirën për të analizuar, shumë shpesh, të njëjtat dukuri. Aspak dy hapësira bashkëplotësuese të njëra-tjetrës, por dy hulli që ndërthuren dhe dallohen” (shih më gjerë Maingueneau 1988, 21-38).

Ishte një qasje e re që vinte pas periudhës së suksesshme të strukturalizmit në studimet gjuhësore, madje “pushtimit” të hapësirave të konsiderueshme prej tij edhe në studimet përtej gjuhësisë, në studimet e shkencave të ndryshme humane e sociale, por që në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit XX e mpaku shkallë-shkallë këtë ndikim për të vijuar rrugëtimin në hullitë e studimit gjuhësor, ku kishte shënuar arritje të konsiderueshme në shumë drejtime.

Qasja strukturaliste në lëmin e gjuhësisë, duke i dhënë përparësinë gjuhës si kod social që i përket një komuniteti (individi në të është thjesht përdoruesi), duke u përqendruar në lëndën gjuhësore (të cilën e vëren si kod, të cilin e klasifikon, e kategorizon në elementet përbërëse, kod të cilin e quan sistem dhe e shqyrton në mënyrë sistimore), duke i dhënë përparësi parimit të imanencës (gjuha është një entitet “më vete e për veten”, i shkëputur prej kontekstit jashtëgjuhësor dhe çdo reference me botën reale), nxiti, qysh me Saussure-in dhe më tej me strukturalistët europianë ose amerikanë, përvijimin e metodologjive të suksesshme në shqyrtimin dhe inventarizimin e formave gjuhësore përmes segmentimit, mundësoi klasifikimin e përqasjen e kategorive morfologjike e morfosintaksore, shqyrtimin e strukturës së gjuhës, të lidhur me një vend dhe një kohë, pra, përmes qasjes sinkronike.

Por aparati përshkruar, sado i sofistikuar dhe i përsosur qoftë në shqyrtimet strukturaliste, në analizat fonologjike, morfologjike, sintaksore, leksikore e semantike, do të duhej të plotësohej nga shqyrtimet dhe legjitimimi i folësve të këtyre idiomave, mjedisit, etj., duke mundësuar njëherazi një rinovim epistemologjik të kuptimit të koncepteve të trashëguara “gjuhë” dhe sidomos “të folur/parole”, duke përvijuar në këtë mënyrë ndërlidhje të reja të

fakteve gjuhësore me kontekstin e prodhimit të *diskurseve*³ (Boutet & Maingueneau 2005, 17-21; Plangarica 2018, 225-246).

Pra, sukcesi i paradigmës strukturaliste bartte, gjithsesi, pamundësinë për shqyrtimin e aspekteve të shumta që paraqiste vetë realiteti gjuhësor (çdo gjuhë e konsideruar si një kod a sistem uniform e homogjen për të gjithë folësit e komunitetit të një gjuhe amtare binte ndesh me larminë e formave gjuhësore që përdor ai komunitet), bënte të pamundur shqyrtimin e kuptimit të përfutur përmes mjeteve gjuhësore (kufijtë e analizës strukturore ndaleshin te fjalja, por fjalja e izoluar nuk ekziston në komunikimin real, i cili realizohet përmes një entiteti tjetër që është diskursi). Për më tepër, ngjizja e kuptimit nuk përftohet thjesht prej të dhënave leksikore e organizimit linear sintaksor të fjalisë, por modalitetet e përfuturit të kuptimit janë skajshmërisht më komplekse; ato i tejkalojnë kufijtë e fjalisë dhe shtrihen në diskurs ose në tërë tekstin; ndaj objekt analize duhet të jenë diskursi dhe/ose teksti. Meqenëse ngjizja e kuptimit ndikohet edhe nga faktorët jashtëgjuhësore, duhet kapërcyer parimi i imanencës.

³ Dihet, tashmë, që skaji “diskurs” është ndër më polisemikët në fushën e gjuhësisë. Për gjuhëtarët që përqasin tradicionalisht sistemin gjuhësor me aktualizimin e tij në kontekst, diskursi është përcaktuar përgjithësisht si *gjuha në përdorim*; shtohet në disa raste në përkufizim edhe një dimension komunikues, duke e përcaktuar diskursin si ligjërimin përtej fjalës, grupit të fjalëve dhe fjalisë, i matuar në mënyrë të tillë që të arrihet një komunikim i efektshëm. Nocioni i *language in use*, i përdorur dendur në literaturën anglofone si parafrazë për “diskurs” bashkëshoqëron dy opozicionet që mund të vërehet diskursi: *tekstore* (diskurs vs fjali) dhe *kontekstore* (diskurs vs gjuhë). Kështu diskursi është përcaktuar shpesh në dy mënyra: një tip i veçantë njësie gjuhësore (përtej fjalisë) dhe një përqendrim në përdorimin e gjuhës.

Përtej gjuhësisë, në kahe e rryma të ndryshme teorike në përbërje të shkencave humane e sociale, nocioni i *diskursit* është plotësuar me të tjera veti. Në ato kontekste: diskursi është një organizim përtej fjalisë, që mobilizon struktura të një natyre tjetër nga fjalja; është një formë veprimi mbi tjetrin dhe jo vetëm një paraqitje e botës; është ndërveprues, pra angazhon dy a më shumë partnerë; është i kontekstualizuar, pra jashtë kontekstit nuk mund t’i jepet kuptim një thënieje, merret në ngarkim nga një subjekt; funksionon në përshtatje me norma të caktuara; merr kuptim veçse në brendësi të një hapësire më të gjerë diskursesh dhe e ndërton kuptimin brenda praktikave sociale të caktuara. (shih Maingueneau 2014, 17-25).

Në praktikat tona studimore për *diskurs* përdoret përgjithësisht skaji *ligjëratë* (ne kemi parapëlqyer “diskurs” dhe “përftesë ligjërimore”); gjithsesi skaji *ligjëratë* ka qenë propozuar në kontekste të tjera, kryesisht në kuadër të gjuhësisë së tekstit, kontekste që nuk janë domosdoshmërisht të barasvlershme me kuptimet që ne e përdorim në kuadër të analizës së diskursit; në propozimet që janë bërë më parë janë bartur njëherazi edhe ngarkesat kuptimore plotësuese të shkollave a kaheve teorike të cilave ato u referohen, e po ashtu edhe të një tradite tonës në trajtimin e atyre dukurive, ose të dukurive të afërta me to.

Këto pamundësi dhe shqyrtimi i dukurive që lidhen me proceset e komunikimit, produktet e larmishme gjuhësore të përfuara në komunikim, nxitën përpunimin e dijeve të reja gjuhësore që do të merrnin parasysh aspektet a treguesit e natyrës sociale të lidhur me proceset përdorimore të gjuhës, ato psikologjikë a etnologjikë, dhe përvijimin e dijeve në disiplina, si sociolinguistika, psikolinguistika, etnolinguistika, semiotika, analiza e diskursit etj.

Por njëherazi edhe brenda hapësirës më të drejtpërdrejtë gjuhësore nxitën që të zgjerohet edhe konceptualizimi i shenjës gjuhësore që do të bartte përtej përcaktimit pak a shumë abstrakt të Saussure-it, të një shenjuesi e të shenjuari (të një forme gjuhësore e një koncepti), edhe konceptualizimin diskursiv përmes një norme sociale dhe një veçantie individuale të dijes, të kushtëzuar nga konteksti.

Duke diskutuar për problematikën e ngjizjes së kuptimit, P. Charaudeau-ja thekson se “jemi të detyruar të vërejmë jo vetëm kuptimin e fjalëve, në vetvete, por edhe kuptimin që ato transmetojnë. [...] Në fakt, dukuria e kalimit prej domethënies së fjalëve në kuptimin që ato transmetojnë (signifiante) përftohet prej këtyre dy orientimeve: një orientim centripetal, që priret të stabilizojë kuptimin që fjalët bartin në vetvete, një orientim centrifugal, që priret të ndërtojë kuptim në funksion të kushteve të përdorimit në aktet e komunikimit. [...] Kuptimësimi i një akti ligjërimi, çfarëdo qoftë ai, është gjithnjë rezultat i një *bashkë-ndërtimi*, në situata të caktuara komunikative.⁴ Dhe pas motivimesh me shembuj konkretë, Charaudeau-ja përfundon: “[...] një gjuhësi e diskursit parakupton një gjuhësi të gjuhës: e para nuk mund të ekzistojë pa të dytën. Por, nga ana tjetër, duhet të pranojmë që një gjuhësi e gjuhës nuk mundet, e vetme, të shqyrtojë kuptimet e akteve të ligjërimit të prodhuara në situata komunikimi reale: ajo ka nevojë të plotësohet nga një gjuhësi e diskursit” (shih më gjerë Charaudeau 2015a, 3-12).

Zgjerimi i hapësirave të gjuhësisë në gjysmën e dytë të shekullit XX ishte pasojë edhe i prurjeve të tjera në mendimin gjuhësor prej kaheve studimore a shkollave të ndryshme gjuhësore a disiplinave të tilla, si Stilistika (qysh me Charles Bally-në e të tjerë), Psikomekanika e Gustav Guillaume-it (në lidhje me mekanizmat bazë të të menduarit që marrin pjesë a ndërfiten në ngjizjet gjuhësore), prurjeve të Rrethit të Pragës (punimet e Trubetsoi-t e Jakobsonit),

⁴ Janë domethënës shembujt që sjell P. Charaudeau-ja për të shpjeguar këtë qasje, në rastet e pohimeve: “Unë jam 30 vjeç” (që në raport me subjektin thënës, një atlet, për shembull, parakupton një moshë jo të re, në krahasim me një tjetër veprimtari); “Ai është intelektual” (në një mjedis zanatçinjsh, për shembull, ku cilësimi merr vlerë pozitive a negative, mosmiratimi a ironie, në varësi të situatës a bashkëfolësve); apo “Të zinj të janë të ndryshëm nga të bardhët” (pohim që nuk është racist në vetvete, por që merr ngjyrim të tillë në varësi të subjektit thënës, situatës komunikative etj.).

prurjeve të Rrethit të Kopenhagen-it, bazë për zhvillimin e semiotikës (Louis Hjelmslev-i përmes glosematikës), prurjeve të Leonard Bloomfield-it, Zellig Sabbetai Harris-it (në fushën e analizës së diskursit), leximit funksionalist të prurjeve sosyriane, me shqyrtimet kryesisht të André Martinet-së dhe Michael Aleksander Kirkwood Halliday-t etj. (shih më gjerë Paveau dhe Sarfati 2011, 166-184).

Rreth modeleve të përvijuara në shqyrtime

Në përvoja të shkollave e kaheve të ndryshme europiane në lidhje me tekstin dhe/ose diskursin janë përvijuar modele të cilat janë formësuar si të tilla në kontekstin e një infrastrukture gjithnjë e më të gjerë shkencore e diturore, që ka angazhuar në shqyrtime gjuhëtarë e studiues të tjerë të studimeve letrare, shkencave shoqërore e humane, me kontribute të shumta për çështjet teorike të shkencave të ligjërimit, por edhe të natyrës praktike të përdorimit të gjuhës, të didaktikës së gjuhëve etj., etj.

Janë angazhuar gjithashtu teoricienë të ligjërimit, themelues të kaheve të sotme të shqyrtimeve diskursive, dhe/ose tekstore.

Por gjendemi në një situatë kur modelet e shqyrtimit të tekstit a diskursit janë, gjithsesi, “heterogjene dhe të alternueshme. Çifti tekst/diskurs u nënshtrohet epistemologjive dhe qasjeve shqyrtuese shkencore të mbështetura në perspektiva tejet të larmishme: historike, politike, komunikative, argumentuese, ose edhe leksikometrike.” Gjithsesi, “[...] larmia ose moria e modeleve diskursive dhe/ose tekstore mundëson qartazi të dallojmë një fill të vijueshëm, skajet e të cilit do të jenë tejet të dallueshme, por ato përvijojnë dhe përbëjnë një vargëzim, hallkat e shumta të të cilit do të nxjerrin në pah përafri të shumëfishta”. (Ablali et al. 2018, 10).

Nga kuota e sotme e vështrimit të atyre përvojave mund të vërejmë që këto modele mund të sjellin një rezultante të përbashkët, të vlefshme për studimet e sotme.

Është *tejkalluar* tashmë paragjykimi ndaj studiuesve të kësaj problematike, të vështruar disi në periferi të studimeve gjuhësore në vitet 1960-1970, duke vlerësuar me objektivitet rëndësinë e prurjeve të tyre në mendimin gjuhësor. Ishte një qëndrim që karakterizonte natyrshëm qasjet në ato vite, ndërsa mbizotëronte qasja strukturaliste në gjuhësi, qasje që ishte shtrirë pothuaj në të gjitha shqyrtimet e shkencave sociale e humane, duke folur edhe për një “imperializëm gjuhësor”.

Vërehet si prijë dhe kërkesë e kohës në etapën e tanishme vendosja e urave të bashkëpunimit mes modeleve të përvijuara tashmë në shkollën franceze (përmes prurjeve shkencore të shënuara në semiotikën e Shkollës së Parisit, analizën e diskursit, me rrymat e saj të ndryshme, gjuhësinë enonciative, gramatikën e tekstit e gjuhësinë e tekstit; e po ashtu analizën e ndërveprimeve gojore, semantikën interpretative, semiotikën e diskursit,

rrymën e ndërveprimit socio-diskursiv, pragmatikën tekstore, praksematikën, teorinë e diskursit social etj.)⁵; modeleve të përvijuara në shkollën anglosaksone (përmes prurjeve të shënuara në Vendet e Ulëta dhe në Angli në kuadër të “Critical Discourse Analysis” (Fairclough, Wodak, van Dijk) ose ato të Halliday & Hasan (Cohesion in English), të konsideruara si pionierët për analizën e shenjuesve të kohezonit, ose edhe ato të zhvilluara nga van Dijk & Kintsch (për të kuptuarit e tekstit, veçanërisht narrativ); ose në prurjet amerikano-veriore në kuadër të etnometodologjisë së bisedës, me zanafillë në punimet e Harold Garfinkel-it, e zhvilluar më tej edhe në Europë, që ka për objektin zbulimin e mekanizmave dhe rregullsive të përvijimit të realitetit social në ndërveprimet në përditshmëri, me dy konceptet çelës, *indeksikalitetin* dhe *refleksivitetin*, huazuar nga gjuhësia klasike përmes të cilave krijohen mundësi për marrjen parasysh të kontekstit në shqyrtime dhe subjektivitetin në procesin e të thënit; të etnografisë së komunikimit, me zanafillë te Dell Hymes-i (përmes ngulmimit për rëndësinë e rregullave dhe kushtëzimeve rituale e kontekstore që folësi është i aftë të respektojë); ndërveprimit simbolik (duke filluar nga vitet 1990, me prurjet e Georges Gerbert Mid-it, që i kushton rëndësi studimit të këmbimeve individuale si sjellje simbolike që rezulton prej një procesi social ndërveprimi) etj.; në shkollën gjermanike, ku theksi është vënë për një kohë të gjatë mbi një teori të diskursit sesa në një metodë, ku mbizotëroi në fillime teoria e “veprimit komunikues” e Jürgen Habermas-it, sipas të cilit kur komunikojmë nuk mundet të mos njohim disa rregulla të diskursit, si barazia ndaj partnerit diskursiv dhe kritikueshmëria e çdo argumenti, e më tej “sociologjia e njohjes” sipas së cilës është diskursi që u

⁵ Janë përvijuar aty modele prej kontributeve të P. Charaudeau-së që “produktet ligjërimore, diskursive i vëren të lidhura gjithnjë me kushtet e tyre psiko-sociale të prodhimit dhe të receptimit të tyre”; modeli i përvijuar nga Jean-Michel Adam-i, i cili synon një analizë tekstore të diskursit, pra një tip analize që mbështetet në shqyrtimin e “niveleve të ndërmjetme të strukturimit” të diskursit, në njësitë “materialisht të vëzhgueshme, domethënë në detajet semiolinguistike të formave që bartin kuptim, ndërmjetëse të diskurseve”; ai i Catherine Kerbrat Orecchioni-t, që i kushton rëndësi shqyrtimit të analizës së bisedës, “duke marrë parasysh njësitë e saj fonetike, dhe prozodike, gramatikore e leksikore, por edhe veçantitë e tipologjive që rregullojnë diskursivitetin si dallim *i shkruar vs i folur*”; ai i D. Maingueneau-së që përvijohet përmes përkujdesjes për shqyrtime në fusha të ndryshme kërkimi, përmes “qasjes ndërdisiplinare ndaj praktikave diskursive të mirëpërcaktuara tashmë (pra përtej analizave të bisedës) te diskursi politik, letrar, filozofik, gazetaresk etj., duke synuar shqyrtimin e marrëdhënies së ndërlidhur të një teksti me vendin e kontekstin social në të cilin ai formësohet”; modeli a qasja e Ruth Amosy-së që ngulmon në ndërthurjen e pikëvështrimeve të analizës argumentuese të mesazheve me ato të analizës së diskursit, deri në “integrimin e teorieve të argumentimit në Analizën e diskursit”, etj. (mbështetur në Soulager, “Préface”, 2015, 9-12).

mundëson partnerëve në komunikim të rigjenden në një terren kulturor e interpretues të përbashkët (atë të “botës së përjetuar” a “të kuptimit social të përbashkët”), por edhe me shqyrtime më pranë shkencave të ligjërimit, me punimet e Busse-s, Ehlich-ut, Jäger-it, Link-ut, Bublitz-it, Diaz-Bone-s, Keller-it, disa prej të cilëve janë ndikuar nga poststrukturalizmi amerikan, por në gjurmët hermeneutike të Heidegger-it, Gadamer-it, Habermas-it. Në *Itali*, ku teksti ka pasur vazhdimisht, në një perspektivë interpretative, qasjen semiotike (Eco). Ura kalimi janë ndërtuar gjithashtu me teorinë belge të hegjemonive të Laclau-së dhe Mouffe-s, me shkollën vjeneze të Beaugrande & Dressler-it, ose tekstologjinë hungareze në linjën e Petöfi-t etj.⁶

Siç mund të vërehet, ka një larmi modelesh, me pikënisje nga disiplina të shkencave të ligjërimit, por edhe përtej tyre, që e trajtojnë problematikën në lidhje me entitetet tekst e diskurs të lidhur me praktikat e shumta që nxjerr në pah realiteti i shoqërive të sotme, të cilat janë shndërruar, në radhë të parë, “shoqëri të komunikimit”.

Synimi i përpjekjeve të sotme është që në këtë larmi modelesh, shkollash e kahesh, “të mund të arrihet bashkëpunimi i modeleve, të imagjinohen *modele pa kufij*, të studiohet se çka vëzhgohet rishtazi, të propozohen mjetet metodologjike të reja dhe të ndriçohen kategori përshkruese inovuese që nxjerrin në pah të renë” (Ablali e al. 2018, 12).

Është një përvojë që duhet të sillet në shqyrtimet tona jo thjesht si kureshti intelektual, por sidomos si ndihmëse për shqyrtimin e dukurive ligjërimore në shqipen e sotme. Duhet jo thjesht familjarizimi me ato prurje teorike, por edhe funksionalizimi i atyre arritjeve në dobi të shqipes. Është një dije me një dinamizëm a gjallëri të spikatur, ndërsa edhe në mendimin gjuhësor euro-atlantik flitet për një rinovim epistemologjik e heuristik në trajtimin e problematikës në lidhje me këto entite, konceptet në funksion të interpretimit të tyre, të metodologjive e mbështetjeve teorike në shqyrtime. Risitë e përvijuara në vijimësi është e nevojshme të jenë të pranishme edhe në mjediset tona studimore.

Përtej hapësirës së shkencave të ligjërimit: Ndërdisciplinariteti

Natyra komplekse e objektit me të cilin merret gjuhësia e diskursit, me njësitë përtejfrazore, vështirëson gjithashtu edhe vetë përcaktimin e ngushtë të disiplinave në të; për më tepër që edhe vetë njësitë a entitetet që shndërrohen në objekt studimi (diskursi/teksti/thënia), që kanë si veti karakterizuese jo

⁶ Këto të dhëna janë mbështetur në: Ablali e al. 2018, 10-12, dhe Angermüller 2007a, 9-23.

madhësinë, por tregues të tjerë formalë, jo pak herë e mpakin qartësinë në raportet e vendosura mes tyre. Megjithatë qasjet e studiuesve a kaheve të caktuara të studimit kanë parashtruar tashmë edhe hapësirat e secilës disiplinë dhe kufijtë mes tyre, duke theksuar edhe rëndësinë e trajtimeve *ndërdisiplinare* dhe pozicionimin në *kryqëzim disiplinash* të dijeve të përfutuara, sidomos në lidhje me Analizën e diskursit, edhe pse në shumë punime është disi e vështirë të thuash se cilit kah, rrymë a drejtim disiplinor i përket saktësisht shqyrtimi, a me cilën disiplinë është i lidhur drejtpërdrejt.

Por praktika e kërkimit shkencor të mundëson të shfrytëzosh përparësitë që ofrojnë shqyrtimet ndërdisiplinare, pa u kujdesur në çdo rast të krijohet modeli i shqyrtimit me përkatësi në këtë apo atë disiplinë (sepse synimi është ndriçimi sa më i plotë i profileve të objektit të shqyrtuar, *interpretimi* i vlerave që përftohen në procesin përdorimor të gjuhës); dhe ndërsa synojmë interpretim, “e kemi të vështirë të dallojmë qartë përkatësinë e interpretimeve të bëra, sepse çdo interpretim mundësohet prej një bashkëmarrëdhënieje mes horizonteve të ndryshme disiplinare” (Charaudeau 2015b, 126); kjo nuk pengon, gjithsesi, për përqendrim, sipas nevojës, në njërën prej disiplinave, për të përfutur atë metodologji që Charuadeau-ja e quan “ndërdisiplinaritet i fokalizuar” (Charaudeau, po aty).

Studiuesit bien në një mendje, përgjithësisht, për dobinë e ndërdisiplinaritetit në shqyrtimet në kuadër të gjuhësisë së diskursit. Ata ngulmojnë që diskursi bëhet vërtet objekt i dijes, kur merret në ngarkim nga “disiplina të ndryshme të diskursit” që kanë çdonjëra një interes të veçantë.” (Charaudeau 2015b, 127).

Madje vetë zanafilla e përvijimit të atyre dijeve është në territore që nuk janë domosdoshmërisht ato të shkencave të ligjërimit. Në Gjermani, për shembull, “përvijimi i Analizës së diskursit/Diskursanalyse u bë në kryqëzimin e shkencave të ligjërimit, të shkencave sociale e të historisë, pa një terren disiplinor të mirëfilltë. [... , ...] prirja e Analizës së diskursit, më pranë shkencave sociale, u karakterizua edhe nga fakti që teoricienët e ligjërimit atje nuk janë detyrimisht gjuhëtarë, por, më së shumti, filozofë, veçanërisht të ardhur prej shqyrtimeve në hermeneutikë (në hullinë e Martin Heidegger-it dhe Hans-Georg Gadamer-it) në rrymën analitike (Ludwig Wittgenstein-it) ose në Shkollën e Frankfurtit (Karl-Otto Apel-it dhe Jürgen Habermas-it)” (J. Angermüller 2007a, 5-16).

Ndikim i ndërsjelltë *shkenca ligjërimit-hermeneutikë* vërehet në prurjet shkencore të Paul Ricoeur-it në Francë. Në qasjen e tij hermeneutike, çështjet e lidhura me diskursin e tekstin, thënien e aktet ligjërimore, subjektet folëse e bashkëfolëse (që ndërtojnë dhe që njëherazi edhe receptojnë), janë objekt sa i hermeneutikës e disiplinave semiologjike, shpjeguese, interpretuese, po aq edhe i shkencave të ligjërimit, përkatësisht gjuhësisë së diskursit. Në një prej veprave të tij (*Du texte à l'action. Essais d'herméneutique, II, (1986)*), ai

përqendrohet e trajton në mënyrë të hollësishme çështje të tilla, si: “përvijimi i ligjërimit si diskurs”⁷ “nocioni i tekstualitetit”,⁸ “teksti si instancë e diskursit” që gjendet në shqyrtim përtej gjuhësisë së gjuhës, në gjuhësinë e diskursit dhe teorinë e akteve të ligjërimit etj.”⁹ Pra, integrohen natyrshëm në këtë problematikë të diskursit edhe aktet ligjërimore, sepse, sipas P. Ricoeur-it, “diskurset janë në vetvete veprime; ndaj lidhja mimetike – në kuptimin e plotë të termit – mes aktit që mundëson të thuash diçka (dhe ta lexosh atë) dhe veprimit të përfutur nuk është kurrë e pagjasë. Ajo veçse bëhet më e ndërlikuar, më e tërthortë nga prishja e lidhjes mes *signum* dhe *res* (shenjë dhe gjësendit a konceptit)” (P. Ricoeur 1986, 8). Duke e parakuptuar mesazhin tekstor si një instancë a shfaqje të ngjizjes së diskursit në aspektin interpretues të tij, shtohet edhe një përmasë tjetër, përveç asaj semiotike – përmasa *semantike*, që nxit interpretime të shumta në teoritë e të lexuarit. Paul Ricoeur-i thekson se para se të përlllogarisnim në procesin e komunikimit përmes të lexuarit rolin e lexuesit, dhe procesit të të lexuarit, “teksti kishte vetëm një kuptim, domethënë lidhjet a marrëdhëniet e brendshme, një strukturë; ai ka tani një domethënie (signification), pra një formësim në vetë diskursin e subjektit që lexon; për nga kuptimi i tij, teksti kishte vetëm një përmasë semiologjike, ai ka tani, për nga domethënia e tij, një përmasë semantike” (1986, 172).

Madje, një pjesë të rëndësishme të asaj vepre (pjesën e dytë, të titulluar “Prej hermeneutikës së teksteve në hermeneutikën e veprimit” ai shtjellon çështje të tilla, si “ç’është një tekst?”, “teoria e tekstit”, “paradigma e tekstit”, “paradigma e interpretimit tekstor”, “roli i imagjinatës në diskurs” etj.

Është arritur të përvijohen këto qasje në një hapësirë studimi përtej shkencave të ligjërimit, por në ndërveprim me to, ndërkohë që në fushën e gjuhësisë, sipas Paul Ricoeur-it, qysh me Benveniste-in “fjalitë (kupto thënie TP) janë të lidhura a kuptimësohen në një *hic et nunc* (këtu e tani). Atëherë teksti i “aktualizuar” gjen një mjedis dhe një pritje a vëmendje prej marrësve të mesazheve; ai vihet në këtë mënyrë në lëvizje e funksionim, i përfshirë dhe i

⁷ Sipas tij, “[...] diskursi përftohet si ngjarje: diçka ndodh kur dikush flet. Ky nocion i diskursit si ngjarje përvijohet qyshse marrim parasysh kalimin prej një gjuhësie të gjuhës ose të kodit në një gjuhësi të diskursit ose të mesazhit” (Ricoeur 1986, 115).

⁸ Tekstualiteti vërehet përmes qasjeve të tilla të përshkallëzuara, si: “përvijimi i ligjërimit si *diskurs*; përvijimi i diskursit si një *tërësi e strukturuar/vepër e strukturuar*; marrëdhënia e *të folurit me të shkruarit* në diskurs dhe në tërësitë/veprat e strukturuar si diskurs; tërësia e strukturuar si diskurs dhe *projektimi i botës/realitetit*; diskursi dhe tërësia e strukturuar si *ndërmjetësi e të kuptuarit të vetes*. Të gjitha këto tipare të marra sëbashku përbëjnë tiparet e tekstualitetit” (Ricoeur, po aty, 114)

⁹ Në interpretimin e asaj çka është thënë, “hermeneutika duhet t’i drejtohet jo vetëm gjuhësisë (gjuhësisë së diskursit, e dallueshme prej gjuhësisë së gjuhës), [...] por edhe teorisë së akteve të ligjërimit, ashtu siç e gjejmë te Austin-i dhe Searle-i” (Ricoeur, po aty, 208).

kushtëzuar te referenca drejt një realiteti dhe subjekteve. Ky realitet a kjo botë është ajo e lexuesit; ky subjekt është lexuesi vetë. Përgjatë interpretimit, do të thonim, të lexuarit bëhet si një proces i të folurit. Unë nuk po them: bëhet të folurit. Sepse të lexuarit nuk barazohet kurrë me ndërkëmbimet gjatë të folurit, me një dialog; por të lexuarit përmbushet konkretisht në një akt që është për tekstin ajo çka të folurit është për gjuhën, domethënë ngjarje dhe shfaqje e diskursit” (1986, 171-172).

Kahe shqyrtimesh që mundësuan të institucionalizohen dijet në Gjuhësinë/Analizën e diskursit

Në një hapësirë kaq të gjerë studimi, duke e parakuptuar diskursin si entitet të ngjizur përgjatë përdorimit të fjalëve, thënieve, teksteve në një kontekst të caktuar, të lidhur me veçantitë e subjekteve në komunikim, në situata të caktuara komunikative, të cilat ndikojnë që mesazhet të (ri-)kuptimësohen si pasojë e këtyre kushteve që veprojnë ndaj domethëniesve të drejtpërdrejta të shenjave gjuhësore, ndërkohë që edhe vetë skaji “diskurs” “nuk tregon medoemos të njëjtin objekt si për një gjuhëtar francez, një etnometodolog amerikano-verior ose semiolog rus”, në këtë fushë të gjerë studimi, pra, “janë të pranishme mënyra trajtimi dhe praktika jo pak herë të ndryshme, madje edhe të kundërta” (Angermuller 2007b, 5).

Përmes një vështrimi përgjithësues, këtë pamje tejet të relievizuar D. Maingueneau-ja e përmbledh në këtë mënyrë: “Në nivelin ndërkombëtar, skaji ‘analizë e diskursit’ ka priirjen të mbulojë atë çka T. A. Van Dijk-u e quan *analizat e gjinisë* (përkatësisht të *gjinive të diskursit* TP)¹⁰ dhe *analizat e bisedës*.

Analizat e gjinisë mbizotërojnë qartazi në përvojat shqyrtuese në Europë, *Analizat e bisedës* mbizotërojnë qartazi në përvojat shqyrtuese në Shtetet e Bashkuara, ku ajo përvojë shqyrtuese është e lidhur fort me etnometodologjinë” (Maingueneau 2025, 11).

Këto pikëvështrime janë institucionalizuar në aspektin konjitiv e social si pasojë e botimeve të shumta dhe angazhimit të studiuesve nga vende të ndryshme e pozicionimeve të caktuara në lidhje me shqyrtimin e problematikës. Janë domethënëse (si shembuj ilustrues), të dhënat për interesimet në trajtimin e kësaj problematike në botimet e bëra në anglisht nga Van Dijk-u, ose ato në frëngjisht në një prej revistave gjuhësore në Francë në dy dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit XX (përveç studimeve të tjera), periudhë

¹⁰ Me “gjinii” kuptohen “gjiniet e diskursit”, mekanizmat e komunikimit të përcaktuar në aspektin social e historik përmes të cilëve janë prodhuar dhe interpretuar thëniet; vetë këto gjini janë të përfshira në “tipa të diskursit”: politik, administrativ, juridik, shkollor etj.” (Maingueneau 2025, 11).

në të cilën u arrit institucionalizimi konjitiv e social i dijeve që trajtonin problematikën e diskursit, të analizës së diskursit a gjuhësisë së diskursit.

Sipas D. Maingueneau-së, një korpus i gjerë studimesh në kuadër të Analizës së diskursit është përfshuar prej Van Dijk-ut, përmes përkujdesjes së gjatë të tij për të botuar në revista shkencore a përmbledhje studimesh kontribute të tij e bashkëpunëtorëve të tjerë të angazhuar në ndriçimin e profileve të ndryshme të objektit “diskurs”: në revistat “Discourse Studies” dhe “Discours and Society”, apo në dy seritë e vëllimeve “Handbook of Discours Analysis” (1985) që përmbledhin 35 punime të vëna në 4 vëllime dhe “Discourse Studies” (2007) që përmbledh 79 kontribute në 5 vëllime.

Janë prurje shkencore që krijojnë një kontekst tejet të gjerë të problematikës së Analizës së diskursit, qysh nga shqyrtimet e drejtpërdrejta gjuhësore, në kuadër të Gramatikës së diskursit, te vështirimet në kuadër të Analizës Kritike të Diskursit, Pragmatikës së bisedës, Vështirimeve ndërkulturore, Gjuhësisë së korpusit, Gjuhësisë tekstore, Retorikës etj. Është kjo qasje tejet e gjerë dhe e larmishme ndaj studimit të objektit “diskurs” që ka imponuar që brenda asaj hapësire të përvijohen kahe shqyrtimi a “disiplina” prej të cilave marrin përkatësi qasjet e veçanta nën emërtimet, si: *gramatikë e diskursit* (grammar discourse), *stilistikë* (stylistics), *retorikë* (rhetoric), *organizimi strukturor* a *superstrukturat* (superstructures): *skemat e diskursit*, *pragmatikë e diskursit*, *analizë e bisedës*, *analizë e gjinisë*. Dukshëm, këto “disiplina” nuk vendosen të gjitha në të njëjtin plan. *Gramatika e diskursit* dhe *organizimet strukturore* (*superstrukturat* - *skemat e diskursit*) shqyrtohen në kuadër të gjuhësisë tekstore dhe *pragmatika e diskursit*, të analizës së gjuhës. Përsa i përket termit “retorikë”, autori ia rezervon atë “strukturave që ishin quajtur tradicionalisht “figura të stilit në retorikën klasike” (Maingueneau 2025, 11).

Ky korpus dijeje u përfshua, në fakt, duke ndjekur hullinë e studimit të hapur më herët në shkollën anglo-saksone, qysh me distribucionalizmin dhe prurjet e Z. S. Harris-it, veçanërisht me artikullin e tij të botuar fillimisht në revistën amerikane “Language”, e mirënjohur për studimet në lëmë të gjuhësisë, të titulluar “Discourse analysis: A sample text” (1952); por më tej edhe me punimet e Halliday-t, veçanërisht me veprën “Cohesion in English” të Holliday-t dhe Hasan-it (1976), që kishin “shpërthyer ndërkohë kufijtë e shqyrtimit brenda fjalisë dhe në një mënyrë a tjetër ishin drejtuar drejt entiteteve tekst e diskurs, duke vënë gurë të rëndësishëm në themelet e një gjuhësie të tekstit dhe të diskursit.

Për të parë ritmet me të cilat po përvijohet institucionalizimi konjitiv e social i kësaj disipline në shkollën gjuhësore franceze në vitet ‘70-‘80 të shekullit XX, le të përmendim që brenda 17 vjetësh, 1969-1986, përveç prurjeve të tjera të natyrave të ndryshme, 10 numra të revistës tejet të

rëndësishme në fushën e gjuhësisë “Langages” i kushtohen tërësisht kësaj problematike.¹¹

Ishte një ecuri e institucionalizimit konjitiv e social të kësaj disipline në shkollën gjuhësore franceze që u përvijua jo vetëm me ritme të shpejta, por edhe me zgjerim, pasurim e thellim të problematikës, në përputhje me vetë natyrën e zhvillimeve të shoqërisë franceze e më gjerë, ndërsa dijet në këtë disiplinë pasqyronin veçantitë e nevojave për komunikim të shoqërisë dhe mendimi gjuhësor angazhohej të ndikonte, analizonte dhe nxirrte në pah pikërisht veçantitë e atyre zhvillimeve. Pikërisht kjo bashkëmarrëdhënie me ato realitete përcaktoi faza të ndryshme në të cilat u zhvilluan dijet e kësaj disipline drejt atij institucionalizimi: një faze të parë, në të cilën problematika e shqyrtimeve të entitetit “diskurs” mbizotërohej nga konceptimi i diskursit të lidhur ngushtë me “ideologjinë”, “psikanalizën”, përgjithësisht nën tisin marksist të ideve të Althusser-it, por edhe dinamikës së zhvillimeve të lëvizjes së vitit 1968, që ndihmoi më së tepërmi në evoluimin e koncepteve edhe në mjediset intelektuale e universitare të kohës, e jehonës po ashtu të ideve të Lacan-it, Foucault-së etj.

Një fazë tjetër, ndërsa mpakja e asaj jehone në vitet 1980 e në vijim, deri në fund të shekullit XX, u karakterizua nga zgjerimi i shqyrtimeve në fushën e pragmatikës, prurjet e shumta në gjuhësinë tekstore, zhvillimi i shkencave të komunikimit e informacionit, përqendrimi në veprimtarinë komunikuese e vështrimi i asaj veprimtarie si një shumësi formash që folësi vë në funksionim, nxjerrja në pah e koncepteve që mundësojnë shqyrtime më të efektshme të proceseve komunikative (subjekti folës, dialogizmi, situatat e të folurit) dhe kushtëzimi i kuptimësimit të mesazheve edhe nën ndikimin e tyre, etj. Këto pikëvështrime të reja sollën një përqendrim të vëmendjes te “gjinitë e diskursit”, te diskursët e natyrave të ndryshme, por sidomos te diskursët filozofike, mediatike, shkencore etj. Ato prurje mundësuan kalimin në një fazë tjetër, në vitet 2000, në të cilën vijuan të lëvizet nëpër hullitë e përvijuara ndërkohë, por u drejtua vëmendja edhe në shqyrtimin e komunikimit numerik/digjital (sitet web, rrjetet sociale, e-mail-et etj.) që mundësoi mënyra të tjera të përhapjes së informacionit, të ndërveprimit gjuhësor, një mënyrë

¹¹ Ja titujt (po i japim të përkthyer në shqip) që përfaqësonin larminë e asaj problematike: n° 13 “Analiza e diskursit”; n° 23 “Diskursi politik”; n° 37 Analiza gjuhësore e diskursit, gjuha dhe ideologjia; n° 41 Tipologjia e diskursit politik; n° 52 Analiza gjuhësore e diskursit zhorasien; n° 53 Diskursi juridik: analizë dhe metodë; n° 55 Analiza e diskursit dhe gjuhësia e përgjithshme; n° 62 Analiza e diskursit politik; n° 71 Procesi diskursiv dhe strukturat leksikale – kongresi i Metz-it (1979) i Partisë socialiste; n° 81 Analiza e diskursit – hulli të reja. Homazh Michel Pecheux-së (Maingueneau 2025, 14).

trajtimi më dinamike e ndërvepruese përmes gjuhës dhe mjeteve të saj, si mesazhe plurisemiotike, ku ndërthuren shenjat verbale, imazhet dhe tingujt, emotikonet, e deri te folësit “johumanë” (zëri te GPS-të, robotët që përgjigjen në telefon etj.); madje deri te përdorimi i Inteligjencës Artificiale (IA). Është një front tjetër i rëndësishëm që pret angazhimin e analistëve të diskursit.

Ndërkohë, nuk reshtin përpjekjet për ta parë tërë këtë korpus dijeje në hullinë e një fushe të mirëpërcaktuar tashmë, edhe pse në zgjerim e sipër të territorit të saj dhe pasurim të problematikës në shqyrtim.

Po sjellim edhe një tjetër vështrim përgjithësues, përmes zërit “analiza e diskursit” në veprën “Termes et concepts pour l’analyse du discours, Une approche praxématique” (2017), produkt i *gjuhësisë praksematike*, me fillime qysh në vitet 1970, në Monpelje, e drejtuar në atë periudhë nga Robert Lafont-i; mes të tjerave, aty theksohet:

“Analiza e diskursit është fushë a hapësirë shqyrtimi e shkencave të ligjërimit që trajton njësitë tekstore në raportin e tyre me kushtet e tyre të prodhimit. Objekti i analizës së diskursit vendoset përtej fjalës dhe frazës, objekte klasike të gjuhësisë. Gjuha e përvijon realitetin e saj nëpërmjet diskursit dhe diskursin e shohim si stabilizim të përdorimeve gjuhësore/ligjërimore: njësia me të cilën njerëzit komunikojnë nuk është as sintagma as fjalia, por diskursi (që mundet nganjëherë të reduktohet në vetëm një njësi frastike ose sintaksore).

Mundet ta vështrojmë analizën e diskursit edhe në një pikëvështrim më të gjerë, në qasjen a perspektivën e *discourse analysis* të traditës anglo-saksone (Schiffrin 1994). Do të përfshijmë atëherë në hapësirën e saj teorinë e akteve të ligjërimit, sociolinguistikën ndërvepruese dhe variacioniste, etnografinë e komunikimit, pragmatikën, analizën bashkëbisedimore/analizën e bisedës, teori që propozojnë mënyra trajtimi të ndryshme të diskursit.

Do të theksojmë në veçanti dallimin e analizës së diskursit nga dega e shkencave të ligjërimit që i qëndron më pranë: gramatika e tekstit (ose – sintagmë që parapëlqehet më shumë sot – gjuhësia tekstore). Sipas modelit të gramatikës së fjalisë (që përshkruan lidhjet brendafrasore), gjuhësia tekstore përshkruan lidhjet ndërfrastike. Objekti i saj, duke qenë se prirët të formulojë sa më qartë se si organizohet ligjërimiti në njësi më të mëdha se fraza – domethënë teksti – nxit, për shembull, interesime, për anaforën, progresionin tekstor, konektorët, izotopitë semantike, më globalisht për të gjitha dukuritë e koherencë/kohezionit tekstor që mundësojnë të dallohet një tekst prej një vijimësie të paorganizuar fjalish. Por ky përshkrim realizohet pa vënë në lidhje njësinë tekstore me kushtet e saj të prodhimit. Analiza e diskursit përkufizohet, në të kundërt, nga vënia në dukje e kësaj lidhjeje: diskursi është i analizuar në kontekstin e tij. Gjithsesi, nuk bëhet fjalë që të shpjegohet diskursi nga konteksti i tij nëpërmjet një qasjeje mekaniciste, por të analizohet se si kuptimi prodhohet në ndërveprim me parametrat e ndryshëm si situata e komunikimit,

subjektet, marrëdhëniet mes diskurseve, ideologjia, formacioni diskursiv, gjinia e diskursit dhe tipat e tekstit” (Termes et concepts, 2017, 24-28).

Përtej këtij pikëvështrimi të përgjithshëm, vlen të përmenden edhe dy aspekte të rëndësishme në zhvillimet e sotme në analizën e diskursit:

Së pari, njëri prej kaheve të zhvillimeve të sotme përqendrohet në shqyrtimin e diskurseve në media, të cilat në etapën e tanishme, me zhvillimin e vullshëm që kanë marrë, janë njëherazi edhe “mbështetësit dhe aktorët e evoluimit të gjuhës” (Boyer 2015, 87), duke qenë njëherazi shprehëse domethënëse të një realiteti social, psikologjik e kulturor të periudhës së tanishme [...] treguese të mënyrave të organizimit të formave, procedeve, teknikave të mediatizimit të diskurseve, më saktësisht të gjinive të diskursit dhe nevojave të praktikave të caktuara ligjërimore e sociale. Për analistin e diskursit shfaqen sfida të shumta në shqyrtimin e këtij realiteti tejet të larmishëm diskursiv mediatik për të parë se si përçohen “synimet sociale”, “kuptimësimet e mesazhe sociale”, që përftohen prej kontekstualizimeve të “kuptimit gjuhësor” në procesin diskursiv mediatik” (Soulages 2015, 15).

Merr rëndësi të veçantë shqyrtimi i këtij realiteti diskursiv, sepse mediat janë “hapësirat më të dukshme ku mund të vërehet kristalizimi njëherazi i gjuhës, i kujtesës historike dhe i një kulture të përbashkët” (Soulages po aty, 15).

Së dyti, kahu tjetër i rëndësishëm në zhvillimet e tanishme të analizës së diskursit, veçanërisht të shkollës franceze, ka të bëjë me qasjet ndaj diskursit letrar. Krahas botimeve të ndryshme qysh në fillim të viteve 1990, një piketë e rëndësishme që orientoi energjitë dhe kahun e shqyrtimeve të këtij aspekti të veçantë në zhvillimet e analizës së diskursit konsiderohet *Kolokuiumi* i mbajtur në Cerisy në shtator 2002, me temën “Analiza e diskursit: një kthesë në studimet letrare”, 2-9 shtator 2002, dhe vepra e botuar nën drejtimin e Ruth Amossy-së dhe Dominique Maingueneau-së “L’analyse du discours dans les études littéraires/Analiza e diskursit në studimet letrare” (2003), me kontributet e diskutimet në atë kolokuium; një vepër reference e vijueshme, si për risitë që u sollën përmes kontributeve, po aq edhe për diskutimet mes personaliteteve pjesëmarrëse në ato diskutime. Qysh në sythin “Paraqitje” të asaj vepre theksohet dalja në pah e një *analize të diskursit letrar* në fillim të viteve 1990, një hapësirë studimi që “përftohet prej përputhjes e bashkimit të përpjekjeve të kaheve a rrymave të ndryshme të shqyrtimit: analiza e diskursit, që kishte eksportuar konceptet e saj drejt korpuseve të reja për të, studimet e teksteve të prirura drejt kategorive të enoncacionit gjuhësor ose pragmatikës, zhvillimet në studimet letrare të angazhuara në kuadër të socio-kritikës [...] [...] Në etapën e tanishme, në lidhje me studimin e teksteve letrare, janë teoritë e enoncacionit gjuhësor dhe rrymat pragmatike, në të shumtën e rasteve të integruara në një gjuhësi të diskursit, që i nxisin ato shqyrtime” (Présentation, 2003, 9-10). Synimi i kësaj hullie të re shqyrtimi të tekstit/diskursit letrar vërehet në

pohimin e D. Maingueneau-së, ndërsa thekson që “me dijet e përpunuara në analizën e diskursit letrar synohet të arrihet një transformim i thellë i qasjeve përmes të cilave mund të studiohen tekstet në disiplinat letrare” (Maingueneau 2003, 15).

Dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XXI kanë shënuar një zhvillim tejte të suksesshëm të analizës së diskursit letrar, me kontribute të shumta që vijnë nga hapësira frankofone e lëvritit të kësaj qasjeje të veçantë të shkollës franceze të analizës së diskursit, por edhe nga vende të tjera si Brazili, Argjentina, Spanja, Portugalia, Italia, Algjeria, Polonia, Danimarka etj., ku ndikimi i asaj shkolle është i konsiderueshëm. Shqyrtimi i çështjeve të tilla që lidhen me marrëdhëniet ndërdiskursive në ngjizjen e mesazheve (letrare), natyra polifonike e ngjizjes së tyre, roli i subjektit folës e thënë në mesazh, rëndësia e skenave/situatave të komunikimit dhe të të thënit, përgjithësisht e “skenografisë” së pranishme në ato ngjizje, paratopia karakterizuese e veprës dhe krijuesit, triada qenie biografike/shkrimtar/qenie tekstore etj. janë tashmë kontribuese në atë “transformim të thellë të qasjeve përmes të cilave mund të studiohen tekstet në disiplinat letrare”, që mëtonte D. Maingueneau-ja në fillimet e zhvillimit të kësaj qasjeje të veçantë të Analizës së diskursit (shih më gjerë Plangarica 2023a). Tërë ky korpus dijeje i formësuar tashmë në gjuhësinë/analizën e diskursit na mundëson të pohojmë që në shumësinë e formave e shfaqjeve të praktikave ligjërimore në etapën e tanishme mund të flitet tashmë jo thjesht për *universin e ligjërimit*, siç e cilësonte Benveniste-i e të tjerë, por për *multiversin diskursiv*, duke parakuptuar në këtë rast realitetet me përmasa të pamata, një shumësi vlerash të përfutuara nga aftësia e qenies njerëzore për të përdorur mjetet e saj të komunikimit, veçanërisht ato verbale.

Por, nga ana tjetër, edhe Gjuhësia/Analiza e diskursit është bërë një multivers, një shumësi universesh, një shumësi vlerash, ku galaksitë e ndryshme fitojnë në kohë forca të ndryshme gravitacionale, që tërheqin të tjera galaksi rreth tyre në një kohë të caktuar ose përafrohen rreth galaksive të tjera që mbizotërojnë në një kohë tjetër, duke ndërtuar njëherazi edhe mundësitë e bashkëveprimit “urat e bashkëpunimit”. Siç theksojnë Damon Mayaffre dhe Laurent Vanni, “Analiza e diskursit është bërë përgjatë dhjetëvjeçarëve një multivers të cilit nuk është e lehtë t’i përshkruash as kufijtë as historinë. Veçanërisht, galaksia franceze, në qendër të gravitetit për një kohë të gjatë, sillet sot rreth galaksisë anglo-saksone e bërë mbizotëruese, çka nxit kryqëzime kulturore dhe epistemologjike të koncepteve të bibliografive, të paradigmave që s’është e lehtë t’i ftillosh. [...] Analiza e diskursit mbetet në një kryqëzim disiplinar [...] por rrugët që të drejtojnë aty, qendra e gravitetit, destinacionet

kanë ndryshuar dhe janë mpleksur përgjatë kohës, duke e kthyer çdo sintezë në një përpjekje jo të lehtë” (Mayaffre dhe Vanni 2025, 41-42).¹²

o o o

Në mendimin tonë gjuhësor i kemi të reflektuara në mënyra të ndryshme këto qasje, edhe pse jo në gjerësinë dhe larmishmërinë e interesimeve që u vunë re në gjysmën e dytë të shekullit XX në shkollat e ndryshme gjuhësore, sidomos në atë anglo-saksone, franceze a gjermanike. Në mënyrë të veçantë ato janë të pranishme në prurjet shkencore të studiuesit Xhevat Lloshi, në kuadër të studimeve të tij në fushë të stilistikës e pragmatikës, veçanërisht në veprat “Stilistika e gjuhës shqipes” (1987) e më tej te “Stilistika e gjuhës shqipe e pragmatika” (1999) dhe ribotuar disa herë, por edhe në shkrimet e veprat me analiza stilistike për vepra të ndryshme të autorëve shqiptarë të periudhave të ndryshme të zhvillimit të letërsisë në gjuhën shqipe. Prurjet e tij shkencore kanë krijuar një model të suksesshëm, të ndjekur në shqyrtime nga studiues të tjerë, specialistë a doktorantë në botime të ndryshme në formën e monografive, artikujve studimorë, tezave të doktoratës, ku gjinitë/tipat e diskursit shqyrtohen si stile funksionale (politiko-shoqëror, tekniko-shkencor, administrativo-juridik, i letërsisë artistike a stili i veprimtarisë fetare) dhe analizat e bisedës integrohen në dijet për stilet ligjërimore dhe njohuritë e dhëna në kuadër të Pragmatikës. Në punimet e Xhevat Lloshit janë të pranishme prurjet e shkollës anglo-saksone e më gjerë, përmes një trajtimi krijues deri në përfitim të një qasjeje origjinale në lidhje me dukuritë në gjuhën shqipe.

Rreth disa shkaqeve të pavëmendjes në shqyrtime ndaj dukurive të lidhura me diskursin

Edhe pse në mendimin tonë gjuhësor vërehen arritje entuziasmuese nga studiues të caktuar, të cilët arrijnë të njohin në kohë risitë që shfaqen në shqyrtime në kuadër të Gjuhësisë/Analizës së diskursit, nuk vërehet, gjithsesi, vëmendja e duhur dhe angazhimi institucional për angazhime më të plota e

¹² Në formën e shënimit, në po këtë shkrim, autorët pohojnë që “këto kryqëzime a ndërmarrëdhënie komplekse – nganjëherë deri në paradoks – mundet të ilustrohen, për shembull, me referencat që Fairclough-u bën te Althusser-i ose Pecheux-ja (ndër themeluesit e shkollës franceze të diskursit, shën. ynë TP), edhe pse s’mund të themi që “Critical Discourse Analysis” në tërësi, për të cilën Fairclough-u konsiderohet ndër themeluesit e saj, është me frymëzim francez e materialist. Nga ana tjetër, vërehet që Shkolla e quajtur “franceze” e Analizës së diskursit ngulmon ta konsiderojë si akt themelues përkthimin e *Discourse Analysis* të Harris-it në *Langages* [...], edhe pse nuk mund të themi që distribucionalizmi amerikan mbizotëron në përvijimin e analizës së diskursit në mjedisin francez prej 55 vjetësh” (Mayaffre dhe Vanni, po aty, Shënimi 1, faqe 41).

synime më të programuara në trajtimin e aspekteve të ndryshme që lidhen me këtë problematikë për shqipen.¹³

Ka një sërë arsyesh për vëmendjen e pakët në shqyrtime ndaj këtij entiteti: arsye që lidhen me karakteristikat e veçantitë e vetë entitetit, që kërkojnë ndriçim në një hapësirë të gjerë epistemologjike, dhe jo gjithnjë të lidhura drejtpërdrejt me interesimet e gjuhëtarëve (le të theksojmë sërish që interesimet, më së tepërmi, lindin edhe në fushën e filozofisë, historisë, ideologjisë, psikologjisë, studimeve letrare, antropologjisë etj.), pra jo vetëm në kuadër të gjuhësisë, a më drejtpërdrejt të shkencave të ligjërimit.

Madje, analiza e diskursit, si një kah a disiplinë e zhvilluar në hapësirën e shkencave të ligjërimit, lidhet ngushtë me “teorinë e diskursit” e cila “rigrupon a mbledh projekte intelektuale që kombinojnë në mënyra të ndryshme angazhime të përfutuara prej poststrukturalizmit, në veçanti prej M. Foucault-së dhe J. Derrida-së, prej *Cultural Studies* dhe konstruktivizmit. Ato nxisin në shqyrtim probleme të parakuptuara të shkencave humane dhe sociale, në veçanti mbi subjektivitetin, kuptimësimin e mesazheve, pushtetin, identitetin seksual, shkrimësinë a mënyrën e të shkruarit, disidencën, postkolonializmin etj. Vetë analistët e diskursit, me metoda të shumta, studiojnë korpusë duke u mbështetur në shkencat e ligjërimit, të cilat këto shkenca (të ligjërimit) i vënë ato në marrëdhënie me fushat e tjera të shkencave humane e sociale” (Maingueneau 2025, 9).

Por zgjerimi i interesimeve ndaj këtij entiteti përtej gjuhësisë s’mund të jetë arsye për shpërfillje nga gjuhëtarët, por duhet të përbëjë një motiv më shumë për vëmendje, për përkujdesje edhe më të veçantë, sidomos për ato aspekte që lidhen më drejtpërdrejt me konceptimin e këtij entiteti, me organizimin e mesazheve në përputhje me situatat komunikative e thënësore, rolin e organizuesve tekstorë, konektorëve a përgjithësisht të shenjuesve diskursivë në ligjërim, sidomos në diskursin shkencor, letrar, gazetaresk etj., përfitim të modaliteteve të ndryshme në lidhje me pozicionimin e folësit a thëniepërfutuesit në situata të ndryshme komunikative e thënësore, që mundësojnë të ashtuquajturin modalizim, përdorimin e kohëve foljore dhe mjeteve të tjera që çojnë përtej përkatësisë së drejtpërdrejtë foljore në të ashtuquajturin temporalitet e aspektualitet, e një sërë dukurish të tjera që kanë

¹³ Gjithsesi është disi më e ndryshme gjendja e studimeve në shqipe për problematikën që lidhet me entitetin “tekst”. Një sërë botimesh në formë monografish, artikujsh studimorë, teza doktorate a në formën e manualeve (për përshkrimin e gjuhësisë a gramatikës së tekstit), shkruar nga studiues të fushave të gjuhësisë a studimeve letrare, janë të pranishme tashmë në botimet tona shkencore në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, por edhe më gjerë, te arbëreshët në Itali etj. (arritjet në këtë fushë studimi do të jenë objekt i një paraqitjeje tjetër).

të bëjnë me kuptimësimin e rikuptimësimin e thënieve, tekstit a mesazheve tekstore.

Mungesa e vëmendjes ndaj këtij entiteti, diskursit, në mjedisin tonë shkencor është nxitur, ndoshta, edhe për shkak të një ngadalësie relative në studimet tona ndaj dukurive e fakteve gjuhësore që kërkojnë shpjegim përtej qasjeve që përqendrohen në studimin e njësive të sistemit, qasje që parakuptojnë objekte studimi përtej kufijve të fjalisë, shqyrtime që kërkojnë njohje të thelluar të metodologjive e mbështetjeve teorike që formësohen përmes disiplinave të ndryshme në përbërje të dijeve të përfuara në të ashtuquajturat *shkencat e ligjërit*.¹⁴

Po ashtu, mefshtësia në shqyrtimin e problematikës që shfaq shqyrtimi i këtij entiteti, s'mund të jetë justifikim për mendimin tonë gjuhësor a specialistët e gjuhës, duke e konsideruar atë përtej territorit të tyre të ngushtë të shqyrtimit, sepse, në radhë të parë, brendia e konceptit “diskurs” bart *gjuhën*, edhe pse të vështuar përtej qasjes së zakonshme që lidhet me shqyrtimet e njësive të sistemit gjuhësor. Shqyrtimi i diskursit nuk e shmang përkujdesjen për studimin e njësive të sistemit, veçse i zgjeron hapësirat e shqyrtimit të tyre, duke i vënë ato në lidhje e marrëdhënie me kontekste të larmishme. Siç vëren D. Maingueneau-ja, aktualisht, ndërsa qasja jonë shkencore përvijohet përmes analizës së diskursit, “jemi të prirur, në fakt, të bashkojmë në shqyrtim gjuhën (madje, më gjerë, burimet semiotike të pranishme në një shoqëri), veprimtarinë komunikative dhe njohuritë (tipat e ndryshëm të dijeve, individuale ose kolektive, që ndihmojnë e mundësojnë ndërtimin dhe interpretimin e kuptimit të thënieve)” (Maingueneau 2025, 9).

Pavëmendja ndaj entitetit “diskurs” në mendimin tonë gjuhësor është shkaktuar, ndoshta, edhe nga njohja jo aq sa duhet e konteksteve në të cilat janë përvijuar dijet e gjuhësisë/analizës së diskursit, jo pak herë larg atyre të gjuhësisë së gjuhës, madje prej studiuesish a lëvruesish që jo pak herë nuk njihen të angazhuar drejtpërdrejt në fushën e gjuhësisë; për më tepër, me përkatësi në vende e paradigma të ndryshme shkencore, në Europë, SHBA, Amerikën latine etj., pra jo vetëm gjuhëtarë, por edhe antropologë e sociologë, filozofë, psikanalistë etj.

¹⁴ Vërehet një lloj pavëmendjeje e pajustificueshme, edhe pse qysh herët, ndërsa po zhvilloheshin këto dije në mjedisin shkencor europian apo atë amerikano-verior, segmente syçela në mendimin tonë gjuhësor po i sillnin në të njëjtën kohë edhe në mendimin tonë gjuhësor ato prurje; studiues të mirinformuar për ato zhvillime po i bënin ato të pranishme edhe në mendimin tonë gjuhësor, mes të cilëve, në mënyrë të veçantë e më sistemos, R. Ismajli, me ngulmimin në sjelljen e dijeve të gjuhësisë tekstore e teorive të të thënit, a Xhevat Lloshi, siç theksuam më parë, për prurjet në lëmin e stilistikës e pragmatikës.

Gjuhësia/Analiza e diskursit në hapësirën e shkencave të ligjërimit dhe qasja ndaj terminologjisë a skajeve të përdorura

Gjuhësia/Analiza e diskursit dhe përgjithësisht disiplinat që bëhen pjesë e *shkencave të ligjërimit*, dijet, konceptet e metodologjitë e përfuara në atë hapësirë mundësojnë jo thjesht njohuri të natyrës metagjuhësore, por edhe njohuri që ndihmojnë në përdorimin sa më të efektshëm të gjuhës, për nevojat nga më të ndryshmet, e njëherazi në situatat nga më të larmishmet.

Natyrshëm disiplinat gjuhësore në përbërje të gjuhësisë/analizës së diskursit, që u kushtojnë vëmendje të veçantë proceseve të komunikimit përmes gjuhës, kanë sjellë para studiuesit një sërë konceptesh dhe terminologjinë përkatëse me të cilat përvijohet *metagjuha* dhe *metadiskursi* i tij, që meritojnë një vëmendje të veçantë. Ka prej tyre që futen rishtazi në përvojat tona, ka të tjera që duhen ridimensionuar, saktësuar, specifikuar për fusha të caktuara shqyrtimi (shtohet detyrimi për këtë përkujdesje, kur njohuritë shkencore të referencës kalojnë më tej në njohuri të didaktizuara në mësimdhënien e shqipes në shkollë dhe integrimin e atyre njohurive në *gramatikën shkollore*).

Në këtë kontekst, pyetje të tilla si këto në vijim, mund të duken edhe më të motivuara: Si do të vijnë në gramatikat tona (dhe më tej në “gramatikën shkollore”) nocionet e *diskursit*, *enonciacionit*, *të funksioneve të ndryshme të akteve të të folurit* apo njësitë a procedetë që lidhen me to? Si do të vijnë nocionet që lidhen me “aktorët” në *situatën e komunikimit* dhe atë *thënësore*, ndërkohë që emërtimet “dhënës” e “marrës mesazhi” mbeten të paplota për të përshkruar veçantitë e përfuara në dy kontekste jo të njëjta situative, ndërkohë që rëndom po dallohen kuptimisht *folësi* (lokutori) e *bashkëfolësi* (alokutori), ndaj *thënësi* a *thëniepërfutuesi* (enonciatori) dhe *bashkëthënësi*; ndërkohë që në analizat e tekstit/diskursit, sidomos atij letrar, po dallohen edhe “qeniet tekstore” që po ashtu “flasim”; për të shkruar më tej te *aktet e të folurit*, *akti lokutiv*, *ilokutiv*, *perlokutiv*, *etj.*?

Më së pari, në lidhje me entitetin a skajin “diskurs”.

Me zhvillimin e shkencave të ligjërimit, përkatësisht të gjuhësisë/analizës së diskursit, skaji “diskurs” dhe vetë koncepti që ai shenjon, e ka zgjeruar çerdhen kuptimore, si pasojë e përdorimit në kontekste të reja të shqyrtimeve shkencore në këto fusha. Siç vëren D. Maingueneau-ja, në këto hapësira shqyrtimi, diskursi *parakupton një organizim përtejfrazor; është një formë veprimi përmes gjuhës; është ndërveprues; është i kontekstualizuar; u nënshtrohet rregullimeve në raport me normën; merr vlerë veçse në brendësi të një situatë të ndërsjellë të ligjërimit, në një interdiskurs*.¹⁵ Për pasojë, ndoshta

¹⁵ Shih më gjerë D. Maingueneau 2009a, 46-47.

duhet që, në varësi të përdorimeve të reja dhe konteksteve të veçanta ku ai përdoret, në gjuhën shqipe (veçanërisht për Gramatikën shkollore dhe botimet popullarizuese) të gjejmë edhe emërtime alternative, nëse është e mundur, duke qëndruar më pranë dhe në lidhje më të drejtpërdrejtë me kuptimin e përfutur në këto kontekste.

Duke e quajtur të përligjur skajin *ligjëratë* për *diskurs*, në kontekstin e vendit të kësaj njësie qendrore në gjuhësinë e tekstit a stilistikë (të pranishëm veçanërisht në trajtesat e studiuesve R. Ismajli¹⁶ dhe Xh. Lloshi), gjithsesi na duket e domosdoshme që në përdorimin e skajit në kuadër të rrymave të sotme pragmatike, teorive të të thënit (enonciacionit), e përgjithësisht në gjuhësinë e diskursit, skaji “ligjëratë” të ketë të pranishme në ato kontekste si alternativë përzgjedhjeje (në varësi të kontekstit dhe parapëlqimit të studiuesit) edhe skajin “diskurs” ose skajin tog “përftesë ligjërimore” (sipas nesh, skaji tog “përftesë ligjërimore”, i përdorur në kontekste të caktuara, është më shprehës për natyrën dhe brendinë që ka skaji “diskurs” jo në pak raste në pragmatikën gjuhësore dhe kontekstet e disiplinave të tjera ku ai përdoret, p.sh., në analizën e diskursit, gjuhësinë e tekstit, didaktikën e gjuhës etj.; dhe, veçanërisht, në “gramatikën shkollore”).¹⁷

Na e përforcon bindjen për përdorimin e skajeve “diskurs” dhe “përftesë ligjërimore” edhe fakti tjetër i përdorimit të dendur që ka tani skaji “diskurs”,

¹⁶ Problemet e lidhura me emërtimet a përdorimin si skaje të koncepteve *ligjërim*, *gjuhë*, *të folur*, e po ashtu edhe *diskurs*/*ligjëratë*, *tekst* janë trajtuar qysh herët në mendimin tonë gjuhësor, mes të tjerëve, në mënyrë tejet të thukët, nga studiuesi Rexhep Ismajli, në dy studime të titulluara “Konceptet ligjërim/gjuhë/të folur” dhe “Teksti”, të botuara në “Shumësia e tekstit”, Rilindja, Prishtinë 1977, 1980, përkatësisht në faqet 32-67 dhe 68-89. Në parashtrimet tona ne kemi përdorur përvojën e përfutur sipas qëndrimeve të R. Ismajlit për skajet *ligjërim*, *gjuhë*, *të folur*; por kemi përdorur skajin *diskurs* ose *përftesë ligjërimore*, në vend të *ligjëratë*. Skajin *ligjërim* e kemi përdorur për *langage*.

¹⁷ Në emërtimin “përftesë ligjërimore” (*përftesë* – diçka që krijohet e prodhohet nga lidhja e dy gjërave, diçka që përftohet; dhe *ligjërimore* – që ka të bëjë me ligjërimin - FGJSSH, 1980, faqe 1430, 998) na çojnë shumë prej vetive që vë në dukje D. Maingueneau-ja për “diskursin”, që parakupton: “procesin e të thënit” (pra një proces që përfton një produkt/përftesë ligjërimor/-e), “një organizim tejfrazor, jo domosdoshmërisht më i madh se fjalia, por produkt që përftohet nga struktura të një natyre tjetër në krahasim me fjalinë” (pra një produkt/përftesë përgjatë përdorimit të gjuhës), “një formë veprimi” (pra, e përfutur për të nxitur një akt), “i orientuar prej synimit të folësit” (pra, që bart përkujdesje e synim përgjatë përftimit), “i kontekstualizuar” (pra, natyrshëm, si diçka e përfutur që bart e përfton njëherazi kontekstin), “i marrë në ngarkim” (pra, diçka e përfutur, që parakupton natyrshëm në ligjërim lidhjen me vetat, kohën, hapësirën), “i drejtuar a mataruar nga norma” (pra, si diçka e ngjizur a përfutur që parakupton natyrshëm normat, rregullat e përftimit) etj. (vetitë e “diskursit” janë cituar nga Maingueneau, 2004/ 2014, 31-35).

në krahasim me *ligjëratë*, në metadiskursin universitar në disiplinat që lidhen me këtë problematikë. Në to janë të pranishme edhe dijet që lidhen me shkollat, drejtimet a disiplinat që mbulohen nga *gramatika diskursive* a *gramatika e diskursit*, si qasje *makrosintaksore*, përtej fjalisë si njësi e *mikrosintaksës* (në anglisht *discourse grammar/discursive grammar, discourse syntax/Text syntax/Suprasentential syntax*); *analiza e diskursit, studimi i diskursit* (në anglisht *discours analysis, discourse studies*); apo *analiza kritike e diskursit* (anglisht *critical discourse analysis*) etj.

I përfutur në kontekstet ku gjuhësia e diskursit ishte në shqyrtim e sipër të veçantive të entiteteve “tekst” e “diskurs”, ndërsa “aktet e të folurit” ende nuk kishin tërhequr vëmendjen e studiuesve tanë me veçantitë e tyre si koncepte dhe entitete të gjuhës në përdorim, skaji “ligjëratë”, nuk po konsiderohet lehtë në metadiskursin e tanishëm si skaj që përfaqëson edhe larminë e shfaqjeve të kësaj brendie të re, ndaj vërehet prirja për përdorimin e skajit të huazuar “diskurs” (krahas grupeve me përbërësen mbiemërore “qasje *diskursive*, analizë *diskursive*” etj.). Nëse në dijet e referencës specialistët e fushave përkatëse të gjuhësisë së diskursit mund të përzgjedhin mes “diskurs” e “ligjëratë” në përputhje me kontekstet teorike në të cilat ata integrojnë shqyrtimet e tyre, mendojmë që në “gramatikën shkollore” dhe dijet popullarizuese të problematikës së lidhur me diskurset, për skajin “diskurs” mund të përzgjidhet e përdoret krahas *ligjëratë*, togu “përftesë ligjërimore”. Ky emërtim përafron edhe me traditën e formësuar tashmë përmes prurjeve të studiuesit Xh. Lloshi në lëmin e *Stilistikës gjuhësore të shqipes*, ku u kushtohet vëmendje organizimit të dytë gjuhësor në sfera të ndryshme të veprimtarisë sociale, pra në studimin e stileve funksionale në shqipe si shprehëse të *praksis-it* diskursiv (a praktikës diskursive) të sferave të ndryshme të asaj veprimtarie.¹⁸

Nga ana tjetër, është pikërisht kjo mënyrë e të kuptuarit të kësaj kategorie që zotërimin e *diskursit*, pra *përftesave ligjërimore*, e bën objektivin kryesor të mësimdhënies së gjuhës, duke vënë në qendër të mësimdhënies praktikat ligjërimore (shih më gjerë Plangarica 2018b, 128-131).

¹⁸ Sipas trajtimit praksematik të analizës së diskursit, “sferat e ndryshme të veprimtarisë sociale prodhojnë dhe strukturojnë *praksis-e* a *praktika* të ndryshme (tërësi veprimtarish që synojnë një rezultat): materiale, simbolike, diskursive [...] Çdo sferë të veprimtarisë sociale i korrespondon kështu një *praksis diskursiv*: sferës së veprimtarisë politike, praksis-i diskursiv politik; sferës së veprimtarisë shkencore, praksis-i diskursiv shkencor, sferës së veprimtarisë fetare, praksis-i diskursiv fetar [...]” etj. (shih Caillat dhe Verine 2024, 13-26; dhe Termes et concepts..., 2017, 299-301). Pra, diskursi politik, shkencor, fetar etj., të vështruar përmes *stileve funksionale politik, shkencor, fetar* etj. mund të vërehen si *përfitesa ligjërimore politike, shkencore, fetare* etj. në tekste që mundësojnë njohuritë e didaktizuara të dijeve të referencës.

Gjuhësia e sotme, duke u përkujdesur që të shqyrtojë jo vetëm produktin gjuhësor, por edhe kushtet e përfuturit të tij, pra në tërësi aktin e komunikimit, ka përpunuar një sërë kategorish e konceptesh që sërish kërkojnë interpretime dhe skaje sa më të përshtatshme në gjuhën shqipe. Në mënyrë të veçantë presin përcaktime të mëtejshme dhe skaje sa më të përshtatshme kategoritë që lidhen me situatën e komunikimit dhe situatën e të thënit (enonciacionit) dhe “aktorët” veprues në të, folësit (lokutorët) e thënësit (enonciatorët). Siç thekson P. Charaudeau-ja, “situata e komunikimit përcakton identitetin social dhe psikologjik të personave që komunikojnë. Por kur ata komunikojnë, këta persona japin edhe një *identitet mirëfilli ligjërimor* që nuk është i së njëjtës natyrë si identiteti psikosocial. Sigurisht, këto dy tipe identiteti konfondohen përgjatë të folurit të folësit. Gjithsesi është e nevojshme t’i dallojmë ato, nëse do të duam të kuptojmë se si janë përvijuar lojërat ligjërimore të aktit të komunikimit” (Charaudeau 1992, 638-639).

Në këtë aspekt, një seri skajesh dalin të lidhura ngushtë me dhënësin e mesazhit a folësin. Gjendemi edhe në gjuhën shqipe në prani të një morie emërtimeesh, si *folës, dhënës mesazhi, thënës, emetues, enonciator*, etj. nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, *bashkëbisedues, marrës mesazhi, bashkëfolës, receptues, bashkëthënës* etj. Në fakt, shumësia e emërtimeve pasqyron edhe një vështirësi që haset në vetë shkencat gjuhësore dhe të komunikimit, ku këto skaje përfaqësojnë nocione që jo gjithnjë kanë qëndrueshmërinë e duhur. Këto janë nocione me vlera jo shumë të qëndrueshme, sepse kushtëzohen nga lidhjet që ato vendosin me nocionet fqinjë, në veçanti me atë të *folësit (locuteur)* dhe veçantitë e vetë kahut teorik në të cilën kategoria përkatëse përftohet dhe përdoret.

Dalin në pah në këtë kontekst një sërë konceptesh-terma që janë të nevojshëm në shqyrtime dhe po hyjnë/do të hyjnë natyrshëm edhe në njohuritë e transmetuara në dijen shkollore përmes mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe letërsisë në cikle të ndryshme shkollore. Prania e koncepteve apo entiteteve të tilla (në shkencat e ligjërimit), si “situatë e komunikimit”, krahas “situatës së të thënit” a “skenografisë” në përfuturin e akteve të ndryshme ligjërimore, dallimi i funksioneve të ndryshme që përmbushen në ato akte (lokutiv, ilokutiv, perlokutiv), dallimi i bërë në lidhje me statuset jo të njëjta që përvijojnë “aktorët” e atyre akteve, si folës a thënës në përvijimin dhe realizimin e thënieve, nga njëra anë, dhe bashkëfolës a bashkëthënës, që mundësojnë rikuptimësimin e mesazhit të përçar, për më tepër, subjektivizimi i këtyre lidhjeve në tekst, veçanërisht në tekstin a diskursin letrar, do të kërkojë ekuivalente didaktike edhe për dijet shkollore. Përftohet në këtë mënyrë një problematikë jo e thjeshtë, pra, edhe në fushë të terminologjisë, çka do të reflektohet edhe në “gramatikën shkollore”. Për emërtimet e koncepteve-terma të kësaj natyre, që shfaqin vështirësi në përdorim, prania e emërtimeve të

përbëra, me sferë më të gjerë shenjimi, mund të jetë e përshtatshme për dijen shkollore.

Emërtimet “folës” e “bashkëfolës” në lidhje me situatën e komunikimit, “thënës” e “bashkëthënës” (apo “thëniepërfutues” e “thëniemarrës”) në lidhje me ngjizjen dhe rikuptimësimin e domethënies së mesazhit, mund të jenë të përshtatshme në tekstet e gjuhës e letërsisë në cikle të ndryshme shkollore parauniversitare. Dhe, mbi këtë logjikë, emërtimi mund të vijohet më tej, kur analiza shtrihet në lidhje me tekstet a diskurset e natyrave të ndryshme që analizohen në procesin mësimor, sidomos atyre letrare, ku subjektiviteti është i pranishëm dhe i ngjizur gjuhësisht, veçanërisht në tekstet poetike.

Gjithsesi, situata në lidhje me tekstin letrar (sidomos atë poetik) shfaqet më e ndërlikuar. Dihet tashmë se vepra letrare është dukuri komunikative që u nënshtrohet ligjësive të komunikimit, duke bartur një sërë veçantish: ajo është shprehëse e pozicionimeve estetike të shkrimtarit; është krijuese e një skenografie të veçantë, ku ndërthuren “aktorët” e natyrave të ndryshme a thëniepërfutuesit dhe, si diskurs, është përftesë e një marrëdhënieje të veçantë me lexuesin (bashkëfolësin e thëniemarrësin), pjesë e së cilës është etosi diskursiv i shprehur përmes qëndrimit të thëniepërfutuesve apo enonciatorëve në ligjërim; nga ana tjetër, folësit a thëniepërfutuesit në vepër vështrohen si burim pikëvështimesh që mundësojnë shumësinë e zërave në thënie a polifoninë në mesazh, duke përftuar në këtë mënyrë një bashkëmarrëdhënie të ngushtë të tri instancave që futen në procesin krijues (individit biografik (qenies biografike), shkrimtarit dhe thëniebartësit (a thëniepërshkruesit, qenies tekstore), duke i inkadruar ato në një hapësirë e kohë të përftuar nëpërmjet treguesve tekstore (përmes deiktikëve a tregorëve hapësinorë e kohorë dhe pranisë së objekteve e rrethanave të tjera të pranishme në thënie/mesazh); në këtë mënyrë ngjizet një proces i veçantë i të thënit, me gjurmë të dukshme që barten në të thënat konkrete në aktin diskursiv të përftuar, çka dekontekstualizohet dhe rikontekstualizohet nga lexuesi a thëniemarrësi, përmes një tjetër procesi të thëni, duke u bërë edhe ai vetë pjesë e rikuptimësimit të tekstit letrar (shih më gjerë Charaudeau dhe Maingueneau 2002, 516-517).

Në tërë këtë proces janë të pamjaftueshme dy skajet e zakonshme të procesit të komunikimit, “dhënës mesazhi” e “marrës mesazhi”; tërësia e emërtimeve të specifikuar në atë proces, ku merret në konsideratë “situata e komunikimit” (dukuri jashtëgjuhësore) dhe “situata e të thënit” dhe “skenografia” (të përftuara përmes mjeteve gjuhësore, në diskurset konkrete), ndihmon lexuesin e interpretuesin të shpjegojë e vlerësojë dukuritë e ngjizjes gjuhësore të diskursit letrar e, në këtë mënyrë, edhe vlerat estetike të përftesës ligjërimore përkatëse, që ngjallin/duhet të ngjallin përjetime estetike. Ndaj na duket e përshtatshme të futim në përdorim konceptet-terma “folës” për “lokutor”, “thënës” a “thëniepërfutues” për “enonciator”, “thëniebartës” a “thëniepërshkrues” për “qenien tekstore” që përftohet si pasojë e polifonisë në

tekst dhe kur i njëjti “aktor” në procesin e të thënit ngjiz gjuhësisht pikëvështrime të ndryshme, e për pasojë edhe “vetje” jo të njëjta. Krijimi i emërtimeve-kompozita me fjalën “thënës”, të përlindur a prejardhur nga “thënie”, na ndihmon më tej për krijime termash që shfaqen në qasje të tjera për diskursin letrar, si ai i “arki-enonciatorit” në diskursin dramatik, që do të shenjojë “aktorin” që përfaqëson autorin në procesin e të thënit në vepër, që mund të vijë në shqip si “thëniepërfutuesi zanafillor”; siç na mundëson të përdorim “bashkëthënës” a “thëniemarrës” si skajin tjetër përballë “thëniepërfutues” e “thëniebartës”.

Kjo mënyrë etiketimi na ndihmon edhe në përcaktimin a përkufizimin e koncepteve. Siç pranohet tashmë “përkufizimi i një termi duhet të mbajë parasysh lidhjen e përfutur nga nocioni me sistemin nocionor [..., ...] nuk mund të studiohet sintagmatika e termave, lidhjet mes përbërësve, pa mbajtur parasysh ekzistencën e serive, domethënë pa mbajtur parasysh lidhjet paradigmatiche” (Portelance 1990, 111,120).

Probleme mund të hasen, gjithashtu, edhe në didaktizimin e njohurive në lidhje me aktet e ligjërimin, *aktit lokutiv*, *ilokutiv* dhe *perlokutiv*. Pranohet tashmë se akti i ligjërimin është një prej nocioneve thelbësore të pragmatikës gjuhësore që parakupton “njësinë më të vogël e cila përgjatë të folurit përfiton një veprim (urdhër, lutje, pohim, premtim [...]), me synimin për ta ndryshuar situatën mes bashkëfolësve [...]; ndërsa bashkëfolësi mundet ta interpretojë mesazhin veçse nëse njeh synimin e folësit. [...] Sipas Austin-it, duke prodhuar a përfutur një akt ligjërimor, përmbushim në fakt njëherazi tri akte: një akt lokutiv (prodhojmë një sekuençë a vijimësi tingujsh që kanë organizim sintaksor dhe që referon te diçka); një akt ilokutiv (përmbushim përgjatë të folurit një veprim që i ndryshon lidhjet mes bashkëfolësve: pohojmë, premtojmë, urdhërojmë [...]); një akt perlokutiv (me anë të të cilit, nëpërmjet aktit ilokutiv, realizojmë veprime të ndryshme)” (Maingueneau 2009b, 15).

Në thelb, kjo është brendia e këtyre akteve, edhe pse autorë të ndryshëm shpjegojnë më gjerë a në mënyrë edhe më të thukët këto koncepte.¹⁹

¹⁹ Për shembull, në *Introduction à la pragmatique*, kemi këto përcaktime: “akti lokutiv është përmbushur duke prodhuar një thënie dhe lidhet me veprimtarinë gjuhësore të folësit. Ai përftohet përmes shumë operacioneve të njëkohshme: prodhimit të tingujve, përzgjedhjes së fjalëve a morfemave, renditjes së tyre sipas rregullave sintaksore, përcaktimit të intonacionit të caktuar dhe, më së fundi, dhënia e një kuptimi dhe një referenti të veçantë njërive të përdorura. Prodhimi i tij i korrespondon në disa aspekte fjalisë; 2. Akti ilokutiv është përmbushur duke thënë diçka dhe përbën aktin ligjërimor të mirëfilltë të të folurit. Ai vlerësohet me terma të suksesit a dështimit dhe varet prej një numri të caktuar rrethanash të përvijimit të të folurit. [...] 3. Akti perlokutiv është përmbushur a kryer nga kërkesa për të thënë diçka dhe për të vënë në dukje efektet e prodhuara nga akti ilokutiv mbi tjetrin. Ky akt manifestohet në formën e reaksioneve të

Edhe në literaturën tonë gjuhësore, sidomos me daljen në dritë të veprave që trajtojnë probleme të pragmatikës, filozofisë së gjuhës, gjuhësisë së përgjithshme a gjuhësisë teorike, brendia e këtyre koncepteve është ndriçuar siç duhet. Ato kanë hyrë tashmë në literaturën që përdorin specialistët tanë të fushës së gjuhësisë a studentët që studiojnë në këtë fushë.

Megjithatë, duke vënë re se këto skaje mbeten të vështira për t'u përvetësuar dhe ngulitur te përdoruesit në përvojat tona shqyrtuese, për shkak të formës latine të emërimit, mendojmë që ato mund të vijnë në gjuhën shqipe me anë të skajeve-kompozita të mëposhtme dhe, si të tilla, mund të rekomandohen edhe në “gramatikën shkollore”: 1. *Akt lokutiv* të përdoret me përgjegjësen në shqipe *akt i thëniepërfuturit a i mirëthënies*; 2. *Akt ilokutiv* të përdoret me përgjegjësen *akt i thënieangazhimit a i thëniesynimit*; 3. *Akt perlokutiv* të përdoret me përgjegjësen *akt i thënieveprimit a thënieefektit* (shih më gjerë, Plangarica 2018b, 137-140).

Dhe, së fundi, do të shtonim se përvijimi i dijes gjuhësore në kuadër të zhvillimeve të sotme të shkencave të ligjërimit (në përbërje të të cilave shumë disiplina shqyrtojnë entitete gjuhësore përtej fjalisë, por, në mënyrë të posaçme, shqyrtojnë edhe dukuritë gjuhësore në njërën prej formave të përdorimit të gjuhës, në *ligjërimin e folur*, ka nxitur qasje të reja edhe ndaj njësive gjuhësore si *fjala*, rikonceptime dhe ripërkufizime të saj, ndërsa ajo studiohet e lidhur me njësitë apo entitetet *thënie*, *periudhë*, *diskurs* e *tekst*.

Për studiues të ndryshëm të shkencave të ligjërimit, ripërkufizimi a specifikimi i brendisë që bartin njësitë sintaksore në hapësirat e *mikrosintaksës* e *makrosintaksës* ndihmon për shqyrtimin e aspekteve të caktuara gjuhësore të pastudiuara më parë. Ky ripërkufizim nxitet nga shqyrtimet që vijnë në përgjigje të pyetjeve të tilla, si: A janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme nocionet e skajet “fjali e thjeshtë” dhe “e përbërë” në shqyrtimet e entiteteve “diskurs” e “tekst”? A mundësojnë ato lehtësi në shqyrtimet e ligjërimit të folur, ku larmia e variacioni krijon të tjera lidhje, raporte e ndërvarësi? A mundet të sigurojmë me këto koncepte analizat në hapësirat e mikrosintaksës e, po ashtu, edhe të makrosintaksës?

Studimet tona në fushën e gjuhësisë së tekstit, të pragmatikës, të analizës së diskursit, sidomos ato që synojnë studimin e ligjërimit të folur (këto të fundit, të mbetura më tepër si projekte të institucioneve tona), po shfaqin dhe do të shfaqin edhe më shumë në të ardhmen ato probleme që janë të pranishme tashmë në përvojat europiane si pasojë e qasjeve të reja konceptuale e metodologjike; ndaj është me vlerë ndriçimi i atyre qasjeve, për të lehtësuar shqyrtimet në lidhje me shqipen.

Në një realitet të ri shqyrtimelesh, ndërsa bëhen përpjekje për të përcaktuar njësitë përbërëse të entiteteve “tekst” e “diskurs”, ndërsa vërehen veçantitë e ngjizjes së ligjërimit të folur dhe gjurmët e oralitetit edhe në ligjërimitin e shkruar, studiuesit vërejnë “brishtësinë” e nocionit “fjali” për shqyrtimin e dukurive tekstore apo në ligjërimitin e folur, ndaj po u drejtohen gjithnjë e më shumë nocioneve “clause”, “propozicion”, “propozicion i aktualizuar a thëniezuar”, “periudhë” etj.

Studiues të ndryshëm që u përkushtohen analizave narratologjike apo të tillë që përqendrohen në veçantitë gjuhësore të ligjërimit të folur, argumentojnë risjelljen në shqyrtime sintaksore, semantike e pragmatike të njësive të tilla minimale sintaksore, si “clause” apo “propozicion”. Për ta është e motivueshme rimarrja e njësisë “clause”, që parakupton përmbushjen e një akti të thëni (enonciativ) të natyrës sintagmatike ose të fjalisë së thjeshtë. Sipas tyre, në një diskurs, “clause-et” e njëpasnjëshme përvijojnë mes tyre raporte semantike të inferencës dhe jo raporte të varësisë morfo-sintaksore (Neveu: 2017:28); të tjerë theksojnë se në vend të “clause”, termi/skaji “propozicion i aktualizuar” (në shqip mund ta përshtatnim “sifjali e aktualizuar” apo “e thëniezuar”), mund të jetë më i përshtatshëm si njësi minimale që vë në dukje a nxjerr në pah natyrën e produktit të një akti të thëni. Sipas J.-M. Adam-it, duke përzgjedhur të flasim për “sifjali të aktualizuar a thëniezuar”, nuk përkufizojmë një njësi dhe aq virtuale si propozicioni i logjicienëve ose gramatikanëve, por një njësi bazë tekstore, të përfutur në fakt dhe të prodhuar nga një akt i të thënit, pra si një thënie minimale (Adam, 2014:82).

Në këtë kontekst mund t'i sillemi edhe nocionit të “periudhës”, që nga studiuesit e gjuhësisë tekstore dhe ligjërimit të folur po përcaktohet si njësi informuese që rigrupon segmente diskursive të quajtura “clause” a “sifjali”, që përvijojnë mes tyre lidhje të presupozimit ose më përgjithësisht të inferencës, si njësi që parakupton çdo sekuençë diskursive, segmentet e së cilës hyjnë në lidhje veçse me ndërmjetësimin e dijeve të përbashkëta me thëniepërfutuesit e bashkëthënësit a thëniemarrësit (Neveu 2017, 100); ose si njësi që përbën njërin prej planeve të organizimit të tekstualitetit, që ka përparësinë e mbulimit të lidhjeve sa logjiko-gramatikore, po aq edhe ritmike (Adam 2014, 164). Në këtë problematikë shtohet natyrshëm edhe qëndrimi që duhet mbajtur në lidhje me emërtimin e disa njësive gjuhësore që shërbejnë për lidhjen e organizimin e entiteteve përtejfrazore, në rolin e konektorëve a lidhëzorëve të natyrave të ndryshme, por edhe me role të tjera për të shprehur anën subjektive të folësit a thëniepërfutuesit, pra në rolin e *organizuesve teksturë* a *diskursivë*, që më së shumti po emërtohen si “shenjues diskursivë”, të cilët po ashtu kërkojnë mbulim terminologjik.

Këto qasje dhe rikuptimësime të nocioneve tradicionale në shqyrtime gjuhësore kanë lindur nga nevoja për shqyrtime të aspekteve që kanë tërhequr vëmendjen në kahe të ndryshme të studimeve gjuhësore, të gjuhësisë/analizës

së diskursit, pragmatikës së diskursit, të narratologjisë etj., dhe mund të bëhen të përshtatshme edhe për shqyrtimet tona kur t'i qasemi më nga afër këtyre aspekteve dhe mbi bazat metodologjike që po përftohen ndërkohë (shih më gjerë, Plangarica 2021, 89-104).

Diskutimi në lidhje me këto probleme dhe përvijimi i qëndrimeve të caktuara në lidhje me to në mendimin tonë gjuhësor mund të krijojë edhe kontekstin më të përshtatshëm për specialistët e didaktikës gjuhësore për të bërë përzgjedhjet më të përshtatshme në njohuritë dhe konceptet-terma që do të përfshihen më tej në “gramatikën shkollore”.

Qasjet dhe riqasjet ndaj entiteteve të tilla si *diskurs* (a përftesë ligjërimore), *akte të të folurit – lokutiv, ilokutiv e perlokutiv* (a thëniepërftimit, thënieangazhimit e thënieveprimit), *qenie tekstore* (a thëniepërftues, thëniebartës, thëniepërshkrues), *ffali, ffali e aktualizuar* (a clause, sifjali e thëniezuar), *periudhë etj.* janë të motivueshme, sepse këto riqasje jo vetëm na mundësojnë të ndriçojmë më mirë atë çka është përvijuar tashmë si përvojë e suksesshme në shqyrtimet gjuhësore, por na mundësojnë të ndriçojmë edhe profile të reja të objekteve tona të studimit, të integruara në gjuhësinë e diskursit, duke na detyruar njëherazi të zgjerojmë edhe hapësirat e interpretimeve tona teorike; dhe, në këtë mënyrë, të rikonceptualizojmë kategoritë e entitetet gjuhësore me të cilat jemi më të familjarizuar apo të lehtësojmë kapjen e domethënieve që bartin entitetet përkatëse si pasojë e riemërtimit përmes kompozitave a etiketimeve sintagmatike.

Meqë shkallë-shkallë, bashkë me njohuritë përkatëse, këto koncepte-terma po futen edhe në dijet e transpozuara a didaktizuara në tekstet e gjuhës e letërsisë dhe materialet didaktike shoqëruese, paraqitja e tyre edhe përmes kompozitave e sintagmave terminologjike që përvijojnë nomenklaturën e fushës së përdorimit do të ishte një rrugë e rekomandueshme. Emërtimet terminologjike përmes kompozitave a sintagmave mundësojnë përfitim të një nomenklature të fushës që lehtëson të kuptuarit e termave, sepse shfaqen si përshkruese të domethënies së tyre.

Në propozimet e bëra nuk mëtojmë të japim një zgjidhje përfundimtare (zgjidhjet përfundimtare në këto raste janë tejet të vështira dhe të kushtëzuara nga një mori faktorësh), por shpresojmë e dëshirojmë që të nxitet diskutimi, prej të cilit përftohen më tej zgjidhje më të qëndrueshme.

Për institucionalizimin konjitiv e social të dijeve të gjuhësisë së diskursit në mendimin gjuhësor shqiptar²⁰

Siç e vumë në dukje në sythet pararendëse të kësaj trajtese, për studimet tona që u kushtohen dukurive të ndryshme të komunikimit në gjuhën shqipe, proceseve të përdorimit të saj dhe produktit të përftuar në kontekste, sfera përdorimi e situata të caktuara komunikative e enonciative, e vërejmë ende të vështirë të pohojmë që dijet e përfthuara në këto fusha studimi për shqipen, prurjet shkencore në to kanë mundësuar përfitim e disiplinave përkatëse në mendimin gjuhësor shqiptar apo të pohojmë që këto disiplina a kahe shqyrtimesh gëzojnë tashmë *institucionalizim konjitiv/intelektual e social* në shkencën tonë gjuhësore.²¹

Duke bërë një analogji, do të theksonim se dija në disiplinat e ndryshme të gjuhësisë së diskursit në mendimin tonë gjuhësor, në çdonjërin nga ato disiplina, është në faza të caktuara të kalimit të katër pragueve që përcaktonte M. Foucault për përfitim e nivelit të shkencueshmërisë së një formacioni diskursiv. Mes katër pragueve që ai parakuptonte për t'u kapërcyer, disiplina të ndryshme të gjuhësisë së diskursit në mendimin tonë gjuhësor janë në lartësi të ndryshme të atij shkallëzimi. Pavëmendja për të cilën folëm më parë vërehet pikërisht në kapërcimin jo të shpejtë të këtyre pragueve.²²

²⁰ Vërejtjet e propozimet në këtë syth janë të pranishme edhe në artikullin tonë “Prurjet në shkencat e ligjërimit në etapën e tanishme dhe kahet/disiplinat që meritojnë përkujdesje të veçantë në studimin e shqipes”, botuar në *Studia Albanica* (organ i ASHSH-së, në anglisht), 2023/3-4.

²¹ Kur flasim për institucionalizimin konjitiv/intelektual dhe social të këtyre disiplinave, kemi parasysh edhe parametrat që parakuptojnë arritjen ose jo të këtij institucionalizimi. Sipas Robert Boure-s, “me *institucionalizimin konjitiv ose intelektual* (ai i referohet edhe R. Whithley-t, që i përdor më parë këto koncepte, shën. ynë) duhet kuptuar formulimi i çështjeve të studimit, problematikat, konceptet dhe teoritë, përpunimi i metodologjisë, ndërtimi i objekteve, pranueshmëria e rezultateve dhe përcaktimi i fushës shkencore, pra përcaktimi i kufijve me disiplinat e tjera, kufij që janë njëherazi pengesë por edhe ndërlihdës”.

Ndërsa “*institucionalizimi social* ka të bëjë me mënyrat e organizimit të studimit dhe mësimdhënies së dijeve të përfthuara, me strukturat sociale të nxitjes së vazhdueshme të studimit dhe ripërtëritjes së komunitetit të studiuesve, të legjitimitimit dhe ndihmës financiare për burimet, me përvijimin e programeve të kërkimit shkencor, me sistemet e publikimit” (Boure 2005, 11).

²² M. Foucault e parakuptonte të tillë këtë kapërcim drejt shkencueshmërisë së formacionit diskursiv, që mundëson më tej përvijimin e disiplinës shkencore: pragu *i përfutueshmërisë së njohurive* që mundësojnë autonominë e fushës së dijes; pragu *i epistemologjizimit të njohurive*; ai *i përvijimit të të shprehurit në atë fushë*, me konceptet e terminologjinë përkatëse dhe pragu *i formalizimit të prurjeve shkencore* përkatëse (Shih më gjërë Foucault 1969, 241).

Janë tashmë të njohura rrugët që mundësojnë institucionalizimin e dijes shkencore (dhe të tilla janë edhe për këto disiplina a nëndisiplina). Mund të përshtasim ato kërkesa edhe për institucionalizimin e gjuhësisë/analizës së diskursit, duke përmendur kalimthi se janë të nevojshme:

- prania e sektorëve përkatës të kërkimit në këto fusha studimi në institucionet kërkimore-shkencore (në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë pranë ASHSH-së, në departamentet e gjuhësisë në fakultetet e Historisë e filologjisë në universitetet e Shqipërisë dhe në institucionet analoge në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut);
- botimi i revistave të specializuara e periodike për shkencat e ligjërimit, duke i dhënë përparësi studimeve për gjuhësinë/analizën e diskursit;
- hartimi e publikimi i projekteve e programeve të studimit në fushat përkatëse, duke përcaktuar kufijtë e nëndisiplinave përkatëse dhe mundësitë për qasje ndërdisiplinare në lidhje me objektet në shqyrtim;
- hartimi e paraqitja e veprave sintetizuese, e përmbledhjeve, e manualeve a teksteve universitare, por edhe e botimeve të destinuara për të shpërndarë rezultatet e kërkimit pranë praktikuesve të shkencave të tjera ose atyre të përafërta;
- planifikimi i punës për përgatitjen e ekipeve të studiuesve që mund të ndërmarrin botimet e përditësuara të veprave bazë të mendimit gjuhësor, siç është Gramatika akademike e gjuhës shqipe, në përputhje edhe me shqyrtimet në këto nëndisiplina, pra, me të dhëna e interpretime edhe të natyrës diskursive e tekstore; si dhe planifikimi i punës për studimin e tipave të ndryshëm të teksteve e gjinive të diskursit;
- nxitja e botimeve sintetizuese për të shpërndarë dijen e formësuar ndërkohë në një gamë të gjerë lexuesish më pak të specializuar, por të interesuar për këtë problematikë;
- nxitja e organizimit të veprimtarive shkencore në këtë fushë studimi e kërkimi shkencor dhe nxjerrja në pah e studimeve të realizuara ndërkohë, si bazë për vështirime të mëtejshme, në qasje më të avancuara;
- përkthimi i veprave më të rëndësishme në fusha të ndryshme të shkencave të ligjërimit (me përparësi të atyre në gjuhësinë/analizën e diskursit) dhe diskutimi i terminologjisë që vjen në shqip përmes prurjeve shkencore e koncepteve në ato vepra;
- etj.

Do të mbushej në këtë mënyrë ajo pjesë e hapësirës së zbrazët që ka të bëjë me institucionalizimin konjitiv/intelektual e social dhe do t'u krijonim prurjeve tona shkencore në këto fusha studimi statusin e nëndisiplinave shkencore si pjesë përbërëse e kësaj gjuhësie më të re. Do të mundësoheshin, pra, hapa më të shpejtë drejt institucionalizimit të gjuhësisë së diskursit në mendimin gjuhësor shqiptar dhe do të vihej në funksionim më të plotë një

gjymtyrë e trupit të gjuhësisë shqiptare, pa funksionimin e së cilës ai trup do të mbetej i gjymtë.

Nëse plotësimi i atyre kërkesave është një ecuri e përgjithshme që karakterizon institucionalizimin e dijeve e disiplinave shkencore edhe për fusha të tjera të gjuhësisë a shkencave të ligjërimit, në etapën e tanishme e konsiderojmë më të ngutshëm ngulmimin në qartësimin shkencor e metodologjik të problematikës që lidhet me dikotominë *tekst/diskurs*, e për pasojë edhe çështjet që lidhen me interpretimin e dikotomisë *proces/produkt ligjërimit*.

Përqendrimi i vëmendjes në këto entite dhe problematikën që lidhet me to do të nxisë zhvillime më harmonike në një sërë disiplinash që janë pjesë e gjuhësisë/analizës së diskursit, duke e plotësuar me prurje konkrete atë hapësirë ende të papopulluar sa dhe si duhet të ngrehinës së mendimit gjuhësor shqiptar.

Meritojnë vëmendje të veçantë:

- qartësimi i pikëvështrimeve që përqendrohen te entitetet *tekst* dhe/ose *diskurs* sipas kaheve e drejtimeve të ndryshme gjuhësore; e po ashtu i qasjeve të ndryshme ndaj tyre në disiplinat që e kanë objekt të drejtpërdrejtë studimi, si gramatika tekstore, gjuhësia teksore, analiza e diskursit, semantika tekstore etj., për të njohur sa më plotë modelet teorike të përfuara dhe për të shfrytëzuar prurjet e atyre dijeve në funksion të interpretimit të realitetit përdorimor të shqipes (për të njohur, pra, qasje të ndryshme në lidhje me të kuptuarit e diskursit (si akt i prodhimit) dhe tekstit (si produkt i tij));
- ndriçimi i problemeve që lidhen me tipologjinë e teksteve dhe gjinitë e diskursit (duke e konsideruar tekstin si ndërtim teorik, të përcaktuar nga veti që ngjizen së brendshmi në të, përballë diskursit, si një realizim gjuhësor konkret, të përcaktuar nga veti a karakteristika socio-komunikative). Pra njohjen e problematikës së tekstit dhe diskursit, të përfuara e diskutuar qysh me Saussure-in dhe reflektimin semiologjik të tij mbi legjendat, parashtrimet mbi ndërtekstualitetin, me fillesa qysh me Bakhtine-in dhe Volochinov-in, me qasjet ndaj subjektivitetit në pikëvështrimet e Benveniste-it, mbi treguesit që mundësojnë argumentimin sipas Ducrot-së a sipas Rabatel-it, të analizës së bashkëbisedimit sipas modelit anglo-sakson të përpunuar nga van Dijk-u, Wodak-u etj., duke mundësuar në këtë mënyrë edhe një përjasje mes shkollave a kaheve të shqyrtimit dhe prirjen për të dalluar edhe “urat” e lidhjes mes tyre; (shih më gjerë Ablali e al. 2018, 15).
- familjarizimi në shqyrtime edhe me teorinë e polifonisë gjuhësore (mes paradigmave të ndryshme teorike) në lidhje me pozicionimin e folësit/thënësit në diskurs, duke parakuptuar një shumësi zërash që i atribuohen folësit, pra bashkekzistencën e “qenieve tekstore/diskursive” të shumta në përbërje të një thënieje;

- njohja e modeleve të përfuara tashmë në shkolla të ndryshme gjuhësore, si në shkollën franceze ku u kushtohet rëndësi edhe qasjes hermeneutike që e vendos tekstin në lidhje me interdiskursin dhe situatën historike e sociale në të cilën shkruhet e lexohet, krahas modeleve anglo-saksone apo anglofone, gjermanike a latinoamerikane, që u kushtojnë vëmendje rolit të prodhuesit dhe receptuesit më shumë sesa analizave të strukturave tekstore;
- njohja e thelluar e prurjeve shkencore të gjuhësisë së tekstit dhe analizës së diskursit, ndërsa studiojmë llojet/gjinitë e tekstit dhe gjinitë e diskursit. Vërehet se në studimet e tanishme, në jo pak raste, edhe pse mëtohet për t'i vendosur shqyrtimet mbi qasjet e gjuhësisë së tekstit dhe të diskursit, nuk arrihet të krijohet një status i vërtetë nga dijet e përfuara nga ato disiplina, edhe pse faktet mbliidhen për t'u shqyrtuar nga qasjet e atyre fushave të studimit. Mungojnë përgjithësisht nocionet a konceptet e përpunuara në to, metodologjitë dhe dijet mbështetëse teorike. Madje, ende nuk vërehet prania e risive dhe prurjeve në shqyrtimin e tekstit dhe diskursit, edhe pse si referenca gjenden jo pak herë autorë, vepra dhe koncepte nga gjuhësia e tekstit dhe analiza e diskursit.
- njohja e përpunimi i një tërësie konceptesh (me termat përkatës), pra jo vetëm tekst e diskurs, thënie e sekuencë thëniesh, por edhe tipa të teksteve, gjini të diskursit, situatë e të thënit (enonciacionit), situatë e komunikimit, praktikë ligjërimore, praktikë diskursive, kontekst enonciativ, model komunikativ, etj. dhe më tej edhe një tërësi konceptesh të tjera që janë përpunuar tashmë për tipa të ndryshëm të tekstit a gjini të caktuara të diskursit, nga sfera e politikës, jurisprudencës, medias së shkruar e të folur, fesë ..., e deri te teksti e diskursi letrar.

Në mënyrë të veçantë, zhvillimi i disiplinave të ndryshme gjuhësore të diskursit, analizës së diskursit, analizës tekstore të diskursit, psikolinguistikës, pragmatikës, semantikës së tekstit etj., si disiplina që i japin peshë të konsiderueshme gjuhësisë së diskursit në shkencat e ligjërimit, parakupton apo ka të nevojshme grumbullimin e të dhënave në formën e korpuseve të ndryshme gjuhësore, përgatitja e të cilave kërkon pashmangshëm zhvillimin e *gjuhësisë së korpusit*, praninë e përvojave europiane e më gjerë në mendimin gjuhësor. Grumbullimi, disiplinimi e përpunimi i të dhënave përmes programeve të ndryshme kompjuterike, të cilët mundësojnë në etapën e tanishme përpunime të shumëfishta të regjistrimeve të gjuhës së folur a të shkruar, krijon një bazë të sigurt për shqyrtime të vlerata në analizën e diskursit e të tekstit, por edhe për shqyrtime të natyrave të tjera, psikolinguistike, sociolinguistike, neurolinguistike etj., shqyrtime që mund të përqendrohen edhe në proceset konjitive përgjatë të folurit etj. Dhe në këtë mënyrë, shqyrtimet zgjerohen natyrshëm jo vetëm në dikotominë tekst/diskurs, por edhe në dikotominë proces/produkt ligjërimor, ku në një marrëdhënie të ngushtë janë

thëniepërfutuesit (personi krijues i mesazhit dhe “qenia tekstore” që merr ngarkim ngjizjen e përcimitin e mesazhit) me bashkëthënësin/co-énonciataire (a lexuesin/dëgjuesin) në procesin e të lexuarit/dëgjuarit.

Në mbyllje

Prurjet e sotme në shkencat e ligjërimit në Europë, SHBA e më gjerë, në mënyrë të veçantë në gjuhësinë e diskursit a nëndisiplinat e kahet e ndryshme teorike pjesë përbërëse të asaj gjuhësie, kërkojnë edhe vetëdijësim për kompleksitetin e ndërmarrjeve shkencore në këtë fushë; ato s’mund të jenë të suksesshme pa një dije sistimore me zhvillime të dukshme jo thjesht në sociolinguistikë a psikolinguistikë, por në të gjitha nëndisiplinat e kahet e tjera të zhvilluara a në zhvillim e sipër, qysh nga njohuritë e thelluara në *gjuhësinë teorike e të përgjithshme, filozofinë e ligjërimit, pragmatikën gjuhësore, semantikën gjuhësore (leksikore, por edhe gramatikore e diskursive/tekstore), analizën tekstore të diskursit, antropologjinë gjuhësore, etnometodologjinë, semiotikën tekstore* etj.; e po ashtu edhe *sociologjinë e diskursit e psikologjinë e gjuhës*, duke u vetëdijësuar tashmë për natyrën ndërdisiplinare të dijeve të përfutura dhe kompetencën e shumëfishtë të studuesve që do të ndërmarrin studime në këto fusha.

Arritjet në të ashtuquajturën “gjuhësi e gjuhës” në mendimin tonë shkencor, përvoja e përfutur në institucionalizimin konjitiv e social të nëndisiplinave të ndryshme të asaj gjuhësie (në fushën e fonetikës, leksikologjisë, semantikës e terminologjisë, gramatikës, dialektologjisë a historisë së gjuhës), mund të ndihmojnë edhe për këto profile të reja, të domosdoshme të mendimit gjuhësor shqiptar.

Por zhvillimet, jo ato të duhura e të kërkuara në gjuhësinë e jashtme a gjuhësinë e diskursit, ndikojnë në ngadalësimin e lëvizjes edhe në “gjuhësinë e gjuhës”. Prurjet shkencore në gjuhësinë/analizën e diskursit në përvoja të ndryshme europiane kanë ndikuar drejtpërdrejt edhe në shqyrtimin e mëtejshëm të njësive të sistemit gjuhësor, duke shkuar përtej qasjes strukturaliste dhe interpretimit formal të dukurive gramatikore e leksikore, duke i bashkëngjitur mëtimin shkencor vlerën kuptimore që bartet në dukuritë e sistemit. Ngulmohet tashmë se “zhvillimi i mendimit gjuhësor ka treguar kufizimet e studimit formal të sistemeve. Strukturat gjuhësore nuk duhet të reduktohen në një gjeometri pa brendi, sintaksa nuk duhet të mendohet e pavarur prej kuptimit. Nga ana tjetër, si bashkëplotësuese e kërkesave në sintaksë, kërkimet në semantikë nuk mund të bëjnë abstragim prej sintaksës, të parakuptuar si organizim i kuptimit nga gjuha. Kuptimi varet prej një marrëdhënieje komplekse leksiko-sintaksore, ai varet prej vetë formës së leksikut dhe të diskursit” (Grezka et al, 2014:8-9).

Përballimi i kërkesave të kohës në këtë drejtim nuk është thjesht detyrë e misioni i studiuesve të këtyre fushave, por detyrë e misioni i tërë “ngrehinës” institucionale shkencore, në hapësirat e përshtatshme e nxitëse të së cilës studiuesit do të mund, më tej, të japin produktin e dëshiruar e të pritur prej tyre.

Në botën e sotme, gjithnjë e më të globalizuar, në të cilën komunikimi mes folësve e veçanërisht komunikimi publik është i pranishëm në përmasa të paimagjinueshme veçse pak kohë më parë, në të cilën mundësitë e informacionit dhe ndërkëmbimeve shkencore janë po ashtu si kurrë më parë, shfaqet e detyrueshme (edhe për zhvillimin në fusha të ndryshme të shkencave), që nivelet e arritjeve të maten a krahasohen me rezultatet e arritjeve në mjediset shkencore jashtë nesh a përtëj nesh.

Për më tepër kur flitet për një objekt studimi siç është “diskursi”, tashmë veçanti tipizuese *par excellence* e qenies njerëzore: “Që njeriu është një qenie e ligjërit, ja çka nuk reshtim së thëni qysh prej një kohe të gjatë; që ai të jetë një njeri i diskursit, ja kalimi në një tonalitet të ri i pohimit, rëndësia e të cilit është ende e pamundur të matet, por që prek gjithsesi diçka thelbësore” (Charaudeau dhe Maingueneau 2002, 12).

Referencat

- Ablali. D., Achard-Bayle G., Reboul-Touré S., Temmar M. (éds.) (2018), Présentation, në *Texte et discours en confrontation dans l'espace européen*, Peter Lang SA, Editions scientifiques internationales, Berne.
- Adam J.-M. (2011, 2014, 3e éds.), *Linguistique textuelle*, Armand Colin, Paris.
- Amossy R., Maingueneau D. (dir.) (2003), *L'analyse du discours dans les études littéraires*, Presses Universitaires du Mirail.
- Angermuller J.. (2013), *Analyse du discours poststructuraliste. Les voix du sujet dans le langage chez Lacan, Althusser, Foucault, Derrida et Sollers*, Limoges: Lambert Lucas.
- _____. (2007a), L'analyse du discours en Europe, në Simone Bonnafous et Malika Temmar (dir.) *L'analyse du discours en sciences humaines*, Paris, Ophrys.
- _____. (2007b), “L'analyse du discours en Allemagne et en France, Croisement nationaux et limites disciplinaires”, në *Langage et société*, 2007/2, n° 120, faqe 5-16.
- Boyer H. (2015), La mise en scène télévisuelle des “accents” et autres variations sociolinguistique: quelques observations en

- discours publicitaire, në *L'analyse de discours. Sa place dans les sciences du langage et de la communication. Hommage à Patrick Charaudeau*, sous la direction de Jean-Claude Soulages, Presses Universitaire de Rennes, page 87-95.
- Benveniste E. (1966), *Problèmes de linguistique générale, I*, collection Bibliothèque des Sciences humaines.
- Barthes R. (1966), Introduction à l'analyse structurale des récits, në *Communications* n°8.
- Boure R. (2005), Réflexions autour de l'institutionnalisation des disciplines, Sciences de l'information et de la communication versus économie?, në *Communication*, vol. 24/1, page 9-37.
- Boutet J. & Maingueneau D. (2005), Sociolinguistique et analyse de discours: façons de dire, façons de faire, në *Langage et Société*, 114 (4), page 15-47.
- Caillat D., Verine B. (dir.) (2024), *Manuel d'analyse du discours, Perspective contemporaines*, De Boeck Supérieur s.a.
- Charaudeau, P. (2015a) De la linguistique de la langue à la linguistique du discours, et retour, në Engwall, Gunnel E. & Fant, L. (eds). *Stockholm Studies in Romance Languages*, Stockholm University Press, page 3-12. (DOI:<http://dx.doi.org/10.16993/bac.a>.License:CC-BY).
- _____. (2015b), Le maelstrom de l'interdiscours, në *L'analyse de discours. Sa place dans les sciences du langage et de la communication. Hommage à Patrick Charaudeau*, sous la direction de Jean-Claude Soulages, Presses Universitaire de Rennes, page 125-138.
- _____. (1992), *Grammaire du sens et de l'expression*, Hachette Éducation.
- Charaudeau P., Maingueneau D. (dir.) (2002), *Dictionnaire d'analyse du discours*, Éditions du Seuil.
- Foucault F. (1969), *L'archéologie du savoir*, Gallimard.
- Garric N., Calas F. (2007), *Introduction à la pragmatique*, Hachette Supérieur, Paris.
- Grezka A., Leclère M., Temmar M. (2014), Introduction në *Les sciences du langage en Europe*, Actes du colloque 2011 de l'ASL – Association des Sciences du Langage, Lambert-Lucas.
- Harris Z.S., (1952) Discourse analysis: A sample text, në *Language*, 28 (4), page 474-494.

- Hjelmslev L. (1966), *Le langage*, Paris: Minuit.
- Halliday M. A. K., Hasan R. (1976), *Cohesion in English*, ed. Longman.
- Ismajli R. (1977, 1980), *Shumësia e tekstit*, Rilindja, Prishtinë.
- Lloshi Xh. (1999), *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, SHBLU.
- Maingueneau D. (2025), Introduction, në *Langue française*, L'analyse du discours, 226, juin 2025 (La composition de ce numéro a été confié à Dominique Maingueneau), Armand Colin.
- _____. (2014), *Discours et analyse du discours, Introduction*, Armand Colin.
- _____. (2004/2014), *Le discours littéraire, Paratopie et scène d'énonciation*, Armand Colin.
- _____. (2009a), *Les termes clés de l'analyse du discours*, Édition du Seuil.
- _____. (2009b), *Aborder la linguistique*, Edition du Seuil.
- _____. (2003), Ouverture, Un tournant dans les études littéraires, në R. Amossy, D. Maingueneau (dir.), *L'analyse du discours dans les études littéraires*, Presses Universitaires du Mirail, faqe 15-25.
- _____. (1988), Langue et Discours. La linguistique et son double, në *DRLAV/Documen DRLAV/Documentation et Recherche en Linguistique Alleman Vincennes/ Année 1988/39/*; Numéro thématique *L'usage des mots*, faqe 21-38 (edhe en ligne, Persée: https://www.persee-https://www.persee.doc.drlav_0754-9296_1988n de
- Mayaffre D., Vanni L. (2025), AD et IA: de la lexicométrie aux réseau de neurones, l'inquiétude méthodologique de l'Analyse du discours", në *Langue française*, 226, juin, 2025, *L'analyse du discours*, faqe 41-57.
- Meschonnic H. (1999), *Poétique du traduire*, Lagrasse, Verdier.
- Neveu F. (2017), *Lexique des notions linguistique*, Armand Colin, 3e édition.
- Paveau M.-A., Sarfati G. -E. (2011), *Les grandes théories de la linguistique, De la grammaire comparée à la pragmatique*, Armand Colin.

- Plangarica T. (2023a), *Prania/paprania e koncepteve dhe qasjeve teorike të shkencave të ligjërimit në programet universitare të studimit të diskursit letrar në gjuhën shqipe*, në Konferencën shkencore ndërkombëtare *Letërsia kombëtare në sistemin universitar*, organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Universitetin e Korçës “Fan Noli”, më 14 nëntor 2023.
- _____. (2023b), Prurjet në shkencat e ligjërimit në etapën e tanishme dhe kahet/disiplinat që meritojnë përkujdesje të veçantë në studimin e shqipes, botuar në *Studia Albanica* (organ i ASHSH-së, në anglisht), 2023/3-4.
- _____. (2021), Sërish mbi konceptet *ffali*, *periudhë*, *thënie*, *diskurs*, *tekst* në shkencat e ligjërimit, në *Aspekte të gjuhësisë së zbatuar*, 3, ASHSH dhe ASA, Tiranë.
- _____. (2018a), Variacioni gjuhësor si objekt shqyrtimi në shkencat e ligjërimit, Analiza e diskursit si bashkëplotësuese e shqyrtimeve në Sociolinguistikë, në *Aspekte të gjuhësisë së zbatuar*, 2, ASA, Tiranë.
- _____. (2018b), Mbi disa skaje gjuhësore në fushën e teorisë së të thënit, pragmatikës dhe gjuhësisë tekstore, në *Aspekte të gjuhësisë së zbatuar* 2, faqe 121-140.
- Portelance C. (1990), *Définition et potentiel de dénomination d'une nomenclature*, TTR, 3(1), 99-124.
<https://doi.org/10.7202/037061ar>.
- Rastier F. (2015), *Saussure au futur*, Editions Les Belles Letres, Collection “encre marine”.
- _____. (1995), Communication ou transmission?, në *Césure*, n° 8, faqe 151-195.
- _____. (1989), *Sens et textualité*, Paris, Hachette.
- Ricoeur P. (1986), *Du texte à l'action. Essais d'herméneutique*, II, Paris, Seuil, coll. “Esprit”.
- Saussure F de. (2002), *Ecrits de linguistique générale*, Paris, Gallimard.
- Soulages J. -C. (eds.) (2015), Préface në *L'analyse de discours. Sa place dans les sciences du langage et de la communication. Hommage à Patrick Charaudeau*” sous la direction de Jean-Claude Soulages), Presses Universitaire de Rennes.
- Termes et concepts pour l'analyse du discours, Une approche praxématique*, (2017), Nouvelle édition augmentée”,

Dictionnaire édité par Catherine Détrie, Paul Siblot, Bertrand Verine et Agnès Steuckard, Paris, Honoré Champion éditeur.

SUMMARY

Towards a Broader Space for Discourse Linguistics in Albanian Linguistic Thought

This study seeks to examine current developments within a particular line of inquiry in the sciences of language commonly referred to as *discourse linguistics* or *discourse analysis*. At the same time, it argues for the necessity of further deepening and consolidating discourse-oriented research within Albanian linguistic scholarship. Special attention is given to the epistemological conditions that enabled a departure from the structuralist conception of language as a closed, autonomous system, toward an understanding of language in use – that is, a shift from the analysis of language as a formal system of signs to the investigation of its realization in concrete discursive and communicative practices. This reorientation entails a methodological and theoretical focus on trans-sentential entities such as *text* and *discourse*.

The broad and complex range of issues associated with the concepts of text and discourse within this strand of linguistic thought – developed alongside, but distinct from, formal linguistics – is approached through a set of interrelated analytical perspectives. These include: the relatively delayed scholarly attention to discursive and communicative practices; the emergence of discourse linguistics as a distinct field within the sciences of language; the scientific and intellectual contexts in which its conceptual and methodological foundations were established; the analytical models developed across European and wider international traditions; the role of interdisciplinarity beyond the boundaries of linguistics proper; the research orientations that contributed to the cognitive and social institutionalisation of discourse analysis; the factors underlying the limited attention accorded to discursive phenomena; issues of terminology and conceptual labelling within discourse linguistics; and, finally, the conditions required for the cognitive and social institutionalisation of discourse linguistics within Albanian linguistic thought.

The study engages extensively with contributions from the Anglo-American tradition in Europe and the United States, particularly in the fields of discourse analysis and critical discourse analysis. These include approaches grounded in speech act theory, pragmatics, ethnomethodology, the ethnography of communication, and conversation analysis. It also examines key developments within the French tradition of discourse linguistics – especially discourse analysis, text linguistics, and textual semantics – situated within broader theoretical frameworks such as enunciation theory, integrated pragmatics, and semiotics. In addition, attention is given to the German tradition, where discourse analysis has evolved in close interaction with text linguistics and the social sciences. Taken together, these traditions demonstrate that discourse linguistics is an inherently heterogeneous field, characterised by a plurality of

theoretical models yet unified by a shared orientation: the analysis of language as social practice and as a means of constructing reality.

The study further addresses issues directly related to the incorporation of these theoretical perspectives into Albanian linguistic scholarship, particularly questions of terminology concerning key concepts in discourse linguistics, including the notion of *discourse* itself, speech acts (locutionary, illocutionary, and perlocutionary), and the speaking subject. Special emphasis is placed on identifying indicators that may facilitate the cognitive and social institutionalisation of discourse linguistics in Albania. While acknowledging the substantial achievements of formal linguistics in the analysis of the Albanian language system, the study notes a relative lack of sustained engagement with discourse-oriented research. It ultimately concludes that, without a more systematic and well-developed body of work in discourse linguistics, Albanian linguistic thought risks remaining structurally and conceptually incomplete.

Evalda Paci

**Elemente të biografisë dhe të autobiografisë
në përpilime të autorëve të letërsisë romake
(vështrim mbi shqipërimi e përshtatje)**

Përmbledhje

Në studimet letrare të kohëve të fundit vërehet sërish një vëmendje e qartë ndaj veprave që përmbajnë elemente biografie dhe autobiografie, duke bërë të mundur dhe të rishtrohen pikëpamje mbi profilizimin e një prirjeje të qartë zhanrore, për fillimet e së cilës jepen mendime jo përherë të njëjta. Bie në sy nënvizimi i vlerave të elementeve biografike në autorë të letërsisë antike, greke dhe romake, por dhe të asaj latine të krishterë, që gjen një reflektim të qartë me “Rrëfimet” (Confessionum libri XIII) e Shën Agostinit, një autor i bërë i njohur për disa vepra të rëndësishme në historinë e krishtërit, veçanërisht për pasqyrimin e meditimeve personale në rrugën e tij drejt besimit të krishterë. Autorë të shumtë janë bërë pjesë e trajtesave mbi letërsinë biografike dhe atë autobiografike, duke bërë të mundur dhe parashtrimin e qasjeve përafruese mes tyre, në veçanti nëse kanë jetuar në periudha të ndryshme, por në të njëjtën kohë bëjnë të mundur të gjurmohen dhe elemente të ngjashme në motive dhe subjekte. Në këtë trajtesë tonën kemi veçuar disa autorë të letërsisë romake, një pjesë e të cilëve qartësisht janë dhe përfaqësues të latinitetit klasik, në disa vështirime, edhe të përfitimeve gjuhësore, edhe të modeleve letrare në të cilët janë ushtruar. Në pikëpamje të shembujve përkatës, janë ilustruar dhe pjesë nga shqipërimet e klasikëve latinë në gjuhën shqipe, duke pasur si referencë përkthimet e Henrik Lacajt (1909-1991), njohës i thelluar i letërsisë latine dhe në veçanti i periudhës klasike dhe perandorake.

Fjalë kyçe: *letërsi biografike, letërsia antike, studime letrare, motiv autobiografik.*

Letërsia biografike dhe vështrimet përkatëse mbi elemente të autobiografisë në autorë e vepra përbën një linjë qenësore në prirjet e studimeve letrare të kohëve të fundit, duke u pasqyruar dhe në botime tematike që kanë lidhje me këtë të fundit e karakterizohen dhe në qasje kryesisht

diakronike, që marrin shtysë që në gjurmët më të hershme të shfaqjes së saj, në vepra të shkrimtarëve të një tradite të lashtë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por dhe në modelet e shkrimtarisë së tyre, duke qenë ata vetë përrues përpilimesh metrike dhe letrare të një veçanësie unike. Duke qenë e trajtuar dhe në vështrim tipologjik e konstitutiv, rreth letërsisë antike greke gjurmohen prurje të shumta që dëshmojnë interesin e gjallë ndaj saj, duke qenë kjo e fundit e pasur në subjekte dhe personazhe që ngjallin shtysa për vështrime të natyrës antropologjike dhe kritike.¹ Jo më pak e pasur paraqitet dhe ajo latine, e përvijuar në pikëpamje të historikut përkatës në shekuj të hershëm, në të cilat evolucioni i vetë gjuhës në të cilën do të shkruhet kjo letërsi shënohet dhe nga dëshmimi në tipare shkrimore që lidhen natyrshëm me praninë e kulturës greke në Gadishullin Italik.²

Ndërkohë, autorë të latinitetit e të romanitetit në kuptimin e mirëfilltë të fjalës ofrojnë dhe pas kaq shekujsh elemente të gjurmimit të momenteve jetësore domethënëse për vetë shkrimtarët e më tej, për hulumtuesit që në biografinë e tyre, në një masë të konsiderueshme dhe në vargje e modele të vargëzimit do të mund të kërkojnë e të interpretojnë zanafillën e dukurive letrare dhe jashtëletrare. Në një traditë të njohur të përgatitjes së botimeve ekdotike mbi veprat në prozë të autorëve që kanë shënuar zhvillime të letërsisë së shkruar në tekste të natyrës epistolare, kryqëzimi dhe nënvizimi i rëndësisë së momenteve jetësore të tyre dhe të bashkëkohësve është pjesë e aparatit kritik që i shoqëron botimet cilësore mbi to, duke u paraqitur dhe si panoramizime sinoptike mbi ndryshime politike, mbi çaste decizive në jetën e perandorëve romakë, të cilët paraprihen fuqimisht nga bëmat dhe aktet e pararendësve të tyre, gjurmët e të cilëve gjithashtu mbeten në trajtesa biografike të transmetuara në gjenerata dhe në të gjitha format e mundshme të ruajtjes së veprës së shkruar.³

Receptimi i vlerave dhe i elementeve të përmbajtjes së veprave të letërsisë latine, jo rrallë në studimet tona të emërtuar dhe me cilësimin “romake” ka qenë i reflektuar ndjeshëm në rasë të autorëve të dërguar në mërgim, një pjesë e mirë e të cilëve kanë luajtur role shoqërore të një rëndësie të veçantë, duke qenë oratorë, senatorë, avokatë, përpilues tekstesh historiografike, përshkrues itinerarësh kulturore, por dhe shkruar biografish, siç paraqitet ndër të tjera dhe

¹ Shih në veçanti dhe A.Fusi, *I modelli classici*, në *L'Epistolografia di antico regime*, Edizioni di Archilet, 2019, f.37-38.

² Shih në veçanti dhe kreun me titull “*Un nuovo genere letterario*”, të studiueses Ch.Mohrmann, në Agostino d'Ippona, *Le confessioni*, Biblioteca Universale Rizzoli, Milano, 1994, f.21-30.

³ Shih në veçanti kapitullin sintetik me titull “*Cronologia della vita e i tempi di Seneca*”, në Seneca, *Lettere a Lucilio, volume primo*, Biblioteca Universale Rizzoli, Milano, 2004, f.12-49.

vepra e mirënjohur e Svetonit mbi jetët e perandorëve, referenciale jo vetëm në gjurmime letrare dhe filologjike, por dhe në rindërtime të profileve historike të kohës.⁴

Formimi i veçantë i autorëve me të cilët periudha të tëra përfaqësohen në pikëpamje të lëvrimit e të pasurimit të gjuhës e të modeleve të shkrimtarisë përkatëse është vënë në dukje nga kritika dhe studimet e thelluara mbi historinë e letërsisë latine, e karakterizuar nga një panoramë e pasur në indice sa i përket jetëshkrimit të shkrimtarëve, rrugëtimit të gërshetuar me rrethana të përveçme (rasti i Ciceronit, por dhe i Ovidit), por dhe të lidhura me ndryshime të rëndësishme në vetë regjimin shtetëror dhe shoqëror të Romës antike, siç dhe ilustron në një sërë studimesh dhe vëllimesh tematike mbi poetë të mërgimit apo të exilit, gjithësesi të lidhur me fatin e vendit të tyre dhe në vendndodhje të largëta e të detyruara. Interpretimi i teksteve të autorëve të kësaj letërsie, një pjesë e të cilëve të mbiquajtur dhe në korrelacion me momentet historike në të cilat dhe profilizohet prirja e tyre në të quajturin “ars scribendi”, vijon të jetë objekt i punimeve doktorale dhe i tezave të magistraturës, duke u bërë e mundur të ndërthuren vështirime ndërdisiplinore të arrira, por njëherësh dhe të nënvizohet përkatësia e tyre në letërsinë biografike dhe autobiografike.

Me një tematikë të orientuar nga elemente të biografisë dhe të autobiografisë ndërliiden natyrshëm jetëshkrimet e autorëve të shekullit të parë para lindjes së Krishtit, të gjurmueshme në elementet qenësore të tyre në vetë pasazhet nga veprat më përfaqësuese të tyre, të paracaktuara të mbijetojnë në shekuj për vetë specifikën dhe korrelacionin me regjimet në të cilat këto të fundit u ngjizën dhe më tej, u përpunuan gjerësisht prej vetë autorëve të tyre. Janë vetë titujt e veprave që bëjnë të mundur të nënkuptohet çfarë është shkruar në brendi për lexuesin, por dhe për destinatarët kryesorë të tyre, që në raste të veçanta janë vetë iniciatorët e një historie të përveçme në rrugëtimin jetësor të autorit.

Në rastin e Ovidit kemi të bëjmë me një itinerar kompleks që rrëfëhet nga vetë autori, gjithashtu burim interpretimesh që mëtojnë zbërthimin e nëntekstit të vargjeve të tij, duke sjellë më afër një kuadër gjeokulturor në të cilin ngërthehet *realja- e panjohura-e papritura- e pamundura*.

Janë pak a shumë ato rrethana që nënvizohen dhe kur Jul Cezari me çdo kusht, pavarësisht kushteve atmosferike dhe pengesave që krijohen në stinë të vështira për t’u praktikuar lundrimi, kërkon të sjellë në brigjet ilirike trupa ushtarake me të cilat do të fillonte mësymjen ndaj fortesave në të cilat Pompeu ishte stabilizuar më herët.⁵

⁴ Shih në veçanti Svetonio, *Vite dei Cesari, tradotte da Giuseppe Rigutini, introduzione di Concetto Marchesi*, Le Monnier, Firenze, 1969.

⁵ Shih dhe kapitullin me titull *Durazzo e Farsalo* në monografinë me titull “*Giulio Cesare*”, me autor J.Carcopino, Tascabili Bompiani, Milano, 2000, f.440 v.

Megjithatë, kemi të bëjmë me raste të ndryshme në pikëpamje të qasjes së personazheve kryesore ndaj këtyre faktorëve: Ovidi njoftohet që duhet të largohet nga Roma menjëherë, me gjithë stinën e pafavorshme për të udhëtuar; Cezari po kërkon të paraprijë në kohë sulmet ndaj kundërshtarit të vet politik duke qenë se ky i fundit natyrisht nuk parashikon se trupat e rivalit do t'u afrohen postblloqeve të tij në këtë segment kohor.

Emri i autorëve të caktuar lidhet me atë të tiranit që ka qenë sundimtar në kohën në të cilën këta të fundit kanë qenë të tillë, dhe ndër shembujt që shërbejnë dhe si modele për t'u cilësuar, pikërisht dhe veçanërisht ai i Ovidit, shkrimtarit që shënoi një fazë të rëndësishme të shkrimtarisë së tij në vise të largëta e që shkaktonin dhe ndjesinë e të panjohurës për romakët, mbetet domethënës dhe me elemente të gjenezës së një sërë veprash që e karakterizojnë dhe profilin e tij.

Peripecitë e Ovidit, poetit të paralajmëruar nga një edikt i Oktavianit janë të shumta dhe vetëm disa prej tyre janë të kushtëzuara nga periudha kohore në të cilën ky edikt arrin në duart e tij, duke u paraqitur si i parevokueshëm dhe i ekzekutueshëm në një kohë të ngutshme. Janë dy veprat kryesore në të cilat mund të gjurmohet një rrjet i pasur të dhënash mbi përjetimet e autorit rreth fatit të tij, të cilat interpretohen dhe riinterpretohen nga studimet mbi periudhën e Augustit, por dhe në ato që lidhen me elemente të qytetërimit romak të asaj kohe.⁶ Në përpjekjet për të konkretizuar momentet në të cilat aktualizohet rrugëtimi i detyruar i Ovidit do të mund të gjurmohet dhe ngulmimi për t'i

⁶ I lindur në vitin 43 para lindjes së Krishtit në Sulmona, Ovidi është bërë i njohur për momentet e përfshirjes së tij në qerthujt kulturorë më të rafinuar në kohën e Augustit, duke qenë se ishte dhe pjesë e oborrit të tij e ndërkohë mbulonte dhe detyrën e magistratit romak. Arsimimi i tij mbart qartë gjurmë të formimit me kulturën greke dhe si rezultat arriti dhe të kompozojë një tragjedi me titull "Medea", për të cilën dhe mori vlerësime që në kohën e realizimit të saj. Krijimtaria e tij e gjerë numëron jo pak vepra, ndër të cilat përmenden shpesh e për arsye referimi në motive e topose dhe "Metamorfozat", një vepër poetike e ndarë në 16 libra, por ndërkohë, evokimi i një momenti kritik në jetën e tij, pikërisht në vitin 8 pas lindjes së Krishtit orienton studiuesit e biografisë së tij ndaj një ndarjeje të diktuar nga kthesa që merr jeta e tij e për më tepër dhe vijimësia e shkrimtarisë së tij në vende të largëta. Në kohën kur Ovidi i mbërrin edikti i Augustit për t'u larguar sa më shpejt nga Roma, ai kishte në proces një vepër të njohur, me titull "Fasti", të cilën e ndërpret në librin e gjashtë për të vijuar me një udhëtim të detyruar drejt Tomit (Kostanca e sotme). Edhe në proces të këtij udhëtimi, Ovidi i dedikohet krijimtarisë letrare, siç dhe mund të ilustron me poemthin me titull "Ibis", dhe me dy librat e parë të veprës me titull "Tristia", të cilën e vazhdon dhe mbas vendosjes në Tomi. Krijimtaria e Ovidit në këtë periudhë finale të jetës së tij dallohet për nota të thella elegjiake, të diktuar nga vetë kthesa që merr rrugëtimi i tij jetësor, por mbetet dhe karakterizuese e një modeli gjinor pak më të ndryshëm nga ato të përdorura më parë prej tij.

dhënë sa më të sakta kufijtë kohorë të mobilitetit të tij, i përshkueshëm në trajektore të përcaktuara e të kushtëzuara qoftë nga pikëmbërritja e largët (destinacioni final mbetet Tomi), qoftë nga rrjeti i rrugëve, qoftë nga stina që lidhet me kohën më të vështirë për të realizuar udhëtimet në det. Rastet e përpilimit të veprave të përveçme dhe të lëvrimit të shkrimtarisë në rrethana të mërgimit janë trajtuar si shfaqje dukurish që lidhen me reflektimin e përjetimeve të vetë autorëve që janë gjendur në vorbull ngjarjesh për të cilat vijojnë të jenë të përmendur e të bërë objekt studimi. Analizat që janë përpiluar në pikëpamje të shqyrtimit të përballjes së autorit augustian me idenë e një habitati të panjohur e me gjasë jomikpritës për të marrin në referim më së pari veprën “*Tristia*”, e cila do të pasohet më tej me atë me titull “*Epistulae ex Ponto*”, dhe kjo e fundit mjaft e trajtuar dhe e interpretuar në disa vështirime, me përparësi nënvizimin e elementit autobiografik që shfaqet që në vargjet më të para të saj.

Mund të vërehet që analizimi i vargjeve në të cilat gjendja shpirtërore e poetit paraqitet mjaft e rënduar shoqërohet në çdo rasë të trajtesave tekstore me një numër të konsiderueshëm shënimesh, që janë dhe një bazë e qëndrueshme interpretative e brendisë së tij.

Vargjet nga “*Tristia*” kanë gëzuar përherë një vëmendje diskrete, por dhe në rasë të shqipërimit që realizohet nga Henrik Lacaj (1909-1991) ofron mundësinë për të ndërtuar krahasime mes varianteve të disponueshme në gjuhën latine dhe atij në gjuhën tonë, me disa dallime që burojnë nga vetë natyra e ndërtimeve të kësaj të fundit.⁷

Ndër kërkimet disavjeçare në materialet që ruhen në një gjendje të mirë në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, shqipërimet e Henrik Lacajt, të sistemuara në format dorëshkrimi dhe në fletë të daktilografuara, konkretisht ato të epigramave të Marcialit ishin motivuese dhe për renditjen e teksteve përkatëse në gjurmime elementesh që shpien natyrshëm në marrëdhëniet e autorit romak me të afërmin, me personazhe të cilësuar përmes emrash të përveçëm, me karakteristikat e secilit, të perifrazuara në vargjet që e ndërtojnë krijimtarinë e tij. Pa dyshim që për vetë përdorimet e elementeve tipike në paradigmën emërore dhe foljore, autori reflekton emocione të vetat dhe ndjesi të shkaktuara nga njohja a mosnjohja e shkrimtarisë së vet nga bashkëkohësit, së cilës dhe i referohet jo pak herë në epigramet e tij. Në disa variante botimi të konsultuara kohët e fundit, pikërisht ato me një strukturë të parashikuar të përmbanin përballë njëri-tjetrit tekstin latin dhe atë gjegjës në gjuhën italiane, janë dhe një instrument i domosdoshëm për të kuptuar më qartë dhe më bindshëm referimin e

⁷ Nga elegjitë, *Nata e fundit në Romë, në Poetë latinë (vargje të zgjedhura)*, i përkthetur nga origjinali H.Lacaj, Tiranë, 1978, f.189-199.

sipërcituar të autorit për vargjet e tij, të cilësuar në gjuhën origjinare me terma specifike.

Dy prej epigrameve më të njohura të Marcialit, që në gjuhën shqipe i kemi brendësuar falë shqipërimit virtuoze të latinistit Henrik Lacaj janë dhe ato drejtuar një plagjiatori, siç cilësohet në titujt *ad hoc* me të cilin vargjet përkatëse introduktohen në botimin e Epigrameve (Epigrammata) në vitin 1842:

Janë dy epigrame të ndryshme në të cilat bëhet fjalë për të njëjtin person, emri i të cilit përmendet dhe në incipitin e tekstit:

XXX: Ad Fidentinum plagiarium/ (it. A Fidentino plagiaro)

*Fama refert nostros te, Fidentine, libellos/ Non aliter populo quam recitare tuos./ Si mea vis dici, gratis tibi carmina mittam;/ Si dici tua vis ; haec eme, ne mea sint.*⁸

Dhe më tej, në një tekst të ngjashëm, por më të thukët, sërish autori i drejtohet të njëjtit personazh:

*In Fidentinum Plagiarium (it. Contro Fidentino plagiaro)*⁹

*Quem recitas, meus est, o Fidentine, libellus; Sed male cum recitas, incipit esse tuus.*¹⁰

Qëmtimi i elementeve të biografisë dhe të autobiografisë të Marciali në veçanti dëshmon dhe larminë e gjurmimit të prirjeve për të ngulitur dukuri e përjetime dhe me anë të një tipologjie tjetër të të krijuarit, që natyrshëm dhe në ditët e sotme lidhet me këtë autor që aktualizon rrugëtimin e tij jetësor në një tjetër fazë të shtjellimit të historisë së Romës, me gjasë në një kohë në të cilën për të metat karakteriale, por dhe për plagë të shoqërisë mund të flitet dhe duke vënë në përdorim forma të tjera të vargëzimit, tipike për arsye të koncizitetit dhe lidhjes që krijojnë mes njëri-tjetrit kur bëhet fjalë për një autor si ai.

⁸ *Epigrammatum liber I; XXX, botim i cituar, f. 107-108.* Përkthimi në italisht nga P. Magenta, Venezia, 1842: È voce, Fidentin, che i versi miei/ spacci per tuoi : se miei tu dirli vuoi / Ten' farò don ; ma se vuoi dirli tuoi,/ Acciò più miei non sian, comprarli dei. (në shqipërimin e H. Lacës, variant në dorëshkrim i konsultuar në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë: *Po thonë o Fidentin, se në publik/ ti merr edhe lexon vjerrshat e mija/ dhe thue se janë të tuat./ Ti po deshe të mbetem unë auktori, t'i jap falas;/ po deshe që të thuhet se janë t' tuat, at-herë m'i blej, kështu s' janë ma të mijat.*

⁹ *Epigrammatum liber I; XXXIX, botim i cituar, f. 112.*

¹⁰ Përkthimi në italisht: I versi che tu reciti/ Son miei ; ma quando poi,/ Fidentin, mal li reciti,/ Allor divengon tuoi.

Në të vërtetë, te secili prej autorëve latinë që mund të merret në analizë dhe në vështrim të reflektimit të elementeve të formimit, të prirjeve në të shkruar, por dhe në vetë nënvizimin e nevojës për të qenë të njohur e të lexuar, gjurmohen elemente të veçanta që dhe në përkthimet me të cilat këta të fundit janë rijetësuar, kanë mbetur të gjalla në vetë konotacionin që bartin, kjo falë vetë gjuhëve në të cilat njohësit e gjuhës latine kanë bërë përpjekje të përkthejnë e t'i përjetësojnë krijimet e këtyre të fundit.

Marciali mbetet një autor që referon konkretisht për vargjet e tij, në më se një pasazh të përpilimeve të tij karakteristike për strofat dhe vetë tipologjinë në të cilën përfshihet tradicionalisht. Është i njohur në traditën studimore përkatëse një fragment nga Epigramet e tij, në të cilin dhe receptimi i zërave të veçantë orienton në njohjen e prirjeve të tij si autor dhe shkrimtar. Edhe në këtë rasë u referohemi të njëjtave vargje në shqipërimin e latinistit Henrik Lacaj, që këtë sekuencë epigramatike e ka bërë pjesë të punës së tij serioze me tekset latine në vargje.

Në një fragment të tillë parashikimi për përkohshmërinë dhe brishtësinë e gjërave të caktuara në jetë është më se i qartë, ndërkohë që gjithnjë autori shprehet me një siguri të lexueshme për jetëgjatësinë e përpilimeve të veta, duke i emërtuar me termin përkatës "libelli": *Quinque satis fuerant: nam sex septemve libelli est nimium: quid adhuc ludere, Musa, iuvat?/ Sit pudor et finis: iam plus nihil addere nobis Fama potest: teritur noster ubique liber/ et cum rupta situ Messalae saxa iacebunt/¹¹ altaque Licini marmora pulvis erunt/ me tamen ora legent/ et secum plurimum hospes ad patrias sedes carmina nostra feret.*

Te Marciali në veçanti gjinden të ndërthurura vargje që pasqyrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dëshirën e autorit për t'u shprehur për krijimet e tij, ndërkohë që përqsjet me të tjera personazhe, emri i të cilëve mund të shfaqet më se një herë në epigramet e tij mbartin dhe nota të qarta ironie, që dhe shënimet kritike me të cilat pajisen botimet përkatëse i nënvizojnë jo rrallë. Numri i epigrameve të Marcialit është i konsiderueshëm dhe për më tepër, referimi ndaj individualiteteve të kohës së tij bën të mundur që dhe kritikët e studiuesit e veprës të marrin në konsideratë koherencën e fakteve që përmbahen në vargjet e tij, jo gjithnjë koncize sa i përket numrit, por të përshkuara nga një realizëm therës, në veçanti nëse objekt bëhen shitësit e skllevërve, keqtrajtuesit e kësaj kategorie shoqërore që përfaqësohej dhe në gjuhën latine me emërtime e përveçime përkatëse.¹²

¹¹ Bëhet fjalë për një prej përkrahësve të Tibulit, poetit elegjiak të kohës së Augustit;

¹² Epigrammatum liber X: XXXI: IN CALLIODORUM. Addixti servum nummis here mille trecentis, ut bene coenares, Calliodore, semel; Nec bene coenasti : nullus tibi quatuor emptus Librarum coenae pompa caputque fuit. Exclamare libet : non est hic, improbe, non est piscis; homo est: hominem, Calliodore, voras.

Por dhe më tej, duke dashur të marrim në konsideratë dhe autorë të tjerë që me përpilimet e tyre dëshmojnë për prani të qasjeve biografike dhe autobiografike në letërsi, pa dyshim që dhe epistolografia, aq më tepër e lëvruar për arsye të të gjendurit në exil të autorëve që e konsiderojnë si mjeshtëri më vete, ka një vend të padiskutueshëm dhe për më tepër, gëzon një hapësirë jo të vogël në manuale, antologji, tekste studimore mbi letërsinë latine.

Qasjet studimore ndaj gjenezës së epistolografisë dhe adaptimit përkatës në autorë e vepra përbëjnë një tjetër linjë trajtesash që sigurisht bën të mundur të shihen dhe ndikime të ndërsjella në këta të fundit: Ovidi e Horaci, p.sh., por dhe të tjerë shkrimtarë që përvijojnë dhe profilin e tyre përmes kësaj gjinie të të shkruarit. Konsiderimi i kësaj të fundit në pikëpamje modeli, por dhe vetë ngërthimit në tekst të detajeve e hollësive që kanë të bëjnë me personalitetin e atij që shkruan ngjall një interes të veçantë kur flitet për Ciceronin, autori që i beson kësaj shtjelle shkrimtarie fragmente jete e momente të vështira për të cilat vijon të studiohet e interpretohet.

Autorët latinë janë ushtruar natyrisht dhe në lëmë të epistolografisë e në këtë vështrim referimi ndaj Ciceronit, të njohur ndryshe dhe si “autori arpinat” ndeshet në shumë studime që i kushtohen lindjes dhe më tej zhvillimit të këtij modeli që njih jo pak pamje e dimensione dhe kur vështrohet në qasje tipike të natyrës ndërdisiplinore.

Pikërisht për një reflektim tipik të afektivitetit dhe marrëdhënieve me të afërmin merret si shembull në antologji, studime mbi historinë e letërsisë dhe atë të poezisë latine krijimi *ad hoc* i Katulit me rasë të ndarjes nga jeta të të vëllait, fatin e të cilit ky i fundit e vajton trishtueshëm në një sekuencë vargësh monumentale që mbeten të pashlyera në kujtesën e studiuesve të botës së latinitetit dhe leksikut specialistik që lidhet me këtë kategori të të shprehurit. Në botime të natyrës antologjike që mëtojnë t’i përfshijnë në masë të konsiderueshme autorët latinë të shekullit të parë para lindjes së Krishtit, udhëtimi i gjatë i Katulit për të arritur në vendprehen e të vëllait dallohet me shënime e shpjegime që përveçse nënvizojnë veçanësinë semantike të disa përdorimeve në tekst, shërbejnë dhe për të bërë dallimin mes këtij të fundit dhe krijimeve të tjera po aq të njohura, por që pasqyrojnë të tjera aspekte të personalitetit të autorit.¹³

Janë qartësisht të larmishme tekstet biografike kur flitet për autorë që iniciuan rrugëtimin e tyre jetësor në përmbyllje apo kapërcyell periudhash të rëndësishme për historinë e Romës. Një rast po aq i përveçëm mbetet dhe ai i epistulave të Senekës, një autor i bërë gjerësisht objekt trajtimi e interpretimi dhe për arsye të ngërthimit të momenteve jetësore me zhvillime politike të një rëndësie të veçantë në historinë e Romës. Një rast më se kompleks ai i këtij

¹³ Catullo, *La morte del fratello, Gli affetti familiari; në Leggere oggi gli autori latini*, Loescher editore, Torino, 2005, f. 168-169.

autori, që e gjen veten të përfshirë në jo pak konflikte dhe mosmarrëveshje, por që gjithashtu merr përsipër dhe të përpilojë korpusë të tëra tekstesh epistolare, në të cilat shfaqet qartë në rolin e një preceptor, siç dhe ndodhte krejt natyrshëm mes një mjeshtri dhe dishepullit të vet.

Seneka ndër të tjera mbetet edhe një pikë referenciale sa i përket lëvrimin tipik të epistolografisë e ndërkaq edhe krahasimeve të mundshme me një pararendës, siç është me të drejtë Ciceroni, i gjendur në rrethana jetësore që reflektohen në letrat e tij drejtuar miqve e të afërmeve të vet.¹⁴ Në vetvete, epistolografia është dhe një orientim për të gjurmuar elemente të letërsisë biografike e asaj autobiografike, duke qenë e ekspozuar në çështje të ndërftjes së hollësive ndërtimore dhe estetike tipike të saj, por dhe të ndryshueshme në varësi të periudhave.

Është pikërisht epistolografia që dhe në këmbimet mes njerëzve të dijes e të kulturës në shekuj të mëhershëm, sërish ndihmon të zbardhen çështje të nevojës për t'i botuar klasikët e botës antike greke dhe romake në formatet e duhura, ato të natyrës filologjike dhe kritike.

Nuk mungojnë as në kohët e fundit trajtesat që argumentojnë domosdoshmërinë e konsiderimit në rang gjinie të letërsisë biografike, duke vënë në dukje dhe përvijimin e saj në periudha të ndryshme, ndër të cilat pikërisht shfaqjet në letërsinë antike greke dhe shenjat e para të këmbimit epistolar që dëshmojnë në to kanë gëzuar një vëmendje të përsëritur. Reflektimi në letërsinë latine dhe veçanësisht që diktohen nga personaliteti i çdo autori e bëjnë dhe më komplekse panoramën që përfshin vepra, modele të përveçme të të krijuarit, por dhe autorë që janë bërë të njohur pikërisht për arsye të identifikimit të individualitetit krijues përmes këtyre të fundit. Edhe vetë përgjithësimi i biografizmit në veprat e kësaj letërsie kërkon t'i qasemi në një rrugëtim diakronik ecurisë së krijimtarisë së disa autorëve, të cilët kanë pasuruar një zhanër të tillë me veprat e tyre, si dhe vetë historinë e letërsisë e të gjuhës latine, një prej gjuhëve më të studiuara dhe në pikëpamje të veçorive autoriale që vihen në dukje sidomos kur studiohen me hollësi periudha dhe zhvillimet që i karakterizojnë ato. Në mjaft studime në të cilat gjurmohet dhe ecuria në një linjë të mirëfilltë modelesh e shkrimtarie e kësaj letërsie reflektohen dhe vlerësime mbi shkrimet e Shën Agostinit (354-430 pas lindjes së Krishtit), ipeshkvit të Ipponës, i cili lë gjurmët e një ecjeje të thellë individuale në veprën me titull "*Confessiones*", duke u bërë që të cilësohet dhe si përpiluesi i një modeli unik të rrëfimit autobiografik, që është bërë i njohur në variante të përkthyer në shumë gjuhë.¹⁵

¹⁴ M. Tullius Cicero, *Epistulae ad familiares*, Cambridge University Press, 1977.

¹⁵ Ch. Mohrmann, në Agostino d'Ippona, *Le confessioni (la via interiore per arrivare a Dio)*, Biblioteca Universale Rizzoli, Milano, 1994, f. 30.

Vështrimi tërësor dhe kontekstualizimi përkatës në rasë të individualizimit të veçorive të të shkruarit të secilit prej autorëve të letërsisë romake paraqitet kompleks duke marrë në konsideratë trajtesat që vitet e fundit kanë marrë një përpjesëtim të shtuar, duke pasur parasysh dhe interpretimet që nënvizojnë dhe momente jetësore tipike për autorë të caktuar. Aq më tepër, kur bëhet fjalë për tipare të të shkruarit që lidhen me vetë elementet referenciale në biografi dhe autobiografi, shqipërimet që disponojmë e që evokojnë dhe kontribute të mëhershme në fushë të përkthimitarisë, marrin një vlerë të shtuar.

Bibliografi

- Castellana, Riccardo. *Finzioni biografiche. Teoria e storia di un genere ibrido*. Roma: Carocci, 2019.
- Castellana Riccardo. *Biografia e autobiografia (scritture di vita dall'antichità a oggi)*. Roma: Carocci, 2025.
- Carcopino Jérôme. *Giulio Cesare*. Milano: Tascabili Bompiani, 2000.
- Catullo Marco Valerio. *Gli affetti familiari*. Në *Leggere oggi gli autori latini*. Torino: Loescher editore, 2005.
- Finelli Francesco. “Biografia latina: note di genere letterario”. *Historias fingidas*, numero speciale 2, 2023.
- Fusi Alessandro. *I modelli classici*. Në *L'Epistolografia di antico regime*. Edizioni di Archilet, MMXIX.
- D'Ippona Agostino. *Le confessioni (la via interiore per arrivare a Dio)*. Milano: Biblioteca Universale Rizzoli, 1994.
- Marziale M.Valerio. *Gli epigrammi, con traduzione e note del cav. P.Magenta*. Venezia: Tipografia di G.Antonelli, 1842.
- Marciali. *Epigrame, i përkthet nga origjinali H.Lacaj*. Tiranë, 1979.
- Martialis M.Valerius. *Epigrammata*. Post V. Heraeum D.R. Shackleton Bailey, Editio stereotyopa editionis primae (MCMXC), Monachii et Lipsiae, MMVI.
- M. Tullius Cicero. *Epistulae ad familiares*. Cambridge University Press, 1977.
- Momigliano Arnaldo. *Lo sviluppo della biografia greca*. Torino: Einaudi editore, 1974.
- Orazio. *Le satire (con testo a fronte)*. Milano: Garzanti, 1976.
- Ovidi. Në *Poetë latinë (vargje të zgjedhura), i përkthet nga origjinali H.Lacaj*. Tiranë, 1978.

Ovidio. *Epistulae ex Ponto* (Lettere dal Ponto), (a cura di L. Galasso), Mondadori, Milano, 2023.

Svetonio. *Vite dei Cesari, tradotte da Giuseppe Rigutini, introduzione di C. Marchesi*. Firenze: Le Monnier, 1969.

Ruiz Urbón Cristina. "La configuración del autor literario a lo largo de la historia". Siglo XXI. *Literatura y Cultura Españolas*, n.29, 2022.

SUMMARY

Elements of Biography and Autobiography in the Works of Roman Literature Authors (a view on translations and adaptations)

In recent literary studies, renewed attention has been directed toward works that contain elements of biography and autobiography, making it possible to reconsider perspectives on the shaping of a clear generic tendency, whose beginnings are not always interpreted in the same way. Particularly noteworthy is the emphasis on the value of biographical elements in authors of ancient literature, both Greek and Roman, as well as in Christian Latin literature, which finds a clear reflection in *The Confessions* (*Confessionum libri XIII*) of Saint Augustine, an author renowned for several important works in the history of Christianity, especially for the portrayal of his personal meditations on the path toward Christian faith. Numerous authors have become part of discussions on biographical and autobiographical literature, allowing for the presentation of comparative approaches among them, especially when they lived in different periods, while at the same time enabling the tracing of similar elements in motifs and subjects.

In certain authors, the biographical element clearly becomes a central motive of their creative work, as well as a criterion for the selection of the literary model to be followed. Texts with elegiac notes, at the same time conveyors of a typical formation such as that of the neoterics, became well known as they were transmitted from tradition to tradition, thus becoming merged/unified whenever the author's name was mentioned. Catullus sings to his deceased brother who, moreover, rests in distant lands; in order to reach his place of burial, the poet must undertake a long journey, crossing seas and vast distances. His sentences have become proverbial and represent, as an incipit, one of the most renowned creations in Roman literature of his time.

In this study, we have highlighted several authors of Roman literature, some of whom are clearly representatives of classical Latinity, both in terms of

linguistic achievements and in the literary models they practiced. Regarding specific examples, passages from Albanian translations of Latin classics are illustrated, with reference to the translations of Henrik Lacaj (1909–1991), a profound connoisseur of Latin literature, particularly of the classical and imperial periods.

Rafaela Marteta

Shkrimet për burgun politik: Trajtat e një teme të re letrare në paskomunizëm

Përmbledhje

Ndër të gjitha përvojat nën komunizëm, përvojat e burgut kishin krijuar te njerëzit që e kishin përjetuar një gjendje njerëzore krejt të veçantë e të dallueshme. Të dhënit zë historive të burgut kthehet në shërbim për të dëshmuar të padukshmen dhe të pazëshmen. Në mungesë të një angazhimi domethënës institucional, letërsia u kthye në një kanal komunikimi alternativ për dëshmitë e lidhura me burgun politik.

Kur përballja me kujtesën dhe kujtimet për burgun bëhen në vetë të parë, rrëfimi, cilado qoftë forma me të cilën përcillet, merr vlerë tjetër për shkak të gjurmës së fortë vetjake, në mos autobiografike, që e dallon nga moria e kumteve të tjera. Ndryshe nga mesazhet e prodhuara institucionalisht – me një shkallë vështirësie në interpretim e njëfarë distance në komunikim – komunikimi individual ndodh në vetë të parë. Qoftë edhe për këtë element kthehet si kundërprovë përballë mesazhit institucional kur ky i fundit rezulton i rremë apo shpërfillet me heshtje, siç ndodhi në Shqipëri.

Në këto kushte, vetvetishëm letërsia u hap edhe falë personave që nuk ishin shkrimtarë, por shkrimet e të cilëve rrodhën natyrshëm në kanalin letrar, si një mënyrë komunikimi alternativ që siguron pjesëmarrje. Asocimi me këtë paradigmë, që shkencat e komunikimit e njohin si paradigma e komunikimit alternativ ose pjesëmarrës, është fort i përshtatshëm për të përshkruar lindjen e një tjetër zëri në letërsi, zë që do të merrte përsipër të shtronte e të shqyrtonte shumë çështje të shoqërisë, në të kaluarën e afërt. Ky proces, me anë të dëshmisë dhe deri diku dokumentimit do të nxiste transparencën për të shkuarën dhe do të synonte ta bënte publikun pjesëmarrës në një proces që do të denonconte strukturat e së shkuarës dhe shtrirjen e tyre në të tashmen.

Shkrimet për burgun përbëjnë një risi për sa i përket qasjes së tematike dhe përzgjedhjes së krijimtarisë letrare si kanal komunikim. Ky zë i ri në letra, guximshëm po merrte përsipër të çinstitucionalizonte heshtjen rreth disa dukurive të shoqërisë komuniste, por edhe të zgjatimeve të tyre në paskomunizëm. Nga ky këndvështrim vërejmë se si letërsia e dhuron veten si instrument për emancipim dhe për pjesëmarrje shoqërore, duke shfaqur funksionin e saj komunikues, që e kthen qenien njerëzore nga objekt i historisë në subjekt aktiv dhe pjesëmarrës në historinë e saj.

Fjalë kyçe: *kommunikim alternativ, burgu politik, autobiografi, shkrime për burgun*

Hyrje

Panorama e të jetuarit nën regjim përjetoi të shkundmet e një ngjarjeje epokëbërëse kur në vitin 1990 Shqipëria iu hap zhvillimeve demokratike. Izolimi prej gati pesë dhjetëvjeçarësh kishte ushqyer mite të gënjeshtërtë për shumë dukuri brenda dhe jashtë sistemit, prandaj, me hapjen faqe botës, shqiptarët u përballën me një krizë konjitive, që vështirësonte dhe gati pamundësonte rikonceptimin e jetës në një sistem të ri organizimi politik e shoqëror.

Kjo krizë konjitive – pamundësi për të njohur – bashkë me një lloj apatie që verifikohej në masën e gjerë, e asgjësonte thujtë në skaje mundësinë e kësaj të fundit për ndërveprim dhe pjesëmarrje. E megjithatë, thotë Martin Buber, kriza ka anën e vet pozitive: «na detyron të shtrojmë çështjen e njeriut pa ngurrim dhe shmangie».¹ Ky ishte thelbi në kontekst shqiptar! Më në fund do të duhej të bënim llogaritë me rezultatet e projektit për ndërtimin e njeriut të ri.² Pakomunikueshmëria që karakterizon të jetuarit nën regjim kishte korrupsuar njëherazi personin dhe komunikimin ndërpersonal e institucional, duke krijuar iluzione për të vërtetën, një mospërputhje mes të thënit dhe të bërit. Dyzimi që ishte kthyer në stil jetese kishte shkaktuar një paafësi të theksuar për të përcjellë kujtesën, përvojën, marrëdhëniet njerëzore, për shkak pamundësisë për të bashkëndarë.

Emergjencia politike e shoqërore favorizonte mënjanimin, heshtjen a tjetërsimin e çështjeve të së shkuarës. Gjendja e rëndë ekonomike i detyronte njerëzit të kërkonin gjithfarëlloj zgjidhjesh për nevojat bazë, arsye për të cilën

¹ Martin Buber, *Il problema dell'uomo*, Editrice elle di ci, Torino, 1983, 6.

² «Si sovjetikët, edhe komunistët shqiptarë kanë kuptuar mirë se mjeti për të siguruar pushtetin e tyre është krijimi i një tipi antropologjik që është plotësisht besnik ndaj Partisë. E njëjta gjë kishte ndodhur edhe në Bashkimin Sovjetik dhe komunistët shqiptarë e kishin tashmë një shembull konkret», Albert Nikolla, *Njeriu i ri shqiptar. Ndërmjet moralist komunist dhe krizës së tranzicionit*, Onufri, Tiranë, 2012, 56.

shumica e shqiptarëve ishin më të zënë për të ikur sesa për të qëndruar. Në këto kushte moskokëçarja për të shkuarën dhe gjithçka që ajo përfaqësonte ishte në harmoni të plotë me një prirje «biologjike për të harruar»: «Prirja për të harruar është një prirje biologjike. Është një fenomen biologjik, (...) i shëndetshëm, sepse na mundëson të harrojmë historitë dhe t'i hedhim tutje».³

Fakti që askush nuk po e kthente gishtin nga e shkuara për të analizuar dhe për të shqyrtuar sistemin në përgjithësi, por edhe për të dëgjuar dhe rrëfyer praktikatat kriminale të regjimit, i asgjësonte fare pritshmëritë për hapjen e një procesi ku viktimave të sistemit t'u njihej botnisht mohimi i të drejtave themelore njerëzore. Gjasat ishin që kjo çështje të mbetej pa një arenë publike ku të mund të shfaqeshin ndjenjat, ndrydhja, zemërimi, mbi të gjitha dëshira për të kuptuar çfarë, si dhe pse kishte ndodhur.

Pezull mes dy kohësh, së shkuarës dhe së ardhmes, dhe mes dy procesesh, harresës dhe kujtesës, qëndron një tjetër kohë, e pakapshme dhe paradoksale: mosvazhdimësia⁴. Koncepti *foucaultian*, që vetë autori e përafron me një paradoks, një çast i pakapshëm, i mohuar dhe i shpërfillur edhe prej vetë studiuesve, sot është kthyer në një prej elementeve themelore të analizës historike, dhe është bartës i një roli të trefishtë.

Michel Foucault na fton të reflektojmë për këtë koncept, mosvazhdimësinë, i cili edhe pse është i vështirë për t'u perceptuar është themelor për të kuptuar rolin e shumëfishtë të tij: konceptual, sistemues dhe rolin përcaktues:

•*Konceptual*: mosvazhdimësia si instrument dhe objekt kërkimi, pasi përcakton fushën e një analize.

•*Sistemues*: ndihmon në periodizim. Edhe në rastin konkret më ka shërbyer për të kapur atë periudhë të ndërmjetme mes dy epokave: komunizëm / paskomunizëm.

•*Përcaktues*: nëpërmjet këtij roli studiuesi është në gjendje të zbulojë: kufijtë e një procesi, pikëkthesa, tipare rregulluese të një dukurie, mekanizma.⁵

Mosvazhdimësia nuk është pra boshllëk mes dy epokave, por vendosja e një tekstore që do të ndikojë në sistemimin dhe në përcaktimin e ngjarjeve të

³ Duccio Demetrio, *Scritture erranti. L'autobiografia come viaggio del sé nel mondo*, Edup, 2003, Roma, 40-41.

⁴ «(...) në disiplinat e quajtura historia e ideve, e shkencave, e filozofisë, e mendimit, por edhe e letërsisë (të harrojmë për një çast veçantinë e secilës) – që pavarësisht nga titulli i shpëtojnë më së shumti punës së historianit dhe metodave që ai përdor – vëmendja zhvendoset nga njësitë e mëdha që përbëjnë 'epokë' apo 'shekull' kah fenomenet e thyerjes», në Michel Foucault, *Il sapere e la storia. Sull'archeologia delle scienze e altri scritti*, Ombre corte, Verona, 2007, 34.

⁵ M. Foucault, *Il sapere e la storia*, 35.

mëpasme. Analiza e konceptit të mosvazhdimësisë nuk është ndër qëllimet e mia, megjithatë m'u duk e rastit ta sjell në vëmendje për dy arsye, së paku. E para, sepse mosvazhdimësia – te ne 'ndërrimi i sistemeve' – mundësoi shkëputjen nga një sistem, dhe si rrjedhojë zanafillën e disa refleksioneve mbi shkak-pasojat që e kishin ushqyer atë.

E dyta, sepse koncepti i mosvazhdimësisë është pashmangshmërisht i përafrueshëm me konceptin e tranzicionit drejt rendit demokratik. Ngjarjet e reja të pas viteve '90 na imponojnë tema të reja, sidomos lidhur me çështjet që plazmojnë e plotësojnë mbamendjen kolektive, pasi etika e mbamendjes na thotë: «(...) kujtesa është thujse krejt një çështje vullneti dhe kur reflektojmë për vlerën e mbamendjes, është e volitshme të reflektojmë edhe për vlerën e harrimit».⁶

Në këtë pikë mund të shtoj një arsye tjetër pse kam sjellë në vëmendje konceptin *foucaultian* të mosvazhdimësisë, e cila ka të bëjë pikërisht me shkëputjen që i ndodh subjektit për shkak të rrethanave historike. Kjo shkëputje krijon nevojën e Unit për t'u njësuar me jetën 'para' dhe jetën 'pas'. Rast domethënës i shkëputjes dhe i ndarjes së kohës në dy pjesë është edhe përvoja e burgut: izolimi fizik i trupit e përdorimi i tij si instrument torture për të përvetësuar edhe mendjen e shpirtin. Kjo është historia e burgut politik në Shqipërinë komuniste.

Izolimi i trupit për shkak të privimit të lirisë krijon një subjektivitet të ri, me një histori vetjake që ndahet 'para' dhe një 'pas'. E dyta është një fazë që shënjohehet nga një zhvendosje e fortë e pikave të referimit të subjektit, sidomos pas daljes nga burgu. Por edhe një zhvendosje e deri përjashtim shoqëror që pëson subjekti për shkak të vështirësisë për t'ia komunikuar këtë histori – që në shumë raste janë histori të skajshme – botës jashtë burgut; nisur nga përbuzja, frika, mospërfillja dhe mungesa e guximit të shoqërisë për të dëgjuar historitë e skajshme.

Vetë politika e viteve të para të regjimit të ri demokratik ishte ende nën ndikimin e fortë të përndjekësve, për shkak të implikimit të këtyre të fundit në rrafshet domethënëse politikëbërjeje. Megjithatë takimi përndjekës/ i përndjekur ndodhte në nivel privat dhe publik, institucionalisht askush nuk promovoi asnjë nismë ligjore që të përballte përndjekësit me drejtësinë, a së paku t'u jepte viktimave të përndjekjes të drejtën e një hapësire për të rrëfyer dhe për t'u dëgjuar.

Kjo kërkonte një sipërmarrje institucionale dhe morale për të zbardhur një të kaluar në shenjë të shkëlqesë së të drejtave të njeriut. Komunikimi dhe angazhimi institucional në këtë drejtim ka qenë i pamjaftueshëm. Në Shqipëri jo vetëm që nuk janë konsideruar personat dhe historia e secilit prej tyre, por

⁶ Alessandro Barbero, *Della memoria*, në *La saggezza del vivere. Tracce di etica*, Alberto SINIGAGLIA (a cura di), Diabasis, Reggio Emilia, 2003, 21.

janë ruajtur qëndrime subjektive, spekulative, përjashtuese e deri shantazhuese në lidhje me mbamendjen e përvojës në burgje.

Në mungesë të një angazhimi domethënës institucional, letërsia u kthye në një kanal komunikimi alternativ për dëshmitë e lidhura me burgun politik. Në përgjithësi, historia e të burgosurve është historia e atyre që nga pikëpamja sociokulturore janë të dobët dhe të fundit e shoqërisë, pra edhe mbamendja për burgun qëllon të jetë e lidhur fort me histori të pazëshme. Por nëse burgu bëhet objekt rrëfimi, atëherë kemi të bëjmë me një instrument alfabetizimi masiv për gjendjen e të përjashtuarve të shoqërisë, por edhe për strukturën tonë shoqërore dhe përgjegjësitë e saj. Në këtë rast, të dhënit zë historive të tyre kthehet në shërbim për të dëshmuar të padukshmen dhe të pazëshmen. «Qysh në ngjizje, vepra letrare bart natyrshëm një jetëgjatësi me përmasa jo të njëjta me ato të krijuesit të saj. Ajo futet në proces komunikimi me lexuesit e kohës në të cilën jeton e krijon autori i saj (jeta e veprës letrare fillon pikërisht në atë proces të të lexuarit), por edhe përtej asaj kohe».⁷

Të shkruarit për të kujtuar është një praktikë e guximshme për disa arsye: për njëfarë shkalle të përfshirjes autobiografike, për ekspozimin, për përballimin me ngjarje që nuk e përkëdhelin sedrën tonë. Por në rastin kur shkruajmë për të kujtuar dhe për të dëshmuar burgun, arsyeve të mësipërme u shtohen edhe disa të tjera më të qenësishme: përballja me stigmën, me plagë të hapura, braktisja shoqërore, mosprania dhe mospërfillja e institucioneve.

Kur përballja me kujtesën dhe kujtimet për burgun bëhen në vetë të parë, rrëfimi, cilado qoftë forma me të cilën përcillet, merr vlerë tjetër për shkak të gjurmës së fortë vetjake, në mos autobiografike, që dallon nga moria e kumteve të tjera. Ndryshe nga mesazhet e prodhuara institucionalisht – me një shkallë vështirësie në interpretim e njëfarë distance në komunikim – komunikimi individual ndodh në vetë të parë. Qoftë edhe për këtë element kthehet si kundërprovë përballë mesazhit institucional kur ky i fundit rezulton i rremë apo shpërfillet me heshtje, siç ndodhi në Shqipëri.

Në këto kushte, vetvetishëm letërsia po hapej edhe falë personave që nuk ishin shkrimtarë, por shkrimet e të cilëve rrodhën natyrshëm në kanalin letrar, si një mënyrë komunikimi alternativ që siguron pjesëmarrje. Asocimi me këtë paradigmë, që shkencat e komunikimit e njohin si paradigma e komunikimit alternativ ose pjesëmarrës⁸, është fort i përshtatshëm për të përshkruar lindjen e

⁷ Tomorr Plangarica, *Rilexim i dramatikës së E. Haxhiademit si tekst dhe diskurs (prurjet në shkencat e ligjërimit, një mundësi më shumë për interpretime)*, në L. Smaqi-E. Paci-A. Leka-Tomorr Plangarica- V. Graçi, Studime mbi autorë e vepra të patrajtuara në letërsinë shqipe, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2022, 205.

⁸ Paradigma e komunikimit alternativ ose pjesëmarrës bazohet në kalimin nga modeli vertikal i komunikimit në atë horizontal.

një tjetër zëri në letërsi, zë që do të merrte përsipër të shtronte e të shqyrtonte shumë çështje të shoqërisë. Ky proces, me anë të dëshmisë dhe deri diku dokumentimit do të nxiste transparencën për të shkuarën dhe do të synonte ta bënte publikun pjesëmarrës në një proces që do të denonconte strukturat e së shkuarës dhe shtrirjen e tyre në të tashmen: «Ato shka do të lexoni këtu hedhin poshtë gjithë historinë e shkrueme gjatë viteve të Partisë; vërtetë ato nuk provohen nga kurrnji dokument zyrtar shteti ose partie, nga kurrnji arkiv».⁹

Ismail Kadare shkruan se nën atmosferën e lirisë pritej të lindte një letërsi e re për periudhën e diktaturës:

*Dihet se pas rënies së komunizmit, nga vendet e ish perandorisë u prit me kureshtje dhe padurim një letërsi e re, që do të dëshmonte në mënyrë të veçantë, më dramatike, më thellë dhe rrjedhimisht më bukur tragjedinë e këtyre popujve. U prit një gjë e tillë, sidomos nga vende klasike staliniste si Shqipëria, burgjet e së cilës u hapën më 1991. Një farë habitje për të mos thënë zhgënjim e pasoi këtë pritje. Në të vërtetë nuk ka patur vend as për habi e as për zhgënjim. Letërsia ka ligjet dhe oraret e saj, kështu që stinët politike, madje edhe përmbysjet e mëdha, qëllon që e trazojnë me shumë vështirësi.*¹⁰

Sigurisht që stina e re e letërsisë shqiptare kishte shumë arsye të ‘trazohej’ me vështirësi dhe vonesë. Ndoshta jo thjesht për shkak të ligjeve dhe orareve të vetë letërsisë, sa edhe për shkak të disa rrethanave e kushteve jashtëletrare konkrete, të cilat e vononin dhe e pengonin këtë letërsi që të dilte në sipërfaqe me të njëjtën shpejtësi të pritshmërive.

Shkrimet për burgun përbëjnë një risi për sa i përket qasjes së re tematike dhe përzgjedhjes së krijimtarisë letrare si kanal komunikim. Shkrimet do të përfshinin emra të përveçëm – janë thuajse arkeologji e emrave të përveçëm – pjesa më e madhe e të cilëve, në fillimet e dëshmimeve ishin ende gjallë dhe me lidhje në nivele të larta ku vendosej dhe ndodhte politika e Shqipërisë paskomuniste. Ky zë i ri në letra, guximshëm po merrte përsipër të çinstitucionalizonte heshtjen rreth disa dukurive të shoqërisë komuniste, por edhe të zgjatimeve të tyre në paskomunizëm.

Nga ky këndvështrim vërejmë se si letërsia e dhuron veten si instrument për emancipim dhe për pjesëmarrje shoqërore, duke shfaqur funksionin e saj komunikues, që e kthen qenien njerëzore nga objekt i historisë në subjekt aktiv dhe pjesëmarrës në historisë së saj. Mbi këto premisa pra mbruheshin pritshmëritë për një konvertim nga krijimtaria socrealiste te një krijimtari autentike, që do të mirëpriste fjalën dhe do të ofronte pjesëmarrje nëpërmjet saj

⁹ At Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, Botime 55, Tiranë, 2006, 528.

¹⁰ Ismail Kadare, *Parathënie*, në Maks Velo, *Kohë anti-shenjë*, Onufri, Tiranë, 2000, 5.

për një shtresë të pambrojtur dhe shumë të brishtë, sikurse ishin vuajtësit e burgut politik.

*Unë e di se letërsia që po bëjmë këtu, ka si vlerë të parë aktin e të krijuarit në burg, një mrekulli e rrezikshme, sfiduese, që mbart mbi supe (ndërsa duart janë të lidhura) gjithë historinë martire të librit. Do ta ushqejë letërsinë si një lumë i nëndheshëm, i përgjakur. Mbase sjellim atë që mungon, jo përmbytjen e asaj që është.*¹¹

Ndër të gjitha përvojat nën komunizëm, përvojat e burgut kishin krijuar te njerëzit që e kishin përjetuar atë një gjendje njerëzore krejt të veçantë e të dallueshme. Mjafton të vërehet se si dinamikat e jetesës në burg e kishin specializuar leksikun për të shprehur praktikën në burg. Fjalë si *ridënim*, *kaush* përkufizojnë gjendje të lidhura përjashtimisht me burgun. Në korpusin e veprave që janë marrë në shqyrtim për të arritur në përgjithësi, fjala *ridënim*¹² shënon praktikën e rinovimit të dënimit për të disatën herë pa dalë fare nga burgu; ose rikthimin në burg pas një dënimi të parë a të dytë. Edhe studiuesi Valter Memisha, në leximin leksikografik që të veprës së Daut Gumenit e ka identifikuar këtë fjalë-praktikë bashkë me shembujt përkatës, dhe e shpjegon brenda domenit përkatës për leksikun e burgut në veprën e marrë në shqyrtim: «*Ridënim*, veprimi dhe gjendja sipas kuptimeve të foljeve *ridëno*, *ridënohem*. – *Ama ridënim qënke ti? Ashtu mund të rrih në burg jo nëntë po nëntëdhjetë e nëntë! Ishte koha kur fushata e ridënimeve dhe e dënimeve në burg, përpiquej të qetësonte disi frikën e diktatorit nga zgjerimi i goditjes politike*».¹³

Fjala *kaush* merr statusin e termit në shkrimet për burgun; përdoret për të mbiquajtur strukturat përbërëse fizike të institucionit: *Kaushi*¹⁴ është hapësira e bashkëndarë me të burgosurit e tjerë, e cila stërmbushet përtej kapaciteteve.

¹¹ V. Zhiti, *Rrugët e ferrit*, 560-561.

¹² «Jo, jo, ti s'lirohesh. Ti do të dënohesh e do të ridënohesh. Pse s'do që ndëshkimi i Diktaturës së Proletariatit të bjerë mbi ata që të morën më qafë, ë, pse s'flet?», V. Zhiti, *Rrugët e ferrit*, 27.

¹³ Valter Memisha, *Leximi leksikografik i veprës 'Shënime nga shkolla e Partisë' të Daut Gumenit*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2019, 119.

¹⁴ «Aso kohe (maj 1968) thuhej se kishte dy burgje: Burgu i vjetër te i cili gjindeshin edhe ato të quejtunat birucat e Koçit, sepse i kishte ndërtue Koçi Xoxe për armiq të popullit dhe Burgu i ri, i cili më së shumti thirrej Kausha. (...)Me duket se këtë emër i a kishin ngjitur mbasi ishte i ndamë ndër dhoma të vogla, të cilat mund të nxejshin katër vetë, por n'ato vite i kishin përshtatë për 16 vetë e deri 20», Z. Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, 526-7; «Ato fillojnë me ditën e arrestimit të secilit dhe ndërpriten pa prituri, njëri është çuar në kaush, tjetri është nisur për spital, dikush është marrë për t'u ekzekutuar», M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 133.

Dhe herë të tjera leksiku 'i specializuar' shërben për të kodifikuar praktika që s'mund të quhen me emrin e tyre: «kur thuhet pyetje don me thanë fillojshin edhe torturat».¹⁵

Shkapërcimi i kangjellave të burgut për një ish të burgosur ishte pikënisja e ndërgjegjësimit për një status të ri që fillonte nga familjarizimi me territorin, rimarrja e marrëdhënieve me familjarët, integrimi në vendin e punës e mbi të gjitha rindërtimi i besimit të ndërsjellë në marrëdhëniet me njerëzit. «Maksi doli nga burgu pas tetë vjetësh. Askush nuk e mori vesh në fillim. Të burgosurit politikë dilnin nga burgu pa zhurmë e si hije. Një ngazëllim i tepërt në shtëpi, vizita të njerëzve, ose takime me ta në rrugë quheshin të rrezikshme. Të porsadalët nga burgu për një kohë të gjatë nuk përziheshin me askënd dhe në rrugë nuk i flisnin të njohurve për të mos u shkaktuar fatkeqësi».¹⁶

Jo të gjithë vuajtësit e burgut nën komunizëm mundën të shpreheshin nëpërmjet shkrimeve. Përkundrazi, ata që u shprehën në letërsi, kryesisht me vetërrëfime – narrativë autobiografike – ishin pjesa më e vogël, nisur edhe nga arsytet që u përmendën më sipër, por edhe për faktin se iu dha hapësirë vetëm përvojës së burgut politik, duke e mos cekur aspak dëshmimin e përvojës së burgut për arsye 'ordinere'.

Njëherë që kemi theksuar se kjo përvojë dhe këto subjektivitete kanë mbetur jashtë, ndoshta është e kurtë se fokusi i këtij punimi do të jenë vetëm dëshmitë shkrimore për burgun politik nën regjimin komunist. Fokusimi në burgun politik, i cili mbërrin përmes dëshmive të vetë vuajtësve që e nyjëtuan këtë përvojë në shkrime, nuk është kurrsesi një qëllim i autores për të copëzuar vuajtjen, duke e ndarë atë në të denjë apo më pak të denjë për t'u regjistruar në kujtesën kolektive.

Nuk është as lehtësi në gjykim apo shkarje vëmendjeje. I shërben thjesht identifikimit të një grupi sa më përfaqësues, nismëtar i një ngjarjeje të re në letrat paskomuniste shqiptare: shkrimet për burgun. Shkrimet për burgun, përveçse ngjarje letrare, ofrohen edhe si hapësirë e re komunikimi për mbarë shoqërinë. Fati i kësaj shtrese të padukshme është shembulli i ndërprerjes, i trazimit të komunikimit jo vetëm në nivel individual, por i mohimit të komunikimit të individit me shoqërinë e anasjelltas: «nëse ndërpritet mundësia e një grupi për të komunikuar përballë një tjetër grupi apo një bashkësie të tërë, problemi është politik dhe mund të shpërthejë në një krizë lirie».¹⁷

Është emblematike pyetja që bënte Theodor Adorno: *Si mund të bëhet poezi pas Auschwitz-it?* Iosif Brodskij, poet në mërgim e rimerr këtë pyetje dhe i shton një shënim të mprehtë: «... edhe kush e njeh historinë ruse mund ta

¹⁵ At Z. Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, 120.

¹⁶ I. Kadare, *Parathënie*, në M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 14.

¹⁷ Furio Colombo, *La immoralità del silenzio*, në *La saggezza del vivere. Tracce di etica*, 37.

përsëritë të njëjtën pyetje, duke ndryshuar emrin në Lager – dhe mund ta përsëritë me arsye më të numërta, meqë viktimat e kampit të Stalinit ishin shumë herë më të mëdha se të nazizmit”.¹⁸ Përvoja e burgut është shumëfaqëshe. Shkrimet për burgun politik nën regjimin komunist si kryetëm letrare janë rezultat i shtresëzimeve të një shumësie të papërcaktuar ndjesish, përvojash e marrëdhëniesh: “*S’do ta kisha besuar se mund të bëhej poezi kjo materie, arrestimet, qelia, minjtë, hetuesia, frika, flokët e qethur, supa me policë etj., etj.*”¹⁹

Nëntemat në shkrimet për burgun

Koha në burg

Koha në shkrimet e burgut është një ndër nëntemat e mëdha. Koha në burg është një fragment i grisur nga rrjedha normale e kohës lineare, i cili krijon një qark të mbyllur pa kurrfarë lidhjeje me të kaluarën e të ardhmen; një e tashme e përhershme e një lloji krejt të veçantë, e përçudnuar, një rikthim ciklik kërcënues. Koha në burg përvetësohet nga i burgosuri si kohë gjithmonë e tashme, që kurrë nuk i kalon së shkuarës. Këtë e ilustron me art autori Maks Velo në *Kohë anti-shenjë*, ku përdor një kontrast të gërshetuar të kohëve të së shkuarës (për fantazitë) dhe të kohës së tashme për përshkrimin e përvojës së burgut, pavarësisht së në momentin kur shkruan, është kohë fizike e tejkaluar:

*Pas kaq muajsh të një grijeburgu, jeshilvjellëse dhe të zezëkrimi pashë ngjyra transparente fluturuese që përmblytën dhomën time. (...) dhoma e hetimit është bosh krejt e zhveshur. Një volum bosh, si një mendim i gërryer. Ky boshllëk është simbol i sistemit. Një sistem që ka frikë nga vetja, që ka frikë mos var-vetvehte.*²⁰

Ritmet në burg shkoqen në bazë të tingujve, sipas të thënave të njerëzve që kanë kontakt me jashtë, nga brimat dhe heshtimet e altoparlantëve që transmetojnë drejtpërsëdrejti gjyqet, nga brohoritjet e popullit gjatë gjyqeve, refleksat e kushtëzuara që krijohen nga «toaleti i mbramjes» apo «i mjesit». Koha matet me orën e çajit të darkës apo me leximin e veprave të Enverit nga ora 9 -11 në burg të Zejmenit: «Asnjë shenjë nuk kishim me kuptue në cilën kohë të ditës jemi. Vorfnia ishte e gjithanshme. Jetohej vetëm me të kaluemen e vetvetes, dhe pa asnjë shpresë për të ardhmen».²¹

¹⁸ Iosif Brodskij, *Dall’esilio*, Adelphi, Milano, 1988, 56.

¹⁹ V. Zhiti, *Rrugët e ferrit*, 266.

²⁰ M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 128-129.

²¹ At Konrad Gjollaj, *Gja e pabesueshme*, në *Antologjia e plagëve*, f. 157.

Koha në burg ‘pjek’ zvetënimin dhe tjetërsimin e njeriut. Çoroditja që shkakton mungesa e orientimit, humbja e pikave të referimit në kohë dhe në hapësirë krijojnë një ‘kulturë oraliteti’, që nuk e mundëson ndryshe regjistrimin e kalimit të kohës, përveçse me të thënë. Nevoja për të tejkaluar oralitetin e burgut – diktuar ky edhe nga barrierat që vendos mungesa e materiales, qofshin këto edhe mjetet më bazike për të shkruar si letër e laps, po edhe frika e tjetërsimit deri në përhumbe ndezin një hapësirë krijueshmërie të burgosuri, që gjen mënyra alternative për ta ngulitur kohën:

... por shumica ishin gërvishtje të vogla 2-3 cm të gërvishtura rresht, me bishtin e lugës. Ishin kalendarë. Secili kish zgjedhur një parcelë. Njeri lart, sa më lart që të ish i sigurt, tjetri poshtë afër dyshemesë, dikush respektonte shenjat e të tjerëve dhe gjente me ngulm një vend të pa gërvishtur më parë, kurse ai tjetri nuk kish pyetur dhe kish filluar kalendarin mbi buzët e një portreti, pikërisht aty ku ish shënjtërimi i femrës, buzët. Kish që e mbanin gjatë muajve vijëzimin horizontal dhe drejt, të tjerë shkonin teposhtë ose përsëlarti sipas gjendjes së tyre morale në hetim.²²

Këto shënime në mur a kudo tjetër me mjete rrethanore kthehen në ‘rezerva ushqimore’ që depozitohen në hambarin e kujtesës dhe shërbejnë për t’i qëndruar zvetënitimit që vjen si rrjedhojë e izolimit të trupit dhe e përdorimit të tij si instrument torture për të zotëruar edhe shpirtin.

Frika si program

Ngjallja e frikës dhe e terrorit qysh në orët e para të pushtetit komunist ishte një ndër programet më efikase për të copëzuar dhe nënshtruar masën. Praktikrat e pashoqe dhe instrumentet për të frikësuar popullatën ishin të një egërsie që paralizonte çdo përpjekje të njerëzve për t’i bërë ballë njerëzsisht asaj. Me shpalljen e ‘armikut’ të popullit – borgjezi, kulaku, tregtari, intelektual qe ka studiuar jashtë – nxiteshin, justifikoheshin dhe legjitimoheshin praktikrat e dhunshme si një nevojë për të luftuar armikun e popullit. Mbas identifikimit të armikut të popullit dhe të shpalljes së luftës së klasave, secili qytetar kishte një arsye të mirë për të urreyer dhe për të pasur frikë tjetrin. Kjo metodë siguronte konsensus në masën e gjerë dhe promovonte në gjirin e shoqërisë një nënstrukturë të mbikëqyrjes shoqërore. Pavarësisht nga pasurimi me elemente kontekstuale shqiptare, këto modalitete u huazuan nga praktikrat sovjetike:

Karakteristika më e rëndësishme e epokës së Stalinit ishte futja e frikës si një element i detyrueshëm në jetën e çdo

²² M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 133.

qytetari sovjetik. Frika kultivohej jo vetëm në procesin e edukimit ideologjik, por përgjatë gjithë edukimit, qysh në moshë të hershme. Njerëzit që ishin angazhuar në veprimtari kulturore luanin një rol të rëndësishëm në përhapjen e urrejtjes dhe kthimin e saj në virtyt.²³

Frika dhe urrejtja janë dy elemente që mbështetën dhe ushqyen luftën e klasave.²⁴ Shkrimet për burgun i kushtojnë një hapësirë domethënëse provës së ekzistencës së luftës së klasës dhe pasojave të saj në burg. Artificiale në thelb, lufta e klasave bëhej e njëmendtë sapo perceptohej si një mënyrë për mbijetesë mes vetë të burgosurve. Ndërsa autoritetet e inkurajonin si një instrument shumë efikas për fragmentarizmin dhe deri asgjësimin e solidaritetit që mund të krijohej në burg.

Soji i spiunit

Të burgosurit ndiheshin të gjithë të kërcënuar, pasi te secili, edhe te shokët e besuar deri pak më parë shihnin spiunët dhe përgjuesit. Kjo krijonte përçarje e deri konflikte vdekjeprurëse mes të burgosurve. Sipas dëshmisë së at Zef Pllumit, partia nëpërmjet të besuarve të vet: «vuni në jetë programin e tmerrshëm të luftës së klasave në burg»:

Ç'ish ajo? Nji përçamje vdekjeprurëse për të burgosunit. Kampi i të dënuemve u nda në dy çeta ku në të parën hijshin ata të rrugës së "riedukimit" dhe në të dytën ata që nuk mund të hinin në atë rrugë dhe që përfaqësonin "reaksionin". Veprimtaria e të parëve ishte "informacioni" ose "shpifja" si dhe pjesëmarrja ndër "aktivitetet kulturalo-shoqnore edukative" që organizonte komanda".²⁵

²³ Mikhail Heller, *Cogs in the wheel. The formation of soviet man*, Alfred A. Knopf, New York, 1998, 100-101.

²⁴ «Nën drejtimin e tij (flitet për G. T.) lufta e klasave mbërrijti kulmin. Të burgosunit nuk guxojshin me folë më mes vedit, sepse gjithshka përgjohej, gjithshka shpifej», Z. Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, 575; «Aty Mehmet Shehu bërtet me histerizëm se ata që bëjnë në shtëpitë e tyre piktura abstraksioniste janë hipokritë e frikacakë, kandidatë për rrufjanë politikë ... asnjë mëshirë për zëdhënësit e armikut të klasës ... rroftë diktatura e proletariatit», M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 69; «Po babai? – u çorr hetuesi për të prishur barazinë që iu duk se vura unë. Dhe e afroi turirin mbi mua, gati cikshëm, siç i pëlqente, që të krijonte kështu dykokësinë monstruoze ballë për ballë me armikun e klasës», V. Zhiti, *Rrugët e ferrit*, 46.

²⁵ «Çdo i burgosur kish arkivin e tij të kundërspiunazhit. Por ky ish një arkiv fantazëm, bazohej në kujtesë dhe nuk kish asgjë të shkruar. (...) Dhe burgjet më bëheshin se ishin një kuvend gjigand që gjykonin spiunët. (...) Por trimat i bënë ekzekutimet hapur, si

Shteti kishte nevojë edhe për instrumentet e veta për të depërtuar në mënyrë sa më kapilare në jetën e secilit të burgosur. Përveç aparateve shtetërore që e bënë këtë punë institucionalisht, kishte edhe një soj tjetër, të painstitucionalizuar, por që me zell i shërbente shtetit me informacione, e në mungesë të këtyre, me shpifje. Këta ishin spiunët që edhe në burg nuk mungonin: «Spiunët e shtruar në infermieri, në ato ditë dhe net të rehatshme, pallë ariu me të vërtetë, gjatë dergjjes në shtrat, të gjithë pa përjashtim, kërkonin ta lexonin Enver Hoxhën. Ai është bar shërues».²⁶

Në Shqipërinë komuniste, as si qytetar i lirë, e aq më tepër i burgosur, nuk ekzistonte një zonë neutrale ku njerëzit të mos ishin nën mbikëqyrje. U shpikën një sërë strategjish e teknikash, nga më të stërholluarat deri te të drejtpërdrejta, për të mbikëqyruar dhe identifikuar personat e ‘përshtatshëm’ që mund të pasuronin radhët e spiunëve jashtë dhe brenda burgut. Aderimi ishte herë vullnetar²⁷, e herë të tjera u përdorën shantazhe dhe presione nga më të ulëtat për të rekrutuar spiunë.

Transferimi i burgut jashtë tij

Burgu nuk ndalonte dhe ndëshkonte thjesht trupin e të dënuarit, pasi jo pa qëllim, autoritetet kujdeseshin që ky ndëshkim i trupit të transferohej dhe të bëhej i ditur edhe jashtë burgut. Rasti më i mirë ishin vizitat e familjarëve²⁸ apo

Qaniu, që goditi në mes të ditës në oborr M. Blushin», M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 163; «Në dhomën ngjitur, por me derë tjetër e çarçafë të varur, ishin renditur disa shtretër, më të mirë se fjetoret tona. Nuk mund të shtrohej kushdo. S’varej dhe aq nga sëmundja e sa rëndë ishte. Por nga komanda, sa i shërbeje asaj», V. Zhiti, *Rrugët e ferrit*, 365.

²⁶ V. Zhiti, *Rrugët e ferrit*, 365.

²⁷ «Konviktorët perveç akteve të dhunës kundra pjesës tjetër të rinisë, zhvillojshin edhe spijunimin ose më tepër shpifjen: delshin dishmitarë në rrenë. Kështu ata, vetëm në këtë mënyrë, pregatiteshin për me pasë në dorë n’nesret jeten kulturore, shkencore e artistike të popullit shqiptar: pregatitja mësimore nuk kishte aq randsi: tjerat i dinte Partia», Z. Pllumi, *Urno vetëm për me tregue*, 168; «Ai (Myfiti) ishte i sëmurë. Kish sëmundjen e spiunimit, këtë gjë ia kishte infektuar komunizmi. Tani këtë të sëmurë nuk e donte më. Dhe operativi nuk i pranonte informatat e tij. Sëmundja e tij ishte një delir», M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 164.

²⁸ «Ajo ditë e takimit të parë kje një tmer për gjithë qytetin e Shkodrës: familjarët nuk i njihshin njerëzit e vet dhe thërritshin: un due filanin, ndersa këndeje hekurash jepej pergjegja: un jam», Z. Pllumi, *Urno vetëm për me tregue*, 20; «Po mendjen e kisha te porta, pashë që mamanë dhe motrën nuk i lejuan të hynin, megjithëse gjyqi ish publik. Lidhja ftonte artistët po nuk u kish çuar ftesa familjes, këtë nuk e kish bërë as gjykata. I lejuan të hynin vetëm mbasdite, pikërisht kur nuk doja. I lejuan të hynin në çastin kur u dha vendimi vetëm e vetëm që t’i terrorizonin», M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 150.

pjesëmarrja e qytetarëve në gjyqe publike.²⁹ Kjo do të shërbente si një praktikë parandaluese dhe paralajmëruese për këdo që nuk kishte mend në kokë t'i bindej regjimit.

Një formë e zgjatimit të burgut ishte edhe sjellja e traumatizuar e personave që kishin dalë jashtë burgut, sepse me daljen nga burgu tre elemente e shoqëronin ish-të burgosurin edhe pasi ishte liruar: frika, heshtja dhe izolimi.³⁰ Pra, roli shoqëror i burgut nuk kishte të bënte vetëm me ndalimin e 'kriminelëve' dhe izolimin e tyre, por kishte të bënte edhe më një rol tjetër: atë të mbajtjes së gjendjes së frikës dhe të terrorit edhe jashtë burgut. Prandaj shumë bien dakord që Shqipëria në përgjithësi ishte një burg i madh: dënonte, por edhe i përdorte dënimet dhe të dënuarit si mënyrë paralajmëruese për dënimin e të tjerëve.

Privatja dhe publikja: shtetëzimi i privatësisë

Disa masa që u ndërmorën menjëherë pas çlirimit e orientuan thuajse menjëherë vendin drejt totalitarizmit. Edhe Kushtetuta i garantonte vetëm formalisht të drejtat dhe liritë e qytetarit, sepse «në praktikë shumë nga këto të drejta do të mbeteshin formale, madje disa do të mohoheshin menjëherë. Kështu, mendimi dhe organizimi i lirë do të ndaloheshin e do të penalizoheshin, kurse prona private do të shkonte drejt kufizimit dhe eliminimit».³¹

Këto ishin premiset që shteti të mos mjaftohej me përvetësimin me anë të shtetëzimit të të mirave materiale, por do të shpikte edhe sisteme për të shtetëzuar edhe jetën private të secilit qytetar të tij, me forma nga më të stërholluarat e çnjerëzoret. Përfitimi që do të merrte pushteti në fuqi ishte riprodhimi i vetvetes përmes një sistemi kapilar kontrollesh dhe mbikëqyrjesh të gjithfarëllojshme, duke mbërritur deri aty sa të asgjësonte sferën private. Jeta e çdo qytetari tashmë i përkiste shtetit dhe do të vihej në shërbim të ruajtjes me çdo kusht të formës së dhunshme që ky po merrte.

²⁹ «Dalja ime mbas gjashtë muaj hetuesi dhe e Edisonit mbas katër vjet burg i tmerroi artistët në sallë. Gjyqet ishin dhe seanca tmerri për ata që i shihnin dhe dëgjonin», M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 170; «Ja, një grup i pikëlluar fëmijësh, nxënës të mi. Kokëulur, të urtë. Mbase besonin se makina qethëse e shtetit kishte ngulur dhëmbëzat e vet edhe te mendimet e mia, te metaforat, idetë, i kishte bërë zero dhe trutë», V. Zhiti, *Rrugët e ferrit*, 132.

³⁰ «Kur dola nga burgu, të gjithë miqtë dhe shokët e dikurshëm bënë sikur nuk më njihnin ... dhe unë bëja sikur nuk i shihja. Kisha perfeksionuar në maksimum një ecje në shikim të paqenë, në mungesë. Unë ecja, por nuk ekzistoj. Për këtë isha përgatitur që në burg», M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 222.

³¹ Xhelal Gjeçovi e të tjerë, *Historia e popullit shqiptar. Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990*, Vëllimi i katërt, Botimet Toena, Tiranë, 2009, 176.

Në spital, në gjyq, deri në intimitet kishte babëzi njerëzore për të qenë pjesëmarrës në dënim, në fatkeqësi, në sëmundje, në gëzim, në marrëdhëniet intime burrë-grua. Përshkrimi i skenës ku nëna dhe dy motrat e Maks Velos ishin strukur në një qoshe nën presionin e turmës publike, që kishte etje për dënimin e birit dhe vëllait, dhe lënia e tyre jashtë sallës së gjyqit është ilustrim i mësymjes dhe i përdorimit të jetës së tjetrit.

Mësymja dhe ndërhyrja në privatësi nga ana e aparateve të shtetit gjen vend domethënës në shkrimet për burgun dhe shprehet së paku përmes tri modaliteteve:

- Ndërhyrja në intimitet³²
- Ndërhyrja në lidhjet familjare e shoqërore³³
- Ndërhyrje në shkëmbimet epistolare³⁴

Asgjësimi i sferës private synon copëzimin e individit, shpeshherë as dashuria nuk është një histori zemrash e trupash mes dy personave dhe përpjekjet për të shthurur çdo grimcë intimiteti janë përpjekjet për të copëzuar kohezionin personal e ndërpersonal.

Vetëdija se shteti mund t'ia behte ditën dhe natën për të konfiskuar letra, libra, ditarë janë një paraburg, që paraprin në shumë raste burgun real. Kjo bashkëjetesë me frikën e mësymjes dhe të pushtimit të papritur të sferës private ishte një presion shumë i madh për të gjithë, por që për disa rezultoi fatal. Pat prej atyre që u vetëshkatërruan përmes autocensurës së punimeve.

*Sekretari i Lidhjes Kujtim Buza e thirri dhe si e kritikoi
rëndë, e "këshilloi" t'i thyente tërë këto vepra që sjellin*

³² «— Nuk të pëlqenin femrat tona ... (...) Ti ... armik i degjeneruar ... dhe për këtë e ke dosjen plot», M. VELO, *Kohë anti-shenjë*, 66; «Takimet speciale ... Të flesh një natë me gruan në dhomat poshtë, afër komandës, i ruajtur dhe i vëzhguar nga policia e burgut.», V. Zhiti, *Rrugët e ferrit*, 294.

³³ «Mbaj mend, Luciana Naraçin, ish gruan time, e pyeta ku ishit që i dëgjuat gjithë këto që sipas jush m'i paska thënë mamaja. Ajo u përgjigj: duke zbritur shkallët, dera e kuzhinës ishte e hapur», M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 149; «Ndër to ishte edhe albumi familjar, i cili ish kontrolluar dhe ishin marrë disa fotografi që sigurojnë materiale prove në dosjen e akuzës. Dyshimet për fotografitë lindën që para tre vjetësh kur gruaja ime Luciana Naraçi së bashku me agjenten Parime Ruçi kontrolluan një mbrëmje sirtarët e fotografive dhe gjetën disa foto ku dukej mamaja në dasmën e mbretit Zog dhe një foto ku unë, katër vjeçar, nderoja me dorë të shtrirë si balilat», M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 221.

³⁴ «Edhe letrat nga familjet tona ashtu i merrnim, të hapura, me zarfin të grisur në anë, sikur ta kishin brejtur minjtë, dhe pullën të shkukur se mos qe shkruar aty ndonjë gjë e dyshimtë», V. Zhiti, *Rrugët e ferrit*, 368. «Po kjo kartolinë armiqësore dërguar poetit armik Frederik Rreshpja? – Hetuesi tundte një kartolinë, e vetmja gjë me ngjyra aty, që nga ajo dhomë shkretane, në korridorin e gjatë dhe të errët e deri te biruca jote», V. Zhiti, *Rrugët e ferrit*, 54.

“degjenerim”. Paçoja me sa duket u tremb shumë, shkoi në studio dhe masakroi veprat e veta. Ishin mbi tridhjetë vepra nga më të bukurat e skulpturës sonë. Kjo e dërrmoi përfundimisht. Deri sa vdiq ai nuk e mori dot vehten, se nuk ia falte vehtes që shkatërroi veprat më të bukura. Që ta kontrollonte më mirë Lidhja dhe sigurimi i futën në studio dhe një skulptor tjetër G. H, që ish agjent i Sigurimit, një nga agjentët më aktivë.³⁵

Në raste të tjera, vetëcensurimi ishte parashkalla për gjestin tjetër ekstrem: vetëvrasjen si akt final i mungesës së rrugëdaljes dhe çlirimi prej makthit të burgimit të sigurt: «Isha si në alarm. Ndjenja e vetëmbrojtjes më ish zgjuar si e një kafshe. Ajo që më vinte shpesh në mend ish vetëvrasja. Ajo i zgjidhte të tëra. Llogarit efektin, ndofta do ju vijë keq kur të dëgjojnë se vrau veten dhe do t'i lënë rehat babanë, motrat, vëllanë.³⁶

Shënjimi i trupit

Shëtitja që na ofrojnë shkrimet e burgut nëpër skutat që vetëm ato dinë të nxjerrin në dritë na imponon një ndalesë të detyrueshme te zëri ‘dhunë’, qoftë kjo verbale³⁷ apo fizike, pasi asnjëra nuk ia ka lakmi shoqes larminë e metodave të torturës. Qoftë edhe vetëm përshkrimi i privimit prej nevojave fiziologjike - *Ah, zotni Dul, ju nuk jeni njerz! E si i pengohen një njeriut ose edhe një shtasës nevojat fiziologjike për 30 orë?*³⁸ – është i mjaftueshëm për të paraqitur fuqinë e antinjeriut mbi njeriun. Ky antinjeri që paradoksalisht kishte ambicie të ishte njeriu i ri, kishte si karburant një urrejtje që ushqejte sistematikisht me gjak, thuajse kishte nevojë që nëpërmjet kësaj të afirmonte ekzistencën e tij, por në të njëjtën kohë edhe besnikërinë e tij, e dalëngadalë përkatësinë e tij në një status tjetër, atë të shtazës.³⁹ Në një panoramë aktesh

³⁵ M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 55.

³⁶ M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 88.

³⁷ Koço Josifi at Zef Pllumit: «Dëgjo Zef, nuk e di pse të mbron drejtorja e Shkodrës, mbasi ti meriton që ta thyenim ne kokën atje në Tiranë ...», Z. Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, 521; «Po ashtu thua ti, i poshtër! Që na nxehesh këtu! Apo rebelë ju, poetët! S’të mbajnë nervat, ngaqë e di se je fajtor. Armik, agjent i poshtër!», V. Zhiti, *Rrugët e ferrit*, 43; «Megjithëse termi Armik në krahasim me shprehjen Element Shoqërisht i Rrezikshëm duket shumë më i ashpër çuditërisht mua më tronditi shumë shprehja në fjalë», M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 180.

³⁸ Z. Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, 95.

³⁹ «Kur njerëzit duen me përbuzë një shoq të vetin i thonë ‘shtazë’, Z. Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, 627.

çnjerëzore që përfshin rojet e burgut, ushtarët, policët, oficerët e deri te hetuesit; dëshmitë, të cilat shpeshherë akuzojnë emra të përveçëm shprehin:

- sistematicitetin e dhunës dhe intensitetin e egërsisë së saj⁴⁰:

- paparashikueshmërinë e llojit të torturës⁴¹;

- bashkëpjesëmarrjen në torturë (disa kundër njerit).⁴²

Të gjitha këto tortura shtesë, që ishin rrjedhojë e natyrshme e privimit të lirisë në burgjet shqiptare, e çnjerëzojnë ‘tipin antropologjik’ të shekullit XX. Racionimi i ushqimit, privimi seksual, goditjet, e sa e sa të tjera nuk ishin rrjedhoja të padëshiruara të të qenit të privuar nga liria; përkundrazi, ishin tortura të paramenduara, që stërholloheshin çdo ditë nga vullneti dhe dëshira individuale e çdo personi që kishte tagrin të ushtronte pushtetin.

Sipas Foucault, përdorimi i trupit si instrument, në kushtet kur njeriu është zhveshur nga çdo liri tjetër, është një përpjekje për të zotëruar edhe të mirën e fundit që i ka mbetur të burgosurit, trupin: «një pasojë e padëshiruar, por e pashmangshme e ndalimit».⁴³ Shënjimi i trupit nëpërmjet privimeve, torturave dhe punës së rëndë, nuk kishte thjesht synim të godiste trupin, por të transferonte objektivin e ndëshkimit nga trupi te shpirti⁴⁴ dhe te mendja, duke

⁴⁰ «Mbas një ore u ndigjuen persri ecje të zhurmshme nëpër korridor: u ndalën te dera jonë. Hynë mbrendë tre vetë. Kishin një sahan me krypë. Na hypën përsipër dhe përdhuni në mbushën gojen me ka një grusht krypë, mandej u kthyen në punë të vet», Z. Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, 121.

⁴¹ «Roja qeshi me të madhe, iu afrua, i këputi një shkelm në qafë me këpucën e rëndë ushtarake dhe po duke u zgërdhirë i tha: - ‘Shko nën tokë dhe na gjej ca pasuri. I mbylla sytë. Dera u përplasa dhe u mbyll përsëri me lloz. Nuk guxoja të hapja sytë. I varur siç isha, lidhur me zinxhira, nuk bëja dot asnjë lëvizje në ndihmë të profesorit». P. Marko, *Krim kundër kulturës universale*, në *Antologjia e plagëve*, 266; “Seancat e hetimit, të pa pritura, tronditëse, ndërronin nga njëra në tjetra. Duke mos pasur asnjë eksperiencë të mëparshme, mundohesha të mblidhja veten para goditjeve të vazhdueshme psikike që më jepte hetuesi Dh. Shkodrani», M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 141.

⁴² «Gjatë punës, jo shumë larg nga ne, policët dhe shërbëtorët e tyne po përpiqeshin, tue sha e tallë, me vu në kurrizin e një burri rreth 40 vjet një karro dore plot me dhe. Ishte një pamje e përditshme. Të sëmurët, pleqtë, të dobëtit, rriheshin e mundoheshin çdo ditë», S. Repishti, *Një shok dhe një mësues*, në *Antologjia e plagëve*, 587.

⁴³ Michel Foucault, *Surveilleur et punir*, Gallimard, 2013.

⁴⁴ «U shtrina me fjetë, po ku vinte gjumi? Gjithë natën e gjatë këtë herë ndeja tue luftue me Zotin. Si asht e mundun që njerzit e mirë, jo vetëm vuejnë tanë jetën, por edhe i mbysin pa faj? Ndërkaq njerzit e kqij, tiranët gjakatarë, gëzojnë të gjitha të mirat!», Z. Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, 524; «Duke u përpirë nga puna dhe frika e saj, na ikën ca trallisja e fundit e boshatisemi nga gjithçka, dhe nga skeletet. O normën, o shpirtin! Të dyja bëhen, po ç’i bëni pastaj shpirtrat tanë?», V. Zhiti, *Rrugët e ferrit*, 552.

prodhuar një individ të çoroditur nga traumat, por edhe një shumatore individësh të pangjashëm me njëri-tjetrin.

Shkrimet e burgut na thonë se spektri i individëve që popullojnë burgjet e komunizmit krijon një vitrinë personazhesh, që asnjë libër fantazie nuk i vë dot bashkë: i çmenduri; ai me një sy për shkak se tjetrin e ka humbur në tortura; njeriu me shpirt sa bota e me leqe të gjymtuara; njerëz pa shpirt, por me trup të fuqishëm; njerëz me kthjellime të herëpashershme, por të çmendur në më të shumtën e rasteve; të vetëshpallur të çmendur publikisht për të mbrojtur integritetin fizik; njerëz të pistë nga parazitët e të tjerë të ndyrë për nga veprat. Në thelb, të gjithë njerëz të dyzuar, tre-katërfishuar, shpënë në skajet ekzistencës si njeri, barazuar me kafshët.⁴⁵

Dedikimi që at Zef Pllumi bën në *Rno vetëm për me tregue*: «Atyne që vdiqën njerz, atyne që qëndruan njerz gjatë asaj periudhe të vështirë në të cilën njeriu u shndrrue në kafshë punë», bën antitezën mes njeriut dhe shtazës brenda tij, si dy gjendje të papajteshme edhe në një qenie të vetme. «O njeri, o shtazë!» Por ka edhe një nivel tjetër të denjë për t'u vënë në dukje, sa i përket marrëdhënies njerëzore me kafshën, që at Zef Pllumi e quan 'shkallëzim' a 'paralele'. Për të njëjtën marrëdhënie, Italo Calvino përdor nocionin «vazhdimësi». Calvino shkruan për kthimin e Uliksit në Itakë: i vetmi që e njeh menjëherë dhe spontanisht është qeni Argo, thua se vazhdimësia e individit shfaqet vetëm nëpërmjet shenjave perceptuese të syrit të shtazës.⁴⁶ Në izolimin e burgut, ku e tashmja e individit është e ngrirë, prania e kafshëve siguron 'vazhdimësinë e individit' në hapësirë dhe kohë, por fatkeqësisht në të tilla kushte, ka edhe të njëjtat fate të individit.

*Me këto fjalë nënkuptohet shkallzimi i jetës. Sipas mendimit tem jeta ka tri shkallë – bimore, shtazore e njerzore. Ende nuk kam mujtë, me atë dijen teme, me përcaktue në se janë shkallzime a po paralele. Jam përpjekë me jetue me të trija. Sot, në pleqni të shtyme, ende jam i pakjartë se sa e tmerrshme do t'ish jeta e njerzve pa shoqnin e tyne.*⁴⁷

⁴⁵ «Unë thosha jam tjetër njeri, normal – armik i askujt – mik i natyrës dhe i kafshëve – dashurues i femrave – adhurues i artit – tip i vetmuar – nuk vjedh – nuk spiunoj – i hapur. Me qenë se unë Maks Velo nuk pranoja Maksdosjen dhe ai hetuesi Dh. Sh. nuk pranonte personin e vërtetë Maks Velo, lindte një kontradiktë. Kjo sillte dhunën, kjo sillte torturat. Torturat janë aplikuar që të pranosh të bëhesh njeriu-dosje», M. Velo, *Kohë anti-shenjë*, 119; «Puna na shkatërron. Lëkura ime është e tëra prej rëre të ashpër, gjithmonë e ngrirë dhe në fytyrë s'më shqiten ca njolla djegësire. Duhet të më duken më shumë, pasi dal nga berberi. Sa herë na qethin, më duket sikur fillon rrjepja në kokë. Pastaj vazhdojnë të na rrjepin të gjithin dhe unë ndihen pa lëkurën e identitetit, me moral të kalbur», V. Zhiti, *Ferri i çarë*, 552.

⁴⁶ Cfr., I. Calvino, *Perché leggere i classici*, 18.

⁴⁷ Z. Pllumi, *Rno vetëm për me tregue*, 627.

Duket se në shkrimet e burgut ka një transferim të mistershëm, por krejt të kapshëm të cilësive njerëzore të kafshët dhe të atyre shtazore të njerëzit. Prania e kafshëve në dëshmitë nuk është as rastësore e as dytësore, është pjesë integrale e rrëfimeve, e përjetimeve, e vuajtjeve dhe e fatit të përbashkët të njerëzve dhe të kafshëve në burgjet dhe kampet e internimit. Absurdi donte që të armiku i popullit të gjendej jo vetëm te njeriu, por te çdo zgjatim i marrëdhënieve të tij, madje edhe te kafshët dhe deri edhe te bimët. Zgjatime këto që do të luftoheshin me të njëjtën egërsi të pashoqe që u rezervoheshin qenieve njerëzore.⁴⁸

Shënime përmbyllëse

Në kushtet kur institucionet përkatëse shqiptare nuk siguruan një proces të drejtë dhe të njëmendtë – komisionet *Bezhani* dhe *Mezini* ishin përpjekje të sikurshme, që nuk sollën rezultate për t'u shënuar – për të vënë rregull në kujtesën kolektive, përvoja e burgut politik nën regjimin komunist filloi të regjistrohej falë shkrimeve të vuajtësve.

Regjistrimi i kujtesës dhe i historive individuale të secilës viktimë i kthen të drejtën e fjalës vuajtësve, por në të njëjtën kohë i ofron ndërgjegjes shoqërore shqiptare një mundësi për hapje, që është sa e parehatshme – ka si parakusht sondimin e ndërgjegjes kolektive nëpërmjet sondimit të fenomenologjisë së përndjekjes nën diktaturë – aq edhe e pashmangshme. Megjithatë, ky është hapi për pjesëmarrje, rindërtim dhe përcjellje të kujtesës

⁴⁸ «Kuqo (daci) ishte bënë djali i të gjithë të burgosunve. Kjo sepse, sikur e ama dikur, edhe ky dac i bashëm, porsa jepej çanga e zgjimit kalonte te kryet e çdo të burgosuni, e për më tepër, kur rreshtoheshin n'oborr për apel dhe pritshin oficerin e rojes për numrimin, ai sillte vëmendshëm mes të gjithë rreshtave, sikur të hetonte kush mungonte. (...) E shumta e rojeve e kqyrshin me dhimbje e mirsi, ndërsa një prej tyre, që thirrej Haki, e kqyrte me inat, sepse, ai shpirti i tij nuk donte që të burgosunit të kishin më të voglin ngushllim, as nga kafshët», Z. Pllumi, *Prno vetëm për me tregue*, 629-630; «Po tregimin për dallëndyshen e plagosur që ra nga frëngjia brenda në një nga dhomat e burgut të Burrelit e dini ju? Iu mblodhën të burgosurit dallëndyshes, ia pastuan plagën e vogël sa një kokërr gruri, ia lidhën flatrën, i dhanë qumësht, ia hapën sqepin për të futur një thërmizë aspirinë, pastaj thërrime biskotash, i dhanë ujë, qumësht prapë, i grinë djathë, sallam e dallëndyshja u shërua dhe s'iku më. Aty e ngriti folenë, në qoshe të dhomës. Edhe kur komanda e prishi atë fole, dallëndyshja nuk iku. (...) duke trembur atë dallëndyshe, policia përndiqte dhe imazhet e krahëve, supeve, gushave të grave nga ne. E qëlluan për ta vvarë», V. Zhiti, *Rrugët e ferrit*, 387, «Qentë tanë bënë veprime të dënueshme politikisht në kamp. (...) Në revoltë, ah, qeni “kishte marrë pjesë aktive”, qe kacafytur me policët, i kafshonte, zhvaste rroba e mish e dekorata, lehte sa në njërin anë të përleshjeve në tjetrën. Mbas shtypjes së revoltës, gjyqi e dënoi me vdekje edhe qenin. (...) Prandaj asnjë qen në burg nuk ishte i dëshirueshëm për komandën», V. Zhiti, *Rrugët e ferrit*, 441.

kolektive si një e mirë e përbashkët: «mendoj se kujtesa kolektive, më shumë se ajo individuale, është fryt i përpjekjeve, po ashtu mendoj se popujt e kujtojnë të kaluarën vetëm nëse intelektualët dhe politikanët, mësuesit dhe artistët e njohin vlerën e kujtesës dhe luftojnë për ta krijuar».⁴⁹

Shkrimet për burgun janë dëshmi të forta që shoqëria zakonisht refuzon t'i dëgjojë; pra përveçse janë mundësi për të rindërtuar komunikimin brenda individit, janë edhe premisë për ta shtrirë këtë rrjet komunikimi në shoqëri. «Theksojmë se në veprën 'Shënime nga Shkolla e Partisë' të Daut Gumenit sheh edhe një herë, tashmë në art, atë që ndodhte në jetën e zakonshme të njerëzve të kohës. Kushdo ndjehej tërësisht i pambrojtur nëse mendonte ndryshe, nëse hapte gojën a ngrihej kundër pushtetit të diktaturës, i cili tregonte orë e çast dhëmbët».⁵⁰

Historia e burgut, edhe pse pat shumë dëshmitarë të drejtpërdrejtë: të burgosurit vetë, policët, oficerët, makinën e Sigurimit të Shtetit, prokurorë, gjykatës, roje burgu, infermierë burgu dhe familjarët e viktimave të përndjekjes, por edhe të vetë përndjekësve, ka mbetur vazhdimisht në kohë një fushë e minuar me heshtje.

Shkrimet për burgun janë një kontribut për të vënë në vend copëzën e munguar të mozaikut, por janë edhe përpjekje për të rifituar një hapësirë të mohuar, për të rifituar dinjitetin, për t'u përballur me plagë të pashëruara për shkak të shpërfilljes institucionale dhe stigmës shoqërore, por edhe për të paraqitur një subjekt autentik, që përvoja e burgut e ka tjetërsuar duke i goditur dikujt trupin e dikujt trupin dhe shpirtin. Pavarësisht nga gjinitë e ndryshme letrare që përdorin, në këto shkrime shquhen trajta përbashkuese lehtësisht të identifikueshme, që krijojnë një temë të re në letrat paskomuniste: shkrimet për burgun. Stili narrativ e më së shumti autobiografik, fton për refleksion, vetëdijesim, përgjegjësi e sidomos për ndërtimin e historive të bashkëndara.

Bibliografi

- Amato, Pierandrea. *Il nichilismo e le sue forme*. Milano-Udine: Mimesis, 2014.
- Barbero, Alessandro. "Della memoria". Në *La saggezza del vivere. Tracce di etica*, Alberto Sinigaglia (a cura di). Reggio Emilia: Diabasis, 2003.

⁴⁹ A. Barbero, *Della memoria*, në *La saggezza del vivere*, 21.

⁵⁰ Valter Memisha, *Leximi leksikografik i veprës 'Shënime nga Shkolla e Partisë të Daut Gumenit'*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2019, 13.

- Beccaria, Gian Luigi (diretto da). *Dizionario di linguistica, e di filologia, metrica, retorica*. Torino: Einaudi, 2004.
- Brodschij, Iosif. *Dall'esilio*. Milano: Adelphi, 1988.
- Buber, Martin. *Il problema dell'uomo*. Torino: Editrice elle di ci, 1983.
- Calvino, Italo. *Perché leggere i classici*. Milano: Mondadori, 1995.
- Colombo, Furio. *La immoralità del silenzio, në La saggezza del vivere. Tracce di etica*. Alberto Sinigaglia (a cura di). Reggio Emilia: Diabasis, 2003.
- Demetrio, Duccio. *Scritture erranti. L'autobiografia come viaggio del sé nel mondo*. Roma: Edup, 2000.
- Foucault, Michael. *Il coraggio della verità*. Milano: Feltrinelli, 2011.
- _____. *Il sapere e la storia. Sull'archeologia delle scienze e altri scritti*. Verona: Ombre corte, 2007.
- _____. *Surveilleur et punir*. Gallimard, 2013.
- Gjeçovi, Xhelal et al. *Historia e popullit shqiptar. Shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore dhe pas saj 1939-1990*. Vëllimi i katërt. Tiranë: Toena, 2009.
- Górny, Maciej. *From the splendid past into the unknown future: historical studies in Poland after 1989, në Narratives unbound*. Sorin Antohi, Balázs Trencsényi, Peter Apor (eds.) Budapest/ New York: CEU Press, 2007.
- Graçi, Virion. *Autobiografizmi dhe romani*. Tiranë: Botimet Albanologjike, 2015.
- Heller, Mikhail. *Cogs in the Wheel. The formation of soviet man*. New York: Alfred A. Knopf, 1988.
- Kati, Fabian (red.). *Antologjia e plagëve. Nën terrorin komunist*. Tiranë: Qendra e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës, 200.
- Krog, Antije. *Country of my skull: Guilt, Sorroë and the Limits of Forgiveness in the New South Africa*. South Africa: Random House, 1998.
- Lever, Franco & Mauro Mantovani (eds.). *Tra silenzio e parola. Percorsi di comunicazione*, Roma: LAS, 2013.
- Memisha, Valter. *Leximi leksikografik i veprës 'Shënime nga Shkolla e Partisë të Daut Gumenit'*. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2019.
- Nikolla, Albert. *Njeriu i ri shqiptar. Ndërmjet moralit komunist dhe krizës së tranzicionit*. Tiranë: Onufri, 2012.

- Nutall, Sara & Carli Coetzee. *Negotiating the past: The making of memory in South Africa*. Cape Town: OUP, 1998.
- Plangarica, Tomorr. "Rilexim i dramatikës së E. Haxhiademit si tekst dhe diskurs (prurjet në shkencat e ligjërimit, një mundësi më shumë për interpretime)". Në L. Smaqi, E. Paci, A. Leka, T. Plangarica, V. Graçi, *Studime mbi autorë e vepra të patrajuara në letërsinë shqipe*. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2022.
- Pllumi, At Zef. *Rrno vetëm për me tregue*. Tiranë: Botime 55, 2006.
- _____. *Saga e Femijnisë*. Shkodër: Botime Françeskane, 2009.
- Smaqi, Laura, Evalda Paci, Arian Leka, Tomorr Plangarica & Virion Graçi. *Studime mbi autorë e vepra të patrajuara në letërsinë shqipe*. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2022.
- Velo, Maks. *Kohë anti-shenjë*. Tiranë: Onufri, 2000.
- Zhiti, Visar. *Rrugët e ferrit*. Tiranë: OMSCA-1, 2012.

SUMMARY

Writings on prison: the features of a new literary theme in post-communism

Among all the experiences under communism, imprisonment had imprinted in people who had lived it a completely unique and distinct human condition. Giving voice to the stories of the prison becomes a service to testimony the unseen and the unheard. In the absence of a significant institutional commitment, literature turned into an alternative channel of communication for testimonies related to the political prison. When confrontation with the memory and memories of the prison is done in the first person, the narrative acquires value due to the strong personal trace that stands out from the multitude of other messages.

Unlike institutionally produced messages individual communication becomes a counter-test against the institutional message when the latter turns out to be false or is ignored in silence, as happened in Albania, under regime. Under these conditions, literature spontaneously opened up thanks to people whose writings naturally flowed into the literary channel, as an alternative mode of communication that ensures participation.

The paradigm of alternative or participatory communication is very suitable for describing the raise of another voice in literature that would take it upon itself awareness, testimony and documentation about issues of the past. It would also represented e chance to participate in a process that would denounce the structures of the past and their extension into the present.

Writings about the prison constitute an innovative thematic approach and the selection of literary creativity as a communication channel. This new voice in literature boldly takes it upon itself to deinstitutionalize silence about certain phenomena of communist society. From this perspective, we can affirm that literature donates itself as an instrument for emancipation and social participation, showing its communicative function. It gives a chance to people to evolve from being an object of history into an active subject and participant of its history, and of one's country's history.

Abdurrahim Maxhuni

**Veçori leksiko-gramatikore të termave
në Fjalor i termave të drejtësisë**

Përmbledhje

Terminologjia e drejtësisë në gjuhën shqipe është një fushë e dijes që është pasuruar në vazhdimësi. Një ndihmesë të vyer në fushën e terminologjisë së drejtësisë ka dhënë autori Sylë Kasumaj, duke botuar *Fjalor i termave të drejtësisë*, botim i Institutit Albanologjik të Prishtinës. Ndonëse nga kjo fushë janë botuar edhe fjalorë të tjerë terminologjikë, ky fjalor dallohet për prurje të shumta, dallohet për saktësi e qartësi, veçori që i japin vlerë shkencore këtij fjalori. Edhe pse autori nuk është gjuhëtar me formim, ai me këtë punë themelore e ka ndihmuar këtë fushë drejt rrugës së njësimi të standardizimit, duke përmbledhur e shpjeguar rreth 6000 terma, terma që pasqyrojnë lëvizjet e sistemit konceptor të fushës së drejtësisë, që nga pavarësimi i Shqipërisë e deri në ditët tona. Këto lëvizje, që kryesisht u ndikuan nga faktorë jashtëgjuhësorë e pasuruan fushën e drejtësisë me njësi të reja, krijime brenda shqipes por edhe huazime, përveç atyre latine që konsiderohen bazë për këtë fushë, edhe me huazimet e kohëve të fundit, sidomos nga anglishtja. Në këtë punim studimor, do të ndalemi te veçoritë leksiko-semantike në këtë fjalor, duke parë, sidomos mënyrën e ndërtimit të termave.

Fjalë kyçe: *terminologji, terminografi, gjuhë shqipe, drejtësi, Instituti Albanologjik, Sylë Kasumaj.*

Zhvillimet e mëdha që kanë ndodhur në botën moderne, që kanë përfshirë edhe hapësirat shqiptare, kanë pasur ndikim të madh edhe në lindjen, në përhapjen dhe në përdorimin e termave e të vetë sistemeve terminologjike në të gjitha fushat e dijes, të shkencës, të teknikës, të artit etj. Puna e organizuar dhe me kritere shkencore me terminologjinë në gjuhën shqipe i përket periudhës pas Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1955 u krijua Sektori i terminologjisë pranë Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë, në Tiranë, duke u ngritur edhe një komision me detyra të veçanta e të rëndësishme, si: njësimi i terminologjisë, pastrimi i terminologjisë nga fjalët e huaja dhe pasurimi me fjalë shqipe, duke synuar zgjerimin e përdorimit të kësaj terminologjie për të përballuar nevojat në të gjitha fushat e veprimtarisë materiale e mendësore. Ky sektor i dha shtysë të

madhe në rend të parë terminografisë, duke botuar disa fjalorë terminologjikë. Si rezultat u hartuan fjalorët e parë nga një komision i veçantë, me emra të njohur, si: Aleksandër Xhuvani, Androkli Kostallari, Eqrem Çabej, Selman Riza, Mahir Domi e Lirak Dodbiba. Me kalimin e viteve sektori i terminologjisë vazhdoi me botimin e dhjetëra fjalorëve terminologjikë shqip-gjuhë e huaj (zakonisht shqip - latinisht, anglisht, frëngjisht, rusisht etj), fjala vjen botimi i një radhë fjalorësh të disiplinave, si gjeografia, gjuhësia, mekanika, e drejta ndërkombëtare, financa, planifikimi, tregtia, anatomia, stomatologjia, gjinekologjia, fiziologjia etj.

Fondi terminografik i shqipes tashmë përfshin mbi 150 fjalorë terminologjikë shqip-gjuhë e huaj të fushave të ndryshme shkencore. Një vend të posaçëm në këtë grup të madh fjalorësh terminologjikë zë edhe vepra *Fjalor i termave të drejtësisë* i autorit Sylë Kasumaj, botim i Instituti Albanologjik të Prishtinës¹. Fjalori sendërtonte një punë të gjatë të autorit si një angazhim rreth 40-vjeçar dhe si rezultat i përkushtimit shkencor të tij. Si jurist me shkollim gjatë punës për përgatitjen e veprës, ai mblodhi me kujdes me qindra e qindra terma terma të kësaj fushe, dhe arriti t'i sistemojë, t'i analizojë, t'i hulumtojë, t'i shpjegojë dhe në fund t'i botojë në një vepër të vëllimshme në rreth 800 faqe.

Në këtë fjalor pjesën më të madhe e kanë zënë termat nga e drejta pozitive, si: e drejta kushtetuese, e drejta civile, e drejta tregtare, e drejta e detarisë, procedurat e falimentimit dhe e përmbarimit, e drejta penale dhe e drejta e procedurës penale, e drejta administrative dhe e procedurës administrative, e drejta ndërkombëtare publike, e drejta ndërkombëtare private, e drejta financiare, e drejta e punës etj.

Fjalori përmban rreth 6000 terma, që korrespondojnë me 6000 koncepte, por edhe shprehje, rregulla e emërtime të institucioneve të rëndësishme juridike, që pasqyrojnë një larmi të madhe tipologjike. Autori materialin e ka vjelë nga fjalorë të ndryshëm të fushës së drejtësisë, nga fjalorët shpjegues të shqipes, nga fjalorë enciklopedikë, nga tekste shkollore e universitare, nga kushtetuta, nga ligjet e nga aktet nënligjore, duke dhënë edhe shpjegimet për gjithsecilën.

Fjalor i termave të drejtësisë i Sylë Kasumajt, ashtu si fjalorët terminologjikë të fushave të caktuara të dijes, ofron në rend të parë informacione themelore e të vyera të fushës së terminologjisë juridike, ofron në të njëjtën kohë një qasje standardizuese për këtë fushë, duke e pasuruar terminografinë e gjuhës shqipe dhe duke ia shtuar vlerën asaj. Ndonëse autori në këtë fjalor nuk mëton ta ketë bërë edhe standardizimin e gjithë sistemit terminologjik të fushës së drejtësisë, ai ka bërë përpjekje që termat e huaj juridikë t'i zëvendësojë me ata shqip, pa ua humbur kuptimin e tyre

¹ Sylë Kasumaj, *Fjalor i termave të drejtësisë*, Prishtinë, 2019.

përmbajtjesor, si në shembujt *detyrimor* për *obligativ*, *shpronësim* për *eksproprijim*, *kryerës* i *veprës* për *ekzekutor* i *veprës* *ligjvënës* për *legjislator*, *kujdestar* për *tutor* etj. Në disa raste autori ka dhënë shpjegime dhe për sinonime, të cilët përdoren dhe kanë zënë vend në terminologjinë juridike, si *e drejta sendore* dhe *e drejta reale*, *shpërblim* i *dëmit* dhe *kompensim* i *dëmit* etj. Përveç zëvendësimit të termave të huaj me ata shqipe, autori ka përfshirë edhe mjaft terma me bazë latine, e të cilët kanë përdorim të gjerë edhe ndërkombëtar, si: *presumim*, *posedim*, *ratifikim*, *kontratë*, *civil*, *inkriminim*, *agresion*, *bilateral* etj. Fjalori përmban edhe terma latinë, shqipërimi i të cilëve ndoshta është i vështirë ose i pamundur për shkak të natyrës së përdorimit të tyre, si: *a contrario* (e kundërta), *a priori* (që më parë), *ipso facto* (nga vetë fakti), *ipso iure* (sipas së drejtës), *ad hoc* (për këtë rast) etj.

Ndonëse thamë se ky fjalor nuk mëton të bëjë standardizimin e termave, ai do të ndihmojë për pasurimin dhe njësimin e terminologjisë së drejtësisë si dhe për saktësimin e termave të drejtësisë në komunikimet publike, ku shpesh përdoren gabimisht termat, si *status* për *statut*, *i akuzuar* për *i pandehur*, *i burgosur* për *i arrestuar*, *amnisti* për *falje dënimi* etj. Vlerë tjetër e këtij fjalori, ani pse më herët janë botuar edhe fjalorë të tjerë nga fusha më të ngushta të terminologjisë të së drejtës, qëndron në atë se shoqëria shqiptare ka përjetuar zhvillim të madh, sidomos pas rënies së regjimit në Shqipëri e çlirimit të Kosovës nga pushtuesit, duke çuar në një riorganizim të përgjithshëm të sistemit të drejtësisë në këto dy vende. Kjo ka ardhur si rezultat i nevojës për koncepte të reja terminologjike, për rishikimin e atyre të vjetrave me përmbajtje moniste e ndikime nga serbishtja zyrtare në Kosovë.

Veçori të formimit të termave në këtë fjalor

Sistemi leksikor është pjesa më e gjallë e gjuhës, e cila vazhdimisht pëson ndryshime, ndryshime që lidhen me zhvillimin e shoqërisë, duke u pasuruar me fjalë e shprehje të reja. Pjesë e këtij leksiku të përgjithshëm është edhe leksiku terminologjik, që funksionon brenda leksikut të përgjithshëm të gjuhës, duke bashkëvepruar e duke qenë në lidhje të ngushta me gjuhën. Kjo lidhje shfaqet me dukurinë e pranisë së një fjale a emërtimi në ligjërimin e përgjithshëm dhe në ligjërimin e veçantë, apo terminologjik, në të njëjtën kohë. Në kuadër të leksikut terminologjik fusha e së drejtës paraqet interes të vazhdueshëm, sepse ajo zhvillohet e pasurohet me shpejtësi, duke u ndikuar nga kërkesat e kohës, por edhe se kjo fushë ka një përdorim të gjatë e të hershëm, madje është pasqyruar edhe në fjalorët e hershëm të shqipes, siç është ai i Bashkimit dhe i Kristoforidhit, por edhe në veprat e para në gjuhën shqipe, me terma të kësaj fushe, si: *besë*, *e drejta*, *gjakatar*, *gjakatës*, *gjakës*, *gjakmarrës*, *gjakmarrje* etj. Pasurimi i kësaj fushe me terma ka zanafillë edhe më të hershme sesa në fjalorët e përmendur. Ajo është brumosur në traditën fisnore shqiptare, në

kohën kur nuk ka ekzistuar shteti e ligji. Nevoja për t'i zgjidhur kontestet e ndryshme shoqërore, ka nxitur edhe lindjen e termave të kësaj fushe.

Shumë nga termat e përfshirë në *Fjalor i termave të drejtësisë* pasqyrojnë këtë mendësi të hershme, me terma e shprehje të kësaj fushe. Vend të rëndësishëm, zënë mënyrat e ndërtimit të njësive të saj, mjetet e gjedhet termformuese, të pasqyruara në praktikë në këtë fjalor. Mënyrat e ndërtimit të terminologjisë së kësaj fushe janë po ato që i gjejnë edhe në fushat e tjera të dijes, si rruga semantike, morfologjike, sintaksore, si dhe përmes shqipërimit e huazimit. Rruga semantika ka bërë me krijimin e termit mbi bazën e kuptimit të fjalës së zakonshme, duke i marrë veçoritë e termit, si **afat** – *koha e caktuar për të bërë diçka ose caku kohor kur duhet të fillojë a të mbarojë një punë*.² Ndërsa në fushën e drejtësisë merr kuptim terminologjik: *çasti i caktuar, nga i cili fillon ose pushon fuqia juridike e një veprimi juridik ose disa nga efektet e tij në një marrëdhënie juridike*,³ **afekt** – *gjendje shpirtërore e shqetësuar nga një ndjenjë e fortë zemërimi, frike, dashurie etj.*,⁴ në fushën e drejtësisë: *gjendje shpirtërore tronditëse, kur personi e kryen veprën penale në këtë gjendje, kjo mund të reduktojë akuzën ose aktpadinë dhe mund të merret si rrethanë lehtësuese*; **akt** – *veprim i menjëhershëm me një qëllim të caktuar, vepër, punë*.⁵ Në terminologjinë e drejtësisë: *veprim i njëhershëm i njeriut që bëhet për një qëllim të caktuar: vepër, vendim shtetëror a zyrtar, dokument*;⁶ **apelim** – *thirrje e të tjerëve për ndihmë a përkrahje*.⁷ Në terminologjinë e drejtësisë: *të drejtuarit një gjykatë më të lartë për të rishikuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët*.⁸

Mënyra morfologjike e pasurimit të leksikut terminologjik me njësi të reja të kësaj fushe, del mjaft e pasur në këtë fjalor. Kjo mënyrë është më prodhimtare në çdo fushë terminologjike, duke ndjekur rrugën e njëjtë të pasurimit sikur leksiku i përgjithshëm, por me specifikat e veta, si një leksik i specializuar, duke u zbërthyer nga ana termformuese dhe karakterizohen me lloje të ndryshme, si të prejardhura, me ndajshtesa, me parashtesim e prapashtesim, të përngjitura etj. Në përgjithësi përdorimi i mjeteve termformuese të pasqyruara në këtë fjalor i ka veçoritë e veta, që shfaqen në anën sasiore, duke ndikuar në numër më të kufizuar mjeteve termformuese, sepse termat zhvishen nga ngarkesat stilistike-emocionues, gjë që e kufizon

² Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f. 28.

³ Sylë Kasumaj, *Fjalor i termave të drejtësisë*, Prishtinë, 2019, f. 22

⁴ Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f. 28.

⁵ Po aty, f. 34.

⁶ Sylë Kasumaj, *Fjalor i termave të drejtësisë*, Prishtinë, 2019, f. 26.

⁷ Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f. 46.

⁸ Sylë Kasumaj, *Fjalor i termave të drejtësisë*, Prishtinë, 2019, f. 56.

përdorimin e ndajshesave, të cilat bartin vlera stilistiko-emocionuese e figurative. Mbizotërojnë parashtesat:

anti: *antikreuzë, antizemitizëm, antikushtetues, antiligjor* etj.

bashkë: *bashkautor, bashkëdetyrim, bashkëdorëzanim, bashkëfajësi, bashkëfajtor, bashkëjetësë, bashkëpadi, bashkëpjesëmarrje* etj.

kundër: *kundërekzekutim, kundërligjshëm, kundërligjshëmëri, kundërpadi, kundërshtim i atësisë, kundërvajtje,*

mos: *mosbërje, mosbindje, mosnjohje, mosveprim, de-, ???, të cilat shprehin veprime ose kuptime konkrete e abstrakte.*

pa: *paaftësi, paanësi, paanshmëri, pabesi, pacenueshmëri, padijeni, paprekshmëri, papërgjegjësi* etj.

ri- *rifitim, riatdhesim, rigjykim, riintegrim, risocializim, rishikim, rivendosje, rizgjedhje, rivendikim* etj.

Me interes dalin edhe formimet me prapashtesa:

-si: *papunësi, parregullsi, pashtetësi, pleqësi, pronësi, shkurorëzim, shtetësi, zhvlerësim,*

-(t)ar: *arbitrar, autoritar, mandatar, qeveritar, qytetar, plenar, pleqnar, sekretar* etj.

-im: *abuzim, abrogim, adoptim, aktvendim, burgim propozim, sanim, sanksionim, sigurim, simulim, spekulim, strehim shërbim, shpërdorim, shpërblim, shtrëngim, vendim, veprim, zbulim* etj.

-ion: *agresion, aksion, sesion* etj.

-je: *arratisje, blerje, braktisje, shpallje, shpikje, shpifje, shtytje, thirrje, udhëheqje, vërejtje, vjedhje, zgjedhje* etj.

-or: *agresor, aksesor, atentator, dytësor, fajtor favor, ligjor, martesor, sektor* etj.

-zëm: *absolutizëm, antisemitizëm, atavizëm, stigmatizëm, terrorizëm, totalitarizëm* etj.

-zim: *shfrytëzim, shkurorëzim, viktimizim* etj.

Përbërja termformuese e termit përfshin si termat emra dhe termat që dalin në pjesët e tjera të ligjëratës, duke krijuar vargje terminologjike. Krijimi i vargjeve të tilla mbi bazën e një rrënje të përbashkët, ose krijimi i çerdhes së termave, është karakteristikë e terminologjisë në përgjithësi. Ato i përshtaten strukturës gramatikore të shqipes.

Shumica e termave të përfshirë i përkasin kategorisë gramatikore të emrit, por nuk mungojnë as mbiemrat e as foljet, ndonëse me përqindje shumë të vogël, si: *i akuzuar, i arrestuar, depozitues, i dëmtuar, i dënuar, i disponueshëm, i dyshuar, fiktiv, fisnik, ilegal, i ligjshëm, madhor, meritör, fajtor, i mitur, i pafajshëm, i paditur, pajtues, i siguruar* etj., dhe folje, si: *mërgoj, uzurpoj* etj.

Numër i madh i termave janë kompozita, që i përkasin pjesëve të ndryshme të ligjërates, si: *aktakuzë, aktgjykim, aktvendim, bashkëfajtor, bashkëfajësi, letërthirrje, ligjvënës, ligjvënie, llogaridhënie, mandatarkëtim, mandatpegesë, pengmarrës, projektligj, pushtetdhënës, shitblerje, vendvotim, vendshikim, vetëgjyqësi, vetëmbrojtje* etj.

Shumë nga termat krijojnë edhe vargje terminologjike, si:

afat: *afat i ankimit, afat i kërkueshmërisë së detyrimit, afat i parashkrimit të padisë kundër veprimit juridik, afat parashikimi, afat pezullues, afat procedural, afat zgjidhës* etj.

akt: *akt administrativ, akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, akt administrativ detyrues, akt administrativ dobipurës, akt i paligjshëm juridik, akt i pavarur juridik, akt arbitrar juridik, akt gjyqësor, akt juridik, akt kriminal, akt kushtetues* etj.

aktgjykim: *aktgjykim detyrues, aktgjykim dënues, aktgjykim fajësues, aktgjykim formal, aktgjykim i pjesshëm, aktgjykim në mungesë, aktgjykim penal, aktgjykim përfundimtar, aktgjykim refuzues* etj.

normë: *normë juridike, normë juridike administrative, normë juridike urdhëruese, normë morale, normë shoqërore* etj.

organ: *organi gjyqësisë, organ legjislativ, organ i kujdestarisë, organi kundërvajtjes, organ i zbatimit të ligjit, organ përmbarues* etj.

padi: *padi detyrimi, padi kërkuese, padi mohuese, padi për dëmshpërblimin e dëmit të shkaktuar me qëllim, padi për të ardhurat* etj.

vetë: *vetëmbrojtje, vetëqeverisje, vetëpunësim, vetëvendosje,*

veprim: *veprim juridik i njëanshëm, veprim juridik i paligjshëm, veprim juridik i pavlefshëm, veprim juridik pa kundërshpërblim, veprim juridik për shkak të vdekjes* etj.

Këta terma për nga ana strukturore mund të jetën terma njëfjalësh e terma togfjalësh. Meqë fjalët si mjete leksikore nuk mund t'i përballojnë të gjitha nevojat gjuhësore të shoqërisë, formohen njësi më të zgjeruara gjuhësore, të pathjeshta, togfjalësha të qëndrueshëm, për të shënuar objekte, dukuri e koncepte të reja.⁹ Për shkak të rëndësisë së tyre, termat togfjalësha pasqyrohen edhe në fjalorë normativë. Në fjalor shpjegues, zërat jepen si njësi shënuese të mëvetësishme, ndërsa togfjalëshat terminologjikë nuk janë njësi shënuese të njëfjalëzuara plotësisht, janë semantikisht të njësuar, por strukturalisht të gjysmënjësuar. Megjithatë ata i zbërthejnë konceptet në mënyrë të tejdukshme e të qartë, ndaj janë bërë sot një nga mjetet kryesore për ndërtimin e termave në përgjithësi.¹⁰

⁹ Agron Duro, *Terminologjia si sistem*, Tiranë, 2001, f. 45.

¹⁰ Valter Memisha, *Termet-togfjaësh në fjalorët shpjegues të shqipes*, në: Gjendja dhe zhvillimi I terminologjisë shqipe-probleme dhe detyre, Tiranë, 2009, f. 107.

Përveç anës kuptimore, termat togfjalësh vështrohen edhe nga ana strukturore. Terminologjinë e karakterizojnë dy lloj togfjalësha terminologjikë: me dy fjalë shënuese ose togfjalësha të thjeshtë dhe me më shumë se dy fjalë shënuese, ose togfjalësha të zgjeruar, të cilët formohen nga bashkimi i termave, ose i termave e i fjalëve së bashku ose i termave togfjalësha. Përbërësit e togfjalëshit terminologjikë mund të shkojnë deri në 8, ndonëse sipas Duros ai duhet të përfshihet përmes dy termave togfjalësha, në të cilët mund të zërthehet ai.¹¹ Edhe në *Fjalor i termave të drejtësisë* togfjalëshat zënë vend të rëndësishëm. Këta terma i karakterizon një dukuri specifike që lidhet me natyrën e kësaj fushe: këtu shpesh janë pasqyruar togfjalëshat terminologjikë me burim të huaj, kryesisht nga gjuha latine, si:

accessorium sequitur principale (lat.)- sendet aksesore ndjekin fatin e sendit kryesor, dytësorja e ndjek kryesore, *acquis communautaire* (lat.) – term i së drejtës ndërkombëtare të BE-së që nënkupton tërësinë e të drejtave dhe të detyrimeve të përbashkëta që i bashkon të gjitha shtetet anëtare në BE.

actio confessoria (lat.) – padi reale juridike për mbrojtjen e servituteve.

actio doli generalis (lat.)- kërkesë për shpallje të pavlefshme të një veprimi juridik.

actio in personam (lat.) – padi për të mbrojtur të drejtat e detyrimit.

actiones bonae fidei (lat.) – padi me të cilën kërkohet që gjyqtari.

bona fide (me mirë besim) të precizojë detyrimet e palëve në kontekstin gjyqësor.

actor dicitur qui prius ad iudicium (lat.) – konsiderohet paditës ai që e ka nisur procesin.

beneficium cohaesionis (lat.) – formë e veçantë e ankesës ndaj aktgjykimit.

beneficium excussionis (lat.) – kundërshtim i padisë paraprake të cilën mund ta bëjë garantuesi kundër kërkesëpadisë së kreditorit kur ky e padit për kryerjen e detyrimeve për të cilat ka garantuar.

beneficium inventari (lat.) – e drejta e trashëgimisë.

clausula rebus sic stantibus (lat.) – ndryshimi i rrethanave.

compensatio necessaria est (lat.) – dëmshpërblim ligjor i domosdoshëm, detyrim ligjor i domosdoshëm.

damnum emergens (lat.) – dëm i pësuar.

essentialia negotii (lat.) elemente thelbësore të veprimit juridik etj.

Pjesa tjetër e togfjalëshave përbëhen nga fjalë shqipe, por edhe fjalë të huaja e shqipe së bashku, si:

afat i parashkrimit të padisë kundër veprimit juridik – afat ligjor brenda të cilit duhet të ngrihet padia për pavlefshmërinë e veprimit të caktuar juridik.

¹¹ Agron Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009.

afat i kërkueshmërisë së detyrimit – afati, koha, momenti kur kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori përmbushjen e detyrimit.

akt administrativ absolutisht i pavlefshëm – lloj i aktit administrativ, i cili për shkak të shkeljes thelbësore të ligjit nuk e ka fuqinë juridike të një akti administrativ të vlefshëm dhe konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar për asnjë çast.

aktgjykim në bazë të heqjes dorë - aktgjykim të cilin e merr gjykata kontestimore kur paditësi heq dorë nga kërkesëpadia.

akuzë penale – aktivitet procedural i paditësit të autorizuar, i cili ka të bëjë me veprimet e llojllojshme procedurale.

delikt në të drejtën penale – çdo veprim i kundërligjshëm për të cilin është paraparë dënimi, palë në kontestin kushtetues – para gjykatës kushtetuese, që ka për objekt vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë ka dy palë kryesore: propozuesi dhe kundërpropozuesi.

regjistër për të drejtat e pronës së paluajtshme – regjistër publik i krijuar sipas ligjit për themelimin e regjistrit mbi të drejtat e pronës së paluajtshme, i cili administrohet nga agjencia kadastrale etj.

Ndërsa sipas elementeve që kombinohen, dallohen këto lloje:

Fjalë + fjalë

abuzim pushteti, afat parashkrimi, afat zgjidhës, anije luftime, anije spitalore, banim i përhershëm, banim i përkohshëm, bashkim çështjesh, detyrë qytetare, detyrim i natyrshëm, largim nga puna, liri e shprehjes, liri e shtypit etj.

Fjalë + term ose term + fjalë

afat zyrtar në procedurë, fillim i procedurës kontestimore, fletëparaqitje kundërvajtëse, funksion legjislativ, gjendje flagrante, gjykatë civile, heqje dorë nga padia, autorizim i kufizuar, krim i rëndë, kujdes prindëror, aktakuzë e drejtpërdrejtë, analogji e ligjit etj.

Term + term

afat procedural, gjykatë e apelit, gjykatë kushtetuese, imunitet diplomatik, imunitet parlamentar, arrestim në flagrancë, kallëzim penal, kamatë kontraktore, klauzolë arbitrazhi, kod civil, kontratë shpedicioni etj.

Në këtë fjalor janë pasqyruar edhe një numër termash të huaj, kryesisht latinë, që kanë një përdorim të gjerë edhe në gjuhët e tjera ndërkombëtare, si: *a contrario* (lat.) – e kundërta, *a fortiori* (lat.) – për një arsye më tepër, *a posteriori* (lat.) – që pason, që vijon (pas një veprimi juridik), *a priori* (lat.) – që më parë, që në fillim, *a vista* (lat.) – me të parë, *ab initio* (lat) – nga fillimi, *abandon* (lat.) – braktisje, *beneficium* (lat.) – e drejtë, privilegj, lehtësira, *bona fides* (lat.) mirëbesim, *caput* (lat.) – status i plotë juridik i qytetarit në të drejtën romake, *casus* (lat.) – rast, *causa* (lat.) – arsyeja, *coimperium* (lat.) –

bashkëpronësi, bashkëqeverisje, *de auditu* (lat.) – me të dëgjuar, *de facto* (lat.) – në fakt, realisht, *de iure* (lat.) – prej së drejtës, nga e drejta, *fides* (lat.) – ndershmëri, ndërgjegje, *incognito* (lat.) – i panjohur, *intestatus* (lat.) – pa testament, *legis* (lat.) – ligje, rregulla, *persona* (lat.) – person, individ, palë, *qorum* (lat.) – kurum, sasi e nevojshme, *usus* (lat.) – e drejtë përdorimi, e drejtë sendore (reale) etj.

Me interes dalin edhe shprehet dhe rregullat juridike me bazë latine, të cilat përdoren edhe në gjuhë të tjera, e me të cilat autori mëton të japë një ndihmesë me vlerë për shqipërimin, njësimin dhe pasurimin e terminologjisë juridike, për përdoruesit e fjalorit, si: *aberratio criminis* – vepër penale e kryer në lajthim, *abstentia causalis* – mungesë e arsyeshme, *actio negatoria* – padi për pengim të pronësisë, *arumentum a contrario* – argument i së kundërtës, plotësim i zbrazëtirës juridike, *beneficium appellationis* – e drejta për ankesë, apelim, *bona immobilia* – pasuri e paluajtshme, *charta non erubescit* – letra duron gjithçka, nuk i vjen keq, nuk skuqet, *contra factum non datur argumentum* – kundër fakteve nuk mund të ekzistojë argumentimi, *depositio testium* – deklaratë e dëshmitarit, *error communis facit iu* – lajthimi i përgjithshëm krijon të drejtën, *finis sanctificat media* – qëllimi arsyeton mjetet, *locus delicti* – vend i krimit, *modus acquirendi* – fitimi i pronësisë nga pasardhësi, *vacatio legis* – pritje ligji, *vis legis* – forcë e ligjit, *voluntas legis* – vullneti i ligjit etj.

Në vend të përfundimit

Autori Sylë Kasumaj, fushën e terminografisë shqipe e ka pasuruar me një vepër të plotë nga fusha e drejtësisë. Si nga struktura, ashtu dhe nga përmbajtja, por dhe nga shpjegimi i termave, autori e ka çuar përpara këtë fushë, e cila është pasuruar dhe vazhdon të pasurohet me terma të rinj. Ndonëse nuk ka qenë qëllimi i autorit të standardizojë këtë terminologji, ky fjalor ka dhënë një ndihmesë të vyer po në këtë fushë, dhe ka krijuar një bazë shumë të mirë me rreth 6000 terma për njësimin e standardizimin e terminologjisë të së drejtës. Ky fjalor përfshin edhe dimensionin historik të fushë së drejtësisë shqiptare, që nga Statuset e Shkodrës, nga e drejta romake, bizantine, sllave e osmane si dhe periudha kanunore e shqiptarëve e deri te e drejta e kësaj kohe, duke përdorur ligje, kushtetuta, me një fjalë legjislacionin ligjor në Kosovë e Shqipëri. I gjithë ky material i konsultuar dhe i përfshirë në këtë fjalor, e bën një vepër të veçantë dhe shumë të rëndësishme në fushën e terminologjisë të së drejtës. Terminologjia juridike, siç është e njohur, bazën e ka te gjuha latine, andaj autori dhe në këtë fjalor ka përfshirë një numër të konsiderueshëm të kësaj terminologjie, me bazë latine, që shkon në mbi 1000 terma, duke e pasuruar me fjalë e shprehje të përdorshme në praktikën juridike. Fjalori sjell informacione

të çmueshme dhe shërben si bazë e mirë për të gjithë të interesuarit që merren me këtë fushë.

Literaturë

- Duro Agron. *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*. Tiranë, 2009.
- _____. *Terminologjia si sistem*. Tiranë, 2001.
- Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006.
- Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe-probleme dhe detyra, konferencë shkencore, Tiranë, 2009.
- Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi, punime nga Sesioni shkencor i mbajtur në Prishtinë, më 1988. Prishtinë, 1988.
- Kasumaj, Sylë. *Fjalor i termave të drejtësisë*. Prishtinë, 2019.
- Maxhuni Abdurrahim. *Leksiku terminologjik islam në gjuhën shqipe*. Prishtinë, 2023.
- _____. *Terminologjia e kompjuteristikës në gjuhën shqipe*. Prishtinë, 2020.
- Memisha, Valter. “Termat-togfjalësh në fjalorët shpjegues të shqipes”. Në: *Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe – probleme dhe detyra*. Tiranë, 2009, f. 106-122.
- Pasho, Hëna. *Probleme gjuhësore të terminologjisë në gjuhën shqipe*. Tiranë, 2017.

SUMMARY

Grammatical - lexical features of the terms within the Dictionary of Legal Terms

Some time ago, the Institute of Albanology of Prishtina released *the Dictionary of Legal Terms*, a significant and largely comprehensive work in the Albanian language that enhances this area of knowledge. Terminological dictionaries in specific fields, such as this one authored by Sylë Kasumaj, primarily provide essential and valuable insights into legal terminology while simultaneously offering a standardizing approach to this domain, thereby enriching the terminology of the Albanian language and increasing its value. Although the author does not claim that this dictionary has achieved full standardization, he has made a concerted effort to replace foreign legal terms with their Albanian equivalents, ensuring that their substantive meanings are preserved, as illustrated by the examples of *detyrimor* [mandatory, obligatory]

for *obligativ* [obligatory], *shpronësim* for eksproprijim [i.e. both meaning expropriation], *doer* of the deed for *executor* of the deed, *lawmaker* for *legislator*, *guardian* for *tutor*, and so forth. In certain instances, the author has offered clarifications for synonyms that are utilized and have assumed their roles in legal terminology, including *property law and real law*, *awarding damage rights and damage compensation*, among others. In addition to replacing of foreign terms with Albanian equivalents, the author has also incorporated numerous Latin-derived terms that are commonly used internationally, such as: *presumption*, *possession*, *ratification*, *contract*, *civil*, *incrimination*, *aggression*, *bilateral*, and so forth. The dictionary additionally includes Latin terms for which the Albanian translation may be challenging or even unattainable due to nature of their usage, such as: *a contrario* (the opposite), *a priori* (that is, before), *ipso facto* (by the fact itself), *ipso iure* (according to law), *ad hoc* (for this case), etc.

In this dictionary, most of the terms originate from positive law, including: constitutional law, civil law, commercial law, maritime law, bankruptcy and enforcement procedures, criminal law and criminal procedure law, administrative law and administrative procedure law, public international law, private international law, financial law, labor law, etc.

The dictionary comprises approximately 6000 terms, each corresponding to a distinct concept, along with expressions, rules, and names of significant legal institutions, showcasing considerable typological diversity. The author has gathered the material from a variety of dictionaries related to justice, including explanatory dictionaries of Albanian, encyclopedic dictionaries, school and university textbooks, the constitution, laws, and sub-legal acts, providing detailed explanations for each entry. While it has been stated that this dictionary does not claim to standardize the terms, it will contribute to the enrichment and unification of justice terminology, as well as to the clarification of legal terms in public communications, where terms such as *status* for *statute*, *accused* for *defendant*, *prisoner* for *arrested*, *amnesty* for *pardon*, and others are often used incorrectly. Another significant value of this dictionary, despite the existence of other dictionaries focused on more specific areas of legal terminology that were published earlier, is that Albanian society has undergone substantial development, particularly following the collapse of the regime in Albania and the liberation of Kosovo from the invaders. This has prompted a comprehensive reorganization of the justice systems in both countries. Consequently, there has been a need for new terminological concepts and a reassessment of outdated terms that possess monistic meanings, as well as influences from the official Serbian language in Kosovo.

This dictionary encompasses the historical aspect of Albanian justice, tracing its roots from the Statutes of Shkodra, through Roman, Byzantine, Slavic, and Ottoman law, as well as the Code [*Kanun*] period of the Albanians,

to contemporary legal frameworks, utilizing laws and constitutions, essentially covering the legal legislation in Kosovo and Albania. The comprehensive material referenced and incorporated in this dictionary renders it a unique and highly significant contribution to the field of legal terminology.

PROBLEME DHE DISKUTIME

Emil Lafe

Rregulla drejtshkrimore që i ka shkelur koha *

Përmbledhje

Në përcaktimin e rregullave të drejtshkrimit të shqipes, po ashtu edhe të përjashtimeve nga rregullat, është marrë parasysh dendur ecuria e praktikës gjuhësore. Disa çështje për të cilat nuk ka pasur

* Shënim i autorit: *Prej shumë kohësh po merrem me plotësimin, saktësimin dhe përmirësimin e rregullave të drejtshkrimit të shqipes, për hartimin e të cilave kam pasur nderin të punoj së bashku me profesorët e mi E. Çabej, M. Domi e A. Kostallari. Përherë gjatë kësaj pune më është dukur se jam përpara tyre në një provë të vështirë. Jam përpjekur të bëj më të mirën sipas përvojës që kam fituar dhe shkollës që kam bërë pranë tyre që nga viti 1961, kur filloi hartimi i projektit “Rregullat e drejtshkrimit të shqipes”, që u botua më 1967, dhe më pas gjatë viteve të diskutimit të tij deri në Kongresin e Drejtshkrimit e sidomos gjatë punës për redaktimin përfundimtar të “Drejtshkrimit të gjuhës shqipe” (1973). Siç jam shprehur edhe tjetër herë, koha ka treguar se rregullat e drejtshkrimit të shqipes në tërësinë e tyre janë të qëndrueshme e racionale. Sipas bindjes sime, në fushën e drejtshkrimit ka punë për një limë të hollë dhe për disa plotësime e saktësime. E vetmja rregull e rëndësishme që ka nevojë për ndryshim, është ajo e paragrafit 37 “Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj”. Sot janë të gjitha rrethanat kulturore e arsimore që lidhur me emrat vetjakë të huaj të rikthehet praktika e mëparshme e shkrimit të tyre sipas origjinalit, në pajtim edhe me praktikën e gjuhëve të tjera europiane e më gjerë, që shkruhen me alfabetin latin. Por krahas kësaj në shkrimin e emrave të përveçëm të huaj dalin edhe shumë çështje më të vogla ose anësore, të cilave jam përpjekur t’u gjej një zgjidhje sa më të arsyeshme. Botimi i këtij redaktimi të ri të rregullës në fjalë në revistën “Studime filologjike” shpresoj se do të japë shkas për rrahje mendimesh në numrat e ardhshëm. Dëshiroj të shpreh paraprakisht mirënjohjen time të çiltër për çdo vërejtje e sugjerim që do të shprehin lexuesit e këtij varianti të ri të rregullës së paragrafit 37 të “Drejtshkrimit të gjuhës shqipe”.*

rregulla unike, janë njësuar më parë në praktikë dhe janë sanksionuar më pas në kodin e drejtshkrimit, p.sh. njësimi i shkrimit të bashkëtingëlloreve të zëshme fundore, d.m.th. mënjanimi i trajtave si *zok, gjemp, oris, zoq* etj. (që mund të përdoreshin paralelisht me *zog, gjemb, oriz, zogj*) u arrit më parë në praktikën e gjuhës së shkruar e pastaj u sanksionua si rregull (më 1956). Vetë autorët e projektit të drejtshkrimit të vitit 1951 pohojnë se “duke u shkruar gjuha e duke u përdorur si mjet kulture e marrëdhëniesh shoqërore, ka marrë një rrugë të mbarë në punë të zhvillimit e unifikimit të saj, janë kristalizuar thuajse pakuptueshëm disa rregulla ...”. Ky vëzhgim i atëhershëm vlen edhe për kohën tonë. Praktika gjuhësore sidomos nga fundi i shekullit të shkuar e deri sot tregon se dy-tri rregulla të kodit drejtshkrimor të vitit 1973 (dhe ndonjë përjashtim) duhen riformuluar, duke marrë parasysh përdorimin e sotshëm në gjuhën e shkrimit. Në këtë artikull bëhet fjalë për disa rregulla drejtshkrimore që praktika i ka tejkaluar dhe propozohet përditësimi i tyre.

Fjalë kyçe: *rregulla drejtshkrimore, përdorimi gjuhësor, praktika shkrimore, përdorimi i shkronjës së madhe, shkrimi i emrave të huaj vetjakë, alfabeti latin*

I. LIDHUR ME DREJTSHKRIMIN E FJALËVE EUROPE, EUROPIAN DHE ZOT

1. Në “Drejtshkrimin e gjuhës shqipe” (1973) është përcaktuar se shkruhet *Evropë* dhe *evropian* e po kështu edhe fjalë të tjera të formuara prej tyre, si *evropianizoj*. Këto fjalë janë dhënë si përjashtime të rregulla që përcakton se “fjalët dhe emrat e përveçëm kryesisht me burim grek, latin a iliro-trak shkruhen dhe shqiptohen me **au, eu**, si: *autokton, autoritet, kozmonaut* etj.; *eufori, leukocite, neutron, pleurit, reumatizëm* etj.; *Aurora, Centaur-i, Glauk-u; Euripidi, Eubeja, Teuta* etj. Trajta *Evropë, evropian* i përgjigjet shqiptimit të greqishtes (*Evropi*) e deri diku edhe të turqishtes (*Avrupa*), po ashtu të gjuhëve të tjera fqinje ballkanike (bullgarishtja, serbishtja). Prandaj kjo trajtë fonetike **Evropë** u përhap në mbarë shqiptimin popullor. Kjo trajtë u pranua edhe në gjuhën e shkruar. Në fjalorin historik të shqipes të S. E. Mann-it¹, që mbështet te gjithë fjalorët e mëparshëm dhe në burime të tjera të paraluftës, gjejmë vetëm *Evropë, Evropas, Evropjan* (jo *Europë*).

Te udhëzuesit drejtshkrimorë të viteve 1948, 1951 e 1956 shkrimi i fjalëve me **au, eu** nuk është trajtuar dhe kështu as për *Evropë* e *evropian* nuk mbahet ndonjë qëndrim. Por te “Fjalor i gjuhës shqipe” (1954) gjejmë dy trajta:

¹ Mann, Stuart E.: *A historical albanian-english dictionary*. Longmans, Green and Co. LTD. London, 1948, 601 f.

europian (si trajtë kryesore) dhe *evropian*. Trajta e dytë ka qenë mbizotëruese në përdorim dhe prandaj te projekti i vitit 1967 e më pas edhe te “Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe” (1973, § 36 d), ku është trajtuar së pari rregulla e shkrimit të fjalëve të huaja me **au**, **eu**, fjalët *Evropë* e *evropian* janë caktuar si përjashtime bashkë me *nevralgji*, *nevralgjik*, *nevraseni*, *nevrasenik*, *nevrik*, me shpjegimin “në pajtim me shqiptimin e ngulitur prej kohësh”. Kështu janë shkruar këto fjalë edhe te “Fjalor i gjuhës së sotme shqipe” (1980) dhe te varianti i shkurtuar i tij (“Fjalor i shqipes së sotme”, 1984). Në variantin e ripunuar të këtij të fundit (Botimet Toena, 2002) janë shtuar fjalët *euro*, *-ja* dhe *euroatlantik*, *-e*, të shkruara me **eu** si fjalë të reja të huaja, por më anë tjetër po aty gjejmë: *evropian*, *evropianizoj*, *evropianolindor*, *evropianoperëndimor*, *indoevropian*, në pajtim me “Drejtshtkrimin”. Te “Fjalor i gjuhës shqipe” (2006) ka një zhvillim të ri: përveç *euro* e *euroatlantik*, janë shtuar edhe *euroçek*, *eurodeputet*, *europarlamentar*, *europërëndimor*, *europol*², *eurovizion*. Te botimi më i ri i këtij fjalori (2020) të gjitha fjalët e mësipërme janë shkruar me **eu**, duke shtuar edhe *eurozonë* (aksidentalisht te ky fjalor mungon fjala *europian* si emër a mbiemër). Kësaj liste me fjalë që përmbajnë rrënjë *eur-*, mund t’i shtohen edhe emrat e përveçëm *Euratom*, *-i* dhe *Eurazi*, *-a*.

Sot në shtyp, në dokumente zyrtare etj., janë mbizotëruese trajtat me **eu**. Praktika e shkrimit të fjalës **Europë** dhe të gjithë fjalëve të tjera ku ajo hyn si element përbërës, e ka zëvendësuar tashmë formën e vjetër greko-sllave me *ev* me formën latine të gjuhëve perëndimore me **eu**.³ Megjithëse në shqiptim dëgjohej jo rrallë trajta *Evropë*, *evropian*, forma e shkruar me **eu** e gjithë vargut të fjalëve të mësipërme po ndikon që pak nga pak ajo të përgjithësohet edhe në shqiptim. Pra, vetë zhvillimi dhe praktika e gjuhës kanë dhënë përgjigjen për drejtshtkrimin dhe drejtshtqiptimin e fjalës *Europë* dhe të gjithë vargut të fjalëve që përmbajnë rrënjën *eur-*.

2. Te “Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe” (1973) nuk është përmendur a shkruhet me shkronjë të madhe apo me të vogël emri *Zot/zot*. Te § 75 i kreut VI (Përdorimi i shkronjave të mëdha), fjalët *allah* e *perëndi* janë cilësuar si emra të përgjithshëm dhe për këtë arsye do të shkruheshin me shkronjë të vogël. Vetëkuptohet se edhe *zot* do të shkruhej si ata. Emrat *Zot*, *Perëndi*, *Allah* shkruhen me shkronjë të madhe, kur kuptohen sipas feve monoteiste si qenia më e lartë e mbinatyrshme, e cila ka krijuar gjithësinë, botën e gjallë, njeriun dhe drejton gjithçka, p.sh.: *Le t’i lutemi Zotit/Perëndisë/Allahut; Falë*

² *Europol* dhe *Interpol* mendoj se merren si emra të përveçëm, e si të tillë nuk e kanë vendin në një fjalor shpjegues të përgjithshëm.

³ Forma me **ev-** ruhet në greqishte dhe në gjuhët sllave që përdorin alfabetin cirilik; nga gjuhët sllave që përdorin alfabetin latin, vetëm në çekishte e në sllovenishte shkruhen me **ev**: *Evropa*, *Evropan*, *evropský*; *Evropa*, *Evropejec*.

Zotit/Perëndisë/Allahut; Me shpresë te Zoti/Perëndia/Allahu; Se Zoti vetë e tha me gojë ... etj. Kur është fjala për fetë politeiste, ku nderohen shumë zota a perëndi e perëndesha, këto fjalë shkruhen me shkronjë të vogël jo vetëm në numrin shumës (p.sh. Tempull kushtuar perëndive/zotave të Olimpiti), por edhe në njëjës: Afërdita njihej si perëndesha e bukurisë; Marsi ishte perëndia⁴ e (ose zoti i) luftës; Poseidoni ishte perëndia e (ose zoti i) qiellit, e rrufeve dhe e shiut etj.

Emri *zot* dhe femërorja *zonjë* shkruhen me shkronjë të madhe kur përdoren për t'iu drejtuar në mënyrë zyrtare a me nderim personaliteteve shtetërore e të fushave të tjera, p.sh.: *Shumë i nderuar Zoti Kryeministër ... Shumë e nderuar Zonja Presidente*

Te § 82 i “Drejtshkrimi”, që përcakton se emrat e festave kombëtare e ndërkombëtare shkruhen me shkronjë të madhe (p.sh. 28 Nëntori, 8 Marsi, 1 Maji ose Një Maji, Dita e Mësuesit, Dita Ndërkombëtare e Gruas, Viti i Ri etj.) është vënë një shënim sipas të cilit emrat e festave fetare shkruhen me shkronjë të vogël. Edhe ky përjashtim sot ka rënë, ose, siç thuhet, e ka shkelur koha. Sot, ashtu si në gjuhët e tjera, shkruhen me shkronjë të madhe (edhe emërtimet me dy gjymtyrë): *Gëzuar Bajramin e Madh, Kurban Bajramin, Pashkët, Krishtlindjet a Kërshëndellat⁵, Novruzin!* ose: *Muaji i madhërueshëm i Ramazanit, Kreshmët e Mëdha, Mevludi, Nata e Kadrit, Nata e Mirë, ose E Premtja e Zezë, Java e Madhe, Ujët e Bekuar etj.*

II. SHKRIMI I EMRAVE TË PËRVEÇËM TË HUAJ

Arsyetim i shkurtër:

Gjatë Rilindjes emrat vetjakë të gjuhëve të huaja janë shkruar përgjithësisht sipas shqiptimit të tyre në gjuhët përkatëse. Arsyet kryesore për këtë besojmë se kanë qenë: a) mungesa e një alfabeti të vetëm me bazë alfabetin latin; b) vështirësia në leximin e emrave të huaj për shkak të nivelit kulturor të ulët të lexuesve. Me përgjithësimin e alfabetit latin të miratuar në Kongresin e Manastirit (1908) dhe me shpalljen e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare e shtetit të pavarur shqiptar (1913) vihet re se emrat vetjakë të huaj të gjuhëve që përdorin alfabetin latin janë shkruar sipas origjinalit. Kjo praktikë vijoi deri nga fillimi i

⁴ Emri *perëndi* është gramatikisht i gjinisë femërore, sepse thuhet: *O Perëndi e madhe!* (jo *O Perëndi i madh!*), prandaj edhe: *perëndia e luftës, e qiellit etj.* (dhe jo *i luftës, i qiellit*).

⁵ Disa emërtime festash fetare të krishtera përdoren në numrin shumës po edhe në numrin njëjës, si *Pashkët - Pashka, Krishtlindjet - Krishtlindja, Kreshmët - Kreshma;* vetëm në shumës përdoren *Kërshëndella-t, Rrëshajë-t.*

viteve '50 të shek. XX, kur u vendos që këta emra të shkruheshin sipas shqiptimit të tyre në gjuhët përkatëse, duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes. Gazetat “Bashkimi” dhe “Zëri i popullit” deri atëherë shkruanin gjenerali Dwight Eisenhower, gjenerali Charles de Gaulle, Winston Churchill, Palmiro Togliatti, Albert Einstein, Frédéric Joliot-Curie etj., por më pas këta emra u shkruan *Duajt Ajzenhauer, Sharl dë Gol, Uinston Çërçill, Toljati, Ajnshtajn, Frederik Zholio-Kyri*. Arsytet për këtë kthesë mendoj se kanë qenë: a) vështirësia në leximin e emrave të huaj për shkak të nivelit kulturor të ulët të lexuesve [Shqipëria sapo kishte dalë nga analfabetizmi (87 % më 1938) nëpërmjet kursesh kundër analfabetizmit]; b) burimi kryesor i informacionit politik dhe i literaturës shkencore u bë gjuha ruse, në të cilën emrat e huaj shkruhen me alfabetin cirilik, pak a shumë sipas shqiptimit, dhe përkthyesi shqiptar (që shumë herë njihte vetëm rusishten si gjuhë të huaj) nuk e dinte trajtën origjinale të emrit të huaj vetjak. Arsye të ngjashme kanë ndikuar që të formulohej e të zbatohet një rregull e ngjashme edhe në Kosovë e në Maqedoni (Shih “Ortografija e gjuhës shqipe”, 1964, paragrafi “Emnat e përveçëm të huej”). Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj, sidomos nga shek. XIX e këtej, është një çështje me interes gjuhësor e kulturor, që ia vlen të studiohet për periudha të veçanta me punime për master ose edhe disertacione doktorate.

Sot rrethanat historike e kulturore kanë ndryshuar rrënjësisht dhe rregulla e mësipërme, ndonëse e miratuar në Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit, nuk ndihet si detyrim për t’u zbatuar. Emrat vetjakë të huaj me burim nga gjuhët që përdorin alfabetin latin, po shkruhen gjithnjë e më shumë në trajtën e origjinalit. Por në tekstet shkollore për inerci vijon praktika e shkrimit sipas shqiptimit, p.sh. *Ajnshtajn, Herc, Lavuazje, Marks, Njuton, Shekspir, Xhejms Vat, Xhejms Xhaul* etj. Por është koha që edhe në gjuhën shqipe të zbatohet rregulla e përgjithshme: **në gjuhët që përdorin alfabetin latin, emrat vetjakë të këtyre gjuhëve shkruhen gjithnjë sipas origjinalit**. Në librat shkollorë në Turqi shkruhet: *Einstein, Heinrich Hertz, Karl Marx, Isaac Newton, William Shakespeare, James Watt, James Jaule, Robert Oppenheimer* etj., dhe mësuesi u shpjegon nxënësve si t’i shqiptojnë këta emra. Nuk ka asnjë arsye të veçantë që e njëjta praktikë të mos zbatohet edhe në shkollat shqipe, në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, në Malin e Zi dhe më gjerë.

Sot jemi në një fazë të ndërmjeme, ku, në shtypin masiv dhe në botime të tjera, nga njëra anë shkruhet, p.sh.: *Biden, Macron, Merz, Scholz, Trump* etj., dhe nga ana tjetër: *Bismark* (Bismarck), *Kastro* (Castro), *Klinton* (Clinton), *Benedeto Kroçe* (Benedetto Croce), *Kuisling* (Quisling), *Franç List* (Franz Liszt), *Karl Marks* (Marx), *Musolini* (Mussolini), *Puçini* (Puccini), *Rosini* (Rossini) etj. Por prirja drejt shkrimit sipas origjinalit është e qartë dhe e pakthyeshme. Sot shtëpitë botuese që botojnë letërsi të huaj ruajnë trajtën origjinale të emrit të autorit (*William Shakespeare* dhe jo *Uiliam Shekspir* si më

parë). Madje ka gjithfarë emrash të njerëzve të artit, të kulturës, të sporteve nga shumë vende të ndryshme të botës, që nuk dihet saktë si shqiptohen në gjuhët përkatëse dhe trajta e origjinalit mbetet e vetmja mënyrë shkrimi.

Rregulla e re:

§ 37 Shkrimi i emrave të përveçëm.

a) Në pajtim me praktikën e përgjithshme të gjuhëve që përdorin alfabetin latin, emrat vetjakë të këtyre gjuhëve shkruhen sipas grafisë origjinale, duke përfshirë përdorimin e vizës lidhëse dhe shkronjat e posaçme që nuk i ka alfabeti i gjuhës shqipe*.

Kështu shkruhen⁶:

Martti Ahtisaari, Dante Alighieri, Jeanne d'Arc, Carl Benz, Otto von Bismarck, Georges Bizet, Leonard Bloomfield, Niels Bohr, Georges Gordon Byron, Ludwig van Beethoven, Pierre Beaumarchais, Hector Berlioz, Björnsterne Björnson (ose Björnsterne Björnson), Franz Bopp, Johann Brahms, Johannes Calvinus, Luís de Camões (ose Camoens), Albert Camus, Ion Luca Caragiale, Giosue Carducci, Sean O'Casey, Miguel de Cervantes, Frédéric Chopin, Winston Churchill, Waclaw Cimosowski, André Citroën, Feargus O'Connor, Charles Augustin de Coulomb, René Descartes, Gaetano Donizetti, Edith Durham, Antónin Dvořák, Alexandre Dumas, Anthony van Dyck, Albert Einstein, Dwight Eisenhower, Mihai Eminescu, Friedrich Engels, Gustave Flaubert, Jean-Bernard-Léon Foucault, Charles de Gaulle, Joseph Louis Gay-Lussac, Johann Wolfgang von Goethe, Vincent van Gogh, Heinrich Heine, Ho Chi Minh, Victor Hugo, James Joule, Lajos Kossuth, Maximilian Lambertz, Antoine-Laurent de Lavoisier, Jack London, Thomas Mann, Alessandro Manzoni, Karl Marx, Guy de Maupassant, James Clerk Maxwell, Gustav Meyer, Adam Mickiewicz, Charles de Secondat Montesquieu, Wolfgang Amadeus Mozart, Alfred de Musset, Isaac Newton, Martin Andersen Nexö (ose Nexø), Nguyen Van Troi, Franz Nopcsa, Ignacy Paderewski, Johann Heinrich Pestalozzi, Sándor Petöfi, Jules-Henri Poincaré, Ferdinand Porsche, Louis

* Për arsye teknike shkronjat e posaçme të disa gjuhëve, si *å, ä, ç, ı, ø, ö, û, æ, œ, ð, ı, ñ, ŋ, ř, š, ť* etj., nuk përdoren në botimet me karakter masiv.

Kjo rregull nuk ka parasysh shkrimin e emrave të huaj të personazheve të veprave letrare të përkthyer në gjuhën shqipe.

Fjalët e prejardhura prej emrash të tillë shkruhen sipas shqiptimit në gjuhën shqipe: *bajronizëm* (Byron), *darwinizëm*, *darwinist* (Darwin), *frojdizëm*, *frojdist* (Freud), *golizëm*, *golist* (de Gaulle), *kalvinizëm* (Johannes Calvinus), *kartezian* (Cartesius), *makartizëm* (McCarthy), *maltuzian* (Malthus), *marksizëm*, *marksist* (Marx), *shovinizëm* (Chauvin), *vagnerian* (Wagner) etj.

⁶ Rënditja sipas mbiemrit.

Pasteur, Jean Racine, Wilhelm Conrad Röntgen, Camille Saint-Saëns, Bedřich Smetana, Johann Strauss, William Shakespeare, Percy Bysshe Shelley, Friedrich Schiller, Madame de Staël, John Steinbeck, Sukarno, Wilhelm Tell, Lope de Vega, Giuseppe Verdi, Leonardo da Vinci, Vo Nguyen Giap, François Marie Arouet Voltaire, Richard Wagner, George Washington, James Watt etj.

Po kështu (por me shkronjë të vogël) shkruhen edhe emërtimet e njësisë të matjes që vijnë nga emra shkencëtarësh, si: *ampere, becquerel, coulomb, farad, henry, hertz, joule, newton, ohm, pascal, volt, watt, weber* etj.

Shënim. Disa emra shtetarësh ose personalitetesh të huaja do të përdoren në trajtën tashmë të ngulitur në gjuhën shqipe, pavarësisht nga trajta origjinale⁷, p.sh.: *Aleksandri I, Alfonsi i Aragonës, Napoleon Bonaparti, Burbonët, Dhimitri i Remë, mbretëresha Elizabeta, Frederik Barbarosa, papa Gjon Pali, Henriku IV, Janosh Huniadi, Jezu Krishti, Karli V, Katerina e Madhe, Kristofor Kolombi, Nikolla Kopernik, Luigji XIV, Ferdinand Magelani, Muhamedi, car Nikolla, Nikolla Tesla, Nikollai V. Gogol, Pjetri i Madh, Plantagenetët, Rikard Zemërluani, mbretëresha Viktoria, Zarathustra* etj.

b) Emrat vetjakë të lashtësisë greko-romake e iliro-trake etj. shkruhen sipas traditës së vendosur në gjuhën shqipe në pajtim edhe me rregullat e pikave **a, b, ç, d, ë, f, i, j, ll, n, r** të paragrafit 36:

*Adonis, Agamemnoni, Akili, Alkibiadi, Alkeu, Anakreonti, Anaksagora, Anteu, Apiani, Apoloni*⁸, *Aristarku, Aristofani, Aristoteli, Arkiloku, Arkimedi, Atena, Audata, Augusti, Augjiasi, Aurora, Baku, Belizari, Centauri, Cerberi, Cezari, Ciceroni, Ciklopi, Cincinati, Cirili, Dari, Dedali, Demetra, Demokriti, Demosteni, Diana, Diodori, Diogjeni, Diomedi, Dionizi, Dioskurët, Driadat, Edipi, Epaminonda, Eskili, Euklidi, Euripidi, Euterpi, Eutropi, Ezopi, Fedra, Fedri, Hamilkari, Hanibali, Hasdrubali, Hefesti, Hektori, Hekuba, Helena, Heliadori, Hera, Heraklidi, Herakliu, Herkuli, Hermiona, Hermogjeni, Herodi, Herodoti, Hesiku, Hesiodi, Hidra, Hiparku, Hiperioni, Hipsia, Hipokrati, Hipoliti, Homeri, Honori, Horaci, Izokrati, Jasoni, Jokasta, Jugurta, Jupiteri, Justiniani, Juvenali, Karonti, Kimera, Kriseida, Krisi, Krisipi, Krisobuli,*

⁷ Kështu veprohet edhe në gjuhë të tjera, p.sh. mbretërit e Francës me emrin *Louis* në gjuhë të tjera quhen me trajtën vendëse të këtij emri: *Lajos, Ludvik, Ludwig, Luigi, Luis, Luj* etj.; po kështu: *Karl, Carl, Carlo, Charles; Pedro, Petar, Peter, Petr, Pierre, Pietari, Pietro* etj.

⁸ Emrat e tipit *Apollo - Apollonis, Cicero - Ciceronis, Leo - Leonis, Nero - Neronis* etj., që i përkasin lakimit të tretë të latinishtes, në gjuhën shqipe përdoren sipas temës së zgjeruar të rasave të zhdrejta: *Apolon-i, Ciceron-i, Leon-i, Neron-i* (Apoloni ishte biri i Zeusit; fjalimet e Ciceronit, papa Leoni, perandori Neron dhe jo Apolo, Cicero, Leo, Nero).

Kronosi, Kserksi, Leonida, Lukiani, Lukreci, Marsi, Mecena, Medeja, Metodi, Mërkuri, Miltiadi, Mitridati, Nausika, Neroni, Nestori, Odiseu, Oktaviani, Pelidi, Penelopa, Perikliu, Pindari, Pitagora, Platoni, Plauti, Pleurati, Plutarku, Polibi, Prometeu, Ptolemeu, Salusti, Saturni, Simonidi, Solomoni, Spartaku, Taciti, Telemaku, Teodoriku, Teodosi, Teokriti, Teti, Teuta, Tezeu, Uliksi, Virgjili etj.

c) Emrat e huaj të vendeve shkruhen sipas traditës së përdorimit të tyre në gjuhën shqipe ose sipas shqiptimit, në përshtatje me fonetikën e shqipes. Me përjashtim të **rr**-së bashkëtingëlloret dyfishë të këtyre emrave nuk ruhen në shkrim në gjuhën shqipe:

*Alaskë, Aleksandri-a, Alto-Adixhe, Amazonë, Amerika e Veriut, Amerika e Jugut, Anadoll, Angli, Antarktidë, Apenine-t, Arktik-u, Atlantik-u, Azerbajxhan, Azore-t, Bangladesh, Bavari, Bejrut, Belgjikë, Beluçistan, Beograd, Bernë, Bohemi, Bolonjë, Bon, Bordo, Bosfor, Bruksel, Budapest, Bukuresht, Burkina Faso, Çeçeni-a, Dallas, Danub, Dardanele-t, Delhi, Dresden, Elbë, Erevan, Filipine-t, Follorinë, Goteborg, Groenlandë, Gjenevë, Gjenovë, Gjermani, Gjibraltari, Hagë, Hainan, Hartum, Havai, Havanë, Helsinki, Himalaja, Janinë, Jenisei, Johannesburg, Kajro, Kaliforni-a, Kalkutë, Kamboxhë, Karlovi-Vari, Kashmir, Kaukaz, Kazan, Këln, Kinë, Kolorado, Kongo, Kopenhagë, Korfuz, Kostur, Krakov, Kretë, Krime, Lajpcig, Leningrad, Lesbos, Letoni, Lihtenshtajn, Lindja e Largët, Lindja e Mesme, Lituani, Lhasa, Liverpul, Lodz, Londër, Los Anxheles, Lozanë, Luarë, Lubianë, Malmo, Mançester, Melburn, Misisipi, Moskë, Mumbai, Mynih, Napoli, Neva, Niagara, Novi-Sad, Nju-Jork, Nju-Orleans, Odesa, Onega, Oslo, Otava, Paris, Pekin, Poznan, Pragë, Prusi, Qipro, Rejjavik, Rin-i, Rio-de-Zhanejro, Rodos, Sahalin, Saksoni, San-Francisko, San-Paolo, Sankt-Peterburg, Sarajevë, Selanik, Senë, Sidnei, Silezi, Skoci, Sofje, Stamboll, Stokholm, Stari-Tërg⁹, Suedi, Suez, Shangai, Shlesvig-Holshtajn, Tajlandë, Tërnovo, Tokio, Tunizi, Tyingi, Uashington, Valencia, Varshavë, Republika e Venedikut (por sot Venecie), Vyrtemberg, Xhamajka, Zagreb etj.**

Arras, Andorra, Kamberra, Londonderri, Sierra-Leone etj.

S h ë n i m 1. Emrat e përveçëm (të personave e të vendeve) nga gjuhët sllave lindore (rusishtja, bjellorusishtja, ukrainishtja), që shkruhen me alfabetin

⁹ Bashkëtingëlloret **l** e **r** rrokjeformuese të disa gjuhëve sllave shkruhen përkatësisht *ël*, *ër* te emrat e vendeve, si: *Vëltava (Vltava), Stari-Tërg (Stari Trg), Tërnovo (Trnovo)* etj.

* Për shkrimin e kategorive të veçanta të emrave të përveçëm me prejardhje të huaj shih pikat përkatëse të § 36 të këtij kreu. Një listë më e zgjeruar me emra të huaj vendesh jepet në “Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe”.

cirilik, pavarësisht nga mënyra e shqiptimit me **I** apo me **II** në këto gjuhë, shkruhen përgjithësisht me **1**, në pajtim me traditën e vendosur prej kohësh në gjuhën shqipe për shumicën e shembujve:

Dobrolubov, Glinka, Gogol, (Jakub) Kolas, (Aleksandra) Kolontai, (Janka) Kupala, Kuriloviç, Larisa, Lavrov, Lermontov, Lobaçevski, Lomonosov, Ludmila, Luiza, Lunaçarski, Mihail, Mihajlov, Mikola, Molotov, Oblomov, Orlov, Pavel, Pavlo, Pavlov, Ruslan, Solzhenicin, Sverdlov, Sholohov, Tolstoi, Vladimir, Volodarski, Volodimir, Volodja, Vsevolod etj.;

Aral, Arhangelsk, Altai, Bajkal, Balkash, Çernobil, Jalta, Jaroslav, Kaluga, Kolima, Komsomolsk-mbi-Amur, Ladoga, Luck, Lugansk, Lvov, Mahaçkala, Orel, Petropavlovsk, Poltava, Tula, Ural, Valaam, Vladimir, Vladivostok, Volokolamsk, etj., por: Bjellorusi, Vollga, Vollgograd.

Emrat e vendeve nga çekishtja, polonishtja e sllovakishtja shkruhen me **I** pavarësisht nga shqiptimi në gjuhët përkatëse:

Bjalistok, Bratislava, Kladno, Lodz, Lublin, Olomouc, Poloni, Vëltava, Vistula, Vroclav etj.; por: Sllovaki.

Po kështu edhe emrat e përveçëm (të personave e të vendeve) nga serbishtja, kroatishtja, boshnjakishtja¹⁰:

Miladin, Milan, Milorad, Milosh, Tesla etj.;

Banja-Luka, Bjelo-Polje, Tuzla, Zlatibor etj.;

por: Jugosllavi, Sllavoni, Slloveni,

Emrat e përveçëm të gjuhëve sllave jugore që kanë kundërvënien **I** (qiellzore) - **II** (prapaqiellzore) (bullgarishtja, maqedonishtja) shkruhen me **I** ose me **II** sipas shqiptimit në gjuhën përkatëse ose sipas traditës së ngulitur në gjuhën shqipe:

Gjevgjelia, Kalin, Milev, Përliçev, Pleven, Plovdiv, Rila, Veles etj.

Bllagojev, Bllazhe, Bullgari, Dellçevo, Jamboll, Kirill (por: Ciril, cirilik), Lloveç, Millosllav, Mlladenov, Nikolla, Sllavejkov etj.

S h ë n i m 2. Emrat vetjakë me **-ij** të burimit rus shkruhen me **-i**:

Belinski, Çajkovski, Dostojevski, Gorki, Musorgski, Stanislavski, Trocki etj.

S h ë n i m 3. Emrat vetjakë nga greqishtja mesjetare dhe e re shkruhen zakonisht sipas shqiptimit, p.sh.:

Dora Bakojani, Aleksis Cipras, Odhiseas Elitis, Maria Faranduri, Gjeorgjios Haxhidhaqis, Maria Kalas, Nikos Kazanxaqis, Joanis

¹⁰ Këto gjuhë nuk kanë **I** prapagjuhore (të velarizuar) si shqipja.

Metaksas, Qiriakos Micotaqis, Mihal Paleologu, Gjeorgjios Papadhopulos, Demis Rusos, Jorgos Seferis, Miqis Theodhoraqis, Ana Visi etj.;

këta emra mund të shkruhen edhe sipas transliterimit ndërkombëtar: *Dora Bakoyanni, Maria Callas, Odysseas Elytis, Maria Farantouri, Georgios Hatzidakis, Nikos Kazantzakis, Ioannis Metaxas, Kyriakos Mitsotakis, Mikhael Palaiologos, Georgios Papadopoulos, Demis Roussos, Giorgios Seferis, Mikis Theodorakis, Aleksis Tsipras, Anna Vissi* etj. Në të njëjtin tekst duhet zbatuar e njëjta mënyrë shkrimi.

Emrat e personave të pakicës kombëtare greke në Shqipëri shkruhen sipas regjistrimit të tyre në gjendjen civile, p.sh.: *Niko Gjini, Thodhori Mastora, Irini Qirjako, Lefter Talo* etj.

S h ë n i m 4. Emrat vetjakë kinezë, si edhe emrat japonezë e koreanë¹¹, shkruhen sipas sistemeve standarde të transliterimit të tyre me alfabetin latin, që praktikohen në vendet përkatëse si edhe në gjuhët që përdorin alfabetin latin, p.sh.:

Cao Xueqin, Chen Yinqe, Chiang Kai-shek, Deng Xiaoping, Guo Moruo, Lao She, Laozi, Liu Shaoqi, Lu Sin, Mao Tse-tung, Sun Yat-sen, Xi Jinping, Xunxi, Zeng Fanzhi, Zhou Enlai etj.¹² Trajtat e përdorura më parë si: *Çan Kai Shek, Çu En Lai, Go Mo Zho, Liu Shao Çi, Mao Ce Dun, Sun Jat Sen, Ten Hsiao Pin* etj., nuk janë të këshillueshme për t'u përdorur më tej, por mund të vihen në kllapa si sqarim, p.sh. *Guo Moruo (Go Mo Zho) Kryetar i Akademisë së Shkencave të RP të Kinës 1949-1978; Zhou Enlai (Çu En Lai), Kryeministër i Republikës Popullore të Kinës në vitet 1949-1976*. Emri i filozofit *Konfuci* shkruhet sipas trajtës së latinizuar që përdoret në gjuhët europiane.

Po kështu edhe emrat japonezë e koreanë:

Kenichi Fukui, Kohei Uchimura, Makoto Kobayashi, Shinzo Abe, Tetsu Katayama, Yasunari Kawabata etj.;

Han Kang, Kim Dae-jung, Kim Il-sung, Pak Chang-ae (ose Pak Den-ai) etj.

S h ë n i m 5. Emrat vetjakë të botës arabe të sotme shkruhen sipas sistemit të transliterimit të tyre në alfabetin latin, që praktikohet në vendet arabe si edhe në gjuhët që përdorin alfabetin latin, p.sh.:

¹¹ Në këto gjuhë vihet përpara mbiemri (emri i familjes), pastaj emri i veçantë vetjak.

¹² Për disa emra kinezë përdoren dy trajta shkrimi, p.sh. *Guo Moruo* ose *Kuo Mo-jo, Mao Tse-tung* ose *Mao Zedong, Zhou Enlai* ose *Chou En-lai*.

Faisal ibn Abdulaziz, Habib Borguiba, Houari Boumediene, Abdelaziz Bouteflika, Naguib Mahfouz, Zayed bin Sultan Al Nahyan, Gamal Abed al Nasser, Anuar Al Sadat, Ahmed Zewail etj.

S h ë n i m 6. Emrat vetjakë me burim nga feja islame që përdoren në Turqi, si edhe të shqiptarët, mund të shkruhen edhe sipas traditës së gjuhës shqipe, p.sh.:

Celal (Xhelal), Hikmet (Hiqmet), Kemal (Qemal), Kenan (Qenan), Recep (Rexhep), Süleyman (Sulejman), Yaşar (Jashar), Yusuf (Jusuf) etj.

S h ë n i m 7. Emrat arbëreshë të personave e të vendeve shkruhen sipas traditës arbëreshe-shqipe dhe në kllapa vihet (kur është e nevojshme) trajta sipas italishtes, p.sh.:

Jeronim De Rada (Girolamo De Rada), Gjergj Guxeta (Giorgio Guzzetta), Dhimitër Kamarda (Demetrio Camarda), Nikollë Keta (Nicolò Chetta), Zef Krispi (Giuseppe Crispi), Mikel Markiano (Michele Marchiano), Zef Skiroi (Giuseppe Schirò), Jul Variboba (Giulio Variboba) etj.;

Hora e Arbëreshëve (Piana degli Albanesi), Kazallveq - Kazallveqi (Casalvecchio di Puglia), Kuntisë - Kuntisa (Contessa Entellina), Maq - Maqi (Macchia Albanese), Mbuzat - Muzati (San Giorgio Albanese), Puhëri - Puhëriu (Pallagorio), Spixanë - Spixana (Spezzano Albanese), Strigar - Strigari (San Cosmo Albanese), Shën Mitër - Shën Mitri (San Demetrio Corone), Shën Sofi - Shën Sofia (Santa Sofia d'Epiro), Vakaric - Vakarici (Vaccarizzo Albanese) etj.

ç) Emrat e huaj të personave marrin trajta rasore sipas rregullave të gramatikës së gjuhës shqipe. Mbaresat e lakimit të emrave të huaj nga gjuhët që shkruhen me alfabetin latin, ndahen me vizë nga emri:

*simfonitë e **Beethoven-it**, opera “Karmen” e **Bizet-së**, komeditë e **Caragiale-s**, operat e **Donizetti-t**, kujtimet e **De Gaulle-it**, zbulimet e **Einstein-it**, lavjerrësi i **Foucault-së**, veprat e **Goethe-s**, romanet e **Hemingwai-t**, eksperimentet e **Lavoisier-së**, romanet e **Manzoni-t**, ligjet e **Newton-it**, teoria e **Saussure-it**, romanet e **Stendhal-it**, tragjeditë e **Shakespeare-it**; studimet shqiptare të Franz **Nopcsa-s**, jeta e Marie **Skłodowska-Curie-së**, operat e Bedřich **Smetana-s**, filozofia e Baruch **Spinoza-s**, zbulimet e Alessandro **Volta-s**¹³; “Emili” i **Rousseau-it*** etj.

¹³ Përdorimi i vizës është i nevojshëm për të shmangur rastet kur zanoret **-i**, **-u** ose **-a** fundore të emrit mund të merren gabimisht si mbaresa të lakimit të shqipes, p.sh. Pestalozzi, Pestalozzi-t, Pestalozzi-n; Eminescu, Eminescu-t, Eminescu-n; de Vega, de

Emrat që dalin më bashkëtingëllore, marrin mbaresat rasore të lakimit të parë (**-i, -it, -in**), përkatësisht të lakimit të dytë (**-u, -ut, -un** – ata që dalin më **-g, -k, -h** fundore), p.sh.:

Nils Bohr-i (Bohr-it, Bohr-in), Isaac Newton-i, William Shakespeare-i; Edvard Grieg-u, Honoré de Balzac-u, Johann Sebastian Bach-u etj.

Emrat që shqiptohen me zanoren **á** ose **ó** të theksuar në fund, marrin mbaresën **-i** në trajtën e shquar dhe lakohen sipas lakimit të parë, p.sh.:

(Eugène) Delacroix-i, (Émile) Zola-i; Nicolas Boileau-i (Boileau-it, Boileau-in), Denis Diderot-i, Léon Foucault-i, Victor Hugo-i, François de La Rochefoucauld-i, Jean-Jacques Rousseau-i etj.

Emrat që shqiptohen me zanoren **-é, -í, -ú** ose **-ý** të theksuar në fund, marrin mbaresën **-ja** në trajtën e shquar me dhe lakohen sipas lakimit të tretë, p.sh.:

Bizet-ja (Bizet-së, Bizet-në), Fouché-ja, Lavoisier-ja, Poincaré-ja; Coty-ja, Platini-ja, Thierry-ja; Pompidou-ja; Camus-ja, Trochu-ja etj.

Emrat që shqiptohen me zanoren **-e** ose **-o** të patheksuar në fund, marrin mbaresën **-ja** në trajtën e shquar dhe lakohen sipas lakimit të tretë, p.sh.:

Ion Luca Caragiale-ja (Caragiale-s, Caragiale-n), Benedetto Croce-ja, Goethe-ja, Heine-ja etj.;

Fidel Castro-ja (Castro-s, Castro-n), Aldo Moro-ja, Pablo Picasso-ja, Marco Polo-ja etj.

Për dijeni:

Shembuj nga gjuhë që shkruhen me alfabetin latin, në të cilat lakohen emrat e përveçëm

shqip	Simfoni të Beethoven-it	Eksperimente të Lavoisier-së
angl.	Beethoven's symphonies	Lavoisier's experiments
bask.	Beethovenen Sinfoniak	Lavoisierren esperimentuak

Vega-s, de Vega-n etj. (khs. *Beethoven-i, Beethoven-it, Beethoven-in*). Trajtat e rasave të zhdrejta të emrave të familjes që dalin më zanoren **-a** të patheksuar, mund të shqiptohen edhe sipas tipit të lakimit të tretë, d.m.th. *Nopçës, Nopçën; Smetanës, Smetanën; Spinozës, Spinozën* etj.

çek.	Beethovenovy symfonie	Lavoisierovy experimenty
dan.	Beethovens symfonier	Lavoisiers eksperimenter
est.	Beethoveni sümfooniat	Lavoisieri katsed
fin.	Beethovenin sinfoniat	Lavoisierin kokeet
gjerm.	Beethovens Symphonien	Lavoisiers Experimente
let.	Bēthovena simfonijas	Lavuazjē eksperimenti
lit.	Bethoveno simfonijos	Lavoisier eksperimentai
pol.	Symfonie Beethovena	Eksperymenty Lavoisiera
romisht	E Beethovenesqe simfonie	E Lavoisier-esqe eksperimenturā
turq.	Beethoven'ın Senfonileri	Lavoisier'in deneyleri

Rregulla e vjetër (1973)

§ 37

Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj mbështetet përgjithësisht në shqiptimin e tyre në gjuhët përkatëse, duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes. Me përjashtim të **rr**-së, bashkëtingëlloret dyfishe të këtyre emrave nuk ruhen në shkrim në gjuhën shqipe*.

Kështu, shkruhen:

Aligieri, Atila, Bajron, Bethoven, Bop, Brams, Çehov, Dostojevski, Dvorzhak, Dyma, Eminesku, Fadejev, Gëte, Gorki, Hajne, Hygo, Kamoensi, Karaxhale, Karduçi, Kozhbuk, Kujbishev, Lu Sin, Manxoni, Mickieviç, Monteskjë, Maxart, Myse, Pestaloci, Petëfi, Rabindranat Tagore, Rasin, Saltikov-Shedrin, Sun Jat Sen, Shekspir, Sheli, Shiler, Shopen, Shtajnbek, Tomas Man, Turgeniev, Vagner, Vilhelm Tel, Volter, Zhan-Zhak Ruso etj.; Amazona, Azerbajxhan, Bejrut, Bohemi, Bolonjë, Bombai, Bon, Bordo, Budapest, Bukuresht, Delhi, Dresden, Filipinet, Hagë, Hartum, Havai, Havanë,

* Në shfaqjen e parë të një emri të kësaj kategorie mund të shënohet në kllapa edhe shkrimi i tij sipas grafisë së gjuhës nga buron.

Helsinki, Jenisei, Johanesburg, Kajro, Kalkuta, Kaukaz, Këln, Kopenhagë, Krakov, Lajpcig, Leningrad, Lihtenshtajn, Liverpul, Lozanë, Luarë, Majakovski, Majer, Mançester, Melburn, Misisipi, Misuri, Napoli, Neva, Niagara, Nju-Jork, Odesa, Onega, Oslo, Otava, Pragë, Rio-de-Zhanejro, Sahalin, Senë, Sidnei, Sofje, Stokholm, Suez, Tajlandë, Tula, Tunizi, Uashington, Valencia, Varshavë, Vyrtemberg, Xhamajka etj.; Arras, Andorra, Kamberra, Sierra Leone etj.

S h ë n i m 1. Emrat e përveçëm të gjuhëve sllave, pavarësisht nga mënyra e shqiptimit të 1-së në këto gjuhë, shkruhen përgjithësisht me 1:

Arhangelsk, Bajkal, Bjalistok, Blagojev, Bratislava, Dobrolubov, Glinka, Gogol, Jalta, Kaluga, Ladoga, Lermontov, Lobaçevski, Lomonosov, Lodz, Lublin, Ludmila, Lugansk, Lunaçarski, Milan, Milorad, Milosh, Mladenov, Oblomov, Parlov, Poloni, Ruslan, Sverdlov, Tula, Ural, Vladimir, Vladivostok, Volodarski, Volodja, Vroclav etj.

S h ë n i m 2. Emrat e përveçëm me -ij të burimit rus shkruhen me -i:

Belinski, Çajkovski, Dostojevski, Gorki, Musorgski, Stanislavski etj.

S h ë n i m 3. Disa emra të përveçëm me prejardhje të huaj shkruhen sipas traditës së ngulitur prej kohësh në gjuhën shqipe:

*Bruksel, Kazan, Korfuz, Moskë, Orel, Paris, Selanik, Stamboll, Suedi, Vjenë, Zvicër etj.**

SUMMARY

Orthographic rules that have been overcome by time

In determining the orthographic rules of Albanian, as well as the exceptions to the rules, the progress of linguistic practice has been closely taken into account. Some issues for which there were no unique rules were previously unified in practice and later sanctioned in the spelling code, e.g. the unification of the writing of final voiced consonants, i.e. the elimination of forms such as *zok, gjemp, oris, zoq* etj. (that could be used in parallel with *zog, gjemb, oriz, zogj*) was first achieved in the practice of the written language and then sanctioned as a rule (in 1956). The authors of the 1951 orthographic project themselves claim that "as the language is written and used as a means of culture and social relations, it has taken a successful path towards its development and unification, and certain rules have crystallized almost

* Për shkrimin e kategorive të veçanta të emrave të përveçëm me prejardhje të huaj, shih pikat përkatëse të § 36 të këtij kapitulli.

unnoticed...". This observation from that time also applies to our time. Linguistic practice, especially from the end of the last century until today, shows that a few rules of the 1973 orthographic code (and some exceptions) need to be reformulated, taking into account today's usage in the written language. This article addresses the following issues:

1. "Orthographic rules" (1973, § 36 d) determines that *Evropë, evropian*, should be written as an exception to the general rule, according to which names originating from ancient Greek and Latin with *au, eu* in these languages, are also written this way in Albanian (*autor, mauzole, neurolog, pleurit* etc.). The popular pronunciation *Evropë* reflects the influence of Greek *Ευρώπη*, Turk. *Avrupa* and neighboring Slavic languages. But today it is increasingly being written *Europë, europian, europeanizim* (also under the influence of words like *euro, euroatlantik, eurodeputet, eurovizion* etj.), i.e. just like in other languages of our continent, which use the Latin alphabet. Therefore, the above exception is unnecessary and the form Europe should be established, which is increasingly spreading in pronunciation.

2. The use of capital letters in Albanian is quite sparing compared to other languages. Therefore, there has been no established tradition of capitalizing religious names such as *allah, perëndi, zot; bajram, kreshmë, krishtlindje, pashkë, ramazan* etc. In addition, the fact that Albania was an atheist country and where religious institutions were prohibited, had the consequence that the Albanian Orthography (1973, § 75, § 82) stipulated the writing of the above names with a lowercase letter. This issue has also been resolved today by practice: these names are generally written with a capital letter. This practice should now also be sanctioned in the spelling rules.

3. Foreign proper nouns from languages that use the Latin alphabet are also written in Albanian according to the original and not according to pronunciation, e.g.: *Albert Einstein, Goethe, Isaac Newton, Giacomo Puccini, William Shakespeare* etc. In the middle of the last century, it was decided to write them according to their pronunciation. This was due to two reasons: on the one hand, a cultural reason (the difficulty in reading foreign names due to the low cultural level of the readers) and, on the other hand, an external reason: the main source of political information and scientific literature at that time became the Russian language, in which foreign names are written in the Cyrillic alphabet, more or less according to their pronunciation, and the Albanian translator (who often knew only Russian as a foreign language) did not know the original form of the foreign personal name. Today, both of these reasons have disappeared, so this rule of the Orthography (1973, § 37) can no longer be maintained. It is time for the general rule to be applied to the Albanian language as well: in languages that use the Latin alphabet, proper

nouns of these languages are always written according to the original. This article also proposes a series of secondary rules for the writing of proper nouns from languages that do not use the Latin alphabet (use other alphabets or writing systems).

KRITIKË DHE BIBLIOGRAFI

Anila Kananaj

Studime në sintaksë teorike dhe të zbatuar
nga prof. Seit Mansaku, Akademia e Studimeve Albanologjike,
Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2022

Vëllimi *Studime në sintaksë teorike dhe të zbatuar* të prof. dr. Seit Mansakut vjen si vijimësi e natyrshme e dy vëllimeve të mëparshme të botuara nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, të cilat në tërësi paraqesin përmbledhjen e rezultateve të studimeve që profesori ka kryer gjatë gjithë jetës së tij. Si gjuhëtar i formuar në atdhe, ai spikat për njohje mjeshtërore të historisë së gjuhës shqipe, të strukturave të saj semantiko-sintaksore dhe të mundësive të mëdha shprehëse të saj. Nga ana tjetër, studimet në Francë, pa lënë mënjanë literaturën bashkëkohëse të shkruar brenda apo jashtë vendit, të konsultuar në mënyrë të rregullt prej tij, kanë krijuar një profil unik, duke e bërë të spikatë si një gjuhëtar i dijshtëm dhe mendjehapur. Janë pikërisht këto veçori që i japin vlerë të veçantë punimeve të tij.

Ky vëllim është strukturuar në mënyrë tematike, arsye për të cilën është ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë trajton probleme me karakter teorik dhe zbatues në lidhje me shqipen standarde. Pjesa e dytë përmban studime sintaksore që lidhen me shqipen e sotme. Sidoqoftë, dy temat bosht, shqipja standarde dhe struktura sintaksore e saj, ndihen në gjithë vëllimin nga fillimi deri në fund.

Artikujt janë mbledhur nga Anila Omari. Emërtimi, ndarja tematike dhe strukturimi i vëllimit është bërë nga Anila Kananaj. Ndarja tematike dhe strukturimi është bërë i tillë që vëllimi të ketë koherencë në tërësinë e tij dhe secila pjesë të ketë koherencë në vetvete, duke i vendosur studimet si kapituj që natyrshëm ndjekin njëri-tjetrin dhe ndërtojnë mbi atë çka është trajtuar në pjesët e mëparshme të punimit. Në këtë mënyrë, ky vëllim ka marrë formatin e një monografie tematike.

Pjesa e parë e vëllimit titullohet *Midis gjuhësisë teorike dhe gjuhësisë së zbatuar: studime sintaksore në shqipen e sotme*. Ashtu siç e shpreh dhe vetë titulli, artikujt e kësaj pjese trajtojnë pikërisht probleme teorike dhe pragmatike

që lidhen me aspektin sintaksor të shqipes standarde. Në vijim bëhet një analizë e përmblendhur e artikujve të kësaj pjese.

Artikulli *Identiteti gjuhësor i shqiptarëve dhe gjuha standarde*, ka në qendër përpjekjet e atdhetarëve dhe të intelektualëve shqiptarë për zgjidhjen e problemit të gjuhës letrare kombëtare të njësuar. Përpjekjet për të shkruar gjuhën shqipe dhe për ta ruajtur atë, të cilat spikatin në veprat e autorëve të vjetër të shekujve XVI - XVII, trajtohen me radhë nga autori. Gjuha shqipe u identifikua me kombin dhe u kthye në një kult të vërtetë gjatë Rilindjes Kombëtare. Kongresi i Manastirit (1908) vendosi një alfabet të përbashkët me bazë latine dhe zgjidhi në të njëjtën kohë një nga problemet themelore gjuhësore dhe kombëtare. Më tej, Komisia letrare shqipe në Shkodër më 1916, me përpjekjet për një ortografi sa më të përbashkët për të dy dialektet, hodhi një hap përpara në rrugën e njësisimit dhe të kodifikimit të drejtshkrimit të shqipes. Hapi vendimtar ishte Kongresi i Drejtshkrimit (1972), i cili përcaktoi gjuhën standarde për të gjithë shqiptarët dhe rregullat e drejtshkrimit të saj, duke pasur për bazë toskërishten letrare të plotësuar me elemente të gegërishtes. Konsulta e Prishtinës (1968) mori vendimin historik që të njohë si gjuhë letrare të shqiptarëve në ish-Jugosllavi gjuhën letrare të Republikës së Shqipërisë, duke krijuar kështu një realitet të vetëm etnokulturor brenda hapësirës shqiptare. Pas viteve '90, termi *gjuhë letrare kombëtare* filloi të zëvendësohet gjithnjë e më shumë me *gjuhë standarde*. Në këtë periudhë filluan edhe diskutimet për të dalluar identitete të ndryshme gjuhësore në rrafshin e standardit, të cilat Mansaku i analizon me mprehtësi dhe gjykon se ato nuk shkojnë në të mirë të forcimit të njësisë kombëtare.

Vijim i natyrshëm i kësaj teme është artikulli *Nga gjuha letrare kombëtare te gjuha standarde: dallime terminologjike dhe përmbajtësore*. Këtu autori jep mendimin e tij të argumentuar në lidhje me kritikën që i bëhen standardit të sotëm, sidomos ato që kanë të bëjnë me mënjanimin e variantit letrar verior, me zgjerimi e bazës dialektore të standardit, me paaftësinë a pamjaftueshmërinë e tij për t'iu përgjigjur nevojave të sotme të zhvillimeve kulturore, letrare, politike e shoqërore të shoqërisë shqiptare. Duke njohur dhe pranuar teorinë e planifikimit gjuhësor e të politikës gjuhësore, Mansaku pranon edhe ndërhyrjen e shoqërisë dhe të institucioneve të saj në përzgjedhjen dhe mbështetjen e një varianti letrar për ta ngritur në gjuhë standarde të shtetit ose të kombit. Megjithatë, ai thekson se këto ndërhyrje nuk duhet të jenë arbitrare dhe nuk duhet t'u bien ndesh realiteteve historike, gjuhësore e kulturore, prirjeve të zhvillimit të gjuhës dhe interesave e të drejtave themelore të përdoruesve të saj.

Mjetet semantiko-leksikore dhe ndërtimet sintaksore të gjuhës popullore a të të folmeve dialektore që e gjallërojnë, e zhdërvjelltësojnë dhe e bëjnë më të larmishme shqipen standarde, trajtohen prej Mansakut në artikullin *Rreth pasurimit dhe përsosjes së strukturës sintaksore të shqipes së sotme*. Autori

kërkon vëmendjen e të gjithëve për t'u ruajtur nga ndërtime jo të natyrshme për shqipen, të cilat prekin rendin e fjalëve në fjali, përshtatjen e kohëve të foljeve në periudhat me fjali të varura, si dhe shprehjen e funksioneve normale të ndërtimeve sintaksore me lidhore ose paskajore. Mjaft mjete sintaksore me burim a mbizotërim dialektor janë ngritur në nivelin e ligjërimit letrar të shqipes standarde dhe mund të përdoren me sukses. Në mbyllje, kërkohet rritja e vëmendjes së shtetit dhe e shoqërisë shqiptare për të ndërmarrë veprime konkrete për ta institucionalizuar kujdesin ndaj gjuhës dhe për të ngritur kulturën e gjuhës.

Boshti i diskutimit në artikullin ***Çështje të normës sintaksore për diskutim*** janë zhvillimet e natyrshme të varietetit të shqipes standarde në rrafshin sintaksor, i cili pasurohet vazhdimisht me prurje të reja nga dialektet e të folmet e ndryshme. Për normën sintaksore nuk ka një manual normativ kodifikues të plotë. Mendimi më i përgjithshëm në rrethet e studiuesve është se nuk ka dallime të rëndësishme midis dialekteve të shqipes në fushën e sintaksës. Gjithsesi, elemente të ndryshme të strukturave dialektore sintaksore janë integruar e mund të integrohen pa vështirësi në strukturën sintaksore të standardit, mjaft që të respektohen normat gjuhësore në nivelin fonetik e morfologjik. Qasja e Mansakut është se nevojiten kërkime të posaçme për të hulumtuar veçori të pavëna re të strukturës sintaksore të të folmeve të shqipes, shprehje, mënyra të thëni, lidhje sintagmatike që mund të pasurojnë gjuhën standarde me lëndë të pashfrytëzuar, duke zëvendësuar ndërtime të huaja për sintaksën e shqipes. Ndër çështjet e trajtuara këtu, përmendim: përdorimi i paskajores së tipit *për të punuar* në funksion kryefjalor dhe kundrinor; përdorimi sinonimik i lidhëzave ffilluese *se* dhe *që*, të cilat dallohen nga përndarja e foljeve të fjalisë drejtuese dhe mënyra e foljes kallëzues të fjalisë së varur, ndoshta edhe nga përndarja dialektore; përdorimi i lokucioneve lidhëzore shkakore *për arsye sepse*, *për shkak sepse* në vend të *për arsye se*, *për shkak se*; përdorimi, krahas lidhëzës kohore e shkakore *pasi (mbasi)*, i lokucionit *pasi që*, sidomos në ligjërime dhe shkrime nga Kosova; përdorimi i lidhëzave *ndërsa*, *derisa*, *përderisa*; përdorimi i frazave me shprehjen *për ç'shkak* me kuptimin “për këtë shkak”; zgjedhja e ndërtimit *i përgjigjem pyetjes suaj* dhe jo *përgjigjem në pyetjen tuaj*.

Në artikullin ***Ndërtimet me lokucionin lidhëzor ‘në vend që’*** trajtohen trajtat dhe funksionet e lokucionit *në vend që*. Ky lokucion ka të njëjtën strukturë morfologjike me lokucionet përgjegjëse në disa gjuhë të huaja, por, sipas Mansakut, nuk është kalk i formuar sipas ndonjëres prej këtyre gjuhëve. Autori argumenton se ai është një formim i brendshëm i shqipes, i cili përdoret dendur në gjuhën e shkruar dhe në gjuhën e folur. Duke qenë se ndërtimet me lokucionin lidhëzor *në vend që* janë marrë edhe si ndërtime me nënrenditje edhe si ndërtime me bashkërenditje, në punim i kushtohet vëmendje funksionit përkatës të tyre. Në tekstet gramatikore, janë trajtuar si lidhëza nënrenditëse

nga pikëpamja e strukturës morfologjike të gjitha lidhëzat ose lokucionet lidhëzore të formuara me pjesëmarrjen e lidhëzave filluese *se a që*, si p.sh., lokucionet: *në rast se, me kusht që, për shkak se, me qëllim që, në mënyrë që*, etj. Nga ky aspekt, lokucioni *në vend që* del se është lokucion nënrenditës. Por, sipas autorit, do të ishte më e drejtë që periodhat me lokucionin *në vend që* të studiohen në një tip të veçantë periodhe, te periodha me fjali të varur opozicionale ku ndërtimet me *në vend që* janë tipi i mirëfilltë që kanë mjetin lidhëzor specifik për shprehjen e marrëdhënieve kushtore.

Ka karakter normativ artikulli *Më drejt 'në vend që' apo 'në vend'*. Pas shprehjes *në vend që* mund të vendoset jo vetëm kallëzuesi në mënyrën lidhore, por edhe gjymtyrë të tjera të fjalisë, kryefjala, rrethanorë etj.; kurse, kur kjo shprehje nuk ka në përbërjen e vet lidhëzën filluese *që*, del në trajtën *në vend*, fjalia e varur, e lidhur me të, duhet të fillojë detyrimisht me kallëzuesin në lidhore; midis lidhëzës dhe kallëzuesit nuk mund të vendoset asnjë gjymtyrë tjetër. Për të gjitha këto arsye autori këshillon që të përdoret gjithnjë shprehja *në vend që* dhe jo *në vend*, pasi kjo e fundit të përdoret vetëm si shprehje parafjalore.

Në doracakët që japin normën gramatikore të shqipes së sotme letrare, si në tekstin *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, ashtu dhe në librin *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, trajtat të *qe* dhe *do të qe* janë përjashtuar si ndërtime që nuk i përkasin normës letrare, madje është dhënë edhe ndonjë shënim për karakterin jonormativ të tyre. Ato bëhen objekt i artikullit *A duhen përdorur trajtat 'të qe' dhe 'do të qe' në vend të 'të ishte' dhe 'do të ishte'?*, trajta të cilat përdoren dendur si në gjuhën e folur, ashtu edhe në gjuhën e shkruar, përfshi letërsinë artistike.

Qendër e artikullit *Një shpërdorim i parafjalës 'prej'* bëhet vlerësimi i përdorimit normativ të ndërtimeve me parafjalën *prej*, e cila përdoret kryesisht për të treguar marrëdhënie vendi, kohe, shkaku, prejardhjeje, largimi, lënde, për të treguar vepruesin etj. Ajo po përdoret mjaft dendur, por shumë herë në mënyrë të pamotivueshme, vë në dukje autori, edhe për të shënuar tiparin a cilësinë e një sendi në togje të tilla: *fjalë prej burri, dashuri prej nëne, fjalë prej çilimiu, mendim a gjykim prej shkencëtari, veprim prej burokrati, uri prej ujku, guxim prej të marri, pjekuri prej të rrituri*. Në raste të tilla, parafjala *prej* nuk shihet e domosdoshme prej Manasakut për ndërtimin e sintagmës. Madje, thekson ai, elimini i saj nga këto përdorime nuk e shpërbën strukturën e tyre, por i bën ato më të natyrshme dhe i çon më pranë gjuhës së gjallë popullore.

Artikulli *Shpërdorimi i fjalës kulturë: kulturë apo antikulturë?* trajton zgjerimin e sferës semantike të e fjalës *kulturë* edhe në sensin e antikulturës. Në ligjërimin e shkruar dhe të folur të shqipes, përfshi përshkrimin e saj në fjalorët shpjegues, fjala *kulturë* përdoret e shoqëruar me fjalë të tjera me përmbajtje pozitive, për të shënuar e pohuar praninë e vlerave të një dukurie, individi ose shoqërie. Për këtë arsye, autori e vlerëson si lajthitje gjuhësore

referimin e dukurive negative me termin *kulturë*, ato duhen emërtuar me termin përkatës *antikulturë*.

Kujdesi për gjuhën, për lëvrimin dhe pasurimin e saj është në qendër të artikullit *Rivendosja e gjuhës shqipe në shkollat e mesme vështruar edhe nga kërkesat e shkollës së lartë*. Nëse nuk zotërohet mirë struktura gramatikore dhe pasuria leksikore e gjuhës amtare, sipas autorit është e vështirë të përvetësohet mirë një gjuhë tjetër e huaj, ashtu siç është e vërtetë që njohja e gjuhëve dhe e kulturave të tjera ndihmon shumë për të thelluar edhe pasuruar njohjen e gjuhës amtare.

Pjesa e dytë e vëllimit titullohet *Studime sintaksore në shqipen e sotme*. Ajo përmban një numër studimesh me rëndësi për fushën e sintaksës shqipe, siç janë çështje që lidhen me lidhëzat, me parafjalët, me fjalë të ndryshme modale, me sistemin funksional korrelacional të trajtave kohore e mënyrore, me sistemin e përshtatjes, me sinoniminë sintaksore, me mjete e lidhje leksiko-sintaksore të reja ose të pashfrytëzuara deri më tani etj.

Artikulli i parë i kësaj pjese, *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes*, ka në qendër evoluimin e disa ndërtimeve sintaksore të gjuhës shqipe, të cilat përcaktohen nga tipologjia e shqipes dhe nga prirjet e përgjithshme të zhvillimit historik dhe të sotëm. Në aspektin strukturor, shqipja bën pjesë në gjuhët sintetiko-analitike, prandaj edhe zhvillimet sintaksore në sintaksën e fjalisë shkojnë në përputhje me këtë tipologji. Kështu, marrëdhëniet përcaktore dhe rrethanore realizohen me sintagma të tipit *emër + emër në rasën rrjedhore* ose *folje + emër në rasën rrjedhore*, të cilat përdoren paralelisht, bashkëjetojnë dhe konkurrojnë me njëra-tjetrën. Prirja e përgjithshme drejt analitizmit paraqitet sistemore dhe kjo shprehet në krijimin e një numri të konsiderueshëm formash analitike në sistemin foljor, të cilat rrjedhin nga struktura sintaksore të lira, si p.sh. *kam për të punuar, me të ardhur* etj. Analitizmi duket qartazi edhe në krijimin e një numri jo të vogël parafjalësh ose lokucionesh parafjalore emërore dhe lidhëzore. Shqipja është pasuruar gjithashtu me një numër të madh sintagmash të reja, të cilat i sjellin gjuhës edhe një lloj fryme modernizuese, siç është rasti i një numër sintagmash të veçuara prej autorit, si: *shoqëri civile (qytetare), shtet ligjor, shtet i së drejtës, zhvillim përgjegjësish, zhvillim institucional, proces integruar, shoqata joqeveritare, demokraci e brishtë, arritje konsensi, prodhon stabilitet* etj. Sintagmat *emër + emër në gjinore* përdoren gjithashtu gjerësisht në shqipe. Për të dhënë një pamje më të qartë se sa është rritur numri i mjeteve lidhëse në shqipen e sotme, Mansaku bën edhe një krahasim me “Mesharin” e Gjon Buzukut.

Artikulli *Dallime sintaksore midis dy dialekteve të shqipes* ka në fokus dallimet sintaksore midis dy dialekteve kryesore të saj, të cilat, sipas Mansakut, nuk janë të shumta. Duke pasur parasysh që dallimet morfologjike dhe ato sintaksore nuk janë të ndara prerazi, vihen në dukje edhe disa dallime themelore midis dy dialekteve të shqipes në fushën e morfologjisë siç janë p.sh.

prania e paskajores së tipit *me punue* në gegërishte dhe mungesa e saj në toskërishte, e ardhmja e tipit *kam me punue* në gegërishte dhe mungesa e saj në toskërishte. Prania e paskajores *me punue* në gegërishte dhe mungesa e saj në toskërishte sjell edhe dallimin sintaksor: praninë e fjalive infinitivore në gegërishte dhe mungesën e tyre në toskërishte. Ka edhe disa dallime dialektore leksikore që shpjen në dallime sintaksore, siç është rasti me kategorinë leksikogramatikore të lidhëzave dhe të parafrjalëve. Ndërsa shqipja ofron një numër mjetesh sintaksore për të realizuar funksione sintaksore të njëjta, disa nga këto mjete sintaksore janë të veçanta në dy dialektet e shqipes, disa janë të përbashkëta, por dallojnë në shkallën e përdorimit, njëri prej tyre mbizotëron në dialektin e Jugut tjetri në dialektin e Veriut. Në këtë frymë autori analizon funksionet semantiko-sintaksore të dy lidhëzave filluese *që* dhe *se*, të parafrjalëve *deri* dhe *gjer*, të përdorimit të parafrjalës *prej* në rasën rrjedhore me ose pa parafrjalë dhe me mbaresën e shumësit *-sh* dhe *-ve*, si p.sh.: *bie borë malesh* dhe *bie borë maleve*, *këshilla miqsh*, *këshilla prej miqsh* dhe *këshilla prej miqve*, apo në ndërtimet e tipit *jam ka shkoj*, *jam ka pushoj*, të cilave u përgjigjen në gjuhën standarde ndërtimet sinonimike: *jam duke shkuar*, *po shkoj*; *jam duke pushuar*, *po pushoj* etj.

Bëhet thirrje për të mos u alarmuar nga gjendja në dukje çoroditëse në zbatimin e normave gjuhësore të standardit në artikullin ***Prirje të zhvillimit të strukturës sintaksore të shqipes së sotme standarde***. Në një vështrim të thelluar të problemit, autori e bind lexuesin se zhvillimet e këtyre viteve të fundit në rrafshin sintaksor kanë krijuar lidhje të reja fjalësh, kanë zgjeruar funksionet e paskajores etj., të cilat e pasurojnë dhe e modernizojnë strukturën sintaksore të shqipes së sotme. Mansaku sjell në vëmendjen tonë se për të gjykuar për karakterin normativ ose jo të një ndërtimi sintaksor, kriteri themelor është ta vështrosh atë nga ana tipologjike, nëse është apo jo në pajtim me strukturën sintaksore të shqipes, me rregullat e bashkimit të fjalëve në togfjalësha e në fjali dhe të fjalive në periudhë, me rregullat e përshtatjes etj. Nga ana tjetër, nuk duhet harruar roli i *usus-it* (përdorimi i gjuhës në ligjërimin e folur), i cili jo rrallë nuk i përfill rregullat dhe analizat e gjuhëtarit dhe imponohet si normë edhe pse nuk i plotëson kërkesat e sapopërmendura, siç është rasti i mospërshtatjes së kohëve në periudhat me fjali qëllimore dhe kohore.

Artikulli ***Sinonimia sintaksore si një mjet i pasurimit dhe i zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës shqipe*** ka në qendër rritjen sasiore të inventarit të mjeteve shprehëse gjuhësore si një faktor zhvillimi në sintaksën dhe leksikon e shqipes. Pasurimi i gjuhës me fjalë dhe kuptime të reja shpie në krijimin e lidhjeve të reja të fjalëve në sintagma dhe të sintagmave në fjali. Këto lidhje realizojnë raporte të ndryshme dhe të shumëllojshme sintaksore, duke rritur njëkohësisht edhe mundësitë shprehëse të shqipes dhe duke përsosur më tej sistemin leksikor dhe sintaksor të saj.

Përshtatja është një dukuri sintaksore që ka shtrirje të gjerë dhe paraqet rëndësi në aspektin teorik dhe të zbatuar të gjuhës. Kjo dukuri hetohet në artikullin *Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën në shqipen letrare*, në të cilin Mansaku ndalet në disa raste të përshtatjes së kallëzuesit foljor dhe të këpujës së kallëzuesit emëror me kryefjalën, të cilat paraqesin interes për anën normative të gjuhës. Në shqipe, kallëzuesi përshtatet në numër dhe në vetë me kryefjalën. Përshtatja mund të jetë sipas kuptimit ose sipas kriterit formal gramatikore. Ndërhyrja normëzuese mbi gjuhën shpie në mbizotërimin e përshtatjes formale gramatikore. Sipas autorit, zbatimi i të dy llojeve të përshtatjes në gjuhën e sotme shkakton në përgjithësi norma dysore, jo thyerje të normës. Më konkretisht, përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën në numër ndikohet nga tiparet semantiko-gramatikore të kryefjalës: kryefjala është një emër përmbledhës me kuptim sasior, kryefjala është një emër vendi i përdorur në mënyrë metonimike për të shënuar tërësinë e njerëzve që banojnë, kryefjala shprehet me një togfjalësh të përbërë nga një emër a përemër në rasën emërore njëjës + emër a përemër në rasën kallëzore me paraafjalën *me*, si dhe rasti i disa kryefjalëve homogjene në numrin njëjës. Konteksti semantiko-gramatikor ndikon gjithashtu në përshtatjen e kallëzuesit në vetë me kryefjalën, veçanërisht kur si kryefjalë shërben një sintagmë e tipit: një pjesë nga ne (prej nesh), një pjesë nga ju (prej jush), disa nga ne (prej nesh), disa nga ju (prej jush), pesë nga ne (prej nesh), pesë nga ju (prej jush), kur fjalitë përcaktore kanë si kryefjalë përemrin lidhor që etj.

Në artikullin *Folje delokutive në gjuhën shqipe* trajtohen një numër foljesh të krijuara mbi bazën e disa shprehjeve të qëndrueshme të ligjërimit të përditshëm me ngarkesë të theksuar shprehëse-emocionale, që shprehin një gjendje të brendshme të subjektit folës në formë urimi, përshëndetjeje, keqardhjeje etj. Folje të mirëfillta delokutive janë foljet *falënderoj*, *ngjatjetoj*, *lamtumirem*, të cilat janë formuar përkatësisht nga lokucionet pasthirmore *faleminderit*, *tungjatjeta* dhe *lamtumirë*. Këto shprehje pasthirmore kanë në përbërjen e tyre një folje, kuptimi i së cilës nuk është zhdukur plotësisht edhe në përdorimin pasthirmor, prandaj dhe kalimi nga lokucioni pasthirmor në folje delokutive ka qenë plotësisht i mundshëm, argumenton Mansaku. Megjithatë, është edhe funksioni sintaksor që lidhet ngushtë me kuptimin leksikor dhe ka rëndësi për të motivuar dhe shpjeguar rrugët e formimit të disa fjalëve të reja, siç është rasti i foljeve *filloj*, *bishtnoj*, *darkoj*, *drekoj*, *muzikoj* e *dredhoj*, të cilat përdoren sot krahas togjeve përkatëse sinonimike: *bëj bisht*, *ha darkë*, *ha drekë*, *bëj muzikën* ose *këndoje me muzikë*, *bëj dredha*.

Artikulli *Formimi dhe përdorimi i mbiemrave 'i fundit' dhe 'i zoti'* heton luhatjet në shkallën e përdorimit mbiemrave *i fundit* dhe *i zoti*. Në një vështrim përmbledhës që u bën Mansaku tërësisë së formave të mbiemrit *i zoti/e zonja*, arrihet në përfundimin se paradigmat në fjalë u përshtaten gjithnjë e më shumë paradigmës së mbiemrave të tjerë të nyjshëm, duke u larguar nga prejardhja e

tyre emërore. Ndërkaq, format e numrit shumësi për të dy gjinitë janë më sistemore dhe pothuajse në përputhje të plotë me strukturën e mbiemrave të tjerë të nyjshëm. Për më tepër, luhatjet që vihen re në format e shumësit, paraqiten në përgjithësi me karakter drejtshkrimor. Lidhjet formale me emrat përkatës nga kanë dalë dy format e këtij mbiemri ruhen më shumë në numrin njëjës e sidomos në rasën emërore në bashkëvjajtje me një emër në trajtë të pashquar, ku mbizotërojnë format *i zoti, e zonja*.

Periodhat me nënrenditje mënyrore, qëllimore, kushtore, lejore dhe krahasore, të përfshira në vijim të këtij vëllimi, janë edhe pjesë e botimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa, Tiranë, 1996. Këto studime kanë rëndësi të veçantë pasi ofrojnë modelet themelore të funksionimit e të përdorimit të njësive sintaksore dhe në këtë mënyrë shërbejnë si manuali bazë për normën sintaksore të gjuhës standarde.

Studimi *Periudha me fjali të varur mënyrore* trajton tipat semantiko-sintaksorë të fjalive të nënrenditura mënyrore, të cilat hetohen në sytha të veçantë sipas mjetit të tyre lidhës. Fjalitë mënyrore në përgjithësi përdoren pa korrelat, d.m.th. me lidhëza a lokucione lidhëzore mënyrore, ndër të cilat më karakteristike janë: *si, siç, ashtu si, ashtu siç, kështu si, sikur, sikurse, ashtu sikurse, sikundër, sikundërse, ashtu sikundër*. Si lokucione lidhëzore mënyrore trajtohen edhe konstruktet *ashtu si, ashtu siç, kështu si, ashtu sikurse* kanë qenë të bashkëlidhura, por sot ndajfoljet *ashtu, kështu*, ku sipas autorit, ndajfoljet janë bashkuar nga ana intonacionore me lidhëzat që i pasojnë, dhe kanë formuar me to një lokucion të vetëm. Megjithatë, dallohen raste kur fjalitë e varur mënyrore ka si korrelat në fjalinë drejtuese ndajfoljet *ashtu, kështu*. Në vijim të punimit, trajtohen format e ndryshme të realizimit të kallëzuesit të fjalive të varura mënyrore, i cili paraqitet kryesisht në mënyrat dëftore, lidhore dhe dëshirore.

Në studimin *Periudha me fjali të varur qëllimore* bëhet përshkrimi dhe analiza tërësore e periudhave qëllimore që përdoren në gjuhën letrare, duke vënë në dukje veçoritë kuptimore dhe sintaksore që shprehen me këto ndërtime. Nga ana gramatikore, fjalitë qëllimore zakonisht e ka foljen kallëzues a këpujë në mënyrën lidhore. Foljet e natyrshme që drejtojnë këto tipa fjalish janë *përpiqem, orvatem, mundohem*, ose edhe folje jokallimtare që tregojnë lëvizje. Ndërkaq, lidhëzat karakteristike të këtij tipi periudhash janë *që, me qëllim që, në mënyrë që*, megjithëse fjalitë e nënrenditura mund të bashkohet me kryesoren edhe me folje në lidhore, pa praninë e një lidhëze qëllimore. Semantika dhe tiparet strukturore të periudhave qëllimore përshkruhen dhe analizohen në detaje në punim.

Hulumtimi *Rreth formave të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare* ka në fokus shprehjen e raporteve kusht - pasojë, duke mos u kufizuar vetëm në periudhën me fjali të varur kushtore, por duke vështruar

edhe ndërtime të tjera që shprehin raporte të këtij lloji. Kjo jep mundësi që çështja të shihet më gjerë dhe të vihen në ndërtimet tipike që shprehin këto marrëdhënie, por edhe gërshetime raportesh ose nuancash të veçanta kuptimore e stilistike. Sipas tipave strukturorë dhe sipas shkallës së qartësisë së semantikës së kushtit, Mansaku rendit format e ndryshme të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare.

1. Periudha me fjali të varur kushtore:

a) Periudha me fjali të varur lidhëzore kushtore.

b) Periudha me fjali të varur kushtore jolidhëzore, që e ka foljen - kallëzues në mënyrën lidhore.

c) Periudha me fjali të varur kushtore me format foljore të pashtjelluara përcjellore dhe pjesore të tipit *pa punuar*.

2. Periudha me fjali asindetë.

3. Periudha me fjali të bashkërenditura, që shprehin edhe marrëdhënie kushtore:

a) Disa periudha me fjali të bashkërenditura veçuese.

b) Disa periudha të ndërtuara me lidhëzat bashkërenditës *edhe, edhe*.

c) Disa periudha të ndërtuara me lidhëzën kundërshtore *po, por*.

4. Periudha me fjali të tjera të varura, që shprehin edhe marrëdhënie kushtore:

a) Disa periudha të ndërtuara me lidhëza kohore.

b) Disa periudha me fjali të varur shkakore.

c) Periudha me fjali kryefjalore me përemra lidhorë të pacaktuar.

ç) Periudhat me fjali krahasore të rritjes përpjesëtimore.

5. Plotësorët e kushtit.

Larmia e madhe strukturore dhe kuptimore e fjalive të varura kushtore përshkruhet dhe analizohet në mënyrë të thelluar në studimin ***Periudha me fjali të varur kushtore***. Raportet kushtore në shqipe dallohen nga ana strukturore dhe kuptimore. Semantika e kushtit në ndërtime të ndryshme mund të jetë kryesore ose nuancë plotësuese. Autori i rendit format e ndryshme të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare duke u mbështetur në tipat strukturorë dhe në qartësinë e semantikës së kushtit. Veçoritë semantiko-strukturore të lidhëzave e të lokucioneve lidhëzore, të cilat ndikojnë në strukturën dhe kuptimin e periudhës, zënë vend me rëndësi në studim. Periudhat më të zakonshme kushtore kryesohen nga lidhëzat *në, në qoftë se, në se, në është se, në rast se, po, po qe se, po qe që, po të jetë se, po të jetë që, sikur, me kusht që, me konditë që, mjafton që, kur*.

Studimi i ***Periudha me fjali të varur lejore*** trajton tipat e ndryshëm të fjalive lejore, duke u mbështetur në semantikën dhe veçoritë e tyre sintaksore. Për nga semantika, periudha me fjali të varur lejore ka pikëtakime me periudhën me fjali të bashkërenditura kundërshtore. Në bazë të semantikës dhe

të formës së shprehjes së raporteve sintaksore, autori dallon tre nëntipa kryesorë të periudhave me fjali të varur lejore:

- 1) periudha me fjali të varur lejore të mirëfilltë a reale;
- 2) periudha me fjali të varur lejore përgjithësuese;
- 3) periudha me fjali të varur lejore – kushtore.

Vëllimi mbyllet me studimin *Periudha me fjali të varur krahasore*, në të cilin fjalitë krahasore përshkruhen dhe analizohen sipas veçorive strukturore të përvijuar në nëntipat vijues:

1. fjali krahasore të bashkëlidhura (korrelative);
2. fjali krahasore jo të bashkëlidhura (jokorrelative):
 - a) fjali krahasore të bashkëlidhura të barazisë;
 - b) fjali krahasore të bashkëlidhura të pabarazisë;
 - c) fjali krahasore të bashkëlidhura të rritjes përpjesëtimore.

Së fundi, theksoj se të gjitha studimet e këtij vëllimi përbëjnë një pasuri të vyer për studiuesit dhe dashamirësit e gjuhës shqipe. Ato shërbejnë për të dokumentuar nivelin e zhvillimit të shqipes në kohën e kryerjes së tyre. Përshkrimet dhe analizat e thella gjuhësore për secilën dukuri të marrë në vështrim, ofrojnë mundësi të mira për studime krahasuese për faza më të hershme ose më të vona të zhvillimit të shqipes. Gjithashtu, një pjesë e mirë e këtyre studimeve janë ideuar dhe strukturuar në mënyrë të tillë që mund të zgjerohen lehtësisht në tema disertacionesh apo monografish, duke ofruar kështu një mundësi shumë të mirë formimi dhe thellimi gjuhësor për këdo që ka interes për fushën e gjuhësisë në përgjithësi dhe të albanologjisë në veçanti.

Evalda Paci

**Studime albanologjike në indoeuropianistikë,
filologji dhe gjuhësi kontakti; vëllim në nderim
të prof. Bardhyl Demirajt, Akademia e Shkencave
e Shqipërisë, Tiranë, 2025**

Ndër botimet më të fundit të dala nga shtypi nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë rezulton dhe libri-kushtim që i dedikohet albanologut, gjuhëtarit, studiuesit të teksteve të vjetra shqipe Bardhyl Demiraj, në rasë të një përvjetori jubilar të lindjes që përkon dhe me disa arritje të tij në disa fusha studimi. Vëllimi më i fundit studimor me kontribute shkencore në lamije themelore të albanologjisë si indoeuropianistika, gjuhësia historike, filologjia dhe gjuhësia e kontaktit përbën një kushtim të ndjerë të kolegëve dhe studiuesve që prej vitesh kanë ndarë me Bardhyl Demirajn pjesë të rrugëtimit të tyre profesional dhe kërkimor, duke i reflektuar shkrimet e tyre në një vepër të përbashkët që pa dritën e shtypit para disa javësh nën siglën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me një redaksi shkencore të përbërë nga Anila Omari, Shaban Sinani, Ledio Hala. Vëllimi në fjalë hapet me një fjalë hyrësë të kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Skënder Gjinushit, i cili nënvizoi dhe rëndësinë e përrurimit të përvjetorëve jubilarë të lindjes së anëtarëve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me libra-kushtim, si dëshmi të vlerësimit të duhur të kontributeve të tyre ndër vite dhe njëherësh të kujtesës për rëndësinë e njohjes së tyre në rrethet studimore albanologjike. Bardhyl Demiraj spikat mirëfilli për një rrugëtim të gjatë në fushë të mësimdhënies universitare, por dhe të kërkimeve shumëvjeçare me një orientim të përqendruar në gjurmimet albanologjike, të karakterizuara nga arritje që përktihen në botime monografike, vepra leksikografike e me një prirje të qartë ndaj përmasës diakronike, pjesëmarrje në projekte madhore ndërkombëtare, ndërmarrje botimesh kritike e filologjike që përfaqësojnë dhe shkolla të veçanta të zhvillimit të dijes së studimit të tekstit, më në veçanti të shkrimeve të vjetra shqipe.¹

¹ Akad. S. Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, “Një libër-kushtim për gjuhëtarin Bardhyl Demiraj; Dy fjalë në vend të hyrjes”, në *Studime albanologjike në indoeuropianistikë, filologji dhe gjuhësi kontakti; vëllim në nderim të*

Kohët e fundit kanë parë dritën e shtypit gjithnjë nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe botimet e kujdesuara prej tij të veprës së Pjetër Budit (1566-1622), mjaft e nevojshme për konsultim për studiuesit e teksteve të vjetra shqipe, duke u paraprirë nga parathënie dhe shënime shpjeguese që përforcojnë dhe dimensionin shkencor të konsultimit të saj.

Fjala hyrëse e akademik Skënder Gjinushit pasohet nga një tekst kushtimi e motivimi me titull “Një karrierë e suksesshme, besnikërisht në albanologji” nga akademik Shaban Sinani (Akademia e Shkencave e Shqipërisë), njohës i mirë i veprës dhe i veprimtarisë komplekse studimore dhe kërkimore të Bardhyl Demirajt, si dhe i karrierës së tij të gjatë universitare, të kurorëzuar konkretisht dhe në një prej katedrave më të njohura të albanologjisë në Evropë.² Kontributet dhe ndihmesat e dhëna prej tij në disa fusha të dijes, në disa orientime studimi, dhe pjesëmarrja në shumë projekte kërkimore që kanë në qendër albanologjinë dhe gjuhën e letërsisë shqipe janë bërë shkas që dhe në një përvjetor domethënës që kujton dhe rrugëtimin e gjatë në një fushë të veçantë formimi për Bardhyl Demirajn të përmbledhen në një vëllim të vetëm artikuj shkencorë që përmbajnë dhe linjë të mirëfillta hulumtimi nga ana e autorëve të tyre, dhe rinëvizime të arritjeve të mëhershme në fusha si gjuhësia i.e., gjuhësia e krahasuar dhe ajo historike, gjuhësia ballkanike, historia e gjuhës shqipe dhe e ndikimeve nga gjuhë si greqishtja e vjetër dhe latinishtja, studimet mbi tekstet e vjetra shqipe dhe tradita e njohjes së tyre në një vështrim ekdotik dhe kritik, studimet mbi korpuset e shqipes dhe gjuhësinë kompjuterike. Një sërë linjash studimore janë përfunduar në një libër-kushtim, në të cilin pasqyrohen sprovat e studiuesve të shqipes e të traditës studimore mbi lashtësinë e saj dhe të burimeve përkatëse në të cilat kjo e fundit përmendet,

prof. Bardhyl Demirajt, Tiranë, 2025, f. 14: “Është kjo veprimtari e gjerë si kërkues, e cila ka bërë që kolegët e tij ta cilësojnë si shenjë e një breznie gjuhëtarësh shqiptarë për rrethin në zgjerim të albanologjisë në qendrat europiane ku ajo ekziston; që institute, fondacione dhe shoqata të ngritura për çështje të gjuhësisë në lidhje apo afëri gjenetike, në kontakt historik e fqinjësor të gjejnë tek Bardhyl Demiraj vlerësuesin, oponentin apo këshilluesin shkencor jo vetëm për pozicionin e shqipes në kontekstin e çështjeve në diskutim, por edhe urën e ndërlidhjes brenda bashkësisë shumëqendrore të albanologjisë së sotme, me përhapje të gjerë në të gjitha kontinentet.”.

² Sh. Sinani, “Një karrierë e suksesshme, besnikërisht në albanologji”, po aty, vëllim i cituar, f. 15: “Ky Festschrift, që i kushtohet Bardhyl Demirajt, profesor universiteti, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; historian i gjuhës dhe etimolog, historian i shkrimit dhe alfabetizimit të shqipes, përfaqësues i shquar i filologjisë së tekstit me kërkimet dhe botimet që ka realizuar ndër vite; organizator tubimesh shkencore ndërkombëtare të suksesshme; nje ndërlidhëse e albanologjisë në Europë, është nëntitulluar “Në shërbim të dijes sonë të shenjtë”, duke nënkuptuar me të shenjtën albanologjinë, së cilës, sikurse nënshkruan shpesh në letrat shoqërore, i qëndroi besnik gjatë gjithë veprimtarisë së tij si studiues.”.

por dhe kontribute që përqendrohen në vetë arritjet e Bardhyl Demirajt në të tilla fusha. Në analiza tekstesh, por dhe elementesh leksikore që shpjen në faza të mëhershme të evoluimit të gjuhëve i.e., gjuha shqipe vjen si një komponente e domosdoshme dhe e vlefshme, fakt që argumentohet në sprovat hyrëse të përfshira në kapitullin më të parë, të titulluar “Gjuhësi indoeuropiane”. Në këtë kapitull përmbahen artikuj me autorë bashkëpunëtorë prej shumë vitesh të B.Demirajt, si Olav Hackstein (Ludwig-Maximilians-Universität München),³ Stefan Schumacher (Universiteti i Vienës),⁴ Sergio Neri (Universität Basel/Ludwig-Maximilians-Universität München),⁵ Giulio Imberciadori (Ludwig-Maximilians-Universität München)⁶, me tematika të lidhura me çështje themelore të studimeve gjuhësore i.e, si dhe me vështirime diakronike mbi historinë e fjalëve të caktuara në shqipe, të reflektuara dhe në gjurmimet krahasimtare mes gjuhëve të familjes gjuhësore indoeuropiane. Një linjë e tillë është mbështetur gjerësisht nga Bardhyl Demiraj dhe në tubimet shkencore ndërkombëtare të organizuara prej tij, në të cilat dhe trajtimi i argumenteve që kanë të bëjnë dhe me historinë e zërave të veçantë të shqipes dhe interpretimin e tyre në dritë të të dhënave nga gjuhësia indoeuropiane kanë pasur përherë një vend të rëndësishëm.

Kapitulli kushtuar gjurmimeve filologjike hapet me kontributin e prof. Anila Omarit (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë), të titulluar “Tekstet e vjetra shqipe (shek. XV-XIX) në shqyrtimin filologjik të Bardhyl Demirajt”. Në këtë artikull nënvizohet prirjet e shfaqura që në studimet më të hershme të Bardhyl Demirajt në lidhje me studimin e teksteve të vjetra shqipe dhe kriteret e botimit të tyre, fakt që dëshmohej që në punimet e disa viteve më parë, në të cilat vëmendja ndaj leximit të saktë, riprodhimit tekstor besnik dhe transkribimit të veprave të letërsisë së vjetër shqipe po orientohej ndaj një konkretizimi të afërt. Seria e botimeve filologjike e kritike që mbajnë vulën e kujdesimit të Bardhyl Demirajt hapet pikërisht me veprën e Gjon Nikollë Kazazit, prelatit të shekullit XVIII, hartuesit të një doracakut doktrinar që sheh dritën e shtypit në vitin 1743 e që falë botimit kritik të vitit 2006 vjen në një format të ri në pikëpamje të riprodhimit fotografik, riprodhimit diplomatik të zgjeruar dhe në vijim me rindërtimin e tekstit kritik, transkribimit dhe shtojca të natyrës ekdotike që e shoqërojnë. Ky botim i plotë që mban siglën e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës paraqitet gjithashtu i pajisur me konkordanca të tekstit dhe një komponent i tillë do të

³ O. Hackstein, “Syllabicity or Non-Syllabicity of Preverbal Onsets in German and Albanian”, po aty, vëllim i cituar, f. 27-40.

⁴ S. Schumacher, “INHEGEN, ERGREIFEN, ANHEFTEN: umfassendes zur Wurzel *keh2p im Albanischen”, po aty, vëllim i cituar, f. 41-56.

⁵ S. Neri, “Zur Herkunft von alb. e ve, Witwe”, po aty, vëllim i cituar, f. 57-76.

⁶ G. Imberciadori, “On Albanian nder m. ‘honor’”, po aty, vëllim i cituar, f. 77-84.

vërehet se përmbahet dhe në botimet e mëvona kritike mbi veprat e së njëjtës traditë letrare dhe shkrimore nga studiuesi Demiraj. Në këtë artikull të A. Omarit pikërisht botimi i sipërcituar shihet si paraprijës i disa realizimeve që në pikëpamje metodologjike përfaqësojnë dhe një prirje të re në përafrimin me tekstet e vjetra shqipe, pa lënë jashtë vëmendjes dhe të dhëna të domosdoshme mbi historikun e veprave të shekujve XVI-XVIII, të reflektuara dhe në botime të përveçme, siç paraqiten dhe sprovat që lidhen me prelatë dhe rishtarë të arealit verior shqiptar për të njëjtën periudhë.⁷

Po në këtë kapitull, me anë analizash tekstore të hollësishme që reflektojnë rëndësinë e konsiderimit të elementeve të çdo nënsistemi gjuhësor, studiuesja Ina Arapi (Universiteti i Vjenës) ka sjellë një vështrim krahasues mbi lutjen “Ati ynë” të Buzuku dhe Matrënga, duke pasuruar dhe spektrin njohës mbi këtë lutje të hershme dhe të përhapur në traditën gojore popullore shqiptare.⁸ Analiza të kësaj natyre shërbejnë jo vetëm për të vlerësuar më shumë nevojën e vështrimit sinoptik të disa teksteve që mund të përmbahen në të njëjtën vepër, por dhe njohjen më të hershme të tyre në burime popullore, që kanë bërë të mundur dhe ruajtjen e tyre për një kohë të gjatë.

Në artikullin e Evalda Pacit (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë) trajtohen çështje të njohjes së historikut të veprave të letërsisë së vjetër shqipe në gjurmimet e Bardhyl Demirajt, me një vëmendje të përqendruar dhe në vlerësimin e të dhënave biografike mbi prelatët e botës arbërore në shekujt XVI-XVIII, si elemente të domosdoshme në plotësimin e panoramës njohëse dhe analitike mbi këta të fundit.⁹ Në këtë trajtesë të E. Pacit rikujtohen dhe kontribute të përveçme që lidhen me historikun e urdhrave kishtarë në viset arbërore dhe të institucioneve kolegjiale edukative si vatra të përrimit të formimit kompleks të rishtarëve të kohës.

Një vështrim të zgjeruar mbi historinë e të shkruarit shqip, varianteve alfabetike dhe tipareve që gjurmohen në tekste të veçanta të veprave të letërsisë së vjetër shqipe ndërmerret nga studiuesi J. Matzinger (Institute for Habsburg and Balkan Studies, Akademia Austriake e Shkencave), i cili analizon dhe çështje të njohjes së alfabetit dhe të kulturës së shkrimit shqip në disa treva të viseve arbërore. Analizat grafematike të J. Matzinger janë dhe reflektime mbi

⁷ A. Omari, “Tekstet e vjetra shqipe (shek. XV-XIX) në shqyrtimin filologjik të Bardhyl Demirajt”, po aty, vëllim i cituar, f. 87-119.

⁸ I. Arapi, “Lutja “Ati ynë” të Buzuku dhe Matrënga- një vështrim krahasues”, po aty, vëllim i cituar, f. 120-132.

⁹ E. Paci, “Çështje të njohjes së historikut të veprave të letërsisë së vjetër shqipe në gjurmimet e Bardhyl Demirajt”, po aty, vëllim i cituar, f. 133-149.

interpretimin e shenjave grafike që ndërlidhin dhe vatra të zhvillimit të kulturës së shkrimit shqip në shekuj të mëhershëm.¹⁰

Në artikullin e autorëve Maria Morozova (Russian Academy of Sciences) dhe Aleksandër Rusakov (Saint Petersburg State University/Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë) analizohen çështje të përfshirjes së poetikës klasike shqipe në korpuset kombëtare shqiptare, duke pasur parasysh ngërthimin e parametrave gjuhësorë dhe filologjikë. Njëherësh, në këtë artikull rimerren dhe çështjet e përditësimit të korpusit të sipërcituar ndër vite, duke pasur parasysh dhe trashëgiminë e veprave të ndryshme në të cilat vetë lamija e poetikës është bërë objekt përfshirjeje dhe analize.

Kapitulli mbi gjurmimet filologjike përmbyllet me një trajtesë të Ledio Halës (Universiteti i Regensburgut; Universiteti “Ludwig Maximilian” - Mynih), i cili paraqitet me kontributin me titull “Sociolinguistika historike e shqipes përmes veprës së Bardhyl Demirajt”, duke shtjelluar dhe refleksione mbi koncepte, metoda e zbatime, si dhe me nevojën e ndërthurjes së kompetencave filologjike me ato të punës së gjuhëtarëve dhe studiuesve të disiplinave të tjera gjuhësore.¹¹

Në kapitullin me titull “Historia e gjuhës shqipe dhe e trevave shqiptare” përmbahen artikuj që kanë në qendër të vëmendjes historikun e njohjes së ndikimeve nga gjuhë të tjera, të kontakteve më të hershme mes popujve dhe kulturave në Ballkan, të autoktonisë së shqiptarëve në studimet shqiptare e në veçanti në ato të Bardhyl Demirajt. Profesor Seit Mansaku (Akademia e Shkencave e Shqipërisë) është autor i artikullit me titull “Problematika e huazimeve latine të shqipes në veprën e Guillaume Bonnet, *Les mots latins de l'albanais*, L'Harmattan, 1998”, duke risjellë në vëmendje dhe çështjen e kategorizimeve të elementit latin në shqipe, edhe në vështrimin e studiuesve të huaj, ndër të cilët dhe ata francezë, që kanë shtjelluar trajtesat e tyre në një sërë nënsistemesh dhe interpretimesh të vyera, gjithnjë duke u mbështetur dhe në arritjet parardhëse të reflektuara në punime dhe studime të përveçme, por dhe duke nënvizuar pikëpamjet e tyre që vijnë në ndihmë dhe të studimeve mbi historinë e gjuhës shqipe.¹²

Po në këtë kapitull mund të konsultohet dhe artikulli me titull “Autoktonia e shqiptarëve në mesjetën e hershme në një studim polemik të Bardhyl Demirajt”, të autores Mimoza Kore (Universiteti i Tiranës). Hapësira tematike

¹⁰ J. Matzinger, “Writing Albanian”, po aty, vëllim i cituar, f. 150-181.

¹¹ L. Hala, “Sociolinguistika historike e shqipes përmes veprës së Bardhyl Demirajt”, po aty, vëllim i cituar, f. 198-205.

¹² S. Mansaku, “*Problematika e huazimeve latine të shqipes në veprën e Guillaume Bonnet, Les mots latins de l'albanais*, L'Harmattan, 1998”, po aty, vëllim i cituar, f. 209-219.

e një argumenti të tillë bën të mundur dhe shtjellimin argumentor dhe njëherësh diakronik të pikëpamjeve mbi prejardhjen e shqiptarëve dhe tezat përkatëse, duke hapur rrugë për tre krerë pasues në të cilët trajtohen pikërisht teoritë e reja mbi çështjen e autoktonisë, sqarimet dhe përgjigjet që u duhen dhënë, çështjet e gjurmëve të të folurit të shqipes në Veriun e Shqipërisë në mesjetën e hershme.¹³

Në artikullin me titull “Rreth disa interesave për leksikografinë historike të studiuesit Bardhyl Demiraj”, të autores Mimoza Priku (Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, trajtohen aspekte të përveçme të kontributit kompleks të profesor Bardhyl Demirajt në gjurmimet albanologjike, ndër të cilat dhe pasurimi i së quajturës “gjuhësi e korpusit” dhe puna madhore me fjalorin historik të shqipes e ilustruar me disa zëra të veçantë zë një vend të spikatur.¹⁴

Një artikull me tematikë që merr shtysë nga trajtesa të mëhershme të profesor Bardhyl Demirajt është dhe ai me titull “Les descendants albanais et roumain du lat. *sclavus*. Notes sur l’histoire de leur employ”, e studiueses Cătălina Vătăşescu (Institut des Études Sud-est Européennes de l’Académie Roumaine), e cila analizon e njëherësh zgjeron sferën e reflektimit të një teme të lidhur me një fushë semantike të veçantë e reflektuar si në etnonime, ashtu dhe në emra të përgjithshëm, por me referencë nga burime të hershme në dorëshkrim në gjuhën rumune dhe me reflektime mbi konotacionin përkatës në këto të fundit.¹⁵

Në këtë kapitull përmbahet dhe artikulli me titull “Trevat shqiptare në kohën e dyndjes së popujve”, me autor akademik Pëllumb Xhufin, në të cilin shtjellohet një panoramë e gjerë analitike mbi gjendjen dhe dokumentimin burimor rreth popullsisë të viseve të sotme shqiptare që në kohë të Dioklecianit e në shekujt në vijim që përkojnë me mesjetën dhe zhvillimet përkatëse. Njohja e një kuadri të tillë kompleks që reflekton dhe përdorimin skrupuloz të një terminologjie shkencore bëhet më e përafrueshme falë burimeve të shumta autoriale dhe studimeve përkatëse që mbështeten në to.¹⁶

Një artikull me mjaft interes për parashtrimin e argumenteve që kanë të bëjnë me reflektimin e emërtimeve të hidronimeve të caktuara në mjaft burime të rëndësishme historiografike dhe gjuhësore është dhe ai i Xhelal Yllit

¹³ M. Kore, “Autoktonia e shqiptarëve në mesjetën e hershme në një studim polemik të Bardhyl Demirajt”, po aty, vëllim i cituar, f. 230: “A kanë qenë viset e Veriut të Shqipërisë hapësirë shqipfolëse në mesjetën e hershme?”

¹⁴ M. Priku, “Rreth disa interesave për leksikografinë historike të studiuesit Bardhyl Demiraj”, po aty, vëllim i cituar, f. 235-246.

¹⁵ C. Vătăşescu, “Les descendants albanais et roumain du lat. *sclavus*. Notes sur l’histoire de leur employ”, po aty, vëllim i cituar, f. 247-265.

¹⁶ P. Xhufi, “Trevat shqiptare në kohën e dyndjes së popujve”, po aty, vëllim i cituar, f. 266-296.

(Akademia e Shkencave e Shqipërisë), i përfshirë po në këtë kapitull dhe që mban titullin “Vëzhgime gjuhësore në hidroniminë e Shqipërisë veriore”.¹⁷

Vëllimi në vijimësi përmban dhe kapitullin me titull “Gjuhësi variantesh dhe shqipja në kontakt”, që paraqitet i pasur me ndihmesa dhe me shkrime që kanë të bëjnë me botën e arbëreshëve të Kalabrisë (Titos Jochalas, Akademia e Athinës)¹⁸; me gjurmime e të dhëna leksikore mbi të folme të përveçme të shqipes të gjurmuara në rrethana të veçanta historike (M.De Vaan, Universitët Basel);¹⁹ Enkeleida Kapia (Akademia e Shkencave e Shqipërisë/ Institute of Phonetics and speech processing.Ludwig Maximilians-Universität München) - Josiane Riverin-Coutlée (Institute of Phonetics and speech processing. Ludwig Maximilians-Universität München), me vëmendje të orientuar ndaj shndërrimeve dhe tipareve dialektore të gegërishtes, të gjurmuara në matje e hulumtime konkrete;²⁰ me fjalë me burim nga greqishtja dhe çështje të fjalësit në Fjalorin etimologjik të K.Topallit (Dhori Qirjazi, Universiteti Aristoteli i Selanikut);²¹ me vëzhgime etimologjike mbi zëra të veçantë që dëshmohen të përfshirë në disa burime leksikografike mbi shqipen (M. Majer, Universiteti i Lodz-it, Poloni)²²; me huazimet orientale dhe çështje të natyrës leksikologjike në Kodikun Beratas (P. Gashi, “Ludwig Maximilians-Universität München”)²³; me çështje të kulturës arsimore dhe përvoja të studentëve shqiptarë në Gjermani (Ema Kristo, Universiteti i Tiranës)²⁴.

Në kapitullin me titull “Albanologu dhe publiku” do të përmbahet artikulli i Ardian Vehbiut “Ndërfaqja e albanologut me publikun – Bardhyl Demiraj si bashkëpunëtor i revistës kulturore online “Peizazhe të fjalës””, me një vëmendje të përqendruar në kontributet më të spikatura të studiuesit Bardhyl

¹⁷ Xh. Ylli, po aty, vëllim i cituar, f. 297-312.

¹⁸ T. Jochalas, “Con gli indimenticabili arberesh della Calabria”, po aty, vëllim i cituar, f. 315-325.

¹⁹ M. De Vaan, “The Kelmendi dialect from Slavonia in 1782 and 1839. Transliteration and concordance”, po aty, vëllim i cituar, f. 326-363.

²⁰ E. Kapia-J.Riverin-Coutlée, “Agent-based modeling of dialect change and stability in Gheg Albanian”, po aty, vëllim i cituar, f. 364-386.

²¹ Dh. Qirjazi, “Fjalë me burim nga greqishtja dhe çështje të fjalësit në Fjalorin etimologjik të K.Topallit”, po aty, vëllim i cituar, f. 387-403.

²² M. Majer, “Mundësitë e një etimologjie sllave të fjalës prondit “prodhoj””, po aty, vëllim i cituar, f. 404-420.

²³ P. Gashi, “Huazimet orientale dhe disa çështje të tjera leksikologjike te Kodiku Beratas (shek. XVIII)”, po aty, vëllim i cituar, f. 421-439.

²⁴ E.Kristo, “Sprachliche Barrieren und Bildungskultur: Einblicke in die Erfahrungen albanischer Studierender in Deutschland”, po aty, vëllim i cituar, f. 440-457.

Demiraj në këtë organ të rëndësishëm të periodikut shqiptar dhe që kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me çështjet më të rrahura në gjurmimet albanologjike.²⁵

Kapitulli me titull “Kulturë shqiptare” përmban artikullin me titull “Kulturelle Überläufer? Versuch einer Kulturgeschichte der Kosovoalbaner in Titos Jugoslawien” të studiuesit Christian Voss²⁶ (Humboldt-Universität zu Berlin) dhe pasohet nga një dëshmi përvoje bashkëpunimi vetjake nga Barbara Epple (Sekretariat Ludwig-Maximilian-Universität München; Institut für Vergleichende und Indogermanische Sprachwissenschaft sowie Albanologie).²⁷

Duke qenë një vëllim që përmbledh në një botim të vetëm mjaft kontribute nga disa fusha të gjurmimeve albanologjike, e gjejmë me vend të nënvizojmë përpjesëtimin e duhur në ndihmesa dhe në kujdesin për të reflektuar sërish disa çështje që e përmbajnë në mënyrë të natyrshme dhe ngërthimin e disa kompetencave, fakt që dëshmohet dhe në sprovat më të fundit të albanologut Bardhyl Demiraj, gjithnjë i vëmendshëm ndaj analizimit të hollësishëm të teksteve dhe varianteve që bëjnë të mundur dhe shtjellimin e interpretimeve të reja dhe mbështetjes në një sërë burimesh dokumentare dhe autoriale me rëndësi e peshë të veçantë. Vëllimi është përgatitur nën kujdesin e vazhdueshëm të redaksisë shkencore e në veçanti të koleges Anila Omari që ka ndjekur me përkushtim gjithë procesin e përgatitjes për botim të tij, duke lënë dhe shembullin e një angazhimi serioz dhe dinjitoz, siç e kërkonte dhe vetë përmasa e një ndërmarrjeje të tillë, kolegjiale dhe njëherësh institucionale. Bashkëpërfshirjen institucionale në këtë ndërmarrje kushtimi ndaj veprës dhe kontributeve të shumta e themelore të Bardhyl Demirajt e dëshmon sërish dhe Tabula gratulatoria me të cilën ky vëllim hapet, duke bërë të mundur të shihen të renditura seli dinjitoze të kërkimit shkencor, të mësimdhënies universitare në Evropë e më gjerë, si dhe emra bashkëpunëtorësh dhe kolegësh me të cilët ai ka ndarë ndër vite përvoja të vyera profesionale.

²⁵ A.Vehbiu, “Ndërfaqja e albanologut me publikun – Bardhyl Demiraj si bashkëpunëtor i revistës kulturore online “Peizazhe të fjalës””, po aty, vëllim i cituar, f. 461-471.

²⁶ Ch.Voss, “Kulturelle Überläufer? Versuch einer Kulturgeschichte der Kosovoalbaner in Titos Jugoslawien”, po aty, vëllim i cituar, f. 472- f.494.

²⁷ B. Epple, “Eindrücke aus der Zusammenarbeit mit Prof. Demiraj”, po aty, vëllim i cituar, f. 495-497.

JETA SHKENCORE

Konferencë shkencore ndërkombëtare për Albanologji e Gjuhësi historike

Në datën 29 shtator 2025, në Universitetin e Baselit, Zvicër, u mbajt tryeza shkencore “New Advances in Albanian Philology and Historical Linguistics – Arritje të reja në filologjinë dhe gjuhësinë historike shqipe”, organizuar nga PD Dr. Sergio Neri, Universiteti i Baselit, Departamenti i Shkencave të Antikitetit, në kuadrin e projektit studimor “The Albanian Language in Antiquity – Gjuha shqipe në Antikitet”, projekt i Departamentit të Qytetërimeve të Lashta në Universitetin e Baselit, drejtuar nga prof. dr. Michiel de Vaan. Në takim morën pjesë tetë studiues të njohur për kontribute në fushë të albanologjisë, të cilët paraqitën rezultatet e kërkimeve në proces në fushë të filologjisë dhe gjuhësisë shqipe dhe diskutuan rreth tyre. Plator Gashi, Universiteti i Mynihut & Marek Majer, Universiteti i Lodzit, Poloni, mbajtën kumtesën “The Southern Tosk Lord's Prayer from Adelung & Vater's Mithridates”, ku paraqitën një analizë filologjike dhe gjuhësore të lutjes Ati ynë në shqip të veprës enciklopedike Mithridates të vitit 1806; Alexander Robert Herren, pjesëtar i projektit Gjuha shqipe në antikitet, foli rreth arritjeve në dukuritë gjuhësore të kontaktit mes rumanishtes e shqipes, me përqendrim në fonologji dhe morfologji. Michiel de Vaan diskutoi për mbaresat foljore në shqipen e vjetër (On the verb endings in Proto-Albanian); Monica Genesin nga Universiteti i Salentos foli për disa parafjalë që drejtojnë lokativin në shqipen e vjetër (Orientation in space: A study based on the cognitive linguistic approach on some locative prepositions in Old Albanian); Stefan Schumacher nga Universiteti i Vjenës paraqiti rezultatet e kërkimeve të tij të thelluara në tekstin e Buzukut në përjasje edhe me modele të tjera bashkëkohëse të tij (Neue Erkenntnisse zu den Textgrundlagen der Perikopen bei Buzuku – Zbulime të reja mbi burimet e teksteve të perikopeve të Buzukut); Gerard Spaans, pjesëtar i projektit Gjuha shqipe në antikitet, kandidat për PhD në albanologji, foli për origjinën e mbaresave femërore të shumësit në shqipe (The origin of the Albanian feminine plural endings).

Në tryezë ishte ftuar edhe punonjësja shkencore e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, prof. dr. Anila Omari, e

cila mbajti kumtesën “Një sprovë klasifikimi të italianizmave të shqipes së vjetër (shek. XVI-XVII)”, në të cilën analizoi korpusin e italianizmave të shqipes së teksteve të vjetra, të përpunuar në kuadrin e projektit “Fjalor digjital filologjik-etimologjik i shqipes së vjetër (shek. XV-XVIII)” (DPEWA) të Universitetit Ludwig-Maximilian të Mynihut, me qëllim klasifikimin sipas mënyrës së transmetimit të tyre në gjuhën shqipe, duke përcaktuar disa kritere për dallimin e huazimeve të marra në rrugë librore, për nevoja të përkthimit dhe të mbetura pa vazhdimësi në hapësirë dhe kohë, dhe huazimeve popullore, të hyra nëpërmjet gjuhës së folur, kryesisht si huazime kulturore përmes kontakteve gjuhësore. Në përfundim të kësaj analize, rezultoi një raport i tillë mes dy kategorive: nga një numër i përgjithshëm prej 950 italianizmash, 232 përcaktohen si huazime popullore dhe 718 të tjerat janë huazime diturore, fjalë librash, shumë prej të cilave janë përdorur vetëm një herë për nevoja të tekstit, ndërsa shumë të tjera mbetën me përdorim të kufizuar në shqipen e vjetër.

Kumtesat u shoqëruan me diskutime të frytshme dhe shkëmbime mendimesh mes specialistëve të fushës së gjuhësisë historike të shqipes.

Anila Omari

**Konferenca shkencore “Gjurmët e fjalës-
Martin Camaj në 100-vjetorin e lindjes”,
Akademia e Shkencave e Shqipërisë,
Tiranë, 15 dhjetor 2025**

Më datën 15 dhjetor 2025 në sallën “Aleks Buda” në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u mbajt konferenca shkencore mbarëkombëtare “Gjurmët e fjalës-Martin Camaj në 100-vjetorin e lindjes”, fryt i një bashkorganizimi mes Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike pranë Akademisë së Shkencave, Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (ASHSH) dhe Qendrës së Studimeve Albanologjike pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Në këtë konferencë morën pjesë studiues të letërsisë shqipe dhe asaj të krahasuar, të gramatologjisë e orientimeve themelore në albanologji, të cilët u paraqitën me argumente me interes e që lidhen ngushtësisht me veprën e Martin Camajt (1925-1992). Në fjalën e hapjes Akademik Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nënvizoi rëndësinë e mbajtjes së kësaj konference, në të cilën Martin Camaj përkujtohet dhe njëherësh rilexohet përmes vështrimesh të reja, por dhe që plotësojnë trajtesa të mëparshme rreth veprës e kontributeve të tij në disa fusha themelore të dijes. Në këtë konferencë mbajti një fjalë përshëndetëse dhe z.Bujar Hudhri, botues i veprës së plotë të Martin Camajt ndër vite, më së fundi dhe i një formati krejt të ri të kësaj të fundit, të pajisur dhe me parathënie të gjerë studimore nga akademik Matteo Mandalà. Receptimi i veprës së Martin Camajt orientohet më së miri dhe nga realizimi i botimeve të kësaj natyre, që merr parasysh gjinitë dhe veprat më të rëndësishme të këtij autori.

Në seancën e parë të kësaj konference, të drejtuar nga prof. dr. Bashkim Kuçuku dhe prof. asoc. dr. Evalda Paci, u trajtuan çështje të rileximit dhe të receptimit të veprës së Camajt, bashkë me nënvizimin e pranisë së arketipisë dhe modeleve të përveçme të gjinive letrare, tipareve të shqiptarësisë që reflektohen në krijimet më të rëndësishme të tij, si dhe vetë diversiteti i tipologjisë zhanrore, fakt që bën që të ketë sërish pikëpamje të ndryshme mbi përcaktimin e gjinive letrare që pasqyrohen në këtë krijimtari të tij. Prof.dr.Bashkim Kuçuku u paraqit me kumtesën me titull “Arketipia, traditë dhe identitete”, duke u ndalur dhe në interpretimin e gjenezës së stilit krijues

dhe motivet themelore e komplekse që reflektohen në krijimtarinë e tij letrare. Në kumtesën me titull “Midis strukturës dhe lirisë: Paralele Camaj - Jakobson mbi gjuhën si sistem dhe përvojë estetike”, prof.dr.Aljula Jubani (Universiteti i Tiranës) në bashkautorësi me A.Jankon trajtoi çështje të pranisë së ndikimit në formimin gjuhësor të Camajt të elementeve e shkollës së rrethit gjuhësor të Pragës, fakt që dëshmohej dhe në qëmtimet e tij në fushë të gramatologjisë. Në kumtesën me titull “Shumëgjuhësia në veprën e Camajt dhe marrëdhëniet e saj me kontekstin e sotëm gjuhësor” të prof.dr.Mimoza Prikut (Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”) u trajtuan çështje të zgjedhjeve gjuhësore në krijimtarinë letrare të Camajt, duke u mbështetur në analiza të tekstit dhe të varianteve të fjalëve të caktuara, me një konotacion të caktuar në leksikon krahinor dhe mbarëshqiptar. Në kumtesën me titull “Dranja, emblema e veprës letrare të Camajt” të prof.as.dr.Arben Prendit (Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”) u trajtuan me hollësi aspekte të klasifikimit e sheshtimit zhanror në veprat e Martin Camajt, duke nënvizuar veçanërisht thyerjen e tipologjisë së llojit, dukurinë e palimpsestit, vëzhgimet mbi tekstin e kodifikuar, mundësinë e interpretimeve të ndryshme në vështrimet e studiuesve.

Në kumtesën me titull “Kultura e librit të shtypur dhe çështje të receptimit të tekstit biblik në studimet e Martin Camajt”, prof.as.dr.Evalda Paci (Departamenti i Studimeve Letrare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë) u ndal në çështje të interpretimit të disa të dhënave që kanë të bëjnë me kulturën e librit të shtypur, aspekte të njohjes së teknologjisë përkatëse në shekullin XVI, si dhe në analizat tekstore me burim pasazhe ungjillore që mundësojnë dhe një brendësim të thelluar të teksteve të vjetra shqipe në optikën e M.Camajt.

Seanca e parë paralele u mbajt sërish në sallën “Aleks Buda” dhe u drejtua nga prof.as.dr.Lili Sula, prof.as.dr.Viola Isufaj, prof.as.dr.Alva Dani. Në kumtesën me titull “Burime klasike në poezinë e Camajt”, prof.as.dr.Lili Sula (Universiteti i Tiranës) u përqendrua në aspekte të pranisë së motiveve të botës klasike në krijimtarinë e Camajt, duke u ndalur në tekste të përveçme poetike të tij, si dhe duke nënvizuar disa vështirime studimore në lidhje me këtë dimension të shkrimtarisë së tij. Me kumtesën e titulluar “Camaj si përkthyes i Ungaretit”, prof.as.dr.Alva Dani trajtoi me anë analizash krahasimtare disa hollësi të përkthimeve të krijimtarisë poetike të letërsisë italiane nga Camaj, duke interpretuar dhe diferencimet përkatëse në përftesa mes varianteve të tij në gjuhën shqipe dhe të teksteve gjegjëse poetike të Ungaretit. Me kumtesën me titull “Ndër mijëra trajta ideja (një qasje fenomenologjike dhe hermeneutike në tekstin poetik të M.Camajt)”, prof.as.dr.Viola Isufaj (Universiteti i Tiranës) u ndal në çështje të interpretimit të simbologjisë komplekse përmes personazhesh në veprën e Martin Camajt, duke ilustruar me analiza konkrete tekstore nga kjo e fundit, për të nënvizuar më tej dhe përsosmërinë e strukturave poetike dhe figurshmërinë komplekse në to. Studiuesi Behar Gjoka u paraqit me një

kumtesë në të cilën trajtohej pikërisht një aspekt me interes në njohjen e personalitetit krijues të Camajt e që mbante titullin “Dramaturgjia ekzistenciale e Martin Camajt”. Me kumtesën me titull “Arkivi që flet: strategjitë e Martin Camajt për albanologjinë e së nesërme”, studiuesi Ledio Hala (Universiteti i Regensburgut) u ndal mbi çështje të rrugëtimit profesional të Martin Camajt, mbi kontributet e tij në fushë të mësimdhënies universitare dhe veçanërisht në lidhje me albanologjinë. Studiuesja Jorina Kryeziu (Shkreta) u paraqit me kumtesën me titull “Evolucioni zhanror; Fillesa, Djella”, ndërsa Alma Abdullahu (Universiteti i Prishtinës) mbajti kumtesën “Limiti i autorit: “Vetëpërcaktimi” i Camajt”.

Seanca e dytë paralele u zhvillua në sallën “Akademikët” dhe u drejtua nga dr.Virion Graçi, prof.as.dr.Zamira Shkreli dhe dr.Belfjore Qose.

Në kumtesën me titull “Novelat e Martin Camajt: “Pishtarët e natës”, “Shkundullima”, “Rrunga në mars”, - mes njëmendësisë e legjendës”, studiuesi Virion Graçi (Departamenti i Studimeve Letrare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë) u ndal hollësisht në çështje të leximit e interpretimit të përmbajtjes në një gjini të përveçme letrare të lëvruar nga Martin Camaj. Në kumtesën me titull “Modernizmi i M. Camajt, një estetikë “e huaj”, dr.Belfjore Qose (Universiteti i Tiranës) trajtoi çështje të rinjohjes së prirjeve letrare dhe estetike në veprën e Camajt. Një vështrim kompleks e njëherësh ndërdisiplinor u paraqit nga studiuesja Rafaela Marteta (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), e cila mbajti kumtesën me titull “Skaje identitare te Djella. Një histori shoqnore dhe gjuhësore sipas Camajt”. Rrezarta Draçini (Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”) u paraqit me kumtesën me titull “Loja e fjalëve dhe loja e jetës: psikeja malësore në krijimtarinë e Camajt”, ndërsa Roven Vata (Departamenti i Studimeve Letrare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë) ceku çështje të leximit letrar dhe antropologjik në trajtesën me titull “Vendlindja, identitetet dhe pjesë të kujtesës antropologjike në vargjet poetike të Martin Camajt”. Studiueset Zamira Shkreli, Anisa Kosteri (Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”), u paraqitën me kumtesën me titull “Martin Camaj si etnolinguist. Ndërlidhja e dialektit, mitit dhe identitetit kombëtar”, duke u përqendruar në vlerat etnokulturore të shkrimtarisë së Camajt e në veçanti në tipare të shprehësisë në novelën me titull “Shkundullimat”.

Neli Naço (Instituti i Antropologjisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë) u paraqit me kumtesën me titull “Shenja të modernitetit: poetika e arkaikes në poezinë e Martin Camajt”.

Me tematikat e cekura gjatë punimeve të kësaj konference shkencore synohej të thelloheshin disa linja studimore që kanë të bëjnë me studimin e prozës dhe poezisë së Camajt, por dhe të analizoheshin tipare të përveçme të krijimtarisë së tij (dramaturgjia ndër të tjera) si dhe arketipia, mitet dhe receptimi i burimeve klasike, gjithashtu dhe kërkime specialistike në fushë të

gjuhësisë, filologjisë së tekstit dhe analizës së krahasuar tekstore, një metodë kjo e pranishme në disa punime shkencore të tij, për të cilat dhe ka vend të flitet më gjerë. Personaliteti shumëdimensional i Martin Camajt u shtjellua gjerësisht dhe në përputhje me tiparet qenësore të krijimtarisë dhe të kontributeve të tij në disa disiplina.

Evalda Paci

Konferencë shkencore ndërkombëtare “Frazeologjia e gjuhës shqipe në arealin gjuhësor ballkanik”

Më 18 dhjetor 2025, në mjediset e Akademisë së Shkencave, në Tiranë, u zhvilluan punimet e Konferencës shkencore ndërkombëtare “*Frazeologjia e gjuhës shqipe në arealin gjuhësor ballkanik*”. Kjo veprimtari e rëndësishme akademike mbledhi studiues nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut por edhe albanologë që punojnë në disa auditorë universitarë të Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë.

Konferencën e hapi përgjegjësi i departamentit, z. Artur Lama, i cili parashtroi rëndësinë dhe qëllimet e saj. Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave, pjesëmarrësit dhe organizatorët i përshëndeti akad. Gëzim Hoxha.

Punimet e konferencës vijuan me seancën plenare, ku akad. Valter Memisha paraqiti referatin shkencor “*Frazeologjia e gjuhës shqipe në arealin gjuhësor ballkanik*”, të përgatitur së bashku me akad. Jani Thomain. Në këtë referat u prezantua fondi i pasur i frazeologjisë së shqipes, i pasqyruar në *Fjalorin e Madh të gjuhës shqipe* dhe në disa fjalorë dialektorë e dygjuhësh. U theksua zgjerimi i tematikës së studimeve gjuhësore, këndvështrimet e reja mbi aftësinë tekstformuese të frazeologjisë, identitetin dhe kufijtë e saj, variacionin frazeologjik, si dhe zhvillimet në fushën e frazeografisë.

Më pas u prezantuan një sërë kumtesash të nivelit të lartë shkencor, të cilat sollën perspektiva të reja mbi rolin e frazeologjisë. *Hajri Shehu*, paraqiti kumtesën “Për barasvlerësinë përkthimore në një fjalor frazeologjik dy gjuhësh me shqipen” duke i mëshuar faktit se gjatë përkthimit të një entiteti frazeologjik nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe, merr rëndësi të veçantë përkthimi i koncepteve. *Gjovalin Shkurtaj*, me kumtesën “Frazeologjia si shprehje e urtësisë dhe e etnografisë së të folurit ndër shqiptarë”, trajtoi urimet që vijnë nga ligjërimi i përditshëm dhe dysorët frazeologjikë dialektorë e stilistikë. *Ali Jashari* në kumtesën “Shpërbërja” e strukturës së njësive frazeologjike në ligjërimin e shkruar që e paraqiti online, trajtoi procesin e rrudhjes dhe shpërbërjes së njësive frazeologjike”. *Agron Duro*, në kumtesën “Veçori kryesore tipologjike semantiko-strukture të togfjalëshave frazeologjike kundrejt togfjalëshave terminologjike në shqipe në përqasje me serbokroatishten”, u ndal në përqasjen e këtyre dy entiteteve gjuhësore në koncepte të qenësishme, si: koka e frazës, grupi i ndërkombëtarizuar frazeologjik, në mundësinë që forma të ndikojë mbi termin kur bëhet fjalë për një variant frazeologjik. Artur Lama me kumtesën “Përdorimi diskursiv dhe

forca humoristike e frazeologjisë në prozën e Qamil Buxhelit" trajtoi zbulimin e peshës dhe të efekteve humoristike të frazeologjive në prozën e Q. Buxhelit përmes mekanizmit njohës intelektual, - vlerave dhe asocimeve emocionale. Këto kumtesa sollën perspektiva të reja mbi rolin e frazeologjisë në gjuhën shqipe dhe marrëdhëniet e saj me gjuhët e tjera të rajonit.

Seanca e parë paralele, e zhvilluar në sallën "Aleks Buda", nisi me kumtesën e përgatitur në bashkautorësi nga Klodeta Dibra dhe Ermira Ymeraj, të titulluar "*Përtej fjalës: strategji dhe teknika të përkthimit të njësive frazeologjike në prozën e Deledda-s*". Autorët u përqendruan në përkthimin si akt interkulturore, duke nxjerrë në pah problematikat që shfaqen gjatë transferimit të frazeologjisë në gjuhën shqipe, veçanërisht në veprën e nobelistes italiane Grazia Deledda, ku frazeologjia është një nga tiparet themelore të stilit të saj. Në vijim, Dhori Qirjazi paraqiti kumtesën "*Lëndë frazeologjike nga viset e Marko Boçarit (vjelë prej veprës së mësuesit Fotius Athanasiu)*", ku u ndal në shqyrtimin e materialit gjuhësor të pranishëm në dy vepra të hershme të Athanasit, përfshirë një gramatikë të botuar në zonën e Sulit, e cila sillte një lëndë të begatë për të folmen e çamërishtes, pavarësisht kufizimeve teorike që kishte. Më pas, Dhimitër Bello, në kumtesën "*Idioma me vatër motivuese kokë dhe mendje në shqipe dhe bullgarishte*", analizoi njësitë frazeologjike që kanë strukturë të ngjashme në dy gjuhët ballkanike, duke i shqyrtuar në fusha tematike si vetëdija, inteligjenca, shkaku dhe pasojat, ngjashmëria dhe ndjesitë fizike, të mbështetura në një lëndë burimore të gjerë nga fjalorë frazeologjikë të ndryshëm. Tomorr Plangarica, me kumtesën "*Frazeologjia dhe diskursi – dy objekte të veçanta studimi, por me ndikim të ndërsjellë*", theksoi nevojën e zgjerimit të qasjeve në shqyrtimin e frazeologjisë, duke e parë ndërdisiplinaritetin si një mundësi të domosdoshme. Ai trajtoi raportet hiper/hiponimike mes diskursit dhe frazeologjisë, duke parashtruar tregues që motivonin marrëdhënien e ndërsjellë mes dy epistemave, si dhe lidhjet e tyre me disiplina të tjera të shkencave të ligjërimit, si gjuhësia e korpusit, leksikometria, logometria dhe tekstometria. Aristotel Spiro, në kumtesën "*Frazemat me vatër motivuese fjalën 'ujë', parë nga një perspektivë konjitive*", bëri një parashtrim teorik të qasjes konjitive në analizën e frazeologjisë, duke theksuar rëndësinë e gjuhësisë konjitive në shpjegimin e dukurive metaforike. Ai u përqendrua në frazemat e përfuara me bazë fjalën "ujë", duke i mbështetur argumentimet në një lëndë të gjerë studimore të marrë jo vetëm nga shqipja, por edhe nga gjuhë të tjera ballkanike si greqishtja, rumanishtja, bullgarishtja dhe serbishtja. Në kumtesën e përgatitur në bashkautorësi "*Rreth pasqyrimin të frazeologjisë në Fjalorin e madh të gjuhës shqipe*", Olger Bame dhe Ali Jashari sollën të dhëna me interes mbi punën e bërë për krijimin e korpusit frazeologjik të shqipes, duke theksuar inventarizimin e plotë të fondit frazeologjik, burimet kryesore si *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe* i Jani Thomajt me rreth 9 mijë njësi, si dhe

pasurinë frazeologjike të pasqyruar në studime dhe veprat letrare. Seanca u mbyll me kumtesën e Merita Brucit dhe Engjëllushe Karajt “*Elemente kozmike në frazeologji: pikëtakime arbërore*”, ku u trajtuan njësitë frazeologjike me vatrë motivuese fjalët *dielli, yjet, hëna* dhe *ylberi*, të pranishme në traditën arbëreshe dhe të nxitura nga Rapsoditë e De Radës. Autorët theksuan rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe gjuhësore të arbëreshëve të Italisë, duke e parë këtë si një pasuri të veçantë për studimet frazeologjike.

Në seancën e dytë paralele, të zhvilluar në sallën “Akademikët”, u trajtuan një sërë problemesh të rëndësishme që lidhen me reflektimin teorik të frazeologjisë shqipe. Kumtesa e Anila Kananajt (IGJL) dhe Teuta Toskës (UEL), e titulluar “*Rreth mekanizmave konjitivë të metaforës dhe metonimisë në frazeologjinë shqipe*”, u përqendrua mbi një material të gjerë, duke shqyrtuar dy rrugët kryesore të formimit të njësive frazeologjike: metaforën dhe metoniminë, si mekanizma konjitivë që gjenerojnë idiomatizim. Dy kumtesa të tjera iu kushtuan gjuhësisë korpusit. Aleksandër Rusakov (IGJL), në kumtesën “*Folja në mënyrën dëshirore në strukturën frazeologjike të shqipes*”, mbi bazën e Korpusit elektronik të gjuhës shqipe, u përpoq të klasifikojë format e mënyrës dëshirore nga pikëpamja e shkallës së idiomatizimit të tyre. Ndërkohë, Adelina Çerpja (IGJL) dhe Anila Çepani (UT), në kumtesën “*Shprehjet frazeologjike ndërmjet strukturës sintaksore në UD dhe përfaqësimit leksiko-semantik në PARSEME*”, trajtuan një problem aktual të gjuhësisë së korpusit, atë të ndërthurjes së analizës sintaksore me përfaqësimin leksiko-semantik. Një tjetër kumtesë me interes ishte ajo e Maria Morozovës (Universiteti i Shën Petersburgut), “*Frazeologjizmat e lidhur me të folurit ndër shqiptarët e Ukrainës: në bazë të materialeve të N. Kotovës*”, e cila iu kushtua shqyrtimit të idiomatikës nga këndvështrimi etimologjik, në një nga dialektet e diasporës shqiptare. Orjeta Baja (USH), në kumtesën “*Shprehësia stilistike e frazeologjisë veriperëndimore shqiptare: nga tradita gojore te vepra ‘Fjalë ari’*”, trajtoi një faqe të rëndësishme të historisë së folkloristikës shqiptare, duke u ndalur në përmbledhjen e Dom Aleksandër Sirdanit dhe pasurinë frazeologjike që ajo përmban. Në kumtesën e Aurela Bashës (UEL), “*Aspekte pragmatike të njësive frazeologjike në gjuhën shqipe*”, mbi bazën e një korpusi të përgatitur posaçërisht, u analizua në mënyrë të hollësishme zhvillimi semantik i togfjalëshit *marr vesh*, duke nxjerrë në pah dimensionin pragmatik të përdorimit të tij. Irda Dervishi (UT), në kumtesën “*Frazeologjitë në shqipe të motivuara nga një huazim sllav*”, paraqiti një analizë të frazeologjizmave të kufizuar nga etimologjia e përbërësit bazë, duke evidentuar ndikimet e huazimeve sllave në strukturën frazeologjike të shqipes. Problemeve didaktike iu kushtua kumtesa e Sejdi Gashit (IAP), “*Shprehjet frazeologjike në tekstet shkollore të gjuhës shqipe të klasave 6–9 në Kosovë*”, ku u trajtuan vështirësitë dhe mundësitë e përdorimit të frazeologjizmave në mësimdhënien shkollore. Seanca u mbyll me kumtesën e Erjena Lamajt (IGJL), “*Kartoteka si burim*

dokumentimi për frazeologjinë krahinore”, ku u analizua historia dhe gjendja aktuale e kartotekës së IGJL-së, duke u parë si një burim i rëndësishëm për studimin e frazeologjisë dialektore.

Konferenca vlerësoi traditën shkencore, parashtrimet serioze në kumtesa dhe orientoi thellimin e trajtimeve sipas qasjeve sotme të shkollave evropiane dhe ballkanike, vijimi e punës për mbledhjen e njësive frazeologjike në prozën letrare të pas viteve '90 dhe në shtypin e përditshëm; promovimin e veprës Fjalori i madh i frazeologjisë që po hartohet nga një grup frazeologësh (J. Thomai, V. Memisha, Ali Jashari), bashkëpunimin ndërinstitucional midis Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe Institutit të Antropologjisë për hulumtimin dhe mbledhjen e variacioneve frazeologjike që shfaqen në praktikën e përditshme ligjërimore.

Artur Lama

IN MEMORIAM

U nda nga jeta prof. dr. Hëna Pasho (1941-2025)

Gjuhëtarja e njohur, prof. dr. Hëna Pasho lindi në vitin 1941 në Përmet. Kreu shkollën e mesme pedagogjike “17 Nëntori”, Tiranë, dhe më pas studimet e larta në Universitetin e Tiranës, dega Gjuhë shqipe e letërsi, të cilat i përfundoi me rezultate shumë të larta në vitin 1966. Për 3 vjet punoi si mësuese dhe si drejtuese shkollë në Përmet. Në vitin 1969 fillon punë në Institutin e Gjuhësisë dhe të Historisë, pranë Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës, kurse në vitin 1972 fillon punë në sektorin e terminologjisë pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, ku punoi deri në vitin 2009, kur doli në pension.

Prof. Hëna Pasho ka qenë një nga studiueset më të spikatura në Albanologji dhe në Institutin e Gjuhësisë deri në kohën që pensionohet, ishte e vetmja femër që mbante titullin “Profesor”. Ajo pati fatin e madh të punonte me akad. Eqrem Çabej, me akad. Mahir Domi, me akad. Androkli Kostallarin, me akad. Jani Thomain, dhe me shumë dijetarë të tjerë, si prof. Lirak Dodbibën, prof. Ferdinand Lekën, prof. Jorgji Gjinarin, prof. Miço Samarën e të tjerë, nga të cilët mësoi shumë.

Prof. Hëna Pasho në vitin 1988 ndoqi “Shkollën verore” të Vjenës (INFOTERM), pranë Qendrës Ndërkombëtare e Terminologjisë, duke pasuruar dhe konsoliduar formimin e vet shkencor.

Fusha saj e ngushtë e studimeve ishte terminografia dhe terminologjia e shkencave shoqërore. Ajo punoi në dhjetëra grupe pune me specialistë e gjuhëtarë për hartimin e 12 fjalorëve terminologjikë normues (shqip-gjuhë të huaja) për disiplinat e ekonomisë, të drejtësisë, të gjeografisë e të anatomisë, që janë vepra kolektive dhe ku ndihmesa e saj si drejtuese dhe si hartuese janë të vlerësuara shkencërisht.

Edhe pas daljes në pension, ajo nuk i ndërpreu asnjë çast marrëdhëniet me Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Në vitin 2017 Instituti botoi përmbledhjen e saj me artikuj “Probleme gjuhësore të terminologjisë në gjuhën shqipe”.

Këta 4 vjetët e fundit ajo dha ndihmesë të çmuar në pasurimin e Korpusit elektronik për Fjalorin e Madh të Gjuhës shqipe (me 125.000 fjalë e që është në proces përfundimi) me terma nga fusha e financës, e ekonomisë, e bankës etj.

Ajo ka marrë pjesë në projektin ndërkombëtar për hartimin e një fjalori shumëgjuhësh me terma të bibliotekës, në cilësinë e konsulentës gjuhësore për termat shqip, projekt i drejtuar nga Research Development Department National and University Library, Ljubljana, Slovenia.

Ajo është nderuar me Urdhrin “Naim Frashëri” të klasit III dhe me Medaljen “Për shërbime të shquara shtetërore dhe shoqërore”.

Largimi i prof. Hëna Pasho nga jeta krijon një zbrazëti që e ndiejnë jo vetëm të afërmit, por dhe ne ish-kolegët e saj të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë.

Valter Memisha

TABLE OF CONTENTS

Bardhyl Demiraj	The Slavic Linguistic-Cultural Influence on Gjon Buzuku's 'Missal' – a Scientific-Philological Narrative.....	5
Anila Omari	Classification of Italianisms in Old Albanian (16th-17th centuries): Learned vs. Vernacular Loanwords	57
Tomorr Plangarica	Towards a Broader Space for Discourse Linguistics in Albanian Linguistic Thought.....	83
Evalda Paci	Elements of Biography and Autobiography in the Works of Roman Literature Authors (a view on translations and adaptations).....	129
Rafaela Marteta	Writings on prison: the features of a new literary theme in post-communism.....	141
Abdurrahim Maxhuni	Grammatical - lexical features of the terms within the Dictionary of Legal Terms.....	163

ISSUES AND DISCUSSIONS

Emil Lafi	Orthographic rules that have been overcome by time.....	175
-----------	---	-----

CRITIQUES AND BIBLIOGRAPHY

Anila Kananaj	<i>Studies in theoretical and applied syntax</i> by Prof. Seit Mansaku.....	191
Evalda Paci	Albanological studies in Indo-European studies, philology and contact linguistics; volume in honor of Prof. Bardhyl Demiraj, Albanian Academy of Sciences, Tirana, 2025	201

SCIENTIFIC LIFE

International scientific conference on Albanology and Historical Linguistics (A. Omari).....	209
--	-----

Scientific conference "Traces of the Word – Martin Camaj on the 100th anniversary of his birth", Academy of Sciences of Albania, Tirana, December 15, 2025 (E Paci).....	211
--	-----

International conference “Phraseology of the Albanian language in the Balkan linguistic area” (A. Lama).....	215
--	-----

IN MEMORIAM

Prof. dr. Hëna Pasho (1941-2025) passed away (V. Memisha).....	219
--	-----